

INSTRUMENTET E KONTROLLIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

MERVETE SHALA

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca juridike, me profil E drejta publike, për marrjen e
Gradës shkencore “Doktor i Shkencave Juridike”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Migena Leskoviku

Numri i fjalëve: 66, 189

Tiranë, 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË

Në përgjegjësin time deklaroj se punimi është punë origjinale e shkruar prej meje, nuk është prezentuar para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar.

Deklaroj se pjesë të veçanta të punimit doktorial janë shfrytëzuar dhe përdorur për botime në revista dhe prezentime në konferenca shkencore, si pjesë e obligimit të studimeve doktoriale. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Abstrakti

Për Kosovën si shtet i ri dhe demokratik që synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian, është qenësore sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qeverisja e mirë. Ky punim trajton mekanizmat e mbikëqyrjes dhe kontrollit të administratës publike në Kosovë, prej periudhës së administrimit ndërkombëtar nga OKB-ja deri në vitin 2017. Hulumtimi është kryer përmes interpretimit të dispozitave kushtetuese dhe kornizës ligjore, duke arritur të identifikojë zbrazëtitrat e legjislacionit të Kosovës dhe nevojës për reformim të kornizës ligjore dhe institucionale. Punimi fokusohet në analizën ligjore krahasuese të instrumenteve të kontrollit të administratës publike të Kosovës si kategori kushtetuese, me instrumente të kontrollit të administratës publike të Republikës së Shqipërisë dhe tre shteteve të ish-Jugosllavisë. Pra, fokusi i studimit dhe analizës është korniza ligjore ekzistuese për instrumentet e kontrollit të administratës publike në Kosovë, a është ajo komplementare me parimet dhe standartet e BE-së, nëse është e plotë, a është e zbatueshme për një qeverisje të mirë, etj.

Në punim janë shtruar disa pyetje kërkimore dhe qëllimi i hulumtimit synon t'i japë përgjigje këtyre pyetjeve: Së pari, a duhet bërë plotësim dhe ndryshim në infrastrukturën ligjore për përmirësimin e qeverisjes së mirë në Kosovë? Së dyti, cilët faktorë ndikojnë në rritjen e efikasitetit të mekanizmave të kontrollit të administratës publike? Së treti, a duhet të krijohet ndonjë mekanizëm i ri për kontrollin e administratës publike— si pjesë e reformës institucionale?

Qëllimi i këtij punimi është të bëjë hulumtim mbi rolin dhe ndikimin e instrumenteve të kontrollit të administratës publike për një qeverisje të mirë. Nga kjo punë kërkimore kemi arritur në përfundimin se pengesë për instrumentet e kontrollit të administratës publike në Kosovë ishin mungesa e kornizës ligjore, zbrazëtitrat ligjore, kompetencat e rezervuara për institucionet ndërkombëtare, kompetencat e kufizuara për institucionet vendore, mungesa e vullnetit politik dhe faktorë të tjerë.

Në punim janë ngritur hipoteza bazë dhe dy nënhipoteza për të mbështetur pyetjet kërkimore. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se, edhe pse ekzistojnë instrumentet e kontrollit të administratës publike në Kosovë, është e nevojshme të krijohet Gjykata

Administrative dhe një Gjykatë Administrative Supreme si institucion i specializuar, i cili do të bëjë kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë së veprimtarisë të administratës publike, gjë që do të krijonte një standard të caktuar të sjelljes së administratës publike.

Në Kosovë ka nevojë për një reformë ligjore dhe institucionale si dhe zbatim në praktikë të legjislacionit, gjë që do të ndikojë në krijimin e një administrate publike të qendrushme, profesionale, efektive, efikase, funksionale, të përgjegjshme, transparente dhe përmirësim të qeverisjes së mirë sipas standarteve të njohura ndërkombëtare dhe europiane.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është e përzier. Ky punim bazohet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave primare dhe sekondare. Si burime primare përmendim: Konventat ndërkombëtare, kushtetuta, ligje dhe akte nënligjore, intervista me zyrtarë të lartë publikë, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile si dhe pyetësor të strukturuar me zyrtarë të lartë publikë. Burime dytësore: literaturë për kontrollin e administratës publike nga autorë vendas e të huaj.

Fjalë kyçe: Parlamenti, Qeveri, Gjykatë Administrative, Gjykatë Kushtetuese, Avokati i Popullit, kontroll, administratë publike, përgjegjshmëri, efikasitet dhe efektivitet, transparencë, llogaridhënie, qeverisje e mirë.

Abstract

For Kosovo as a new and democratic country which aims to affiliate in the European Union, the rule of law, the respect of human rights, fundamental freedom and good governance is essential. This paper treat the mechanisms of supervision and control of public administration in Kosovo, since the International Administration from the UN until 2017. The research was conducted through the interpretation of the constitutional provisions and the legal framework, by identifying the gaps in Kosovo's legislation and the need to reform the legal framework. The research focuses through legal comparative analysis of control instruments for public administration of Kosovo as a constitutional category with the instruments of public administration control of the Republic of Albania and some countries of the former Yugoslavia. Thus, the focus of the study and analysis is the existing legal framework for control instruments of the public administration in

Kosovo, whether it is complementary to the EU standards principles, and if it is complete, is it applicable for good governance.

In the paper, the research questions were made and the purpose of the research is to answer the research questions: Firstly, is there a need to complete and change the legal infrastructure for the improvement of good governance in Kosovo? Secondly, which factors will impact on increasing the efficient of public administration control mechanisms? Thirdly, is there a need for constituting new mechanisms for control of public administration?

The purpose of this paper is to identify the role and impact of instruments for public administration control for good governance. This research was able to find that the obstacles to the instruments of control of public administration in Kosovo were the lack of a legal framework, legal lacks, reserved powers for international institutions, limited competencies for local institutions, lack of the political will and other factors.

In the paper, basic hypotheses and two sub-hypotheses were raised to support the research questions. The research results showed that although there are instruments of control of public administration in Kosovo, it is necessary to establish an Administrative Court and a Supreme Administrative Court, as a specialized institution, which shall carry out judicial control over the legality of the work of all public administration activities, to create a certain standard of public administration behavior.

In Kosovo, there is also a need, for a legal and institutional reform and implementation in practice of legislation that would have an impact on the sustainable, professional, effective, efficient, functional, responsible, and transparent and improvement of the good governance according to Internationally recognized and EU integration.

The methodology used in this paper is mixed as well as this paper is based on the collection and analysis of the primary and secondary data. The primary sources: International Convention, Constitution, Laws and Bylaws, Legal Analysis and Comparison, Interviews with Senior Public Officials, Media and Civil Society and the structured questionnaires with Senior Public Officials. The secondary sources: revision of the literature on public administration control by the national and international author.

Key words: Parliament, Government, Administrative Court, Constitutional Court, Ombudsperson, control, public administration, accountability, efficiency and effectiveness, transparency, accountability, good governance.

DEDIKIMI

Ky punim i dedikohet familjes sime.

FALËNDERIME

Se pari, falënderime të sinqerta dhe mirënjohje për udhëheqësen time Profesor Dr. Migena Leskoviku për këshillat profesionale që më ka dhënë në realizimin sa më të plotë të temës si gjatë procesit të kërkimit ashtu edhe gjatë procesit të finalizimit të saj.

Falënderoj të gjithë profesorët e tjerë të Fakultetit Juridik për sygjerimet dhe këshillat profesionale gjatë ditëve doktoriale.

Falënderoj Zyrtarët e lartë publik për ndihmën me të dhëna empirike si: ish Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Deputet, Minister, Prokuror, Gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtar të Gjykatës së Apelit, Gjyqtar të Gjykatave Themelore, Avokatin e Popullit, Zv.Avokatin e Popullit, Sekretar të Përgjithshme në Ministri, ish Drejtorin e Agjensionit Kundër Korrupsionit, Drejtoret e Departamenteve në Ministri, Këshilltarët politik të Ministrisë të Administratës publike. Ekspertet, ish Drejtorin e TVSH-së, kryeredaktor, gazetar, Drejtor Instituti, shoqëri civile, të cilët pa hezitim u përgjigjën në intervistë dhe në pyetësor për realizimin e këtij punimi.

Falënderoj drejtuesit e Institucioneve të Kosovës për ndihmën me të dhëna empirike dhe qasje në dokumente publike si: Kuvendin e Kosovës, Institucionin e Avokatit të Popullit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Supreme të Kosovës, Ministrin e Administratës Publike dhe Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Një falënderim i veçant për familjen time, prindërit e mi, vëllezërit dhe motren time për mbështetjen, ndihmën e pakursyer në të gjitha nivelet e studimeve edhe në studimet doktoriale.

Mirënjohje!

LISTA E TA

BELAVE OSE DIAGRAMEVE

Tabela:

Tabela 1: Lëndët administrative për vitet 2007-2013 në Gjykatën Supreme

Tabela 2: Paraqet numrin e përgjithshëm të Ankesave të paraqitura nga qytetarët në IAP, Rastet e hapura për hetim, raste të mbyllura prej vitit janar 2010 deri në 17 dhjetor 2017

Tabela 3: Funkcionet e shumëfishta të zyrtarëve të lartë

Tabela 4: Procesi i përgjithshëm i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë

Tabela 5 - Zyrtarë të lartë publikë pjesëmarrës në këtë hulumtim

Tabela 6: Paga për pozitë të njëjtë në Ministri, Institucion dhe Agjensi të Pavarur

Tabela 7: Lëndët e rasteve të hetuara nga Institucioni i Avokatit prej janarit 2010 deri në 17 dhjetor 2017.

Grafiket:

Grafiku1: Interpelancat e mbajtura në Kuvendin e Kosovës në pesë legjislatura

Grafiku 2: Përgjigjet në pyetjet parlamentare në periudhën 2011- 2016

Grafiku 3: Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave nga 2009 deri në dhjetor 2016

Grafiku 4: Lëndët (çështjet) administrative të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura prej Janarit 2013 deri në Dhjetor 2017 në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Grafiku 5: Lëndët administrative të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura për katër vite 2014-2017 në Gjykatën e Apelit në Prishtinë

Grafiku 6: Lëndët administrative të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura për katër vite 2014-2017 në Gjykatën Supreme të Kosovës

Grafiku 7: Zbatimi i Rekomandimeve të Avokatit të Popullit, janar 2012- dhjetor 2016

Grafiku 8: Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale

Grafiku 9: Zbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit, janar 2006-dhjetor 2016

Grafiku 10: Raste të përcjella në organe kompetente si dhe personat e përfshirë prej 1 janarit 2007 deri në 31 dhjetor 2016

Grafiku11: Shkaktarët e shfaqjes së shpërdorimit të detyrës zyrtare, korrupsionit në administratën publike

Grafiku12 - Korniza ligjore për kontrollin e Administratës Publike

Grafiku13: Opinioni i zyrtarëve të lartë publikë mbi legjislacionin për Kontrollin e Administratës Publike në Kosovë

Grafiku14: Opinioni i deputetëve të Kuvendit të Kosovës për mbikqyrjen e punës së Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike

Grafiku15: Përdorimi i instrumenteve të kontrollit parlamentar

Grafiku16: Pyetjet parlamentare për tre Legjislatura

Grafiku17: Opinioni i deputetëve për përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar

Grafiku18: Opinioni i deputetëve për performancën e instrumenteve të tjera të kontrollit të administratës publike

Grafiku 19: Opinioni i Gjyqtarëve për performancën e instrumenteve të tjera të kontrollit të administratës publike

Grafiku 20: Opinioni i nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësve civilë të nivelit drejtues për kontroll dhe mbikëqyrje të punës së administratës shtetërore

Grafiku 21: Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në institucione

Grafiku 22: Vizitat monitoruese të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në institucione

Grafiku 23: Vëzhgimi i procedurës së rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues prej janarit 2010 deri në dhjetor 2016

Grafiku 24: Procedura e vëzhgimit të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues

Grafiku 25: Opinioni i deputetëve për Themelimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme.

Grafiku 26: Opinioni i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për themelimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme

Grafiku 27: Opinioni i zyrtarëve të lartë publikë për krijimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme

Grafiku 28: Opinioni i zyrtarëve të lartë publikë kundër krijimit të Gjykatës Administrative

Grafiku 29: Kërkesa të parashtruara nga personat fizikë dhe personat juridikë në Gjykatën Kushtetuese prej vitit 2010 deri në dhjetor 2016

Grafiku 30: Vendimet e institucioneve gjyqësore dhe insitucioneve shtetërore të kontestuara për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore

Grafiku 31: Numri i kërkesave formale dhe ankesave, si dhe rasteve të zgjidhura pozitivisht

Grafiku 32: Përkatësia etnike e parashtruesve të kërkesave dhe ankuesve prej vitit 2001 deri në 2008

Grafiku 33: Palët përgjegjëse për kërkesa dhe ankesa

Grafiku 34: Ankesat, rastet e mbyllura dhe rastet e mbyllura pozitivisht

Grafiku 35: Zbatimi i Rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Figura

Figura 1: Numri i përgjithshëm i shkeljeve të konstatuara

Figura 2: Totali i ankesave të parashtruara në KPMSHCK prej janarit 2007 deri në dhjetor të vitit 2016.

Figura 3: Totali i vendimeve dhe zbatimi i vendimeve të KPMSHCK nga organet e punësimit

Figura 4: Opinioni i deputeteve për joefikasitet në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve negative në administratën publike

Figura 5: Opinioni i gjyqtarëve për joefikasitet në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve korruptive, shpërdorimit të funksionit zyrtar dhe keqmenaxhimit të fondeve publike në administratën publike.

Figura 6: Të punësuarit në Agjensi të Kuvendit, Qeverisë dhe Ministrive (përfshirë Zyrën e Kryeministrit, por pa llogaritur Policinë e Kosovës).

Figura 7: Opinioni i gjyqtarëve për Departamentin për Çështje Administrative

Figura 8- Opinioni i gjyqtarëve për krijimin e Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatat Themelore

Figura 9: Opinioni i gjyqtarëve të Gjykatave Themelore për krijimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme

Figura: 10- Tregon opinionet e gjyqtarëve për ndërhyrje politike në punën e gjyqësorit

Figura 11: Opinioni i deputetëve për masat të cilat duhet të ndërmerren për qeverisje të mirë.

Figura 12: Tregon opinionin e gjyqtarëve për masat që duhet të ndërmerren për qeverisje të mirë.

LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORIT

AAK - Aleanca e Ardhmërisë së Kosovës

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

AKP - Agjencia Kosovare e Privatizimit

AKR - Aleanca për Kosovën e Re

AOIP - Agjensionet, Organizatat dhe Institucionet e Pavarura

AP- Administratë Publike

ASH - Administratë Shtetërore

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BE -Bashkimi Evropian

DMP - Divizioni për mbikëqyrjen e pasurisë

EULEX-i - Misioni i Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje i vendosur në Kosovë nga Bashkimi Evropian (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë)

EUSR- Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian në Kosovë

GAP -Instituti për Studime të Avancuara

GJA - Gjykata e Apelit

GJED - Gjykata Evropiane e Drejtësisë

GJK - Gjykatë Kushtetuese

GJS – Gjykata Supreme

GJTH - Gjykata Themelore

IAL - Institucionet e Administratës Lokale

IAP - Institucioni i Avokatit të Popullit

IAQ -Institucionet e Administratës Qendrore

IGJK -Instituti Gjyqësor i Kosovës

IKAP - Instituti i Kosovës për Administratë Publike

IPOL -Instituti Ballkanik i Politikave

IPVQ - Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
IVQPK - Institucionet Vetëqeverisjes të Përkohshme në Kosovë
KBF - Komisioni për Bugjet dhe Financa
KBFP - Kontrolli i brendshëm financiar publik
KDI - Instituti Demokratik i Kosovës
KE - Këshilli i Evropës
KFOR - Prania Ndërkombëtare të Sigurimit (KFOR)
KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK - Kuvendi i Kosovës
KKIE - Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian i Republikës së Kosovës
KKVQPK - Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë
KMDLNJ - Këshilli për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut
KPASH - Kodi i procedurës Administrative të Shqipërisë
KPJ - Klubi për Politikë të Jashtme
KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPMShCK - Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Sherbimin Civil të Kosovës
KPPK - Kodi i Procedurës Penale në Kosovë
KSK - Këshilli i Sigurisë së Kosovës
KSKB - Këshilli i Sigurimit i Kombëve të Bashkuara
LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës
LPAK - Ligji për procedurën administrative të Kosovës
LPPA- Ligji për procedurën e përgjithshme administrative të Kosovës
LVV - Levizja Vetëvendosje
MAP -Ministria e Administratës Publike
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKP- Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese
MTPT - Ministria e Transportit Postës dhe Telekomunikacionit
OJQ - Organizatë Joqeveritar
OJF- Organizatë Jofitimprurëse

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE -Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë
PDK - Partia Demokratike e Kosovës
PSBE - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
PSRK-ja - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSSP - Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
PUN-ja - Prania ushtarake ndërkombëtare
PVRAP - Plani i Veprimit për Reformën e Administratës Publike
QKSS -Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
RFJ - Republika Federative e Jugosllavisë
TBE- Traktati i Bashkimit Evropian
UNDP - Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNMIK -Misioni Ndërkombëtar i Organizatës të Kombeve të Bashkuara
ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZCN -Zyra Civile Ndërkombëtare
ZKM - Zyra e Kryeministrit të Kosovës
ZSHA - Zyra Shtetërore e Auditimit

PËRMBAJTJA E LËNDËS

DEKLARATA E AUTORËSISË	II
Abstrakti	III
DEDIKIMI.....	VII
FALËNDERIME.....	VIII
LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE	IX
LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORIT.....	XIII
PËRMBAJTJA E LËNDËS	XVI
KAPITULLI I: HYRJE.....	1
1.1. Parathënie	1
1.2. Struktura e punimit.....	9
1.3. Qëllimi dhe objektivat e punimit	11
1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza	13
1.5. Metodologjia e kërkimit	14
1.5.1. Burimet e studimit.....	15
1.6. Pritshmëritë dhe kufizimet e punimit	16
KAPITULLI II. PARIMI I QEVERISJES SË MIRË NË ADMINISTRATËN PUBLIKE .	18
2.1. Kuptimi i qeverisjes së mirë në administratën publike.....	18
2.2. Parimet e qeverisjes së mirë në administratën publike	22
2.3. Praktikrat e mira të qeverisjes së mirë në administratën publike	29
2.4. Qeverisja e mirë dhe reforma e administratës publike	33
KAPITULLI III. INSTRUMENTET E KONTROLLIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË KOSOVË.....	43

3.1. Kuptimi dhe objekti i kontrollit të administratës publike	44
3.2. Historiku i themelimit të instrumenteve të kontrollit të administratës publike në Kosovë.....	48
3.3. Mekanizmat institucionale për kontrollin e administratës publike në Kosovë.....	51
3.3.1. Kontrolli politik i administratës publike.....	53
3.3.1.1. Instrumentet e kontrollit parlamentar në Kosovë.....	55
3.3.1.1.a. Interpelancat parlamentare.....	57
3.3.1.1.b. Mocioni i votëbesimit dhe shkarkimi i qeverisë.....	61
3.3.1.1.c. Pyetjet parlamentare.....	63
3.3.1.1.ç. Miratimi i buxhetit dhe raportet periodike.....	66
3.3.1.1.d. Raportet periodike.....	68
3.3.1.1.dh. Komisioni hetimor, mjet kontrolli për punën e Qeverisë.....	70
3.4. Kontrolli administrativ i administratës publike	74
3.4.1. Mbikëqyrja e organeve të pavarura të administratës shtetërore dhe administratës së pushtetit lokal.....	78
3.5. Kontrolli gjyqësor i administratës publike.....	87
3.5.1. Kontrolli i administratës publike nga ana e prokurorisë.....	99
3.6. Gjykata Kushtetuese në kontrollin e administratës publike.....	103
3.7. Kontrolli i administratës publike nga Avokati i Popullit.....	114
3.8. Kontrolli i administratës publike nga Auditori i Përgjithshëm.....	124
3.9. Institucionet dhe Agjensitë në kuadër të Kuvendit të Kosovës.....	128
3.9.1. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.....	129
3.9.2. Agjencia Kundër Korrupsionit	135
KAPITULLI IV: INSTRUMENTET E KONTROLLIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË DISA SHTETE TË RAJONIT - ANALIZË KRAHASUESE	144
4.1. Kontrolli i administratës publike nga organi ligjvënës në shtetet e rajonit	144
4.2. Kontrolli administrativ i administratës publike në shtetet e rajonit.....	147
4.3. Kontrolli gjyqësor i administratës publike në shtetet e rajonit.....	154

4.4. Gjykata Kushtetuese në kontrollin e administratës publike në shtetet e rajonit	161
4.5. Kontrolli i administratës publike nga Avokati i Popullit në shtetet e rajonit	169
4.6. Kontrolli i administratës publike nga Institucioni i Lartë i Auditimit në shtetet e rajonit	177
KAPITULLI V. ANALIZË E TË DHËNAVE EMPIRIKE	184
5.1. Instrumentet e kontrollit të administratës publike në Kosovë – trajtim analitik	187
5.2.. Përbushja e detyrave dhe përgjegjësive të Kuvendit në kontrollin e administratës publike	190
5.3. Kontrolli i punës së administratës shtetërore përmes mbikëqyrjes administrative-trajtim analitik	197
5.4. Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil në institucionet qendrore dhe lokale - analizë e tyre	200
5.5. Kontrolli gjyqësor si kontroll i jashtëm i administratës publike– qasje analitike	208
5.6. Ndikimi i kontrollit kushtetues në administratën publike– qasje analitike	216
5.7. Kontrolli i administratës publike nga Avokati i Popullit – trajtim analitik	219
5.8. Krijimi i institucioneve të reja për kontrollin e administratës publike.....	228
5.9. Kontrolli i administratës publike, faktor për një qeverisje të mirë në Kosovë	232
KAPITULLI VI: KONKLUSIONE.....	236
LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA	252

KAPITULLI I: HYRJE

1.1. Parathënie

“If men were angels, no government would be necessary.

If angels were to govern men,
neither external nor internal controls on government would be necessary”

Xhejms Medison (1751-1836).¹

Kosova është një shtet i ri demokratik më transformime të thella shoqërore e politike si rezultat i ndryshimeve politike, ekonomike dhe proceseve të tjera. Ky tranzicion e ka shtyrë Qeverinë dhe institucionet e tjera, për të gjetur mënyra, rrugë të reja për një qeverisje më të qendrueshme, qeverisje në funksion dhe shërbim të qytetarit dhe biznesit të vendit.

Në përgjithësi, qytetarët dhe publiku presin prej administratës publike të respektojë dhe realizojë pesë grupe vlerash themelore: politike, ligjore, sociale, ekonomike dhe ekologjike. Orientimi i vlerave dominuese ka ndryshuar gjatë periudhës bashkëkohore, nga politike (demokratike) dhe ligjore në sociale, ekonomike dhe ekologjike. Pra, vlerat janë të shumta dhe të ndryshme, ato janë më shumë se pika të integruara, në një sistem qeverisës [Koprić, 2011:6]. Neni 2 i Traktatit të Bashkimit Evropian parashikon “vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën sundon pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave” [TBE neni 2].

¹ James Madison “The Federalist No. 51” The Structure of the Government Must Furnish the Proper Checks and Balances Between the Different Departments Independent Journal Wednesday, February 6, 1788 shih: <http://www.constitution.org/fed/federa51.htm> (qasur 10.5.2018)

Traktati parashikon vlerat themelore të Bashkimit Evropian [Klaus-Diter Borçard, 2010:19]. Prandaj, këtyre vlerave themelore duhet t'i përmbahet edhe shteti i Kosovës, për integrimin sa më të shpejtë të tij në Bashkimin Evropian.

Në shumicën e rasteve, qeverisja si në shtete të zhvilluara ashtu dhe në shtete në zhvillim është e strukturuar në mënyrë që të sigurojë ndarje ligjore dhe praktike të kompetencave të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Një ndarje e tillë është vendosur qëllimisht për të lejuar kontrolle dhe balanca mes degëve të qeverisjes. Nocioni i përgjegjësisë është i lidhur ngushtë me konceptin e demokracisë [Gedeon M. Mudacumura & Göktug-Morçöl, 2014:3].

Sipas Abraham Linkolnit “demokracia është një formë qeverisje që del nga populli e që ushtrohet nga populli, në interesin e tij më të mire” [Schmidt, 2012:19]. Sipas Montesksesë “gjithë populli s’ka mundësi materialisht të jetë ligjvënës, prandaj duhet t’ia delegojë mundësinë e nxjerrjes së ligjeve atij që e përfaqëson”². Ishte ai (Monteskje) që krijoi idetë mbi demokracinë, të cilat ende janë karakteristikë e demokracive moderne, dhe përhapi idenë për ndarjen e pushtetit [Sadiku, 2013:27]. Për të mos mundur të abuzohet me pushtetin, duhet që me anë të rregullimeve përkatëse, një pushtet duhet të kufizojë pushtetin tjetër. Prandaj, sa herë që njeriu përpiket të krijojë një mekanizëm mbrojtës ndaj pushtetit abuziv, një tjetër, ose ai vetë kur hipën në pushtet, rreket të gjejë një mjet tjetër për të shmangur këtë pengesë [Duhamel, 1993:37]. Qëllimi kryesor i ndarjes së pushteteve, konceptuar si nga Monteskje ashtu dhe Madison, ishte se kjo do të parandalonte tiraninë dhe do të mbronte lirinë [Aziri & Saliaj, 2012:85].

Sipas Rusoit, “nuk është mirë që, ai që bën ligjet, edhe t’i ekzekutojë ato, as që trupi i popullit ta shmangë vëmendjen nga problemet e përgjithshme dhe ta drejtojë atë në objekte të veçanta” [Ruso, 1998:94]. Sipas Locke, “do të provokonim një tentativë shumë të fortë për brishtësinë e njeriut, si subjekt i ambicies, në rast se do t’u besonim atyre që kanë pushtetin e të bërit ligje, edhe pushtetin e ekzekutimit të tyre” [Berberi, 2014:15]. Në kontestin historik, Xhon Loku njihet “si ndër të parët që e

²Ouari, Luan. “Sistemi parlamentar Lindja dhe evolucioni i parlamentarizmit Parlamenti në Shqipëri” (vështrim historiko-juridik) botimi i katërt, Elena Gjika, Tiranë, fq.71.

trajton shkencërisht teorinë mbi ndarjen e pushtetit, me kufizimin e qeverisjes absolute të monarkut dhe që, në të njëjtën kohë, është nismëtar i ideve për shtetin ligjor” [Abdullai & Mehmeti, 2008:42].

Në Kosovë, me Rregulloren për Autorizimet e Administratës së Përkohshme Nr.1999/1, e miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), e cila ka pasur fuqinë e ligjit, në Nenin një (1) përcaktohet se pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë, duke përfshirë dhe administrimin e organeve të drejtësisë, është kompetencë e UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm apo Kryeadministratori. Kryeadministratori kishte përgjegjësi të emëronte dhe shkarkonte çilindo person që kryente funksione në administratën civile në Kosovë, duke përfshirë edhe ato të sektorit të drejtësisë (prokuror dhe gjyqtar) [Rregullore Nr.1999/1, UNMIK/Rreg/1999/1, neni 1 dhe neni 2]. Korniza ligjore e miratur nga institucionet ndërkombëtare është konsideruar si burimi kryesor i së drejtës, me fuqinë më të lartë në Kosovë, për formimin dhe funksionimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ). Në mungesë të Kushtetutës, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) ka nxjerrë një rregullore (Kornizën Kushtetuese), dhe në bazë të dispozitave të saj janë themeluar Institucionet, është përcaktuar mandati i tyre, raporti mes tyre, si dhe fuqia absolute e Kryeadministratorit (PSSP) dhe bartja e përgjegjësisë tek vendorët. Në kuadër të Rregullores 2001/9 të UNMIK-ut, ose Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, në Kreun e parë, paragrafi një (1), nën-paragrafi 1.4, përcaktohej shprehimisht se: “Kosova do të qeveriset në mënyrë demokratike, nëpërmjet organeve dhe institucioneve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore, në pajtim me këtë Kornizë Kushtetuese dhe Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara”.

Paragrafi një (1), nën-paragrafi 1.5 i Kornizës përcaktonte se Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes janë: Kuvendi, Kryetari i Kosovës, Qeveria, Gjykatat dhe Organet e institucioneve të tjera të parashtruara në këtë Kornizë Kushtetuese (Kreu i parë, paragrafi një(1), nën-paragrafi 1.5). Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe zyrtarët e tyre duhet të promovojnë dhe respektojnë parimin e

ndarjes së pushteteve mes atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (Kreu i dytë, paragrafi i tretë). Ndërsa, Kreu i tetë përcaktonte disa kompetenca dhe përgjegjësi të rezervuara, të cilat mbeteshin eskuzivisht në duart e PSSP-së [Rregullore 2001/9 e UNMIK-ut, për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohëshme në Kosovë, Kreu i parë, i dytë dhe i tetë.]. Sipas Prof. Arsim Bajramit “Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohëshme në Kosovë ishte bazë për themelimin e institucioneve të Kosovës, e cila parashikoi bartjen e përgjegjësive hap pas hapi në institucionet e Kosovës, standardet e promovuara për Kosovën për përmbushjen shpejt dhe sa më mirë, si dhe bartjen e përgjegjësive nga administrata ndërkombëtare në Institucionet e Kosovës” [Bajrami, 2004:6].

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon se Kosova është Republikë demokratike, e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit mes tyre. Sipas nenit 4 të Kushtetutës, ndarja e pushtetit bëhet në këtë mënyrë:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Republika e Kosovës ka institucionet e vetapër mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës” [Kushtetuta neni 4].

Sipas Profesor Arsim Bajramit “kjo mënyrë e ndarjes së pushteteve, ka përjashtuar nga kjo ndarje Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese, të cilat nuk janë pjesë e ndarjes së pushteteve, por më shumë janë mekanizma të balancimit mes këtyre pushteteve. Sa i përket kontrollit të pushteteve, Kushtetuta e Republikës së Kosovës është mjaft fleksibël në këtë drejtim, për arsye se nuk përcakton ndonjë mekanizëm strikt të kontrollit reciprok të të tri pushteteve, përveçse kur është fjala për kontrollin parlamentar të qeverisë. Në lidhje me kontrollin e pushteteve, Kushtetuta më shumë përdor mekanizmat e jashtëm, siç janë: Institucioni i Presidentit dhe ai i Gjykatës Kushtetuese” [Bajrami, 2012:155]. Megjithëse, një autor tjetër, Sokol Berberi thekson se “Gjykatat Kushtetuese kanë

marrë një rol më aktiv kur shqyrtojnë legjislacionin kundrejt Kushtetutës. Ky rol në rritje e gjykatave në politikën legjislative ka çuar studiues të ndryshëm të flasin për një qeverisje të gjyqësorit ose për gjyqësorizimin e politikës” [Berberi, 2014:153]. Sa më i pranishëm të jetë kontrolli dhe balanca, aq më funksionale është ndarja e pushteteve [Aziri & Saliaj, 2012:95-96].

Në vitet e fundit, Kosova ka bërë përpjekje legjislative dhe institucionale për të pasur korniza ligjore të përgjithshme dhe të specializuara për kontrollin, inspektimin dhe auditimin e aktiviteteve publike (administrative, gjyqësore, financiare, policore, doganore, tatimore, inspektoriate të ndryshme dhe organe të tjera monitoruese dhe mbikëqyrëse).³

Për të siguruar ligjshmëri, përgjegjësi dhe cilësi në punën e organeve të administratës publike dhe të shërbimeve publike, është i domosdoshëm kontrolli mbi këto organe. Sipas Profesorëve Pollozhani, Dobjani, Stavileci dhe Salihu “kontrolli mbi administratën paraqet një veprimtari të vazhdueshme të mbikëqyrjes, që subjektet juridikisht të autorizuara e kryejnë lidhur me sjelljen e administratës, të mënyrës së përdorimit të autorizimeve të saj dhe të akteve, përkatësisht të masave që dalin nga përdorimi i autorizimeve shtetërore, përkatësisht publike si kontrolli i ligjshmërisë dhe kontrolli i përshtatshmërisë” [Pollozhani, Dobjani, Stavileci & Salihu, 2010: 183]. Sipas E. Methasanit “kontrolli i administratës publike dhe ushtrimi me efikasitet të këtij kontrolli janë më të nevojshëm e të domosdoshëm. Kështu, do të mund të sigurohej një respektim maksimal i të drejtave dhe lirive themelore, do të mund të vihej në jetë dhe koncepti i pranuar nga Kushtetuta, lidhur me kufijtë e veprimtarisë së shtetit, që përcaktohen nga e drejta dhe do të realizohej koncepti me ndarjen dhe balancimin e pushteteve”. [Eralda (Methasani) Cani, 2010:161].

Sipas Profesor Ermir Dobjanit “qëllimi i ushtrimit të kontrollit shtetëror dhe i marrjes së masave për sigurimin e ligjshmërisë, në radhë të parë ka për qëllim të vihet në vend ligji i shkelur dhe së dyti, të saktësohet përgjegjësia e organeve ose e

³ Këshilli i Evropës, Prill 2015, Raporti i vlerësimit mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit (LKK), Cikli 1, faqe 74. Shih: <http://www.akk-ks.org/repository/docs/AC%20ALB%20WEB.pdf>

punonjësve të aparatit publik që kanë shkelur apo kanë lejuar shkeljen e ligjit” [Dobjani, 2004:195].

Sipas Profesor Stavileci “me kontrollin parlamentar veçanërisht pretendohet:

- a) sigurimi i funksionimit të rregullt dhe të mirë të administratës;
- b) garantimi i ligjshmërisë dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve, dhe
- c) ushtrimi i mbikëqyrjes së përgjithshme mbi veprimtarinë administrative”

[Stavileci, 1997:124].

Profesor Arsim Bajrami thekson se “kontrolli parlamentar i qeverisë është një proces politiko-juridik, që siguron një mbikëqyrje të vazhdueshme politike të qeverisë nga Parlamenti” [Bajrami,2010:110]. Problemi i mbikëqyrjes dhe kontrollit në Kosovë qëndron se Kuvendi i Kosovës ka themeluar më shumë se 30 institucione dhe agjenci të pavarura, rregullatore dhe ekzekutive, ndërsa Qeveria ka themeluar 46 organe qendrore si pjesë e ministrive të linjës. Ky fakt e ka zvogëluar apo ulur rëndësinë e ndarjes së pushteteve në Kosovë, mes Kuvendit si organ legjislativ dhe Qeverisë si organ ekzekutiv dhe ka bërë që të mos ketë një mbikëqyrje apo kontroll adekuat mbi performancën e këtyre trupave [MAP, 2016:7].

Kontrolli i brendshëm sipas E. Stavileci “ushtrohet nga kontrolli i organeve të larta ndaj organeve të ulëta të administratës publike, ushtrohet si kontroll institucional dhe si kontroll hierarkik” [Stavileci, 2010:100]. Të gjithë personat që marrin përsipër detyra publike ose mbajnë funksione publike në Kosovë, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, duhet t’i respektojnë standardet e pranuar ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të mos diskriminojnë asnjë person [Rregullore Nr.1999/1, UNMIK/Rreg/1999/1, neni 2].

Sipas Professore Methasanit “kontrolli i veprimtarisë administrative është një ndër shprehjet e të drejtave themelore të njeriut, por edhe një nevojë realiste për t’i adresuar abuzimet e mundshme që mund të bëhen me veprimtarinë administrative” [(Methasani) Cani, 2010:149]. Pra, mbikëqyrja është e nevojshme për ta bërë administratën publike të përgjegjshme, për të siguruar që trupat administrative përdorin fuqitë e tyre sipas ligjit dhe ndjekin procedurat e vendosura. Institucionet

dhe mekanizmat e mbikëqyrjes monitorojnë dhe vëzhgojnë veprimet e zyrtarëve publikë [SIGMA, 2001,Nr.27, fq.12].

Sipas Profesore Migena Leskoviku “konceptimi i administratës publike si një administratë e përgjegjshme dhe e besueshme për qytetarët, konsiderohet si një nga qëllimet e qeverisjes demokratike.Ndryshimet dhe përmirësimi i politikave publike kërkon edhe ndryshime në rikonceptimin e administratës publike në shoqëri dhe reformimin e saj.Në vitet e fundit, sektori publik gjithnjë e më tepër po shihet në dinamikën e tij, në forcimin e partneritetit me sektorin privat dhe shoqërinë civile, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, rritjes së përgjegjësiwe sociale dhe garantimit të pjesëmarrjes së gjerë të qytetarëve në vendimarrje, dhe dhënies së mendimit të tyre për performancën e shërbimeve publike që ofrohen” [Leskoviku, 2014: 41].

Qëllimet e mbikëqyrjes janë që të vlerësojë nëse organizmat publikë i kryejnë funksionet e tyre me efektivitet, në mënyrë eficiente dhe në kohë, dhe i përmbahen parimeve dhe procedurave të vendosura nga rregulla specifike ose të përgjithshme.Me fjalë të tjera, mbikëqyrja synon të sigurojë parimin administrativ “administrim nëpërmjet ligjit”, sepse është thelbësore për të mbrojtur si interesat publike ashtu edhe të drejtat e individëve. Këto institucione dhe mekanizma mbikëqyrës mund të marrin forma të ndryshme, si: gjykata, prokurori, Avokat i Popullit, kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm, inspektoriate, autoritete të vendosjes së standardeve, komisione parlamentare, media, etj.[SIGMA, 2001/1, Nr.27, fq.12].

Një shtet i së drejtës nënkupton kapacitetin e qytetarëve për t’ia nënshtruar veprimet administrative kontrollit gjyqësor, si një instrument i domosdoshëm për të rritur cilësinë e veprimtarisë administrative dhe për të siguruar një qeverisje të mirë [Woehrling Jean-Marie, 2006:36]. Të gjitha vendet evropiane kanë pranuar tashmë këtë ide themelore, që ka rezultuar në një përforcim të rolit të gjykatave në kontrollin e administratës në të gjithë Evropën [SIGMA,2005:1].

Sundimi i ligjit nuk është vetëm një garanci për qytetarin, ajo është gjithashtu një udhëzues i mirë për punën racionale,të drejtë dhe efikase të organeve administrative.Efektiviteti i një shqyrtimi nga gjykatat e pavarura angazhon

nëpunësit publikë për të marrë vendime mbi baza ligjore që mund të justifikohen para gjyqtarëve [SIGMA, Jean-Marie Woehrling, 2005:10]. Prandaj, të gjithë këto mekanizma dhe institucione synojnë të forcojnë në mënyrë efektive veprimin e ligjit, transparencën, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin si parime kryesore në administratën publike dhe shërbimin civil. Me fjalë të tjera, ato synojnë të mbrojnë të drejtat individuale si dhe interesin publik, të përmirësojnë cilësinë në vendimarrje dhe në fund, të përmirësojnë besueshmërinë, sigurinë ligjore dhe legjitimitetin e administratës publike. Asnjë organ apo institucion tjetër bashkëkohor nuk ka qasur shumë mënyra të ndryshme mbikëqyrje dhe kontrolli si administrata publike [SIGMA, 2001/1, Nr.27, fq.13].

Konrolli i administratës publike ndikon në qeverisjen e mirë dhe disa autorë e konceptojnë qeverisjen si një forcë pozitive për të nxitur rritjen ekonomike. Kështu Fukuyama (2013) e sheh qeverisjen si aftësinë e Qeverisë për të bërë dhe për të zbatuar rregullat dhe për të ofruar shërbime, pavarësisht nëse qeverisja është demokratike apo jo (McCawley 1993). Qeverisja e mirë po bëhet gjithnjë e më e zakonshme si një element kyç i zhvillimit. Në fakt, suksesi i zhvillimit është i varur nga një qeverisje e mirë, e cila shpesh barazohet me qeverisjen demokratike [Gedeon M. Mudacumura, 2014:2]. Reformat e qeverisjes janë shpesh të ndërlidhura, për shembull, më menaxhim të mirë të shpenzimeve publike dhe përpjekjet për të luftuar korrupsionin, për një administratë publike më shumë profesionale dhe më tepër decentralizim [Merilee S. Grindle & Edward S. Mason, 2002:6].

Pra, si koncept, qeverisja e mirë në dekadat e fundit po gjen përdorim në administratën publike, shkenca politike dhe menaxhimin publik. Si komponentë thelbësorë të qeverisjes së mirë, Leftwich (1993) vëren disa karakteristika: shërbim të mjaftueshëm publik, sistem të pavarur gjyqësor dhe zbatim të kuadrit ligjor, administrim të përgjegjshëm të fondeve publike, auditim i pavarur publik, legjislativë përfaqësuese e të përgjegjshme, respektimin e ligjit dhe të drejtave të njeriut në të gjitha nivelet e qeverisjes, një strukturë pluraliste institucionale dhe një media të lire [Gedeon M. Mudacumura, 2014:2]. Për të nxitur qeverisjen e mirë dhe për të siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile, institucionet, organet, zyrat dhe

agjencitë duhet të kryejnë punën e tyre në mënyrë sa më të hapur [Traktati për funksionimin e Bashkimit Europian, neni 15].

1.2. Struktura e punimit

Ky punim është i organizuar në gjashtë kapituj, të cilët marrin në analizë çështjen e instrumenteve të kontrollit të administratës publike në Republikën e Kosovës, në aspekt krahasimor me vendet e rajonit.

Kapitulli i parë, është hyrja që paraqet një përmbledhje të të gjitha aspekteve bazë, qëllimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezën, metodat kërkimore të përdorura, pritshmëritë dhe kufizimet e hasura gjatë hulumtimit.

Në Kapitullin e dytë, trajtohet parimi i qeverisjes së mirë në administratën publike, me theks të veçantë parimet e qeverisjes së mirë. Po kështu, trajtohen praktikat e mira të qeverisjes së mirë në administratën publike. Në vijim të këtij kapitulli, trajtohet edhe roli i Kuvendit për një qeverisje të mirë, reforma e administratës publike si faktor për qeverisje të mirë. Ky punim trajton qeverisjen e mirë në administratën publike, sepse qëllimi i kontrollit është sigurimi i ligjshmërisë dhe rritja e cilësisë së veprimtarisë të administratës publike.

Kapitulli i tretë, fokusohet tek instrumentet e kontrollit të administratës publike në Kosovë dhe është kapitulli bazë i punimit. Pra, këtu analizohet historiku i krijimit, organizimi dhe funksionimi i instrumenteve të kontrollit ndaj administratës publike, vlerësimi i këtyre mekanizmave si dhe sfidat në këtë drejtim. Në këtë kapitull shtjellohen mekanizmat për kontrollin e administratës publike në Republikën e Kosovës të cilat, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontroll mbi administratën publike (kontrolli i brendshëm dhe kontrolli i jashtëm). Në këtë kapitull bëhet një analizë e kornizës ligjore të instrumenteve të kontrollit të administratës publike nën Administrimin e Përkohshëm të UNMIK-ut dhe pas pavarësisë, që rregullon themelimin dhe funksionimin e instrumenteve të kontrollit të administratës publike. Një rëndësi e posaçme i kushtohet kontrollit politik të administratës publike, kontrolli parlamentar mbi veprimtarinë e ekzekutivit në procesin e emërimit dhe shkarkimit të ekzekutivit, përgjegjësia politike dhe kontrolli

ndaj Institucioneve dhe Agjensive të Pavarura në varësi të Kuvendit. Po ashtu, trajtohet kontrolli i brendshëm administrativ, si dhe kontrolli gjyqësor i veprimtarisë së administratës publike, si instrument i cili ndikon në rritjen e cilësisë së veprimtarisë së administratës publike dhe qeverisjes së mirë. Gjithashtu, trajtohet kontrolli kushtetues mbi veprimtarinë administrative, Avokati i Popullit si një institucion i pavarur kushtetues që mbron, mbikëqyr dhe promovon respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga institucionet e administratës publike në Kosovë.

Gjithashtu, trajtohet roli i Auditorit të Përgjithshëm si mekanizëm që kontrollon përdorimin e fondeve publike nga administrata publike, ndikimi i tij për një menaxhim më të mirë financiar dhe rritjen e llogaridhënies publike; Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si institucion i pavarur kushtetues për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, roli i Agjencisë Kundër Korrupsionit në kontrollin e administratës publike si mekanizëm që mbikëqyr dhe monitoron administratën publike nga format abuzive, siç janë: korrupsioni, mitmarrja, nepotizimi dhe konflikti i interesit etj.

Në Kapitullin e katërt, trajtohen instrumentet e kontrollit të administratës publike të shteteve të rajonit, ku analizohen në formë krahasimore disa shtete të rajonit, si: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia, vende të cilët kanë disa karakteristika të përbashkëta, ashtu siç kanë edhe specifikat e tyre të veçanta kur flitet për procedurën e emërimit dhe shkarkimit, mandatin dhe kompetencat që kanë këto instrumente të kontrollit të administratës publike.

Kapitulli i pestë, merr në analizë rezultatet e nxjerra nga terreni, ku në këtë pjesë të punimit empirik shqyrtohen rezultatet e dala nga intervistat e zhvilluara me zyrtarë të lartë publikë, me përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile.

Kapitulli i gjashtë, përmban përfundimet dhe sugjerimet e temës së doktoraturës.

Gjithashtu, punimi shoqërohet me listën e plotë të literaturës së shfrytëzuar, që për lehtësi identifikimi, paraqitet e kategorizuar sipas llojit të burimit të referuar.

1.3. Qëllimi dhe objektivat e punimit

Synimi i të gjitha shteteve është të kenë një administratë publike funksionale, efikase, efektive, të përgjegjshme, profesionale, llogaridhënëse dhe transparente, të kenë një qeverisje të mirë dhe prosperitet në vend.

Punimi fokusohet në njohjen e instrumenteve të kontrollit të administratës publike në Kosovë dhe efektivitetin e tyre praktik për garantimin e një qeverisje të mirë në Kosovë. Ky punim trajton instrumentet e kontrollit të administratës publike në Kosovë prej periudhës së administrimit ndërkombëtar nga OKB-ja deri në vitin 2017.

Qëllimi i studimit është të hulumtojë situatën aktuale të instrumenteve të kontrollit të administratës publike, vlerësimin e këtyre mekanizmave të kontrollit të administratës publike dhe në të njëjtën kohë sfidat me të cilat ballafaqohen vendet e rajonit. Kjo synohet të realizohet përmes analizës së efikasitetit të mekanizmave të kontrollit të administratës publike, përmes akteve juridike dhe veprimtarisë së këtyre instrumenteve të kontrollit.

Hulumtimi ka për qëllim të shtjellojë rolin dhe ndikimin e instrumenteve të kontrollit të administratës publike për qeverisje të mire, kontrollin e administratës publike si faktor esencial për funksionimin e një administrate publike të qendrueshme, profesionale, efikase, funksionale, të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, për një qeverisje të mirë në Kosovë.

Në fokus është edhe krahasimi i mekanizmave të kontrollit të administratës publike të Kosovës me sisteme të kontrollit të administratës publike në disa shtete të rajonit, me qëllim nxjerrjen në pah të veçorive të sistemeve të brendshme të këtyre shteteve në raport me Kosovën. Ndër rezultatet e dala nga trajtimi në këtë punim përmendim:

- roli i instrumenteve të kontrollit të administratës publike;
- identifikimi i masave të cilat duhet të ndërmerren për qeverisje të mirë në Kosovë;

- nevoja për reformë ligjore dhe reformë të institucioneve të administratës publike në të ardhmen, si në nivelin vertikal ashtu edhe në atë horizontal;
- nevoja për ngritjen e mekanizmave të rinj për kontrollin e administratës publike, për garantimin e një qeverisje të mirë.

Nëpërmjet këtij punimi së pari, synohet të jepet një kontribut në literaturë mbi instrumentet e kontrollit të administratës publike dhe rolin e këtyre mekanizmave të kontrollit të administratës publike, për garantimin e një qeverisje të mirë në Kosovë. Në vendet e zhvilluara, ekziston një literaturë e gjerë në lidhje me instrumentet dhe format e kontrollit të administratës publike, ndërsa në Kosovë kjo është një fushë studimi pak e eksploruar. Mungesa e literaturës në Kosovë për instrumentet e Kontrollit të administratës publike përbën edhe një nga kufizimet për realizimin e punimit.

Së dyti, ky punim ka për qëllim të japë një kontribut modest për çështjet që janë të diskutueshme në opinionin akademik dhe atë politik që kanë të bëjnë me kontrollin e administratës publike, pavarësinë e mekanizmave të kontrollit mbi administratën, përcaktimin e mbikëqyrjes dhe raportimit të Institucioneve dhe Agjensive të Pavarura në varësi të Kuvendit dhe Qeverisë.

Së treti, punimi synon të ndihmojë në zgjerimin e njohurive për faktorët kryesorë të cilët ndikojnë në funksionimin e një administrate publike të qendrueshme, profesionale, të përgjegjshme, efikase, efektive, transparente dhe llogaridhënëse për garantimin e qeverisjes së mirë në Kosovë.

Së katërti, ky punim ka për qëllim të pasqyrojë një sërë masash të cilat del si domosdoshmëri të ndërmerren për një qeverisje të mirë në Kosovë. Ky punim ka rëndësi praktike, duke qenë se vlerësimet empirike të tij mbi instrumentet e kontrollit të administratës publike mund të merren në konsideratë gjatë hartimit të reformës ligjore dhe institucionale dhe përcaktimit të masave për përmirësimin e zbatimit në praktikë të legjislacionit në Kosovë.

Së pesti, punimi mund të shërbejë si referencë për studime më të thelluara për instrumentet e kontrollit të administratës publike, për të inkurajuar studiuesit për të

pasuruar më tej literaturën për kontrollin e administratës publike, duke dhënë një kontribut individual në sferën e botimeve akademike dhe të kërkimit shkencor.

1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza

Ky studim ka për qëllim dhënien e përgjigjeve të këtyre pyetjeve kërkimore:

- A është e nevojshme reforma ligjore për përmirësimin e qeverisjes së mirë në Kosovë?
- Cilët faktorë ndikojnë në rritjen e efikasitetit të mekanizmave të kontrollit të administratës publike?
- Në cilat aspekte të tjera duhet të fokusohen reformat e ardhshme institucionale për kontrollin dhe mbikëqyrjen e administratës publike?
- A është e nevojshme të krijohet ndonjë mekanizëm i ri për kontrollin e administratës publike?
- Sa janë përdorur instrumentet e kontrollit parlamentar në Kosovë? Sa ishin funksionale instrumentat e kontrollit të administratës publike në Kosovë në periudhën 1999-2008 dhe pas shpalljes së pavarësisë?
- Si mund të parandalohet dhe luftohet korrupsioni, shpërdorimi i detyrës zyrtare, keqpërdorimi dhe keqmenaxhimi i fondeve publike në administratën publike në Kosovë? Çfarë masa duhet të ndërmerren?

- **Hipotezat**

Hipotezat e ngritura në këtë punim janë:

H.1. Hipoteza bazë: Kontrolli i administratës publike është faktor kryesor për funksionimin e një administrate publike të qëndrueshme, profesionale, të përgjegjshme, efikase, efektive, transparente dhe llogaridhënëse, për garantimin e qeverisjes së mirë në Kosovë.

H.1.1. Nëhipoteza e parë: Fuqizimi i mekanizmave aktualë të kontrollit të administratës publike dhe themelimi i Gjykatës Administrative për kontrollin e ligshmërisë së administratës publike, janë faktorë për të krijuar një shtet të së

drejtës, qeverisje të mirë në Kosovë, institucione funksionale, shoqëri demokratike dhe mundësi për integrim në Bashkimin Evropian.

H.1.2. Nënhipoteza e dytë: Në Kosovë është e nevojshme një riorganizim i administratës publike për përcaktimin e qartë të mbikëqyrjes apo kontrollit mbi performancën e institucioneve dhe agjensive që funksionojnë në varësi të Kuvendit dhe Qeverisë si dhe të raportimit të tyre.

Pas analizimit të problematikave të instrumenteve të kontrollit të administratës publike për garantimin e një qeverisje të mirë në Kosovë, ky punim synon t'i përgjigjet pyetjeve të mësipërme dhe të sugjerojë disa rekomandime në përputhje me rezultatet e studimit empirik.

1.5. Metodologjia e kërkimit

Në këtë punim do të ketë një gërshetim metodash, të instrumenteve kërkimore duke i dhënë atyre rëndësinë që bartin, si mjet për të përsosur punimin. Metodologjia e përdorur do të jetë metoda cilësore dhe sasiore, do të përdoret metoda e përshkrimit, krahasimit, analizës ligjore dhe analizës së të dhënave dhe informacionit të mbledhur nga procesi i hulumtimit.

Analiza ligjore në këtë punim fokusohet tek përmbajtja e kuadrit kushtetues dhe ligjor për instrumentet e kontrollit të administratës publike në Kosovë dhe në Republikën e Shqipërisë dhe disa vendeve të tjera të rajonit. Analiza ligjore që i përket instrumenteve të kontrollit të administratës publike në Kosovë, përdoret gjerësisht edhe për të sqaruar zbatimin e ligjeve dhe parimeve në praktikë. Më anë të kësaj metode, synohet të evidentohen problematikat gjatë zbatueshmërisë së legjisllacionit.

Metoda krahasuese e përdorur në këtë punim pasqyron ngjashmëritë dhe dallimin e instrumenteve të kontrollit të administratës publike të Kosovës me mekanizmat e kontrollit të administratës publike në shtetet e tjera të rajonit ballkanik, të përfshira në këtë punim. Në mënyrë të veçantë, kjo merr rëndësi kur flitet për procedurën e

emërimit dhe shkarkimit, mandatin dhe kompetencat që kanë këto instrumente të kontrollit të administratës publike dhe specifikat e tyre të veçanta.

Metoda përshkruese e përdorur në këtë punim ka pasur për qëllim pasqyrimin e gjendjes aktuale të instrumenteve të kontrollit të administratës publike, si dhe njohjen me historikun e vendosjes së mekanizmit të kontrollit të administratës publike, duke trajtuar me hollësi kompetencat, parimet, procedurat, instrumentet, të parashikuara në dispozitat kushtetuese e ligjore, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Metoda sasiore apo statistikore është përdorur gjatë studimit të materialeve të shumta, studimit të raporteve vjetore të institucioneve, statistikave lidhur me kontrollin e administratës publike dhe mekanizmat e kontrollit. Kjo metodë përdoret edhe në pjesën empirike të punimit.

Në punim është përdorur dhe metoda cilësore, pyetësor dhe intervista me zyrtarë të lartë publikë dhe ekspertë vendas, për të hedhur dritë mbi nevojat për ndryshime dhe plotësime ligjore, sa i përket krijimit të disa instrumenteve të reja të kontrollit dhe fuqizimit të instrumenteve aktuale të kontrollit të administratës publike. Qëllimi i intervistimit të zyrtarëve të lartë publikë dhe përdorimi i pyetësorëve gjatë hulumtimit ishte nxjerrja e rezultateve dhe krahasimi i gjetjeve individuale me mendimet e zyrtarëve të lartë publikë dhe specialistëve të secilës fushë për instrumentet e kontrollit të administratës publike. Në bazë të hulumtimit dhe rezultateve të nxjerra nga të dhënat empirike, bëhet edhe argumentimi i hipotezave të ngritura në këtë punim.

1.5.1. Burimet e studimit

Metodologjia e punimit bazohet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave parësore dhe dytësore. Punimi bazohet në një analizë të detajuar të burimeve parësore dhe burimeve dytësore.

Burimet parësore: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e OKB-së, Rezoluta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, konventa ndërkombëtare, Kushtetuta, ligje dhe

akte nënligjore, vendime të Gjykatës Kushtetuese, vendime të Gjykatave dhe raporte vjetore të institucioneve vendase dhe ndërkombëtare, intervista dhe pyetësor, etj. Si instrumente për mbledhjen e të dhënave primare janë përdorur intervistat dhe pyetësor të strukturuar. Në hulumtim, grupi i targetuar janë zyrtarë të lartë publikë në këto institucione: Kuvendi i Kosovës, Presidencë, Ministri, Gjykatë Kushtetuese, Gjykatë e Apelit, Gjykatat Themelore, Prokurori Themelore, Institucioni i Avokatit të Popullit, Policia e Kosovës, Agjensia Kundër Korrupsionit, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias. Po ashtu, kemi mbledhur të dhëna empirike nga zyrtarë të lartë publikë më pyetësor të strukturuar si: deputetë dhe gjyqtarë në të gjitha Gjykatat Themelore të Kosovës dhe gjyqtarë në Gjykatën e Apelit. Një shtjellim më i gjerë për këtë fazë të hulumtimit dhe rezultatet e tij, trajtohet në kapitullin e pestë të këtij punimi. Për të arritur në analizat e të dhënave primare nga intervistat dhe pyetësorët dhe për t'i interpretuar rezultatet, është përdorur softueri Microsoft Office Excel. Interpretimi i gjetjeve është pasqyruar në tabelë, grafikë, figura dhe në bazë të gjetjeve është bërë vërtetimi i hipotezës. Në fund janë paraqitur konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse me disa sugjerime për të ardhmen.

Burime dytësore: artikuj shkencorë për instrumentet e kontrollit të administratës publike, botime të shkruara nga autorë vendas dhe të huaj, gazeta, faqe të internetit, etj.

1.6. Pritshmëritë dhe kufizimet e punimit

Hulumtimi fokusohet në njohjen e mekanizmave të kontrollit të administratës publike, ngjashmëritë dhe dallimet mes instrumenteve të kontrollit në shtete të cilat janë marrë si raste studimore dhe janë trajtuar në këtë punim; në njohjen sa më të mirë të instrumenteve të kontrollit të administratës publike, me qëllim përmirësimin e parametrave dhe standarteve që garantojnë qeverisjen e mirë në Kosovë.

Hulumtimi në këtë fushë ishte shumë interesant dhe sfidues, nisur kjo edhe nga vetë natyra e punimit për kontrollin e administratës publike, prej periudhës së fillimit të administrimit të Kosovës nga UNMIK-u e deri më sot.

Ky punim nuk mund të konsiderohet si shterues për asnjë nga dimensionet e analizuara, sepse tema e tij është e gjerë, e cila përfshin të gjitha instrumentet e kontrollit të administratës publike si kategori kushtetuese, ndërsa analizon dy mekanizma të pavaruar të mbikëqyrjes dhe kontrollit siç janë: Këshilli Mbikëqyrës i Shërbimit Civil dhe Agjensia Kundër Korrupsionit, si institucione që raportojnë në Kuvendin e Kosovës.

Gjatë intervistimit, një pjesë e zyrtarëve të lartë publikë kanë qenë të prirur të jepnin përgjigje të natyrës politike ose dhe hezitonin të përgjigjeshin në intervistë. Ndërsa në intervistën për gjyqtarët, një pjesë e tyre kërkonin paraprakisht që autori i hulumtimit të merrte leje nga Kryetari i Gjykatës Themelore për zhvillimin e intervistës. Po kështu, në disa ministri, disa Sekretarë të Përgjithshëm dhe disa drejtorë në Departamente hezitan të pranonin për t'u intervistuar. Një pjesë pranuan të intervistohen, por kërkuan të mos i publikohet emri i tyre në punim për arsye të frikës ndaj pasojave që mund të kenë. Ndërsa me pyetsorët për zyrtarët e lartë publikë, ata treguan se kishin më shumë gatishmëri për t'u përgjigjur për arsye të anonimitetit dhe ruajtjes në diskrecionit të opinionit të tyre.

Gjithashtu, janë hasur pengesa për sa i përket aksesit në dokumentet zyrtare në periudhën e administrimit nga UNMIK-u dhe pas shpalljes së pavarësisë. Disa institucione nuk lejonin qasje në dokumente publike pa iu dorëzuar Kuvendit dhe pa u publikuar në faqen e internetit të institucioneve. Po ashtu, do të përmendja si vështirësi edhe mungesën e gatishmërisë së një numri zyrtarësh të lartë publikë gjatë intervistimit për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me probleme të caktuara që kanë të bëjnë me fenomenin korruptive, apo me efikasitetin (ose jo) e instrumenteve të kontrollit. Ky punim i hap rrugën një sërë punimesh të tjera në të ardhmen, që mendoj se duhen plotësuar gjithnjë e më shumë për secilin instrument të kontrollit të administratës publike, për reforma të veçanta në të ardhmen të secilit instrument kontrolli, me qëllim garantimin e një qeverisje të mirë në Kosovë.

KAPITULLI II. PARIMI I QEVERISJES SË MIRË NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në këtë kapitull do të elaborohet qeverisja e mirë në administratën publike, nisur nga shqyrtimi i literaturës për qeverisje të mirë, me theks të veçantë tek parimet e qeverisjes së mirë në administratën publike, duke i trajtuar më shumë në aspektin ligjor. Gjithashtu, do të trajtohen praktikat e mira të qeverisjes së mirë në administratën publike, roli i Kuvendit për një qeverisje të mirë dhe reforma e administratës publike si faktor për qeverisje të mirë.

2.1. Kuptimi i qeverisjes së mirë në administratën publike

Banka Botërore në raportin e vitit 1992 të titulluar "Qeverisja dhe zhvillimi", dha përkufizimin e saj për qeverisjen e mirë. Ky term përcaktohet si *"mënyra në të cilën ushtrohet pushteti në menaxhimin e burimeve ekonomike dhe sociale të një vendi për zhvillimin e tij"*.⁴ Qeverisja e mirë është më tepër një term bashkëkohor që nënkupton qeverisjen si ushtrim i autoritetit ekonomik, politik dhe administrativ për të menaxhuar çështjet e një vendi në të gjitha nivelet, me të cilat shtetet promovojnë kohezionin social, integrimin dhe sigurojnë mirëqenien e popullatës së tyre. Ky koncept përfshin të gjitha metodat e përdorura për menaxhimin e burimeve publike, shpërndarjen e pushtetit, dhe organizatat që ndihmojnë qeverinë në ekzekutimin e politikave. Gjithashtu, ai përfshin mekanizmat, proceset dhe institucionet përmes të cilave qytetarët dhe grupet sociale artikulojnë interesat e tyre, ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore, përmbushin detyrimet e tyre dhe zgjidhin dallimet mes tyre.⁵ Leskaj thekson se "qeverisja e mirë ka të bëjë me mënyrën më efektive dhe eficiente se si qeveria, shoqëria civile, sektori i biznesit dhe të gjitha institucionet dhe organet e

⁴IFAD International Fund for Agricultural Development Executive Board – Sixty-Seventh Session Rome, 8-9 September 1999 Good Governance: An Overview, fq.1.

shih web faqe: <http://www.ipa.government.bg/sites/default/files/pregled-dobro-upravljenje.pdf>.

⁵UNDP and Governance Experiences and Lessons Learned Management Development and Governance Division Series, No.1, fq. 10.

shih: <ftp://pogar.org/LocalUser/pogarp/other/undp/governance/lessonslearned-e.pdf>.

tjera kushtetuese ndërliidhen për të menaxhuar punët dhe plotësuar përgjegjësitë e tyre” [Leskaj, 2013:16]. Qeverisja e mirë është ndër të tjera, pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse. Gjithashtu, është efektive dhe e barabartë dhe nxit sundimin e ligjit.⁶ Qeverisja e mirë siguron që prioritetet politike, sociale dhe ekonomike të bazohen në një konsensus të gjerë në shoqëri dhe se zërat e më të varfërve dhe më të rrezikuarve të dëgohen në vendimmarrjen mbi shpërndarjen e burimeve dhe zhvillimit.⁷

Shumica e organizatave ndërkombëtare kanë dhënë përkufizime për qeverisjen e mirë në një vend. Banka Botërore përshkruan tri aspekte të qeverisjes:

- a) lloji i regjimit politik,
- b) menaxhimi publik i burimeve ekonomike dhe sociale, dhe
- c) kapaciteti i qeverisë për të hartuar, miratuar dhe zbatuar politika

[Stella, 2008:11].

Banka Aziatike e Zhvillimit (ASDB) e përkufizon qeverisjen e mirë si: *"mënyra me të cilën ushtrohet pushteti në menaxhimin e burimeve ekonomike dhe sociale të një vendi, për zhvillimin e tij"*. Qeverisja e mirë konceptohet në të paktën dy dimensione: a) politik (p.sh. demokracia, të drejtat e njeriut); dhe b) ekonomik (p.sh. menaxhimi efikas i burimeve publike).⁸ Përkufizimet e tjera variojnë midis problemeve sociale, politike, ekonomike madje edhe të natyrës teknike.⁹ Dimensioi social: sipas OSBE-së *"qeverisja e mirë në të gjitha nivelet është thelbësore për rritjen ekonomike, stabilitetin politik dhe sigurinë"* (OSBE)¹⁰ Dimensioi ekonomik: sipas FMN- së *"qeverisja është një koncept i gjerë që*

⁶UNDP, Governance for sustainable human development, A UNDP policy document shih: <ftp://pogar.org/LocalUser/pogarp/other/undp/governance/To-Adel/5-ChapterOne.htm>.

⁷UNDP, Good Governance – and sustainable human development. shih: <http://mirror.undp.org/magnet/policy/chapter1.htm>. (last visited on 28 August 2008).

⁸ IFAD International Fund for Agricultural Development Executive Board – Sixty-Seventh Session

Rome, 8-9 September 1999 Good Governance: An Overview, fq.4.

shih web faqe: <http://www.ipa.government.bg/sites/default/files/pregled-dobro-upravljenje.pdf>.

⁹ Friederike Bundschuh-Rieseneder, Good Governance: characteristics, methods and the Austrian examples, Transylvanian Review of Administrative Sciences, 24E/2008, fq. 28, më gjerësisht shih: <http://rtsa.ro/tras/index.php/tras/article/viewFile/91/87>.

¹⁰ OSCE, Good governance, shih web faqe: <https://www.osce.org/good-governance>

mbulon të gjitha aspektet se si qeveriset një vend, duke përfshirë politikat ekonomike, kuadrin rregullator dhe aderimin në sundimin e ligjit. Qeverisja e mirë është çelësi i suksesit ekonomik. Për qeverisjen e mirë janë dy fusha kryesore: i) menaxhimi i burimeve publike nëpërmjet reformave që mbulojnë institucionet e sektorit publik; dhe ii) zhvillimi dhe mirëmbajtja e një mjedisi transparent dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe rregullator për aktivitetet e sektorit privat¹¹.
Dimensioni politik: *"legjitimiteti i qeverisë, llogaridhënia, elementet politike të qeverisë, respektimi i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit"* (OECD, 1997).¹²
Në vitin 2000, Bashkimi Europian përfshiu konceptin e qeverisjes së mirë në Marrëveshjen e Partneritetit ndërmjet Shteteve të Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit dhe Bashkimit Europian: "në kontekstin e një mjedisi politik dhe institucional që mbështet të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës, qeverisja e mirë duhet të jetë transparente në menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve njerëzore, natyrore, ekonomike dhe financiare për qëllimet e zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm. Ajo përfshin procedura të qarta në vendim-marrje në nivelin e autoriteteve publike, institucione transparente dhe të përgjegjshme, përparësinë e ligjit në menaxhimin dhe shpërndarjen e burimeve dhe ndërtimit të kapaciteteve, si dhe zbatimin e masave që synojnë në veçanti parandalimin dhe luftimin e korrupsionit".¹³

Ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan e përshkruante qeverisjen e mirë si: "një forcë që siguron respektimin e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit, forcimin e demokracisë, promovimin e transparencës dhe të kapaciteteve në administratën publike". [Stella, 2008:11]. Kofi Annan theksonte se "në praktikë, qeverisja e mirë përfshin promovimin e sundimit të ligjit, tolerancën e grupeve minoritare dhe të opozitës, proceset politike transparente, angazhimin për të luftuar

¹¹ IMF and Good Governance March 8, 2018 shih ne web faqe: <https://www.imf.org/en/About/Factsheets/The-IMF-and-Good-Governance>

¹²Friederike Bunde, Rieseneder, Good Governance: characteristics, methods and the Austrian examples, Transylvanian Review of Administrative Sciences, 24E/2008, fq. 28, më gjerësisht shih: <http://rtsa.ro/tras/index.php/tras/article/viewFile/91/87>.

¹³European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission Draft Report on the notion of "Good Governance" On the basis of comments by Mr Oliver KASK (Member, Estonia) Mr Asbjørn EIDE (Expert, Norway) Study no. 470/ 2008, Strasbourg, 8 October 2008, fq.4.

korruptionin, një sistem gjyqësor të pavarur, forcë policore të paanshme, një ushtri që rreptësisht i nënshtrohet kontrollit civil, media të lirë dhe institucione të shoqërisë civile aktive, si dhe zgjedhje kuptimplota. Mbi të gjitha, qeverisja e mirë do të thotë respekt për të drejtat e njeriut”.¹⁴

Një përkufizim tjetër për qeverisjen e mirë është: “menaxhim i përgjegjshëm i burimeve njerëzore, natyrore, ekonomike dhe financiare, transparencë për qëllime të zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm, në kontekst të një mjedisi politik dhe institucional që mbështet të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe sundimin e ligjit¹⁵, zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësisë së organit qeverisës që të jetë efektiv”.¹⁶ Qeverisja e mirë po bëhet gjithnjë e më e zakonshme si një element kyç i zhvillimit. Në fakt, suksesi i zhvillimit është i varur nga një qeverisje e mirë, e cila shpesh barazohet me qeverisjen demokratike (McCawley, 1993).¹⁷

Sipas Komisionerit Johannes Hahn “cilësia e administratës publike ka rëndësi për të gjithë. Qytetarët kanë të drejtë të presin nga shteti që të garantojë një administratë publike funksionale dhe efektive, të kërkojnë që ajo të ketë kapacitete të mjaftueshme administrative për të ruajtur ligjin dhe rendin, për të mbrojtur të mirat publike, për të ofruar shërbime publike në mënyrë efektive dhe të jetë transparente dhe e arritshme për qytetarët. Së dyti, cilësia e administratës publike gjithashtu përfshin përmirësimin e menaxhimit të financave publike, veçanërisht forcimin e efikasitetit të procedurave të prokurimit publik. Ajo mbulon përmirësimin e

¹⁴UNIS/SG/2358 Facing the Humanitarian Challenge. Towards a Culture of Prevention, Kofi Annan, Secretary-General of the United Nations, September 1999, shih: <http://www.unis.unvienna.org/unis/en/pressrels/1999/sg2358.html>.

¹⁵Friederike Bundschuh-Rieseneder, Good Governance: characteristics, methods and the Austrian examples, Transylvanian Review of Administrative Sciences, 24E/2008, fq. 27. shih: <http://rtsa.ro/tras/index.php/tras/article/viewFile/91/87>.

¹⁶The Office for Public Management (OPM®) and the Chartered Institute of Public Finance and Accountancy (CIPFA), The Independent Commission for Good Governance in Public Services, 2004. The Good Governance Standard for Public Services, fq.4. e gjerësisht shih ne web faqe http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/good_gov_standardps_en.pdf. shkarkuar me 25 shtator 2015.

¹⁷Gedeon M. Mudacumura, Göktuğ Morçöl, Challenges to Democratic Governance in Developing Countries, Springer International Publishing Switzerland, 2014, fq.1.

integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në administratën publike”.¹⁸ Sipas Koprivica & Đorđije qeverisja e mirë është “një koncept i bazuar në disa parime të rëndësishme. Të gjitha parimet kanë për qëllim ndërtimin e një qeverisje në mënyrë të tillë, e cila çon në rritjen e përgjegjësisë në shoqëri”.¹⁹

2.2. Parimet e qeverisjes së mirë në administratën publike

Kërkesa për një qeverisje të mirë dhe të hapur ka ngritur stekën e standardeve që qeveritë dhe administratat publike duhet të përmbushin. Shumë qytetarë të botës demokratike kërkojnë gjithnjë e më tepër një qeverisje, ku parimet e qeverisjes së mirë si: përgjegjshmëria, transparenca, reagimi, barazia, përfshirja, mbrojtja e të drejtave dhe ndjekja e drejtësisë të jenë themelet e shoqërive të tyre.²⁰

Parimet dhe standardet e Administratës së mirë burojnë nga legjislacioni dhe jurisprudenca e BE-së si dhe nga praktika e mirë administrative në Shtetet Anëtare të BE-së. Këto parime ju ofrojnë politikëbërësve udhëzime në drejtim të anëtarësimit në BE dhe bashkëpunimit administrativ ndërkufitar [SIGMA, 2012:7]. Disa parime veçanërisht të rëndësishme të përcaktuara edhe nga Gjykata Europiane e Drejtësisë, të cilat duhet t'i zbatojnë të gjithë Shtetet Anëtare kur zbatojnë legjislacionin e Bashkimit Europian, janë midis të tjerash: parimi i administrimit nëpërmjet ligjit, parimet e proporcionalitetit, sigurisë juridike, mbrojtja e pretendimeve të ligjshme, mosdiskriminimi, e drejta për t'u dëgjuar në procedurat administrative vendim-marrëse, ndihma provizore, kushte të drejta për akses të individëve në gjykatat administrative, përgjegjësitë jo-kontraktuale të administratës publike. Nëse

¹⁸ Johannes Hahn, Public Administration Reform as the key pillar in the enlargement process, Conference on Reinforcing Public Administration Reform in the Enlargement Process, Brussels on 12 November 2014. Fq.5 shih:

<http://www.sigmaxweb.org/publications/Final%20conference%20report%20-%20PAR%20conference%2012%20Nov%202014.pdf>

¹⁹ Koprivica, Dragan & Đorđije Brkuljan, Good Governance in Montenegro challenges and Recommendations for improvement of situation April, 2013, fq.2; me gjerësisht shih: <http://www.cdtmn.org/images/sampledata/stavovi/dobro-upravlanje/en/Good-governance-in-MNE.pdf>.

²⁰ Shqiptarët dhe modeli social evropian, Administrata Publike në Shqipëri midis politikës dhe qytetarit. Tiranë, 2014, fq.11.

mundohemi të klasifikojmë parimet bazë të së drejtës administrative për vendet e Europës perëndimore, do të dallonim grupet e mëposhtme:

- besueshmëria dhe parashikueshmëria (siguria juridike);
- të qenit i hapur dhe transparencja;
- përgjegjshmëria dhe
- eficaenca dhe efektiviteti.

Parime të tjera mund të rrjedhin nga këto të mësipërmet [SIGMA; 2001/1, Nr.27, fq.7].

Koncepti i qeverisjes së mirë është përkufizuar vazhdimisht nga vendet e BE-së dhe është përfshirë në Kartën e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore. Parimet përkufizojnë se çfarë përfshin qeverisja e mirë në praktikë dhe përcaktojnë kushtet kryesore që duhet të respektohen nga vendet gjatë procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.²¹ Këto parime administrative nuk janë thjesht ide të bazuara mbi dëshirën e mirë, por ato janë të ngulitura në institucione dhe procedura administrative të të gjitha niveleve. Aktorët në sferën publike janë të detyruar me ligj t'i zbatojnë këto parime ligjore, të cilat duhet të mbështeten nga trupa kontrolli të pavarur, sisteme drejtësie dhe zbatim ligjor, hetime parlamentare, dhe duke siguruar mundësi për t'u dëgjuar, si dhe dëmshpërblim për individë dhe persona juridikë [SIGMA; 2001/1, Nr.27, fq. 7].

Parimet e administratës së mirë duhet t'iu përgjigjen sfidave të vjetra dhe të reja. Aktualisht, ato përfshijnë elementet vijuese: administrata e mirë është e besueshme dhe e parashikueshme. Ajo garanton siguri ligjore duke respektuar sundimin e ligjit. Organet administrative i ushtrojnë fuqitë dhe përgjegjësitë e besuara në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme. Ato i zbatojnë rregullat e përgjithshme dhe parimet me paanshmëri ndaj kujtdo që përmbush kushtet e duhura, duke marrë parasysh kriteret interpretuese të elaboruara nga gjykatat. [SIGMA, 2012:8].

²¹Johannes Hahn, Komisioner për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerimin, Parimet e administratës publike, fq. 6, për me shume informacione shiko në web faqe <http://www.sigmaxweb.org/publications/ALBANIAN%20Principles%20of%20Public%20Administration%20Overview%20web.pdf>

Autoritetet publike mund të vendosin vetëm mbi çështje për të cilat ata kanë autoritet ligjor. Në këtë kontekst kompetenca do të thotë një fuqi e dhënë shprehimisht nga ligji për të vendosur mbi një çështje të caktuar me interes publik, që ligjërisht bën të aftë autoritetin publik jo vetëm të marrë vendim mbi çështjen, por e detyron të marrë edhe përgjegjësi. Një autoritet publik kompetent nuk mund ta neglizhojë këtë përgjegjësi, pasi kjo (kompetenca) është një përgjegjësi për të. Nocioni i kompetencës aplikohet në mënyrë strikte që vendimi i marrë nga një autoritet pa juridiksion ligjor të jetë i pavlefshëm dhe të deklarohet i pavlefshëm nga gjykatat [SIGMA; 2001/1, nr.27, fq. 9]. Gjatë ushtrimit të diskrecionit të tyre, këto autoritete mbeten brenda kufijve të përcaktuar me ligj, në mirëbesim dhe mënyrë të arsyeshme dhe proporcionale, duke respektuar detyrimin e trajtimit të barabartë. Ato vendosin në kohë të arsyeshme, dhe duke respektuar rregullat ligjore, ku organet administrative realizojnë kërkesën minimale të demokracisë në formën e sundimit të ligjit. [SIGMA, 2012:8]. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, në nenin 41 parashikon se çdo person ka të drejtë që çështjet e tij ose të saj të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda afateve kohore të arsyeshme nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Europian, të drejtën e çdo personi të dëgjohet përpara se ndaj tij të merren masa që do ta cënonin atë, si dhe detyrimin e administratës që të arsyetojë vendimet e marra.²²

Si parim, parashikohet edhe në Kodin e Procedurave Administrative të Shqipërisë, në të cilin përcaktohet se administrata publike, në ushtrim të funksioneve të saj, trajton në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat hyn në marrëdhënie [KPASH, neni 12]. Respektimi i kohës në veprimin e administratës publike mbështet fuqishëm parimet e parashikueshmërisë dhe besueshmërisë. Vonesa e marrjes së vendimeve dhe kryerjes së veprimeve nga administrata publike mund të shkaktojë pakënaqësi, padrejtësi ose dëm të rëndë, si për interesin publik ashtu dhe për interesat private [SIGMA; 2001/1, Nr.27, fq.10]. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cënohen nga veprimi administrativ,

²² Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, neni 41, Strasburg, 12 dhjetor 2007 (GZ C 303, 14.12.2007, fq. 1).

përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.²³ Prandaj, organet e administratës publike sigurojnë zbatimin e akteve administrative të tyre.²⁴

Administratë e Hapur dhe Transparente - Parimi i të qenit i hapur sugjeron që administrata është e gatshme për hetim të jashtëm, ndërsa transparencja sugjeron që, kur egzaminohet nga afër, mund të shihet përtej për qëllimin e hetimit dhe mbikëqyrjes. Një administratë publike e hapur dhe transparente lejon, nga njëra anë, që çdo njeri i ndikuar nga një veprim administrativ të njohë bazën e këtij vendimi, dhe nga ana tjetër lehtëson hetimet e jashtme të veprimeve administrative nga institucionet mbikëqyrëse. Të qenit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumenta të nevojshëm për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë [SIGMA; 2001/1, Nr.27, fq.21].

Në dekadat e fundit, qeveritë në mbarë botën, me shpejtësi janë ballafaquar me rritje të kërkesës që ta bëjnë shërbimin publik dhe administratën efektive, efikase dhe transparente.²⁵ Prandaj, qytetarët dhe palët të interesuara gjithnjë e më shumë janë duke kërkuar që qeveritë të jenë më transparente dhe të ofrojnë shërbime më të shpejta dhe me efikasitet.²⁶

Sipas Farazmand (2009:115) “etika e llogaridhënies dhe transparencja janë parimet më të rëndësishme ndër-sektoriale të demokracisë dhe besimit në qeverisje dhe administrim efektiv”, pasi ato parandalojnë mundësitë për korrupsion dhe administrim të keq”. Disa të tjerë (Behn 2001; UNDP 2002; Brinkerhoff, 2006) “e konsiderojnë transparencën, përgjegjshmërinë, dhe llogaridhënien si të domosdoshme për një qeverisje të mirë” [Gedeon M. Mudacumura, Göktuğ Morçöl, 2014:2].

Organi administrativ i cili zhvillon procedurën administrative, është i detyruar t’u japë informacion pjesëmarrësve në procedurë edhe në lidhje me të drejtat dhe

²³Ligj Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 4.

²⁴Ligji Nr. 02/L-28 “Për procedurën administrative” i Republikës së Kosovës, neni 3.

²⁵Manuel Pedro Rodríguez-Bolívar (Editor), *Measuring E-government Efficiency The Opinions of Public Administrators and Other Stakeholders*, Springer New York Heidelberg Dordrecht London, 2014, fq.2.

²⁶Po aty, fq.10

detyrimet e tyre.²⁷ Pra, organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të. Çdo person fizik dhe juridik, pa qenë e nevojshme të tregojë interes specifik, në raportet me organet e administratës publike, ka të drejtat procedurale që vijojnë:

- a) të marrë informacion që është në zotërim të një organi të administratës publike,
- b) brenda një kohe të arsyeshme,
- c) në të njëjtën mënyrë si për çdo person tjetër.
- d) me mjete të përshtatshme dhe efektive [LPAK Neni 9].

Informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me ligjet përkatëse. Për refuzimin e qasjes në informacion, organi i administratës publike merr vendim me shkrim, (vendim) i cili duhet të përmbajë arsyet e marrjes së këtij vendimi dhe udhëzimet për mundësinë e ankesës.²⁸ Pra, të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.²⁹

Përgjegjësia e administrimit kërkon transparencë, qasje në informacion dhe mundësinë e qytetarëve për rishqyrtim administrativ dhe ligjor. Kjo nuk vlen vetëm në lidhje me trajtimin e drejtë të qytetarëve, por edhe në lidhje me përgjegjshmërinë për performancën [Hahn, 2014:7]. Koncepti i qeverisjes së hapur është mbuluar gjerësisht në literaturën akademike gjatë viteve të fundit (Bertot dhe të tjerët 2010; Veljkovic dhe të tjerët 2012; Di Maio 2010; Gustetic 2010). Të dhëna të hapura, transparenca, pjesëmarrja dhe bashkëpunimi janë renditur si atributet kryesore që

²⁷ Kodi i Procedurës Administrative i Shqipërisë, neni 20.

²⁸ Ligji Nr. 02/L-28 për procedurën administrative në Kosovë, neni 9.

²⁹ Kodi i Procedurës Administrative i Shqipërisë, neni 20.

lidhen me konceptin e qeverisjes së hapur.³⁰ Sidomos *E-Government* (Qeverisja elektronike), ka çuar në modernizimin e administratës publike, me qëllim që të forcohet qeverisja (Calista dhe Melistki, 2007), duke siguruar qasje më të madhe dhe transparencë në informacion (Caba dhe të tjerët, 2008), ofrimin e përmirësuar të shërbimeve publike (West 2004), ndërveprim më të madh dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në menaxhimin publik (Dunleavy dhe të tjeret, 2006).³¹ Ndërsa, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, në nenin 41 parashikon të drejtën e çdo personi për të parë dosjen e vet, duke respektuar interesat legjitime të ruajtjes së fshehtësisë së informacionit si edhe të sekretit profesional dhe tregtar.³²

Administrata e Mirë është e përgjegjshme. Qeveritë dhe punonjësit e tyre duhet të jenë përgjegjës për veprimet e tyre.³³ Objektivi i transparencës dhe përgjegjësisë në menaxhimin e organeve ekzekutive kërkon që të bëhen kontrole të brendshme dhe të jashtme mbi veprimtarinë e tyre [SIGMA (2007), Nr. 43, fq. 69]. Organet e administratës publike dhe punonjësit e tyre mbajnë përgjegjësi për dëmet që iu shkaktojnë personave privatë nëpërmjet: marrjes së vendimeve të paligjshme, refuzimit të paligjshëm për të marrë vendime dhe dhënies së informacioneve shkresore të pasakta për personat privatë, si për çdo shkak apo rast tjetër të parashikuar me ligj [KPA i Shqipërisë, neni 14].

Organet administrative, puna dhe rezultati i tyre janë të hapura për analizë dhe shqyrtim nga ana e autoriteteve të tjera administrative të pavarura, nga legjislativi si dhe gjykatat [SIGMA,2012:8]. Përgjegjshmëri do të thotë që asnjë autoritet nuk duhet të përjashtohet nga hetimi.Kjo mund të vihet në efekt me anë të mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë gjykatat, apel tek një trup administrativ më i lartë,

³⁰Manuel Pedro Rodríguez-Bolívar (2014) Measuring E-government Efficiency: The Opinions of Public Administrators and other Stakeholders, Sanja Bogdanović-Dinić, Nataša Veljković, and Leonid Stoimenov, How Open Are Public Government Data? An Assessment of Seven Open Data Portals, fq.25.

³¹Laura Alcaide-Muñoz, Antonio M. López Hernández, and Carmen Caba-Pérez, Public Managers' Perceptions of E-Government Efficiency: A Case Study of Andalusian Municipalities, 2014, fq.150.

³² Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, neni 41, Strasburg, më 12 dhjetor 2007 (GZ C 303, 14.12.2007, fq. 1).

³³ IFAD International Fund for Agricultural Development Executive Board – Sixty-Seventh Session Rome, 8-9 September 1999, Good Governance: An Overview, fq. 2. Shih web faqe: <http://www.ipa.government.bg/sites/default/files/pregled-dobro-upravljenje.pdf>.

investigim nga Avokati i Popullit, inspektim nga një bord ose komision special, dhe hetim nga një komision parlamentar. Përgjegjshmëria është një instrument që tregon nëse respektohen parimet e ligjshmërisë, transparencës, paaanësisë dhe barazisë para ligjit. Përgjegjshmëria është esenciale për të siguruar vlera si efienca, efektiviteti, besueshmëria dhe parashikueshmëria e administratës publike [SIGMA; 2001/1, Nr.27, fq.12].

Administrata e Mirë është efektive dhe efikase. Autoritetet publike duhet të jenë të suksesshme në arritjen e synimeve dhe trajtimit të problemeve të publikut të parashtruara nga ligji dhe qeveria. Autoritetet publike duhet t'i shfrytëzojnë burimet publike në mënyrë proporcionale me rezultatet e arritura. Autoritetet publike duhet të parashtrojnë objektiva të qarta, duke vlerësuar përvojën e kaluar si dhe ndikimin e ardhshëm të veprimit të tyre. Mos-imponimi i ngarkesave dhe kostove të panevojshme mbi qytetarët dhe biznesin është një mënyrë tjetër e rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit [SIGMA,2012:7].

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European, në nenin 41 parashikon se çdo person ka të drejtën që t'i kërkojë Bashkimit European zhdëmtim për dëmet që mund të jenë shkaktuar prej institucioneve apo prej nëpunësve të tij gjatë ushtrimit të detyrave, në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për legjislacionet e Shteteve Anëtare³⁴, megjithëse njohja e efiençës si një vlerë e rëndësishme për administratën publike dhe shërbimin civil është relativisht e re. Nocioni i produktivitetit ka hyrë në administratën publike që kur shteti është bërë prodhuesi kryesor i shërbimeve publike. Për shkak të kufizimeve fiskale në shumë shtete, sot po studiohet gjithnjë e më tepër performanca efiente dhe efektive e administratës publike në dhënien e shërbimeve publike për shoqërinë. Efiçenca është në mënyrë karakteristike një vlerë menaxheriale që në thelb ka të bëjë me mbajtjen e një raporti të mirë midis burimeve dhe rezultateve të arritura [SIGMA; 2001/1, Nr.27, fq.13].

³⁴ Parlamenti European, Këshilli dhe Komisioni, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European, neni 41, Strasburg, 12 dhjetor 2007 (GZ C 303, 14.12.2007, fq. 1).

2.3. Praktikët e mira të qeverisjes së mirë në administratën publike

Sipas Professore Batallit “administrata publike është shndërruar në një instrument të qeverisjes qendrore për trajtimin e problemeve të përgjithshme shoqërore”(Batalli, 2012:6).

Administrata e Mirë është në shërbim të komunitetit dhe promovon besimin shoqëror në pushtetin ekzekutiv, ajo kontribuon në stabilitetin politik dhe kultivon zhvillimin ekonomik dhe pasurinë sociale.Ndërsa, një administratë jofunksionale është pengesë për investimet produktive dhe mund të çojë në rezistencë të qytetarit dhe protestë kundër shtetit, e në rastin më të keq në dështim të shtetit[SIGMA,2012: 7]. Një administratë publike funksionale është parakusht për qeverisje demokratike, transparente dhe efektive.Si themel i funksionimit të shtetit, ajo përcakton aftësinë e qeverisë për të ofruar shërbime publike dhe për të kultivuar konkurrencën dhe zhvillimin e vendit.³⁵

Sipas Bankës Botërore (2012), efektiviteti i qeverisë reflekton në perceptimet e cilësisë së shërbimeve publike, cilësinë e shërbimit civil dhe shkallën e pavarësisë së saj nga presionet politike, cilësinë e formulimit dhe zbatimin e politikave, dhe besueshmërinë e angazhimit të qeverisë ndaj këtyre politikave [Manuel Pedro Rodríguez-Bolívar, 2014:6].

Administrata e mirë është objektiv kyç i politikave që përforcon ofrimin e shërbimeve publike, e përfshirë në legjislacion dhe që zbatohet vazhdimisht në praktikë [SIGMA; 2001/1, Nr.27, fq.27].

Qeverisja e mirë dhe administrata publike funksionale janë thelbësore në krijimin dhe ruajtjen e besimit ndaj qeverisë, dhe në bërjen e reformave të nevojshme strukturore për rritjen e standardit jetësor në shoqëri. Rëndësia e administrimit të mirë u bë e dukshme veçanërisht gjatë krizës së fundit financiare globale.³⁶

³⁵Mari Kiviniemi Zëvendëssekretare e Përgjithshme, OECD, Parimet e administratës publike, faqe 5 SIGMA. Më gjerësisht shiko në web faqe: <http://www.sigmaxweb.org/publications/ALBANIAN%20Principles%20of%20Public%20Administration%20Overview%20web.pdf>, e shkarkuar më 15 prill 2015.

³⁶Po aty, faqe 5.

Parlamenti luan rol të rëndësishëm për të pasur një qeverisje të mirë në një shtet.³⁷ Parlamenti luan një rol vendimtar në matjen, sistemimin dhe paraqitjen e pikëpamjeve dhe nevojave të njerëzve, artikullimit të pritjeve dhe aspiratave të tyre në përcaktimin e agjendës së zhvillimit kombëtar. Si organ mbikëqyrës, parlamenti ndihmon për të identifikuar problemet dhe sfidat e politikave që kërkojnë vëmendje dhe ndihmon në kapërcimin e amullive burokratike.³⁸ Përvojat e kohëve të fundit në reformën e sektorit publik kanë treguar se demokracia, sundimi i ligjit dhe një treg efikas nuk ka gjasa të ekzistojnë pa organe të forta legjislative. Suksesi i reformave institucionale në të gjithë sektorin publik është shumë i varur nga strukturat legjislative dhe rregullatore që i shoqërojnë. Forca e një sistemi legjislativ matet nga aftësia e tij për të shprehur opinionin publik, për të përfaqësuar qytetarët dhe për të shprehur me saktësi vullnetin e popullit. Gjithashtu, duhet të rritet ndërgjegjësimi i publikut në çështjet me interes kombëtar. Për ta bërë këtë, shumë organe legjislative kërkojnë forcimin e rëndësishëm institucional si pjesë e një procesi më të madh të demokratizimit.³⁹

Parlamenti duke ushtruar tre funksionet e tij, mund të promovojë demokraci parlamentare dhe qeverisje të mirë në një shtet. Qeverisja e mirë nuk është më luks, por është domosdoshmëri për një shtet që të ketë barazi politike dhe qëndrueshmëri zhvillimore, ekonomike dhe sociale. Që nga vitet '90, është rritur interesimi në mbarë botën për demokracinë dhe qeverisjen e mirë. Demokracia dhe shteti i së drejtës presupozon një legjislativ të aftë, që mund të përfaqësojë në mënyrë adekuate dhe të artikulojë kërkesat e elektoratit të tij, të kontrollojë fuqinë e ekzekutivit përmes mbikëqyrjes efektive dhe të miratojë ligje të qëndrueshme dhe

³⁷United Nations Economic and Social Council Committee of Experts on Public Administration The critical role of public administration and good governance in implementing the United Nations Millennium First session New York, 22-26 July 2002, E/C.16/2002/4, Fq.5 shih web faqe : <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/un/unpan003535.pdf>

³⁸ Economic Commission for Africa, The Role of Parliament in Promoting Good Governance, Governance and Public Administration Division (GPAD), fq. 1. Shih: <http://www.uneca.org/sites/default/files/PublicationFiles/role-of-parliament-in-promoting-good-governance.pdf>.

³⁹UNDP, UNDP and Governance. Experiences and Lessons Learned, Management Development and Governance Division Lessons-Learned Series No. 1, fq. 22. shih: <ftp://pogar.org/LocalUser/pogarp/other/undp/governance/lessonslearned-e.pdf>.

koherente. Për këtë qëllim, sigurimi i demokracisë kërkon qeverisje të mirë, e cila nga një anë, varet nga pjesëmarrja gjithëpërfshirëse, transparencë, llogaridhënia dhe promovimi i sundimit të ligjit.⁴⁰

Qeverisja e mirë në administratën publike siguron ofrimin efikas të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit, duke përfshirë edhe procedurat më të mira administrative dhe ofrim të shërbimeve të qeverisjes elektronike. Gjithashtu, një sistem i shëndoshë i menaxhimit të financave publike është një bazë për qeverisje demokratike dhe një parakusht për ofrimin efektiv të shërbimeve dhe parandalimin e korrupsionit.⁴¹ Pra, menaxhimi i mirë është thjesht një mënyrë e parandalimit të korrupsionit në një shoqëri [Koprivica & Brkuljan, 2013:2]. Një ndër sfidat kryesore për të pasur një administratë të mirë është respektimi i sundimit të ligjit. Gjithashtu, vendimet administrative duhet të bazohen në dispozita ligjore, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe kufizimet, duke përcaktuar mundësinë dhe detyrimin që vendimet të mund të shqyrtohen dhe kontrollohen në rrugë administrative duke respektuar hierarkinë, si dhe nga gjykatat [SIGMA, 2012:7].

Sundimi i ligjit është përcaktues për cilësinë dhe qeverisjen e mirë. Pra, në Kosovë, duhet që Qeveria pa kompromis të bëjë luftë ndaj korrupsionit, krimit të organizuar, terrorizmit dhe aktiviteteve të lidhura me dukurinë e terrorizmit, krimit ekonomik, trafikimit të qenieve njerëzore dhe llojeve të tjera të kriminalitetit, për të pasur një qeverisje të mirë. Kjo mund të realizohet vetëm me njerëz që kanë duar të pastra dhe që janë të përgjegjshëm.⁴² Po kështu, Profesor Stavileci thekson se “Kosova pas përkufizimit të statusit, do të duhej të përqafojë vlerat e demokracive perëndimore. Së pari, zgjedhje të lira; së dyti, ushtrimin e pushtetit nga shumica; së treti,

⁴⁰United Nations Economic and Social Council Committee of Experts on Public Administration, The critical role of public administration and good governance in implementing the United Nations Millennium First session, New York, 22-26 July 2002, E/C.16/2002/4, fq.5.

⁴¹Simon Mordue, Conclusions of the Chair, Commissioner Johannes Hahn presented the Commission's enhanced approach on public administration, conference on Reinforcing Public Administration Reform in the Enlargement Process, Brussels on 12 November 2014, fq.40. shih: <http://www.sigmaweb.org/publications/Final%20conference%20report%20%20PAR%20conference%2012%20Nov%202014.p>.

⁴²Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, fq. 34; shih http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_2015-2018_10_mars.pdf.

respektimin e opozitës, që nënkupton lirinë e kritikës dhe parimin e alternimit në pushtet; së katërti, konstitucionalizmin, detyrimin e të gjithëve për t'iu nënshtruar Kushtetutës dhe nga ana tjetër, detyrimin e pushteteve publike që t'iu nënshtrohen kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë për aktet e tyre, nga një organ juridik i pavarur” [Stavileci, 2009:297].

Si komponentë thelbësorë të qeverisjes së mirë, Leftwich (1993) vë në dukje disa karakteristika: shërbim publik efikas, sistem i pavarur gjyqësor dhe kuadrin ligjor për të zbatuar kontratat, administrimi i përgjegjshëm i fondeve publike, një auditor i pavarur publik, legjislaturë përfaqësuese përgjegjëse, respektimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut në të gjitha nivelet e qeverisjes, strukturë pluraliste institucionale, si dhe media të lirë [Gedeon M. Mudacumura, Göktuğ Morçöl, 2014:2]. Mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave themelore është shtylla kryesore në funksionimin normal të një shteti demokratik. Në fakt, nga kjo varet drejtpërdrejt zhvillimi politik, ekonomik dhe juridik i një shteti.⁴³

Sipas Prof. M. Leskovikut “krijimi i një administrate publike efëcente, të përgjegjshme, të besueshme dhe në shërbim të qytetarëve, nuk është vetëm një qëllim madhor në planin e brendshëm, por është edhe një prioritet për t'iu përgjigjur sfidave në kuadër të proceseve integruese të vendit” [Leskovikut, 2014:41].

Sipas Tait (2000), “një shërbim publik modern pasqyron vlerat që e bëjnë atë:

- demokratik (qeveri e përgjegjshme, sundim i ligjit, mbështetje për demokracinë, respektim të autoritetit të bartësve të zgjedhur, besnikëri, neutralitet, llogaridhënie, proces i rregullt);
- profesionale (neutralitet, meritë, përsosmëri, sinqeritet, shërbim ndaj klientëve, punë ekipore, inisiativë, kreativitet, cilësi);
- etike (integriteti, ndershmëria, matura, paanësia, barazia, liria, besimi i publikut);

⁴³Po aty, Fq. 35,

- orientimi i njerëzve (respektimi, kujdesi, mirësjellja, toleranca, hapja, pjesëmarrja, drejtësia, moderimi, humanizmi, guximi)”.⁴⁴

Sipas Ministres Tahiri “administrata publike është zemra e sistemit të qeverisjes dhe ajo duhet të funksionojë në mënyrë të shëndetshme, të jetë në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, bazuar në parimin e mundësive të barabarta. Si e tillë, administrata publike do të jetë çelësi i demokracisë dhe i qeverisjes demokratike të vendit, si dhe do të kontribuojë në përshpejtimin e integriteteve evropiane dhe euro-atlantike.”⁴⁵ Po kështu, mediat kanë rolin e tyre, pasi detyrojnë një qeveri të jetë transparente dhe e përgjegjshme [Kelmendi,2015].

Për të arritur një qeverisje të mirë në administratën publike në Kosovë, sipas praktikave ndërkombëtare, nevojitet së pari, të ketë sundim të ligjit, të respektohen të drejtat e njeriut, të luftohet nepotizimi, të bëhet depolitizimi i administratës, të parandalohet dhe luftohet korrupsioni dhe keq-qeverisja në institucione. Së dyti, duhet të ketë një kornizë ligjore adekuate; së treti, të bëhen emërimet nëpër institucione sipas kualifikimeve profesionale e jo në bazë të preferencave politike; së katërti, rritje të transparencës dhe llogaridhënies; së pesti, menaxhim të mirë të fondeve publike; dhe së gjashti, reforma në administratën publike.

2.4. Qeverisja e mirë dhe reforma e administratës publike

Sipas Wimmer “reforma është parim kushtetues i administratës publike. Reforma është vetëm gatishmëri institucionale e administratës publike që të jetë në gjendje për t’i përmbushur kërkesat për ndryshim në shoqëri.Reforma e administratës

⁴⁴UNDP, Democratic Governance Reader—A reference for UNDP practitioners, fq.112. Shih web faqe : http://www.undp.org/content/dam/aplaws/publication/en/publications/democratic-governance/oslo-governance-center/democratic-governance-reader/DG_reader-2009.pdf.

⁴⁵ Tahiri Edita, Reforma e administratës publike, Intervistë e publikuar në Buletinin e Ministrisë së Administratës Publike, Nr.1/Dhjetor 2010, fq. 4.

publike duhet të përputhet me racionalitetin politik dhe efikasitetin. Rëndësia e këtyre qëllimeve mund të ndryshojë dhe varet nga çështjet relevante politike”.⁴⁶

Sipas ministres Tahiri “reforma e administratës publike është një ndër komponentët esenciale të shtetit në ndërtim, vizioni për të ndërtuar një administratë publike të qëndrueshme, efektive dhe efikase dhe mbi të gjitha të paanshme”.⁴⁷ Reforma e administratës publike është një shtyllë e procesit të zgjerimit, bashkë me sundimin e ligjit dhe qeverisjen ekonomike. Të tri këto shtylla janë të lidhura ngushtë, ato janë çështje të ndërthurura e me rëndësi thelbësore për suksesin në reformat politike dhe ekonomike, si dhe në krijimin e bazës për zbatimin e rregullave dhe standardeve të BE-së. Një administratë publike që funksionon mirë është e domosdoshme për një qeverisje demokratike. Pra, drejtpërdrejtë ajo ndikon në aftësinë e qeverive për të ofruar shërbime publike dhe për të kultivuar konkurrencën dhe zhvillimin [SIGMA, 2001/1, Nr.27, fq.4].

Sipas Batallit reforma e administratës publike mund të përkufizohet si “sfidë për të bërë ndryshime të konsiderueshme në qeveri, që i referohen strukturës administrative të përgjegjshme dhe efikasitetit. Si një proces i vazhdueshëm, risitë e administratës publike përfshijnë decentralizimin e administratës publike, thjeshtimin e procedurave, informatizimin e shërbimeve dhe përmirësimin e zhvillimeve në lëmin e burimeve njerëzore” [Batalli, 2012:7].

Profesor Pusiçi thekson se “procesi i reformimit dhe modernizimit të administratës publike është i vazhdueshëm, dhe se ajo kurrë nuk është e thjeshtë, madje edhe në vendet shumë të zhvilluara. Sepse, sado reforma e administratës mund të duket e papërsosur, e dhimbshme dhe e shtrenjtë, ajo nuk është më pak e pamëshirshme se metodat e përdorura në konkurrencën e tregut”.⁴⁸ Kurse, Czarniawska thekson se “reformat administrative shpesh nuk rezultojnë në objektivat zyrtare të pritshme të

⁴⁶Norbert Wimmer, Reform of Public Administration in Austria Activities and Perspectives, Hrvatska Javna Uprava god. 7. (2007.), br. 3., str. 635.

⁴⁷ Tahiri, Edita. Reforma e administratës publike, Intervistë e publikuar në Buletinin e Ministrisë së Administratës Publike, Nr.1/Dhjetor 2010, fq.4.

⁴⁸Pusia, 1999:241 i cituar nga Bađun, Marijana. Governance and public administration in the context of Croatian accession to the European Union, fq.155, Chapter 6, shih <http://www.ijf.hr/eng/EU2/Badjun.pdf>.

përmirësimin, rregullimit me rrethanat e alternuara, rritjen e kapaciteteve institucionale, etj. Megjithëse, ato nuk janë pa efekt në vend, pasi së bashku me rezultatet e dëshiruara, reformat gjithashtu kanë efekte të tjera dhe të ndryshme. Këto janë: shpërndarja e pushtetit, rinovimi i legjitimitetit shoqëror të administratës publike dhe të gjithë sistemit politiko-administrativ, thyerja e rutinës administrative, frikësimit, etj.”(Czarniawska-Joerges,1989).⁴⁹ Azizi thekson se “reforma në administratën publike synon të sigurohet efikasiteti dhe përgjegjësia e pushtetit ekzekutiv në zbatimin e së drejtës, përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët, kontrollin e harxhimit të mjeteve të buxhetit, thjeshtësimin e procedurave administrative në ushtrimin e veprimtarive të ndryshme, si dhe zvogëlimin e aparatit administrativ” [Azizi, 2008:57].

Sipas ministres Tahiri “reformimi i administratës publike nuk është i lehtë për asnjë shtet dhe mund të hasë në pengesa të ndryshme dhe serioze që kërkojnë analizimin e problemeve, për të ardhur deri të zgjidhja, duke iu përshtatur sepcifikave të administratës”.⁵⁰ Një proces i suksesshëm i reformës mund të jetë i përshtatur vetëm individualisht për çdo administratë të veçantë, edhe pse ekzistojnë parimet universale. Kjo sepse reforma e administratës publike kurrë nuk ka qenë një detyrë e lehtë [Stella, 2008: 37].

Sipas Kiviniemi “janë disa elemente kyçe të cilat ndihmojnë për të përcaktuar suksesin e reformave. Së pari, reforma e administratës publike mund të jetë e suksesshëm vetëm nëse qeveria gëzon besimin e qytetarëve të saj. Zbatimi i parimeve ka një ndikim të drejtpërdrejtë në besimin të qeveria. Së dyti, për të arritur këtë, është e nevojshme të krijohet një mjedis, i cili nxit risi dhe një shkallë të caktuar rreziku si dhe shpërblime të menaxherëve të lartë, të cilët janë të suksesshëm në zbatimin e reformave. Së treti, planifikimi i duhur i shpenzimeve të

⁴⁹ Czarniawska-Joerges, 1989 i cituar nga Koprić, Ivan, Priority areas in reforming governance and public administration in Croatia, fq.2.

shih: <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/un/unpan017009.pdf>.

⁵⁰ Tahiri Edita Reforma e administratës publike Intervist e publikuar në Buletinin e Ministrisë së Administratës Publike, Nr.1/Dhjetor 2010, fq.34.

zbatimit dhe një lidhje e ngushtë mes planifikimit dhe menaxhimit të financave publike të politikave, është vendimtar”⁵¹.

Kuadri kushtetues për organizimin dhe funksionimin e administratës qendrore të shtetit ndryshon së tepërmi nga njëri vend në tjetrin. Është veçanërisht e rëndësishme të kuptohen mirë modelet e ndryshme ekzistuese të rregullave dhe të parimeve përkatëse kushtetuese në mënyrë që:

- të kuptohen vështirësitë zyrtare dhe politike të cilat kanë kushtëzuar dhe akoma vazhdojnë të kufizojnë zgjedhjet për organizimin ose reformimin e administratës shtetërore qendrore;

- të identifikohen parakushtet kushtetuese për reformë të mundshme të administratës shtetërore qendrore;

- të identifikohen ndryshimet kushtetuese të cilat mund të jenë të domosdoshme për zbatimin e një reformë të caktuar; dhe

- të zgjidhet zgjedhja e dytë më e mirë në rastin kur kufizimet kushtetuese ekzistuese nuk mund të kapërcehen për shkak të rëndësisë politike të rregullit ose të parimit në fjalë, ose për shkak të mungesës së konsensusit për reformë ndërmjet partive politike [SIGMA (2007)7, Nr. 43, fq.31]. Sipas Bađun “në vendet në tranzicion, si masë e parë në reformën e administratës publike duhet të jetë depolitizimi i administratës, masë e cila duhet arritur nga rekrutimi sipas meritës dhe jo sipas lidhjeve politike”.⁵²

Në Kosovë, nevoja për një administratë publike të reformuar e cila në qendër të vëmendjes ka qytetarët, bizneset dhe vetë institucionet, ka bërë që Ministria e Administratës Publike të Kosovës, të përqendrohet në riorganizimin e brendshëm të administratës shtetërore [MAP Raporti vjetor për vitin 2013, fq.2].

⁵¹Mari Kiviniemi, The Principles of Public Administration in the enlargement process, Conference on Reinforcing Public Administration Reform in the Enlargement Process, Brussels, 12 November 2014, fq.10. Shih:<http://www.sigmaxweb.org/publications/Final%20conference%20report%20%20PAR%20conference%2012%20Nov%202014.pdf>.

⁵²Bađun, Marijana. Governance and public administration in the context of Croatian accession to the European Union, fq.158, Chapter 6; shih: <http://www.ijf.hr/eng/EU2/Badjun.pdf>.

Reforma e administratës publike paraqet një dimension të rëndësishëm të prioritetëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Ministrisë së Administratës Publike, për të ndërtuar një administratë moderne, profesionale dhe efikase. Zhvillimi i administratës publike dhe reformat në këtë sektor, duhet të kenë përherë si pikësypnim të tyre një administratë publike më afër qytetarit, si dhe ofrimin e shërbimeve të shpejta, cilësore dhe financiarisht të përballueshme. Shembulli më i mirë për këtë është projekti i qeverisjes elektronike, i cili siguron ofrimin e shërbimeve dhe veprimeve administrative përmes sistemeve elektronike, duke ndërtuar një urë të shpejtë komunikimi ndërmjet administratës shtetërore në një anë dhe qytetarëve në anën tjetër [MAP Plani zhvillimor strategjik 2009-2013, fq. 2].

Ky proces, edhe pse ka filluar së zhvilluari që nga pas lufta, ka gjetur materializimin e tij konkret me Strategjinë e Reformës së Administratës Publike. Qeveria e Kosovës aprovoi Strategjinë e saj për Reformën e Administratës Publike në mars të vitit 2007, duke synuar përcaktimin e qëllimeve për një periudhë kohore pesë (5) vjeçare. Strategjia mbulonte tetë fusha kryesore: burimet njerëzore, strukturën institucionale, menaxhimin e administratës publike, komunikimin me qytetarët, qeverisjen elektronike, menaxhimin e financave publike, luftën ndaj korrupsionit, si dhe politikën dhe legjislacionin.⁵³ Për zbatimin e Strategjisë u hartua edhe plani i veprimit për reformën e administratës publike, që kishte për qëllim arritjen e këtyre objektivave. Ministria e Administratës Publike synonte të arrinte këto objektivat në fushën e reformimit të administratës publike, të cilat përqendrohen në ndërtimin e një shërbimi civil profesional dhe të paanshëm, në ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin dhe implementimin e Strategjisë së Reformës në Administratën Publike dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, nëpërmjet thjeshtimit të procedurave administrative dhe ngritjes së platformës së qeverisjes elektronike [MAP, Plani zhvillimor strategjik 2009-2013, fq. 2].

⁵³ Qeveria e Republikës së Kosovës Strategjia e reformës së administratës publike (2010-2013) E miratuar me vendimin e Qeverisë nr. 07/145, datë 15. 09.2010, fq. 1-2.

Pas shpalljes se pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, u bë rishikimi i strategjisë, që kishte për bazë kontekstin e ri politik të krijuar si dhe pas vlerësimeve mbi zbatimin e kësaj Strategjie. Mbi këtë bazë, Qeveria e Republikës së Kosovës ishte e angazhuar për rishikimin e strategjisë, me qëllim që reformat në administratën publike të zhvilloheshin konform kërkesave të shtetit të ri për efikasitet, efektivitet dhe evropianizim të administratës. Objektivat e planit të veprimit synonin ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët dhe bizneset, mbrojtjen e vlerave të mundësive të barabarta, paanësinë dhe integritetin në shërbimin civil, përmirësimin e marrëdhënieve me komunitetin e biznesit, zbatimin e *acquis communautaire* dhe shfrytëzimin efikas të resurseve.⁵⁴ Ministria e Administratës Publike miratoi disa Strategji të Reformës së Administratës Publike dhe plane të veprimit, që ishin të përqendruara në rritjen e performancës në menaxhimin e politikave, në hartimin e legjislacionit, në etikë dhe transparencë, në komunikimin me qytetarët, në planifikimin e buxhetit, në ekzekutimin e buxhetit, kontrollin dhe auditimin e brendshëm, prokurimin publik, organizimin e administratës publike, menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, racionalizimin e proceseve elektronike administrative dhe qeverisja elektronike (e-government).⁵⁵ Po kështu, shumë autorë theksojnë se “Qeverisja elektronike çon në modernizimin e administratës publike dhe forcohet qeverisja demokratike (Calista dhe Melistki, 2007), duke siguruar qasje më të madhe dhe transparencë në informacion (Caba dhe të tjerët, 2008), ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara (West, 2004), ndërveprimin më të madh dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në menaxhimin publik (Dunleavy dhe të tjerët, 2006)”.⁵⁶

Ministria e Administratës Publike të Kosovës si bartëse e procesit të koordinimit dhe menaxhimit të reformës së administratës publike, deri më tani ka ndërmarrë një

⁵⁴ Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia e reformës së administratës publike (2010-2013), e miratuar me vendimin e Qeverisë nr. 07/145, datë 15. 09.2010, fq. 4- 5.

⁵⁵ Po aty, fq.6.

⁵⁶ Manuel Pedro Rodríguez-Bolívar Editor Measuring E-government Efficiency The Opinions of Public Administrators and Other Stakeholders , Laura Alcaide-Muñoz, Antonio M. López Hernández, and Carmen Caba-Pérez, Public Managers’ Perceptions of e-Government Efficiency: A Case Study of Andalusian Municipalities, Springer Science+Business Media New York 2014, fq.150.

sërë veprimesh për përmirësimin e shërbimeve të administratës publike, ku një numër i konsiderueshëm i shërbimeve tanimë janë digjitalizuar dhe ato ofrohen në formë elektronike.⁵⁷ Prandaj, për shkak të rëndësisë së Reformës në Administratën Publike në procesin e Integritimit Evropian, është themeluar Grupi i Veçantë për Reformën e Administratës Publike (GVRAP), si trupë e përbashkët e Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, e që është pjesë e agjendës evropiane në procesin e përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA.⁵⁸ Mirëpo, përkundër faktit se janë miratuar disa strategji për reformën e administratës publike dhe janë hartuar Plane të Veprimit për Reformën e Administratës Publike, nga grupet e ekspertëve me përbërje të ekspertëve vendorë e ndërkombëtarë ende nuk kemi realizimin e kësaj reforme.

Në Kosovë, ka nevojë edhe për një riorganizim të administratës publike sepse Institucionet dhe agjencitë që funksionojnë në kuadër të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës janë themeluar ndër vite pa pasur një kornizë ligjore, e cila do të vendoste disa rregulla dhe parime bazë të cilat do të aplikoheshin për të gjitha këto institucione dhe agjenci. Pra, nuk ka pasur rregulla bazike sa i përket themelimit, organizimit, mbikëqyrjes, llogaridhënies, mandatit, qeverisjes dhe reformimit apo përfundimit të mandatit të institucioneve dhe agjencive të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës. Si pasojë e kësaj, të gjitha institucionet dhe agjencitë janë themeluar rast pas rasti, dhe kështu është krijuar një numër i madh i institucioneve dhe agjencive. Janë 76 institucione dhe agjenci në kuadër të Kuvendit dhe Qeverisë⁵⁹ dhe

⁵⁷ Qeveria Republikës së Kosovës, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, fq. 38, shih http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_2015-2018_10_mars.pdf.

⁵⁸ Ministria e Administratës Publike, Raporti vjetor – 2013 i publikuar më datë 31.1.2014, fq.2.

⁵⁹ Sqarim: *Institucione të pavarura Kushtetuese në Kosovë janë*: Gjykata Kushtetuese, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Institucioni i Avokatit të Popullit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Banka Qendrore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Agjencia e Kosovës për Intelejgencë, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Komisioni Pavarur i Mediave.

Institucione në kuadër të Kuvendit janë: Agjensioni Kundër Korrupsionit, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Agjencia Kosovare e Pronës, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Akademia e Shkencës dhe Arteve të Kosovës, Agjencia Kosovare e Konkurrencës, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Instituti Gjyqësor i Drejtësisë, Këshilli i Mbikëqyrjes së Pavarur i Shërbimit Civil, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor, Komisioni i Pavarur i Minerave dhe Mineraleve, Komisioni Rregullativ i Prokurorimit Publik, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe

ekzistojnë më shumë se 20 koncepte me të cilat përshkruhet statusi i këtyre agjencive në ligjet që i kanë themeluar ato.⁶⁰

Sipas opinionit të Deputetëve të Kuvendit të Kosovës të përfshirë në studim “reforma e administratës publike po vazhdon tashmë më vite të tëra, dhe ende nuk është arritur të krijohet një administratë moderne dhe profesionale; ende nuk ka mekanizma të mirëfilltë kontrolli madje edhe ato ekzistuese nuk funksionojnë. Realizimi i reformës së administratës publike është sfidë për Kosovën, mirëpo është i domosdoshëm edhe reformimi i kornizës ligjore”.

Sipas Ministres Tahiri “administrata publike në Republikën e Kosovës është në një proces të reformave të thella në pajtim me kërkesat për një administratë moderne, efikase dhe profesionale. Reforma e Administratës Publike përbën një platformë të studiuar mirë dhe me ekspertizë të gjerë vendore e ndërkombëtare, nga suksesi dhe rezultatet e së cilës varet zhvillimi dhe zbatimi i politikave qeveritare në kontekst me të gjerë, të drejtuara kah zhvillimi ekonomik dhe ofrimi i shërbimeve publike administrative ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Zhvillimin e administratës publike

Parashtrësia, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), Autoriteti i Aviacionit Civil, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, Zyra e Rregullatorit për Energji.

Agjencitë (organet qendrore dhe të pavarura) në kuadër të Qeverisë janë: Agjencia e Kosovës për Akreditim, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia e Statistikave e Kosovës, Agjencia Shtetërore e Arkivave, Avokatura Shtetërore, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, Agjencia për Shoqërinë e Informacionit, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Agjencia Qendrore e Prokurimit, Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Agjencia e Kosovës për Forenzikë, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit e Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Agjencia e Financimit Shëndetësor, Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, Administrata Tatimore e Kosovës, Thesari, Dogana e Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare, Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati i Punës, Agjencia e Punësimit, Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Investimeve në Kosovë, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, Agjencia Kosovare për Standardizim, Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtoria e Akreditimit e Kosovës, Agjencia e Meteorologjisë e Kosovës, Agjencia e Pronësisë Industriale, Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Instituti i Kosovës për Administratë Publike, Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Inspektorati i Tregut, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.

⁶⁰Ministria e Administratës Publike, Rishikimi i Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura të Kuvendit dhe Organeve Qendrore të Qeverisë, fq. 6. Shih: <https://map.rks-gov.net/getattachment/0d53302c-5f3f-4175-bec7-707d9692e3af/Rishikimi-i-Institucioneve-dhe-Agjencive-te-Pavaru.aspx>.

dhe kapacitetin administrativ i konsiderojmë si mjetet kryesore nga të cilat do të varet aftësia e shtetit për t'u marrë me reformat dhe kriteret e kërkuara nga procesi i integritimit evropian të vendit” [Tahiri, 2015].

Këshilli i Bashkimit Europian i ka bërë thirrje Kosovës që të përqendrohet në zbatimin e reformave të gjithanshme të nevojshme për të përmbushur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit (MSA). Kosova duhet të ndërmarrë reforma të rëndësishme, si reformës zgjedhore ashtu dhe reformës së administratës publike, duhet t'i jepet prioritet.⁶¹ Sipas ministres Tahiri “Kosova gjendet para një sfide të madhe që të bëjë reforma të mirëfillta në administratën publike, duke ndjekur teoritë dhe praktikat më të avancuara ndërkombëtare.”⁶² Një shërbim publik i strukturuar, bazuar në standarde, një shërbim jopolitik i bazuar në rekrutim të drejtë dhe transparent, promovim në bazë të meritës dhe ngritjes profesionale, gjithashtu mbeten prioritetet. Po ashtu, duhet theksuar nevoja për krijimin e një sistemi unik të pagave në administratën publike, digjitalizimi i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore, përmirësimi i shërbimeve nëpërmjet rritjes së transparencës dhe fuqizimit të mekanizmit të ankesës dhe qasjes në dokumentet publike, që rezultojnë edhe në mundësinë e korigjimit administrativ dhe ligjor, ofrimi i shërbimeve më të mira nëpërmjet qeverisjes elektronike, si një mundësi më e shpejtë, më e lirë dhe më efiçiente, si dhe monitorimi i shpenzimeve publike, raportimi dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare.⁶³

Administrata publike në Kosovë është e mbingarkuar në punësim me militantë partiakë dhe mbi baza nepotizimi. Intervistuesit gjatë hulumtimit kanë shprehur se “sfida më e madhe për Kosovën mbetet reformimi i administratës publike, që nënkupton zvogëlimin e saj dhe kjo do të krijojë shqetësim të madh social. Për këtë shkak, deri më tani asnjë nga pushtetet në vend, nuk kanë provuar apo nuk e kanë në

⁶¹Council of the European Union, Outcome of Proceedings Enlargement and Stabilisation and Association Process, 15356/15, ELARG 73 COWEB 150, Brussels, 15 December 2015, (OR. en) fq. 19, pika 53. Shih <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15356-2015-INIT/en/pdf>.

⁶²Tahiri, Edita. Reforma e administratës publike, Intervistë e publikuar në Buletinin e Ministrisë së Administratës Publike, Nr.1/Dhjetor 2010, fq. 4.

⁶³Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, fq. 39. Shih http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_2015-2018_10_mars.pdf.

objektiv trajtimin serioz të kësaj çështje. Kjo pasi çështja e reformës së administratës publike në Kosovë më tepër ka të bëjë me kontekstin politik sesa ligjor apo procedural’.

KAPITULLI III. INSTRUMENTET E KONTROLLIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË KOSOVË

Në këtë kapitull do trajtohen të gjitha instrumentet e kontrollit të administratës publike në Republikën e Kosovës, të cilat qoftë në mënyrë direkte apo indirekte ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontroll mbi administratën publike. Punimi fokusohet në analizën e kornizës ligjore të instrumenteve të kontrollit të administratës publike nën Administrimin e Përkohëshëm të UNMIK-ut dhe pas pavarësisë, të cilat rregullojnë themelimin dhe funksionimin e instrumenteve të kontrollit të administratës publike. Po ashtu trajtohet kontrolli parlamentar mbi veprimtarinë e ekzekutivit në procesin e emërimit dhe shkarkimit të ekzekutivit, përgjegjësia politike, dhe kontrolli ndaj institucioneve dhe agjencive të pavarura, kontrolli i brendshëm administrativ, si dhe kontrolli gjyqësor i administratës publike si instrument që ndikon në rritjen e cilësisë së veprimtarisë së administratës dhe qeverisjes së mirë. Gjithashtu, analizohet ndikimi i kontrollit kushtetues të administratës publike nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese, si garantues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe shtetit të së drejtës, si dhe roli i Avokati të Popullit dhe Auditorit të Përgjithshëm si mekanizëm i cili kontrollon përdorimin e fondeve publike nga administrata publike, për një menaxhim të mirë financiar dhe për rritjen e llogaridhënies publike. Në kuadër të mekanizmave mbikëqyrës trajtohet edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil, një institucion i pavarur, i cili zgjidh ankesat e nëpunësve civilë dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil; dhe roli i Agjensisë Kundër Korrupsionit në kontrollin e administratës publike, si mekanizëm që ruan administratën publike nga format abuzive, siç janë: korrupsioni, mitmarrja, nepotizimi dhe konflikti i interesit etj.

3.1. Kuptimi dhe objekti i kontrollit të administratës publike

Segmenti kryesor për funksionimin e një shteti është administrata publike. Zhvillimi dhe përparimi i vazhdueshëm i administratës publike kërkon angazhim të vazhdueshëm jo vetëm të Qeverisë dhe strukturave publike e politike, por edhe të të gjitha segmenteve të shoqërisë.⁶⁴ Për rolin e Administratës Publike, Wilson ka thënë se “administrata është pjesa më e dukshme e Qeverisë”⁶⁵. Ai sheh “një vijë të qartë ndarje midis administratës dhe politikës dhe, që atëherë, kjo ndarje në dy pjesë ka përcaktuar betejat më të vështira në këtë fushë”.⁶⁶ Po kështu, Frank J. Goodnow (1900) argumenton se politika dhe administrata ishin dy funksione të dallueshme të një qeverie. Sipas tij, politika bën formulimin e politikave dhe administrata duhet t’i ekzekutojë këto politika. Goodnow bëri një dallim teknik ndërmjet politikës dhe administratës.⁶⁷ Ishte Frank J. Goodnow, ai i cili përkrahu kauzën Wilson [Donald F. Kettl, 2000:2]. Prandaj, ideja e një administrate të pavarur dhe apolitike e cila fillimisht ishte paraqitur nga Wilsoni (Woodrow Wilson) në shkrimin e tij “Studimi mbi administratën publike” (1887) dhe aplikimi i kësaj ideje, vazhdon të mbetet një risi, përderisa administrata publike është gjithmonë në reformim konstant. Kjo pikëpamje ndaj administratës fillimisht është aplikuar në shtete të orientuara kah demokracia dhe ekonomia e tregut, pasi shtetet e centralizuara komuniste e kanë shpërfillur këtë trend.⁶⁸

Sipas ligjit nr.152/2013 për Nëpunësin Civil në Shqipëri i parashikohen institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale,

⁶⁴ Ministria e Administratës Publike, Raporti gjithëpërfshirës për zbatimin e strategjisë së reformës së administratës publike 2010 – 2013, Qershor 2014, fq.5.

⁶⁵ Module I Unit 1 an introduction to public administration fq.10, shih: http://archive.mu.ac.in/myweb_test/SYBA%20Study%20Material/pol_sc-III.pdf shkarkuar me date 15.01.2015

⁶⁶ Donald F. Kettl, (2000) Public Administration at the Millennium: The State of the Field, Public Administration at Millennium 8/J-PART, January 2000, fq.2

⁶⁷ Module I Unit 1 an introduction to public administration fq.10, shih: http://archive.mu.ac.in/myweb_test/SYBA%20Study%20Material/pol_sc-III.pdf shkarkuar me date 15.01.2015

⁶⁸ Policy Report Politizimi në administratën publike të Maqedonisë, fq.1, Korrik 2011, shih <http://www.analyticamk.org/images/stories/files/report/2011/044/11044policyreport-sq.pdf>.

si dhe administrata e prefektit.⁶⁹ Ky ligj parashikon si pjesë të administratës publike edhe Administratën e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, të Prokurorisë dhe çdo institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutë apo i krijuar me ligj dhe që i raporton Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale.⁷⁰

Me një fjalë, togfjalëshi “administratë publike” është shumë më i gjerë se nocioni i administratës shtetërore, sepse përfshin administratën shtetërore dhe veprimtaritë e institucioneve, të cilat ushtrojnë punë të karakterit publik.⁷¹ Shafritz dhe Russell e definojnë administratën publike nga katër perspektiva të ndryshme: politike, ligjore, menaxheriale dhe profesionale. Në aspektin politik, administrata publike nënkupton atë që qeveritë bëjnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të terthortë në interesin publik përmes ciklit të politikëbërjes. Në aspektin juridik, administrata publike definohet si rregulla dhe ligje në veprim, kurse ajo menaxheriale si degë e qeverisë që kërkon specializimin menaxherial të bazuar në talent natyror dhe përpjekje të vazhdueshme. Parë nga këndvështrimi profesional, administrata publike merret si një kategori e profesionit që kërkon aftësi të mira shkrimi, dozë të lartë të idealizimit dhe stërvitje formale akademike [Pajaziti, 2008:99]. Koncepti “administratë publike” ka si kuptimin e gjerë, ashtu edhe atë të ngushtë.

Sipas autorëve gjermanë, “ky problem mund të diskutohet në dy kritere: nëse do merrnim si kriter vetëm interesin publik dhe financimin e institucioneve nga buxheti i shtetit, atëherë të gjitha institucionet brenda pushtetit ekzekutiv, gjyqësor dhe legjislativ, do t’i konsideronim si administratë publike, duke i dhënë kështu një hapësirë të gjerë këtij koncepti (sensu lato). Kjo lloj doktrine nuk është pa bazë dhe e panjohur, sepse në konceptin formal, administrata përfshin të gjitha veprimtaritë e ushtruara në një shoqëri nga institucionet, të cilat, detyrë kryesore kanë

⁶⁹ Ligj Nr. 152/2013 për Nëpunësin civil në Shqipëri, neni 4, paragrafi 1, pika a.

⁷⁰ Ligj Nr. 152/2013 për Nëpunësin civil në Shqipëri, neni 4, paragrafi 1, pika b

⁷¹ Doracak për zyrtarët komunal të mjedisit, Konventa “Aarhus” Kuptimi, rëndësia dhe aspekte të zbatimit të saj në praktikë, Prishtinë, Shtator 2006, Fq.29, shih web faqe: <http://kos.rec.org/albanian/pdf/Doracaku%20-%20Shqip.pdf>

administrimin në kuptimin material, duke përfshirë të gjitha ato aktivitete, që mund të jenë në vetvete administrative, ekzekutive, legjislativë ose gjyqësore.”⁷²

Nëse do të merrnim në konsideratë vetëm veprimtarinë me natyrë ekzekutive-urdhërdhënëse, atëherë administrata publike ka të bëjë me institucionet e burokracisë shtetërore, strukturat organizative që përbëjnë bazën e marrjes dhe të zbatimit të vendimeve dhe rregullave, koncepti do të ngushtohet, duke përfshirë vetëm ato institucione që e luajnë këtë rol dhe që do të konsideroheshin ngushtësisht administratë publike (strictu sensu)⁷³, të cilat kryejnë shërbimet publike.⁷⁴

Në qasjen klasike "Weberiane", kemi ndarje në dy pjesë midis politikës dhe administratës publike me dallimin normativ midis politikanit demokratik i legjitimuar dhe shërbyesit civil jodemokratik të legjitimuar. Në një demokraci përfaqësuese, "përparësia e politikës" është normë e cila është e lidhur ngushtë me idenë e besnikërisë së shërbyesit civil (Bovens dhe tjerët, 2001). Në modelin standard evropian të administratës, i cili bazohet tek një sistem parlamentar, linja kryesore e përgjegjshmërisë është nga nëpunësit publikë tek anëtarët e qeverisë, nga këta të fundit tek parlamenti, dhe nga anëtarët e parlamentit tek zgjedhësit [SIGMA, (2007)7, nr.43:22].

Në praktikën e sotme, dallimi ndërmjet politikës dhe administratës publike është jo aq i qartë sa duket (Bovens dhe tjerët, 2001). Ajo është plotësuar (sipas Hartit dhe të tjerëve 2002) me një qasje pluraliste moderne, e cila ofron hapësirë për ekspertizën dhe profesionalizmin e nëpunësve civilë [Kool, 2014:16]. Sipas modelit Weberian të administratës, linja hierarkike fillon me politikanin në majë dhe shkon poshtë deri në nivelin e nëpunësit të thjeshtë. Koncepti i përgjithshëm bazohet në një ndarje vertikale sipas fushave të politikave ndërmjet ministrive dhe brenda ministrive.

⁷² H.J.Wolf & O.Bachof, Verwaltungsrecht I, 9th edition, Munich, 1974, f. 212. i cituar nga disertacioni Dr. Artan Kolnikaj me temë: Aktet reale dhe aktet administrative me natyrë diskreciale, Tiranë, 2015, fq. 19

⁷³ H.Maurer, Allgemeines Verwaltungsrecht, 5th edition, Munich, 1986, f. 131, cituar nga Çështje të së drejtës administrative në vështimkrahësues, Grup autorësh, Tiranë, 2010, f. 122-123. i cituar nga disertacioni Dr. Artan Kolnikaj me temë: Aktet reale dhe aktet administrative me natyrë diskreciale, Tiranë, 2015, fq. 19

⁷⁴ McMillan Alistar & Iain Mclean Fjalor përbëldhjes i plotitikes, Oxford University Press, Botimi i tretë IDK, 2011, Fq. 19

Funksionimi i një strukture të tillë hierarkike mbështetet mbi linja të qarta hierarkike, përsa i përket pushtetit vendim-marrës dhe përgjegjshmërisë, mbi ekzistencën e një sistemi pushtetesh dhe sanksionesh disiplinore dhe mbi vëzhgimin e hollësishëm parlamentar të veprimeve të politikanëve [SIGMA, (2007)7, Nr.43, fq.17].

Sipas Profesor Stavilecit, Sokolit &, Batallit “në demokraci, organet e administratës shtetërore realizojnë detyra dhe veprimtari të shumta, nxjerrin akte të llojllojshme dhe aktivitetin e vet e zhvillojnë në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Puna e organeve të administratës shtetërore bazohet në parimin e kushtetutshmërisë, ligjshmërisë ku çdo veprim në administratë dhe çdo akt i organeve të administratës, duhet të jetë i bazuar në dispozita juridike (ligj)” [Stavileci, Sokoli &, Batalli, 2010:111].

Profesorët Pollozhani, Dobjani, Stavileci & Salihu e përkufizojnë kontrollin mbi administratën si “veprimtari të vazhdueshme të mbikëqyrjes, që subjektet juridikisht të autorizuar, e kryejnë lidhur me sjelljen e administratës, të mënyrës së përdorimit të autorizimeve të saja dhe të akteve, përkatësisht të masave që dalin nga përdorimi i autorizimeve shtetërore, përkatësisht publike, të tilla si kontrolli i ligjshmërisë dhe kontrolli i përshtatshmërisë” [Pollozhani, Dobjani, Stavileci & Salihu, 2010:183]. Kurse, sipas Prof. Methasanit “kontrolli do të thotë edhe një e drejtë e qytetarit (subjekteve përkatëse), për të vënë në lëvizje proceset e rishikimit ndaj vendimeve administrative të marra, që prekin interesat e të parit, pra niveli më i lartë i demokracisë në vend” [Eralda (Methasani) Cani, 2010:150].

Sipas S. Sadushit “kontrolli i vlefshmërisë formale të akteve dhe veprimeve administrative bëhet mbi dy arsye: së pari, mbi inkompetencën, që do të thotë së akti administrativ i kundërshtuar pretendohet të jetë nxjerrë nga një organ ose zyrtar publik, pa autorizim përkatës ligjor; së dyti, mbi kompetencën procedurale ultra vires, që do të thotë se akti administrativ është marrë në shkelje të normës procedurale thelbësore që cenon drejtpërdrejt kompetencën e organit. Kontrollin e vlefshmërisë substanciale të akteve dhe veprimeve administrative e ushtron gjykata për dy shkaqe: së pari, për shqyrtimin për shkelje të ligjit, që mund të ndahet në

shqyrtim për shkak të gabimeve në interpretim dhe zbatimin e ligjit dhe fakteve, sipas natyrës së vendimit të kundërshtuar, edhe për gabime në vlerësimin e fakteve; së dyti, shqyrtimi për arsye të shpërdorimit të pushtetit diskrecionar nga organi publik” [Sadushi, 2014:169,170].

Objekt i kontrollit të administratës sipas Prof. Pollozhani, Dobjani, Stavileci & Salihu është “sjellja e administratës, mënyra e përdorimit të autorizimeve me të cilat ajo disponon, pastaj aktet dhe masat të cilat nxirren, përkatësisht ndërmerren. Subjekte të kontrollit janë subjektet të cilët, me normë juridike, janë të autorizuar të kryejnë forma të caktuara të mbikëqyrjes mbi administratën dhe që, në rastet e caktuara, të shfrytëzojnë autorizimet kontrolluese me të cilat disponojnë— subjektet aktive të kontrollit, p.sh organet përfaqësuese (parlamenti, asambleja), gjykatat etj” [Pollozhani, Dobjani, Stavileci & Salihu, 2010:183].

3.2. Historiku i themelimit të instrumenteve të kontrollit të administratës publike në Kosovë

Kosova pas luftës në vitin 1999, u vendos nën administrimin e Kombëve të Bashkuara. Këshilli i Sigurimit më datë 10 Qershor 1999 miratoi Rezolutën 1244 (1999). Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, në paragrafin dhjetë, autorizonte Sekretarin e Përgjithshëm, që me ndihmën e organizatave të tjera relevante ndërkombëtare, të krijonte një prani civile ndërkombëtare në Kosovë, në mënyrë që të vendosej një administratë e përkohshme për Kosovën, të sigurohej administrimi kalimtar derisa të krijoheshin institucionet e përkohshme demokratike vetëqeverisëse, për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Rezoluta në pikën 11, përcaktonte përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare si: përkrahjen dhe krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisje përmbajtësore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare, si dhe organizimin e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse demokratike dhe

autonome deri në zgjidhjen politike, duke përfshirë mbikëqyrjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve. Gjithashtu, aty përcaktohej edhe faza përfundimtare e mbikëqyrjes, për kalimin e pushtetit nga Institucionet e Përkohshme të Kosovës tek institucionet e themeluara me marrëveshje politike. Administrata e Përkohshme duhet të siguronte administrimin kalimtar, derisa krijon dhe mbikëqyr zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse, për të siguruar kushte për një jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës.⁷⁵

Me deklarin e pavarësisë së Kosovës më datë 17 shkurt 2008 nga Kuvendi i Kosovës, Rezoluta si e tillë, edhe pse e pasuprimuar juridikisht nga KS i OKB-së, faktikisht është Rezolutë e pazbatueshme. Kjo për shkak të krijimit të marrëdhënieve të reja dhe zgjidhjes përfundimtare të statutit politik të Kosovës si dhe pranimit të pavarësisë së saj nga shtetet me fuqi vendimmarrëse në Evropë dhe botë [Susuri, 2011:65]. Pra Rezoluta 1244, ka përcaktuar qeverisjen substanciale të institucioneve të Kosovës, drejt krijimit të institucioneve të qëndrueshme demokratike dhe të kushteve për zgjidhjen e statusit final të saj [Bajrami, 2004:6].

Administrimi i Kosovës nga UNMIK-u e gjeti vendin të shkatërruar nga lufta, pa institucione vendore dhe pa infrastrukturë ligjore. Në Kosovë, për disa kohë institucionet aplikonin ligjet e miratuara në periudhën e ish-Jugosllavisë socialiste, si ligje federative, republikane dhe krahinore, si dhe aktet nënligjore që ishin miratuar para viteve 1999 ato ligje të miratuara të cilat nuk ishin diskriminuese për qytetarin. Kjo mungesë e infrastrukturës ligjore, e detyroi Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të miratojë disa rregullore që kishin fuqi ligjore për themelimin e institucioneve, dhe me dispozita ligjore parashikonte edhe kontrollin e administratës publike. Themelimi i institucioneve dhe instrumenteve të kontrollit të administratës publike në Kosovë është rregulluar me akte nënligjore siç janë rregulloret e miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të cilat kanë pasur fuqinë e ligjeve. Neni një i Rregullores për Autorizimet e Administratës së Përkohshme Nr.1999/1 përcaktonte se gjithë pushteti legjislativ

⁷⁵ Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara pika 11 dhe ankesi dy

dhe ekzekutiv në Kosovë, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, është kompetencë e UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm apo kryeadministratori. Kryeadministratori kishte përgjegjësi të emëronte dhe shkarkonte çilindo person që kryente funksione në administratën civile në Kosovë, duke përfshirë edhe ato të sektorit të drejtësisë (prokuror dhe gjyqtar). [Rregullore Nr.1999/1 UNMIK/Rreg/1999/1, neni 1-2].

Me vendosjen e Kosovës nën Administrimin e Përkohshëm Civil Ndërkombëtar (1999) u nxorrën një numër rregullash juridike që pretendonin ta bënin me të lehtë funksionimin e tij. Mirëpo, kompleksiteti i raporteve të organeve dhe organizatave ndërkombëtare të instaluar në Kosovë krijuan kompleksitet edhe në fushën e legjislacionit. Zbatimi i rregulloreve të UNMIK-ut, si ligje të veçanta, ndërkohe që nuk janë shfuqizuar ligjet e Serbisë dhe të ish Jugosllavisë. Prej kohës kur Kosova kishte fituar të drejtën që të merrte pjesë në krijimin e legjislacionit, ishte krijuar një konfuzion legjislativ [Baraliu & Stavileci 2014:336]. Prandaj, në fazën e parë do të duhej të vendoseshin caqet e një rendi juridik burimor, i cili do të pamundësonte aplikimin e një legjislacioni, mbi bazën e të cilit është zbatuar represioni e dhuna në Kosovë me pasoja të rënda, që shpinin deri në shfarosjen e shqiptarëve [Stavileci, 2009:257]. Sipas Batallit “gjatë pesë viteve të para të periudhës së pas konfliktit në Kosovë, ndërtimi i administratës publike ka kaluar në tri faza kryesore: krijimi i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (KB), formimi i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) dhe lansimi i planit implementues “Standardet për Kosovën” [Batalli, 2012:9].

Administrata publike në Kosovë është organizuar në dy nivele: niveli qendror që ka përfshirë insitucionet e UNMIK-ut dhe Institucionet e Vetëqeverisjes të Përkohshme dhe niveli lokal, që ka përfshirë autoritetet e nivelit lokal siç janë komunat. Që nga vitit 1999, pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Republikën e Kosovës dhe pas zgjedhjes së institucioneve vendore demokratike në nivelin qendror dhe lokal, është bërë bartja progresive e përgjegjësive nga autoritetet ndërkombëtare në autoritetet vendore. Në vazhdimësi të kësaj, ka qenë edhe procesi i bartjes së

kompetencave nga organet e nivelit qendror në organet lokale, si dhe themelimi i komunave të reja [MAPL, 2012:45].

Në Kosovë, baza ligjore që mundësoi themelimin dhe funksionimin e mekanizmave të kontrollit të administratës publike ishin rregullore të UNMIK-ut, Korniza Kushtetuese dhe miratimi i ligjeve nga Kuvendi i Kosovës dhe pas shpalljes së pavarësisë është Kushtetuta në përgjithësi dhe ligjet e veçanta të cilat rregullojnë fushën e kontrollit të administratës publike. Pas pavarësisë së Kosovës, BE-ja është aktive në Kosovë nëpërmjet përfaqësuesit të saj special (EUSR) dhe misionit të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Evropës (ESDP) në sferën e sundimit të ligjit (EULEX). Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë luan një rol në promovimin e standardeve evropiane. EUSR-ja (Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian në Kosovë) ofron këshilla dhe ndihmë për Qeverinë e Kosovës, koordinon praninë e BE-së dhe promovon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, kurse EULEX-i jep ndihmë për autoritetet kosovare në sferën e sundimit të ligjit, veçanërisht në polici, në sistemin gjyqësor dhe në dogana.⁷⁶ Ky mision funksionon mbi një bazë ligjore që, në njërin anë ka burim të ashtuquajturin Plani i Ahtisaarit dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe, në anën tjetër Rezolutën e OKB-së 1244, e cila është neutrale ndaj statusit të Kosovës [Raport politikash nga GLPS & DPC, Nr. 05, Prill 2014: 6].

3.3. Mekanizmat institucionalë për kontrollin e administratës publike në Kosovë

Në çdo shtet demokratik duhet të respektohet parimi i ndarjes së pushtetit, i cili nënkupton ndarjen e pushtetit në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, organet e veçanta për ushtrimin e këtyre pushteteve, si dhe raporti midis organeve bartëse të këtyre pushteteve. [Salihu, 2001:214]. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e

⁷⁶Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian në Kosovë Shih: https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/7641/kosova-dhe-be-ja_sq.

përcaktuar prej tyre. Çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore.⁷⁷ Sipas Charls Monteskie (1689-1755): “Në mënyrë që të mos mund të keqpërdoret pushteti, duhet që, duke i mbarshtruar punët, pushteti ta ndalë pushtetin. Një kushtetutë mund të jetë e atillë që asnjëri të mos jetë i shtrënguar t'i bëjë ato punë për të cilat ligji nuk e detyron dhe të mos i bëjë ato që ligji ia lejon” [Gyshe, 2005:413].

Sipas Profesor Bajramit “Balanca dhe ekuilibri i pushteteve në shtetet demokratike parlamentare duhet të arrijë dy qëllime kryesore: e para, të sigurojë pavarësinë e pushteteve; e dyta, të kufizojë pushtetet, duke përcaktuar mekanizma të kontrollit të tyre reciprok. Rëndësia e ndarjes së pushteteve, qëndron në krijimin e sistemeve të kontrolleve dhe të ekuilibrave” [Bajrami, 2005:74]. Sipas Profesor Stavileci “qeverisja e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve nuk lë shumë hapësirë që të jetë autoritare, por krijon mundësinë për më shumë vlera të shtetit të së drejtës, sepse synon që veprimet e të gjitha organeve të bazohen brenda kufijeve të ligjit, por nga ana tjetër krijon mundësinë për të patur një sistem politik më demokratik” [Stavileci, 2009:299]. Në çdo shtet demokratik duhet të respektohet parimi i shtetit të së drejtës që nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative.⁷⁸

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin katër, ka përcaktuar formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit si dhe kontrollin e balancat mes tyre.⁷⁹ Mekanizmat e kontrollit të administratës publike janë: kontrolli i administratës nga Kuvendi, kontrolli brenda administratës publike, kontrolli gjyqësor, kontrolli i administratës nga Avokati i Popullit dhe kontrolli nga Auditori i Përgjithshëm. Në vijim do të shtjellojmë mekanizmat institucionalë të kontrollit të administratës publike në Kosovë.

⁷⁷Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë Nr. 15, datë 15.04.2010 (V – 15/10)

⁷⁸ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë Nr. 15, datë 15.04.2010 (V – 15 /10)

⁷⁹Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 4

3.3.1. Kontrolli politik i administratës publike

Kontrolli parlamentar⁸⁰ në vendet me demokraci të zhvilluar dhe në vendet që kanë përcaktuar sistemin parlamentar, përbën një nga format me të rëndësishme të kontrollit të jashtëm të administratës publike [Stavileci,2010:101].Kuvendi, ushtrimin e funksionit të kontrollit, e bën në komisione parlamentare, komisione hetimore, në senaca publike dhe në ushtrimin e funksionit të shkarkimit [Bufi, 2010:497]. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 4 dhe Kapitullin IV, neni 63 ka përcaktuar qartë se Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës, i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Duke iu referuar nenit 65 të Kushtetutës, në kuadër të kompetencave të Kuvendit, parashikohet se Kuvendi në pajtim me Kushtetutën, zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj si dhe mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit.⁸¹ Sipas Profesor Bufit “funksioni i kontrollit parlamentar është atribut kushtetues i institucionit të Parlamentit. Funksioni i kontrollit përcakton veprimtarinë politike të Parlamentit dhe përfshin një numër të madh instrumentesh, nga ato që vënë në pikëpyetje përgjegjesinë e qeverisë deri në ato të veprimtarisë me karakter thjesht informativ [Bufi, 2010:497]. Paralel me funksionin përfaqësues dhe ligjvënës, mbikëqyrja e Qeverisë dhe mbajtja e saj përgjegjëse konsiderohet si një nga përgjegjësitë kryesore të parlamenteve demokratike.E drejtë dhe përgjegjësi e parlamentit që përfaqëson interesat e qytetarëve është që vazhdimisht të mbikëqyrë performancën e degës ekzekutive [Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak, 2012:7]. Sipas Profesor Bufit “funksionet kryesore të kontrollit parlamentar janë: të zbulojë dhe të parandalojë abuzimet, sjelljet arbitrare ose jo ligjore dhe antikushtetuese të qeverisë dhe organizmave publike, si dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të qytetarëve” [Bufi, 2010:497]. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e

⁸⁰Shala, Mervete Politic Control of Public Administration from Assembly of Kosovo Academic Journal of Interdisciplinary Studies MCSER Publishing, Rome-Italy, Vol 4 No 2 S1 2015, Fq. 138-146; E-ISSN 2281-4612 ISSN 2281-3993 (Pjesë të veçanta të kontrollit politik dhe instrumeteve të kontrollit politik të punimit është publikuar në këtë Revist shkencore).

⁸¹Kushtetuta e Republikës se Kosovës neni 63 dhe 65

ligjeve, e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Për më tepër, mandati i kontrollit parlamentar të Kuvendit të Kosovës nuk kufizohet vetëm në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, por ai përfshin edhe institucionet e tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit të Kosovës.⁸²

Në një demokraci parlamentare, mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjeve është po aq e rëndësishme sa edhe procesi i miratimit të tyre. Edhe pse mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjeve bëhet edhe nga shoqëria civile, vetëm institucionet publike janë përgjegjëse që gjetjet nga aktivitetet mbikëqyrëse t'i shndërrojnë në hapa konkretë për ndryshim të gjendjes faktike. Përmes mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, Kuvendi mund të nxjerrë informata rreth zbatimit praktik të ligjeve, si dhe të kërkojë përgjegjësi politike nga bartësit e institucioneve, nëse mësohet se institucioni zbatues nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara me ligj [Kuvendi i Republikës të Kosovës, Doracak 2012:20].

Në këtë aspekt fatkeqësisht probleme të shumta po e përcjellin Kuvendin edhe në ditët e sotme. Paaftësia për të realizuar planin legjislativ të punës së tij, cilësia jo e mirë e ligjeve të miratuara, kontrolli tejet i dobët parlamentar ndaj Qeverisë, mos zbatimi i ligjeve në praktikë, degradimi i rekomandimeve apo qëndrimeve të Kuvendit nga ana e Qeverisë, janë fakte të cilat nuk po mund ta çojnë këtë institucion në kryerjen e obligimeve sipas kompetencave të garantuara me rendin juridik në Kosovë.⁸³ Po kështu, Kuvendi duhet të përmirësojë mbikëqyrjen e kompanive publike, institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullative. Në këtë drejtim, duhet të themelohen mekanizmat adekuate, më baza të qarta ligjore për raportim dhe llogaridhënie. Ndër sfidat kryesore të cilat duhet të adresohen janë: vonesat në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të këtyre institucioneve dhe autoriteteve si dhe dështimi për të përcaktuar mekanizmat për llogaridhënie të anëtarëve të Bordit. Shumë emërime janë bërë në bazë të preferencave politike dhe

⁸²KDI, Raport Fletënotim Kuvendi i Republikës së Kosovës I – VI/2013, fq. 5

⁸³Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Lëvizja FOL, Instituti për Studime të Avancuara GAP, Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL). Raporti i progresit made in Kosova, Tetor 2010, Prishtinë, fq.10

jo sipas kualifikimeve profesionale, ose janë shtyrë për shkak të mosmarrëveshjeve politike [Komisioni Evropian (2014) Raporti i Progresit për Kosovën, fq. 8].

Në çdo shtet me demokraci përfaqësuese të zhvilluar, organet legjislativë kanë mekanizma të veçantë përmes të cilëve mbikëqyrin punën e institucioneve ekzekutive.⁸⁴

Kuvendi i Kosovës krahasuar me tre legjislaturat e mëparshme, ka bërë progres në mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në konsultimet me shoqërinë civile. Numri i aktiviteteve monitoruese dhe niveli i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit është rritur në legjislaturën e katërt [Komisioni Evropian (2014) Raporti i Progresit për Kosovën, fq.8].

3.3.1.1. Instrumentet e kontrollit parlamentar në Kosovë

Kuvendi është vendi i vetëm për politikëbërësit e zgjedhur që të ndajnë mendimet, shprehin qëndrimet dhe hartojnë politikat në një mjedis që mbron lirinë e dialogut rreth të cilës ndërtohet demokracia. Sigurisht që ekzistojnë dallime në mes demokracive përfaqësuese në kuptimin e kërkesave kushtetuese apo ligjore, si dhe traditave të ndryshme politike.⁸⁵

Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 4 paragrafi një, e ka përcaktuar Kosovën Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.⁸⁶ Kuvendi e mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit.⁸⁷ Janë dispozitat kushtetuese ato që zakonisht përcaktojnë mjetet që duhet të përdorin parlamentet për ushtrimin e

⁸⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak funksioni mbikëqyrës i komisioneve parlamentare, Prishtinë, Qershor 2012, fq. 7

⁸⁵ OSBE Mesioni në Kosovë, Shoqëria civile dhe procesi legjislativ në Kosovë, Studim analitik në fund mandatit të dytë të Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, dhjetor 2007, fq.10

⁸⁶ Kushtetuta Republikës së Kosovës neni 4 paragrafi një dhe dy.

⁸⁷ Po aty, neni 65, paragrafi 9.

funksionit të kontrollit, si: pyetjet, interpelancat, mocionet, debatet, hetimet, raportimet etj.[Bufi, 2010:498].

Kuvendi, si institucioni më i lartë përfaqësues në vend dhe me premisa të një institucioni demokratik që nga konstituimi i legjislaturës së parë, vazhdimisht po përballlet me sfida dhe probleme të vazhdueshme në ndërtimin e një institucioni i cili do të ishte pishtar i vlerave demokratike në Kosovë.⁸⁸ Për arsye të statusit të saj të veçantë ligjor dhe ndërkombëtar, sistemit të ndërlikuar të bashkëqeverisjes së agjencive ndërkombëtare dhe vendore, si dhe mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi punët e saj, faktorë të jashtëm kanë formësuar agjendën legjislative të Kosovës, shpeshherë jo domosdoshmërisht të dalë nga nevojat e shoqërisë. Agjenda legjislative e Kosovës nuk ishte transparente dhe e qartë, aq sa shoqëria të mund ta formësonte atë.⁸⁹ Aktiviteti mbikëqyrës i Kuvendit të Kosovës ndaj Qeverisë dhe institucioneve të pavarura, që nga zgjedhjet e para qendrore, nuk ishte në nivelin e duhur. Kjo për shumë arsye, si: mungesa e përvojës parlamentare në Kosovë për disa vite, qeverisja në koalicion duke përfshirë në qeverisje tre partitë më të mëdha dhe krizat qeveritare, mungesa e një opozite konstruktive që nga fillimet e para të parlamentarizmit në Kosovë, mosarritja e kuorumit dhe bojkotet e seancave plenare, të cilat rezultojnë me vonesa në marrjen e vendimeve dhe miratimin e legjislacionit si dhe pamundësim të kontrollit të punës së Qeverisë dhe institucioneve të pavarura [Komisioni Evropian (2014) Raporti i Progresit për Kosovën, fq.8].

Kushtetuta në nenin 97 përcakton se Qeveria, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat mbajnë përgjegjësinë për vendimet që merr Qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësisë të tyre.⁹⁰ Më Kushtetutë është përcaktuar ndarja e pushteteve dhe kontrolli e balancimi në mes tyre,⁹¹ por në praktikë, ky parim po

⁸⁸QKSS, Lëvizja FOL, GAP,KPJ, KDI & IPOL Raporti i progresit made in Kosova, Tetor 2010, Prishtinë, fq.10

⁸⁹ OSBE Mesioni në Kosovë, Shoqëria civile dhe procesi legjislativ në Kosovë Studim analitik në fund të mandatit të dytë të Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, dhjetor 2007, Fq. 7

⁹⁰Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 97 Gazeta zyrtare, nr. 03.06.2008

⁹¹ Po aty, shih Neni 4 paragrafi 1

tregon se në Kosovë akoma nuk është arritur niveli i respektimit të aktit më të lartë të vendit.

Ky kontroll parlamentar realizohet nëpërmjet mjeteve të tilla si: pyetjet, interpelancat, komisionet hetimore, mocioni i mosbesimit dhe shkarkimi i qeverisë, të cilat konsiderohen si mekanizma politike të kontrollit [Vendimi i GJK shqiptare Nr.15, datë 15.04.2010 (V – 15/10)]. Në vijim do të trajtojmë instrumentet e kontrollit parlamentar të cilat Kuvendi i Kosovës i ka në dispozicion sipas dispozitave kushtetuese, legjislacionit dhe Rregullores së punës së Kuvendit.

3.3.1.1.a. Interpelancat parlamentare

Profesor Bufi thekson se “Interpelanca është një kërkesë zyrtare për informacion ose për sqarime në lidhje me një politike të Qeverisë. Në një numër rastesh, procedohet me një votim në vazhdim të interpelancës, duke përfshirë mocionin të besimit” [Bufi, 2000: 526].


Sipas Profesor Omarit & Anastasit “përsa i përket efikasitetit, interpelanca sipas doktrinës, ka dy karakteristika kryesore: mund të hapë debat mbi orintimet e Qeverisë, në të cilin mund të marrin pjesë deputetë të ndryshëm, veç atyre që kanë paraqitur interpelancë. Madje, si rregull, në disa parlamente interpelanca nënkupton një mbajtje qëndrimi nga ana e Parlamentit, për arsye se debati përfundon në një votim që shpreh kënaqësinë ose pakënaqësinë për shpjegimet e dhëna nga Qeveria” [Omari & Anastasi, 2010:264].

Sipas nenit 44 të Rregullorës së punës së Kuvendit të Kosovës është përcaktuar se një grup parlamentar ose gjashtë (6) a më shumë deputetë, mund të parashtrajnë kërkesë për interpelancë për të shqyrtuar një çështje që lidhet me punën e Qeverisë ose të një Ministrie. Punimet e Kuvendit për shqyrtimin e një interpelance mund të zgjasin deri në tre orë. Duke u bazuar në nenin e lartëcekur, paragrafi pesë, mocioni për interpelancë i dorëzohet Kryetarit të Kuvendit. Kryetari, brenda dy ditësh, pas marrjes, ia përcjell Kryeministrit ose ministrit, të cilit i drejtohet mocioni.

Kryeministri ose ministri është i detyruar ta shqyrtojë mocionin brenda shtatë ditësh. Kryeministri ose ministri, të cilit i parashtrohet interpelanca, e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë për çështjen e shtruar në interpelancë. Interpelanca për të njëjtën çështje nuk mund të parashtrohet më shumë se dy herë gjatë një viti kalendarik.⁹²

Interpelanca si mekanizëm i mbikëqyrjes mbi ekzekutivin është përdorur shumë pak në Kuvendin e Kosovës, kjo pasqyrohet më së mirë në vijim.

Grafiku 1: Interpelancat e mbajtura në Kuvendin e Kosovës në pesë legjislatura



Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve të Kuvendit⁹³, të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku pasqyron interpelancat parlamentare të mbajtura në Kuvendin e Kosovës prej periudhës së legjislaturës së parë të vitit 2001 deri në dhjetor 2017 në legjislaturën e pestë. Në Kuvendin e Kosovës gjatë legjislaturës së parë 2001-2004 dhe deri në qershor të vitit 2006, është mbajtur vetëm një interpelancë parlamentare.⁹⁴

⁹²Regullorë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 44.

⁹³Kuvendi i Republikës së Kosovës Raport për punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Legjislaturën e V 2014-2017 Prishtinë Qershor 2017 Fq.21, Raport për punën e Kuvendit për Legjislaturën e IV-të 2011-2014 Qershor 2014 fq.4, Raport për punën e Kuvendit për Legjislaturën e III-të 2008-2010, Qershor 2010 Fq.23

⁹⁴KDI & Forum 2015 Raport (analize) mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë 2013: 16

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në Legjislaturën e tretë (2008-2010), ka mbajtur vetëm katër interpelanca.⁹⁵ Kurse, në vitin 2011 Kuvendi thirri Kryeministrin në tre interpelanca dhe një interpelancë Ministren e Tregtisë dhe Industrisë.⁹⁶ Në legjislaturën e katërt (IV) në Seancat Plenare, kur në rend dite ishin interpelancat e ministrave, në kohën kur Kuvendit i propozohej votimi i mocionit, është aplikuar bojkotimi i Kuvendit nga Qeveria dhe deputetët e pozitës⁹⁷.

Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012 ka diskutuar në katër interpelanca lidhur me çështjen e personave të pagjetur, procesin e privatizimit, taksën e eksportit dhe politikën e jashtme, të cilat janë mbajtur në pajtim me nenin 44 të Rregullorës së Punës së Kuvendit. Dy nga katër mocione kanë rezultuar me një varg rekomandimesh të miratuara nga Kuvendi për Qeverinë. Edhe në këtë rast, miratimi i rekomandimeve nga ana e Kuvendit ishte përmbyllja e procesit mbikëqyrës, pasi kërkesit e interpelancave nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim për të përcjellë më tutje zbatimin e këtyre rekomandimeve.⁹⁸ Ndërsa, në Kuvendin e Kosovës gjatë vitit 2013, janë zhvilluar tre interpelanca parlamentare.⁹⁹ Prej fillimit të vitit 2011 deri në dhjetor të 2013, Kuvendi i Kosovës ka zhvilluar 11 interpelanca parlamentare.

Në legjislaturën e IV është rritur dukshëm numri i interpelancave parlamentare dhe iniciativave të tjera për kontroll parlamentar ndaj qeverisë. Mirëpo, partitë e koalicionit qeverisës në shumicën e rasteve kanë arritur që në fund të debatit, me votat e tyre kundër, të mos miratojnë mocionet e ngritura nga parashtruesit ose

⁹⁵ Kuvendi i Republikës të Kosovës Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Dr. Jakup Krasniqi për aktivitetet e Kuvendit të Kosovës gjatë Legjislaturës III (2008-2010), në takimin e fundvitit me gazetarë dhe kryeredaktorë.

⁹⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës Aktiviteti legjislativ i Kuvendit gjatë vitit 2011 (Shkurt -Dhjetor 2011) Kuvendi, 22 Dhjetor 2011, Legjislatura IV-të

⁹⁷ Procesverbali i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 12 e 13 Korrik 2012, Mbledhja plenare e Kuvendit P- 71, Prishtinë, më 12 Korrik 2012, Interpelanca e ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35 % për importimin e çimentos nga Shqipëria

⁹⁸ OSBE, Misioni në Kosovë Raport i monitorimit të punës së Kuvendit Korrik, 2013, Fq.7

⁹⁹ Kuvendi i Republikës të Kosovës Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi, në takimin e fundvitit me media; me gjerësisht shiko në : <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,184,182>

iniciuesit e interpelancave, gjë që ka zbehur rëndësinë e këtij instrumenti demokratik.¹⁰⁰

Në legjislaturën e pestë, Kuvendi i Kosovës në periudhën 8 dhjetor 2014 - 2017 ka mbajtur gjashtë (6) Interpelanca.Pra, Interpelancat e mbajtura janë: Dy interpelanca me kryeministrin Isa Mustafa për përgjegjësinë kushtetuese të Qeverisë për themelimin e Gjykatës Speciale dhe për përgjegjësinë dhe ushtrimin e kompetencave kushtetuese neni 94, paragrafi 1, pika 3 e Kushtetutës së Kosovës; dhe një interpelancë me ministrin e Jashtëm Hashim Thaçi, lidhur me procesin e demarkacionit të kufirit Kosovë - Mali i Zi.¹⁰¹ Në vitin 2016 u mbajtën dy interpelanca dhe në vitin 2017 një interpelancë me kryeministrin Mustafa. Përkundër ekzistencës të kësaj të drejte,e cila në vendet me demokraci të konsoliduar konsiderohet si një nga instrumentet më të rëndësishme të kontrollit parlamentar të Qeverisë, Kuvendi i Kosovës përkatësisht deputetët, nuk e kanë shfrytëzuar këtë formë të mbikëqyrjes parlamentare.¹⁰²

Kuvendi i Kosovës gjatë kësaj periudhe 2001 deri në dhjetor të vitit 2017, në ushtrimin e mandatit të tij si mbikëqyrës i punës së Qeverisë dhe Institucioneve tjera të cilat i raportojnë Kuvendit, ka mbajtur 24 interpelanca parlamentare.Kuvendi i Kosovës nuk e shfrytëzoi këtë instrument të kontrollit aq sa ishte e nevojshme, për arsye se i mungoi vullneti politik dhe pamundësia e sigurimit të numrit të deputeteve për t'i kërkuar interpelancë Qeverisë. Sikur deputetët të kërkonin më shumë interpelanca parlamentare, do të arrihej një mbikëqyrje më efikase ndaj Qeverisë.

¹⁰⁰KDI & Forum 2015 Raport (analize) mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë, 2013: 16

¹⁰¹Kuvendi i Kosovës Raport i punës së Kuvendit për periudhën 8 Dhjetor 2014 - 3 Gusht 2015, fq.4

¹⁰²QKSS, Lëvizja FOL,GAP, KPJ, KDI & IPOL, Raporti i progresit made in Kosova, Tetor 2010, Prishtinë, Fq.11

3.3.1.1.b. Mocioni i votëbesimit dhe shkarkimi i qeverisë

Profesor Bajrami thekson se “institutit i votëbesimit të Qeverisë paraqet institutin kryesor të kontrollit parlamentar, me të cilin shtrohet përgjegjësia politike e Qeverisë në Parlament. Ky është instrumenti më i fuqishëm të cilin e disponon Parlamenti dhe mjeti me të cilin ai ushtron kontrollin mbi Qeverinë dhe instrumentin me të cilin drejtpërdrejt shtrohet çështja e kontrollit politik të Qeverisë” [Bajrami, 2005:112]. Sipas Profesor Bufit “Mocioni i mosbesimit është një institut tipik i formës së qeverisjes parlamentare dhe gjysmë-persidenciale, është fjala për një akt nëpërmjet të cilit parlamenti tregon se ka humbur besimin ndaj Qeverisë” [Bufi, 2000:532].

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 100, ka përcaktuar mocionin e votëbesimit të Qeverisë. Mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë mund të ngrihet me propozimin e një të tretës (1/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Votëbesimin e Qeverisë mund ta kërkojë Kryeministri (Kushtetuta, neni 100) dhe kjo shihet si ‘presion’ që Qeveria bën mbi Kuvendin [Hasani & Çukaloviç, 2013:379]. Mocioni i mosbesimit vihet në rendin e ditës të Kuvendit, jo më vonë se 5 ditë e as më herët se 2 ditë nga data e parashtrimit të tij. Konsiderohet se mocioni i mosbesimit është pranuar, nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Nëse mocioni i mosbesimit dështon, mocioni tjetër i mosbesimit nuk mund të ringrihet gjatë nëntëdhjetë ditëve të ardhshme. Nëse mocioni i mosbesimit votohet për Qeverinë në tërësi, atëherë Qeveria konsiderohet e dorëhequr.¹⁰³

Sipas Profesor Omarit “ideja e përgjegjësisë politike të qeverisë është strumbullari i regjimit parlamentar. Qeveria e përcakton vetë politikën e saj, por nuk mund ta zbatojë atë dhe të qëndrojë në fuqi pa besimin e parlamentit. Në rast mosmarrëveshje ndërmjet qeverisë dhe parlamentit, ky i fundit mund ta rrëzojë qeverinë”.¹⁰⁴ Sipas Profesor Bajramit “shkarkimi i Qeverisë paraqet instrumentin e fundit të përgjegjësisë politike të Qeverisë, përmes të cilit Parlamenti i merr

¹⁰³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 100

¹⁰⁴ Omari, Luan. Sistemi parlamentar lindja dhe evolucioni i parlamentarizmit Pralamenti në Shqipëri (vështrim historiko-juridik) Botimi i katërt, Elena Gjika, Tiranë, fq.69

mandatin Qeverisë si pasojë e votimit të mosbesimit. Pra, në rast të votëbesimit, në procedurë parlamentare, Qeveria konsiderohet e shkarkuar. Shkarkimi, në kuptimin juridik paraqet një lloj sanksioni, të cilin Parlamenti e ndërmerr ndaj Qeverisë, si pasojë e mosrealizimit të programit, i cili me parë ka marrë besimin në Parlament” [Bajrami, 2005:116]. Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar dy herë mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe një mocion për shpërndarjen e Parlamentit të Kosovës.

Rasti i parë i mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës është ngritur me 2 nëntor 2010, me propozimin e Grupit Parlamentar të AKR-së, me mbështetjen e 40 deputetëve, me arsyetimin se kriza institucionale, e shkaktuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që ka konstatuar shkelje serioze të Kushtetutës nga ana e presidentit, ka rezultuar me dorëheqje të presidentit të Republikës së Kosovës dhe pas tërheqjes së Lidhjes Demokratike të Kosovës nga koalicioni qeveritar, rrezikon të derivojë me krizë të përgjithshme institucionale në vend.¹⁰⁵

Rasti i dytë i mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës, është parashtruar më 10 Maj 2017, i propozuar nga grupet parlamentare “Nisma për Kosovën”, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lëvizja “Vetëvendosje”, e mbështetur nga 42 deputetë.¹⁰⁶ Kuvendi e miratoi mocionin e mosbesimit për Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe në të dy rastet, deputetët e PDK-së i votuan mocionin e mosbesimit edhe pse ishin parti në pushtet.

Në Kuvendin e Kosovës ka pasur tentativa të ngritjes së mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë Thaçi II në vitin 2014 (muajin prill 2014) nga deputetët e partisë së *Aleancës të Ardhmërisë së Kosovës* (AAK-së). Kjo tentativë për sigurimin e nënshkrimeve të deputetëve të opozitës dështoi, për arsye se partitë e tjera opozitare nuk e përkrahën dhe nuk kishte mundësi të sigurote vota të mjaftueshme për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Po kështu, qeveria nuk i kishte votat për

¹⁰⁵Kuvendit Republikës së Kosovës Transkripti i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Kosovës të Republikës së Kosovës, të mbajtur me 2 Nëntor 2010, fq.2

¹⁰⁶ Kuvendi i Kosovës Transkripti i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 10 Maj 2017, fq. 68.

votimin e çështjeve më të rëndësishme që ishin në rend ditës në Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës.

Më 7 maj 2014, grupi prej 57 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, propozoi që mbi bazën e nenit 82, pika 2 e Kushtetutës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës të shqyrtojë *mocionin për shpërndarjen e Parlamentit të Kosovës*, propozim që u miratua. PDK-ja e mbështeti këtë mocion me përgjegjësinë si mazhorancë për ta ruajtur funksionalitetin kushtetues të Kuvendit të Kosovës dhe stabilitetin e përgjithshëm institucional të institucioneve të Republikës së Kosovës.¹⁰⁷

3.3.1.1.c. Pyetjet parlamentare

Profesor Bufi thekson se “Parlamentarët munden rregullisht t’i bëjnë pyetje Qeverisë për t’i kërkuar asaj llogari. Natyrisht, ata mund të marrin informacione nëpërmjet mjeteve të tjera, për shembull, duke komunikuar në mënyrë informale me përgjegjësit e rëndësishëm të administratës. Duke i bërë pyetje parlamentare, qeveria është e detyruar të japë një përgjigje, e cila është njëkosisht publike” [Bufi, 2000:520].

Neni 45 i Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës parashikon se secili deputet mund t’i bëjë pyetje për përgjigje me gojë një anëtari të Qeverisë, me kusht që pyetja parlamentare të jetë parashtruar paraprakisht me shkrim në Zyrën për Propozime dhe Parashtrësa të Kuvendit, më së paku dyzet e tetë (48) orë para fillimit të mbledhjes. Deputeti, pyetjen e parashtruar me shkrim, e paraqet edhe me gojë në mbledhje, në kohën e rezervuar për pyetje parlamentare. Në rastet kur pyetja e deputetit nuk merr përgjigje brenda dy seancave të radhës, publikohet në Revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit, kurse Zyra për Informim e Kuvendit lëshon një njoftim për media, brenda 24 orëve, pas mbledhjes së dytë.


¹⁰⁷ Kuvendi i Kosovës Transkripti i Mbledhjes së Jashtëzakonshme Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 7 Maj 2014, fq. 3.

Neni 46 përcakton se deputetët mund t'i parashtrojnë pyetje për përgjigje me shkrim Kryeministrit ose ndonjërit nga ministrat, për fushën e tij të përgjegjësisë. Përgjigjja jepet brenda dy javësh pas datës së parashtrimit të pyetjes dhe evidentohet në procesverbalin e mbledhjes plenare të radhës së Kuvendit. Lista e pyetjeve, për të cilat nuk është dhënë përgjigje brenda kohës së caktuar, publikohet në Buletinin e Kuvendit dhe u dërgohet deputetëve.¹⁰⁸ Në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në tre Legjislatura prej periudhës 2008-2017 janë parashtruar 2083 pyetje parlamentare. Në Legjislaturën e III-të janë parashtruar 915 pyetjet parlamentare, në Legjislaturën e IV-të 588 pyetje, në Legjislaturën e V-të 580 pyetje parlamentare.¹⁰⁹ Megjithëse, deputetët gjatë kësaj periudhe parashtruan 2083 pyetje parlamentare, vetëm një pjesë prej pyetjeve parlamentare morën përgjigje nga kryeministri dhe ministrat, ndërsa një numer i madh i pyetjeve kanë mbetur pa përgjigje për shkak të mosprezencës së ministrave në Kuvend. Në vijim, pasqyrohen në formë grafike, të dhënat nga përgjigjet për pyetjet parlamentare të kabinetit qeveritar.

¹⁰⁸ Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 45 dhe neni 46 Prishtinë, 29 Prill 2010

¹⁰⁹ Të dhënat të përpunuara nga autori i punimit bazuar në Raportet e punës së Kuvendit për periudhën 2008,2009,2010,2011,2012,2013,2014 dhe 2015. Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Dr. Jakup Krasniqi për aktivitetet e Kuvendit të Kosovës gjatë Legjislaturës III (2008-2010), në takimin e fundvitit me gazetarë dhe kryeredaktorë.; Kuvendi i Republikës të Kosovës Aktiviteti legjislativ i Kuvendit gjatë vitit 2011 (Shkurt -Dhjetor 2011) Kuvendi, 22 Dhjetor 2011, Legjislatura IV-të Kuvendi i Republikës së Kosovës,Raport për punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Legjislaturën e V 2014-2017 Prishtinë Qershor 2017 Fq.22,Raport për punën e Kuvendit për Legjislaturën e IV-të 2011-2014 Qershor 2014 fq.4, Raport për punën e Kuvendit për Legjislaturën e III-të 2008-2010 , Qershor 2010 Fq.23

Grafiku 2: Përgjigjet në pyetjet parlamentare në periudhën 2011- 2016



Burimi: bazuar nga të dhënat e Raporteve të Kuvendit¹¹⁰ të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron pyetjet e parashtruara gjatë periudhës janar 2011-dhjetor 2016 nga deputetët në Kuvend dhe përgjigjet me gojë nga kryeministri ose nga ministrat përkatës, si dhe pyetjet pa përgjigje të cilat janë publikuar në buletin e Kuvendit. Në praktikën e punës së Kuvendit, mosprezenca e Qeverisë gjatë kohës së parashtrimit të pyetjeve i ka krijuar Kuvendit vështirësi në menaxhimin e duhur të kohës për parashtrimin e pyetjeve. Për më tepër, vonesa në dhënien e përgjigjeve në pyetjet e parashtruara, ka ndikuar që të humbasë rëndësia e pyetjeve parlamentare. Kuvendi nuk ka ndonjë mekanizëm për të detyruar ministrat për t’iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e deputetëve të Kuvendit.¹¹¹

Hezitimi i ministrave për t’iu përgjigjur pyetjeve parlamentare dhe mosprezenca e tyre në seancat e Kuvendit kur trajtohej problematika e veprimtarive të punës së tyre, ishte një mospërfillje që i bëhej Kuvendit dhe rekomandimeve e qëndrimeve të

¹¹⁰ Kuvendi i Kosovës Raportet vjetore e punës së Kuvendit për periudhën 20011, 2012,2013,2014 dhe 2015

¹¹¹Bazuar nga të dhënat e Raproteve të OSBE, misioni në Kosovë, Raport i monitorimit të punës së Kuvendit, 2013, fq. 8 ; Kuvendi i Republikës i Kosovës Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi, në takimin e fundvitit me media; me gjerishte shiko në: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,184,182>; Kuvendi i Kosovës Raport i Vjetor i Punës së Kuvendit për vitin 2014 dhe vitin 2015, janar 2016 fq.6; Instituti Demokratik i Kosovës Raport i Monitorimit të punës së Kuvendit për vitin 2016 Fq.30, Prishtinë, prill 2017 të përpunuar nga autori i punimit

tij. Kuvendi i Kosovës, në legjislaturën e tanishme dhe legjislaturat e ardhshme duhet t'i kërkojë llogari dhe përgjegjësi kryeministrit dhe kabintetit qeveritar në rastet kur hezitojnë t'i përgjigjen pyetjeve parlamentare të deputetëve dhe injorojnë rekomandimet edhe qëndrimet e Kuvendit. Legjislatura e dalë nga zgjedhjet parlamentare të Qershorit të vitit 2017, duhet të miratojë një ligj për punën e Kuvendit të Kosovës. Në ligjin e punës të Kuvendit të përcaktohet detyrimet për Kryeministrin/ministrat që të përgjigjen në pyetjet parlamentare të deputetëve.

3.3.1.1.ç. Miratimi i buxhetit dhe raportet periodike

Miratimi i buxhetit nga Kuvendi nuk është një detyrë thjesht dhe vetëm sa për të qenë në pajtim me Kushtetutën, por është vendi i përgjegjëshmërisë financiare. Më qëllim që të jetë një mjet efektiv në menaxhim dhe vendim-marrje, buxheti duhet të paraqesë informacione mbi qëllimet e aktivitetëve të propozuara dhe burimet që do të shpenzohen [Denhardt B. Robert & Denhardt V. Janet, 2010:255].

Konkurrenca për fuqi në buxhet është e zakonshme, por tensioni midis dy institucioneve është pranuar si një nga kontrollet thelbësore dhe balancat e demokracisë. Nëse Kushtetuta dhe ligji i buxhetit janë hartuar në mënyrën e duhur, atëherë pushteti i njërit autoritet e fuqizon tjetrin.¹¹² Allen Schick, një studiues i njohur në fushën e buxhetimit, ka sugjeruar se buxhetet mund të kenë tre qëllime të ndryshme, të cilat reflektohen bashkarisht në të gjitha trajtimet buxhetore. Këto qëllime janë planifikimi, menaxhimi dhe kontrolli. Sipas Schick, çdo përpjekje për reformim të buxhetit, ndryshon balancën ndërmjet tre qëllimeve herë nga pakujdesia dhe herë qëllimisht [Denhardt B. Robert & Denhardt V. Janet, 2010:255-256]. Me miratimin e buxhetit, Kuvendi përcakton të hyrat publike dhe shpenzimet publike për realizimin e programit qeveritar. Në shumë shtete, buxheti miratohet në fund të vitit, në muajin Dhjetor ku i mundësohet Qeverisë me fillimin e vitit kalendarik prej 1 Janari të fillojë me buxhet të ri. Kuvendi ka të drejtën e miratimit të buxhetit, dhe

¹¹²Menaxhimi i shpenzimeve publike, përgaditur nga Ministria e Financave me mbështetjen e GTZ-se, Tiranë 2004 Fq.65

deputetëve të Kuvendit, në rastin e miratimit të buxhetit, iu mundësohet një kontroll politik ndaj qeverisë dhe punës së saj.

Sipas Profesor Bajramit “jo rrallë, Qeveria gjatë vitit kërkon ndryshime dhe plotësime të buxhetit nëpërmjet ribalancave dhe mjeteve shtesë, e që kërkon të lejohen nga Parlamenti. Këto kërkesa vijnë si pasojë e shpenzimeve të mjeteve financiare të lejuara në buxhet, dhe si pasojë e shtimit të kërkesave plotësuese për financimin e administratës shtetërorë” [Bajrami, 2002:142]. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Neni 22 paragrafi një parashikon se pas miratimit të propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Propozim Ligjit për Ndarje Buxhetore, Qeveria ia dorëzon këto dokumente Kuvendit jo më vonë se më 31 Tetor të atij viti fiskal. Duke u bazuar në nenin e lartëcekur paragrafi dy, përcakton se Ministria ka të drejtë që të paralajmërohet në mënyrë adekuate dhe të marrë pjesë në cilindo dëgjim, i cili mbahet nga një komision i Kuvendit lidhur me cilindo aspekt të projekt- Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës ose Ligjit të Propozuar për Ndarjet Buxhetore. Sipas Nenit 23 përcaktohet se, pas miratimit nga Kuvendi të një projekti kapital, Ministria dhe Kuvendi duhet t’i kushtojnë prioritetin më të lartë sigurimit të fondeve si dhe ndarjes buxhetore të nevojshme për financimin e rregullt dhe me kohë të projektit kapital gjatë përgatitjes dhe miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Ligjit të Ndarjeve Buxhetore për vitin aktual dhe vitet e ardhshme. Ministri do të përgatisë dhe mandej Qeveria do të shqyrtojë raportet tremujore që mbulojnë vitin fiskal për çdo çerek viti të përfunduar. Këto raportet i parashtrihen Kuvendit brenda 30 ditëve nga mbarimi i çdo çerek viti dhe do të publikohen nga Ministri.¹¹³ Një organizatë buxhetore mundet, pa marrjen e miratimit paraprak nga Ministri, të transferojë deri në pesë për qind të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal; megjithatë, kjo transfertë nuk mund të bëhet në ndarjen buxhetore për paga dhe mëditje pa miratimin paraprak të Ministrisë dhe, sipas rastit, Qeverisë ose

¹¹³Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nenet 22, 23.

Kuvendit.¹¹⁴ Kuvendi ka rol qendror në mbikëqyrjen e shpenzimit të parasë publike. Mbikëqyrja efikase e ekzekutimit të buxhetit ndihmon në përmirësimin e praktikave menaxhuese me buxhetin shtetëror, zvogëlimin e dallimeve në mes të parasë në dispozicion dhe parasë së shpenzuar, si dhe më e rëndësishmja për vendin tonë, parandalon korrupsionin. Gjithashtu, mbikëqyrja e buxhetit ndihmon Kuvendin që të kuptojë më mirë nevojat buxhetore të sektorëve të caktuar dhe të penalizojë me mos ndarje të buxhetit, ato organizma buxhetorë të cilat nuk e shpenzojnë si duhet buxhetin e ndarë në vitin paraprak (kanë suficit buxhetor apo planifikim jo të mirë).¹¹⁵ Profesor Bufit thekson se “Kontrolli buxhetor është një funksion kryesor i komisioneve të përhershme sektoriale, sepse shumica e programeve qeveritare zbatohen mbi bazën e një buxhetit të dhënë. Kontrolli buxhetor është instrumenti kryesor që i lejon komisionet të vlerësojnë programet qeveritare” [Bufi, 2000:504].

3.3.1.1. d. Raportet periodike

Profesor Bajrami thekson se ‘‘në sistemet tipike parlamentare, qeveria është e obliguar që për punën e saj të njoftojë parlamentin përmes raporteve për punën e saj. Raportet periodike, të cilat qeveria i parashton në parlament, paraqesin instrumente

¹¹⁴Po aty, neni 30 par.1- 4 i Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë parashikon se: Ministri, nëse merr një arsyetim të vlefshëm nga udhëheqësi i një organizate buxhetore, mund të autorizoj transferimin e një pjese të një ndarje të organizatës buxhetore në një ndarje tjetër të organizatës së njëjtë; me kusht që, vlera e shumës së transferuar të mos jetë më e madhe se pesëmbëdhjetë përqind (15%) e ndarjes së ndikuar negativisht. Nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore, kërkon nga Ministri që të autorizojë transferimin e një shume që është më e madhe se pesëmbëdhjetë përqind 15 %, por më e vogël se njëzet e pesë përqind 25 % e ndarjes së ndikuar negativisht, atëherë Ministri mund të autorizoj një transfer të këtillë vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Qeveria. Nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore kërkon nga Ministri që të autorizojë transferimin e një shume të barabartë me njëzet e pesë 25% apo më shumë, të ndarjes së ndikuar negativisht, Ministri mund të autorizojë transferimin e këtillë vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Kuvendi. Kurse, Neni 46 parashikon se jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Ministri do të përgatitë dhe dorëzojë Qeverisë, për miratim dhe dorëzim në Kuvend, një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe dy vitet paraprake fiskale. Po kështu, edhe Kryetari i Komunës duhet të përgatitë dhe t’i dorëzojë Kuvendit Komunal një raport përfundimtar përmbledhës buxhetor i cili përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 46 paragrafi një (1) sikur që aplikohen ato për Komunën përkatëse.¹¹⁴

¹¹⁵Kuvendi i Republikës së Kosovës, Doracak funksioni mbikëqyrës i komisioneve parlamentare, Prishtinë, Qershor 2012, Fq.31

të kontrollit politik, me të cilin parlamenti mbikëqyr zbatimin e ligjeve dhe të politikës shtetërore nga qeveria” [Bajrami, 2005:103]. Në Kosovë, sa i përket llogaridhënies dhe raportimit, nuk ka linja të qarta në institucionet dhe agjensitë e pavarura. Disa institucione dhe agjenci të pavarura të Kuvendit nuk e kanë të definuar me ligj raportimin në Kuvend, disa prej tyre raportojnë praktikisht në Kuvend, disa e dërgojnë raportin vetëm për njoftim derisa ka të tilla që e kanë të definuar raportimin por nuk raportojnë në Kuvend. Në Kuvendin e Kosovës nuk ka një dokument i cili tregon se cila agjensi raporton në cilin komision, por kjo është zhvilluar vetëm si praktikë dhe ekziston vetëm një person në Kuvendin e Kosovës si koordinator me institucionet dhe agjensi të pavarura [MAP, 2016:7].

Për këtë çështje është domosdoshmëri një reformim i legjisllacionit, të ndryshohen dhe të plotësohen ligjet specifike të institucioneve dhe agjensive, si dhe të përcaktohet mbikëqyrja dhe raportimi i këtyre trupave.

Sipas Kushtetutës, Ligjit për Buxhetin dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i obligojnë të gjitha insitucionet të cilat shpenzojnë para publike, që të raportojnë në baza të rregullta tre mujore, gjashtë mujore dhe si dhe raporte vjetore për shpenzimet. Ligji për buxhetin neni 5 parashikon se Ministri mban regjistrin e të gjitha ndarjeve buxhetore të miratuara, transfertat dhe rialokimet e ndarjeve buxhetore dhe përshtatjet e tjera të miratuara të ndarjeve buxhetore të kryera gjatë vitit fiskal.¹¹⁶ Të paktën dy herë në vit, gjatë shqyrtimit të raportit gjashtëmujor dhe raportimit përfundimtar për mbylljen e vitit fiskal, ministri mbi bazën e këtij regjistri do të raportojë për ndryshimet dhe përshtatjet buxhetore të ndodhura gjatë vitit fiskal.¹¹⁷ Në çdo kohë kur kërkohet nga Kuvendi, Ministri, në emër të Qeverisë, prezanton para Kuvendit raportin gjithëpërfshirës që ofron detajet dhe barazimin e ndarjeve buxhetore të aprovuara për atë vit, dhe të gjitha transfertat pasuese dhe ndryshimet e tjera, si dhe ndarjet buxhetore finale për vitin fiskal.¹¹⁸ Qeveria është e obliguar që t’i dorëzojë Kuvendit një raport mbi secilën organizatë buxhetore brenda tridhjetë ditëve pasi ky raport t’i jetë dorëzuar Qeverisë nga

¹¹⁶Ligji nr.06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 Neni 5

¹¹⁷ Ligji Nr. 04/L-165 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, neni 3

¹¹⁸Ligji Nr. 04/L-233 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 Neni 3

organizata përkatëse buxhetore. Ministri do të përgatisë dhe Qeveria do të shqyrtojë raportet tremujore që mbulojnë vitin fiskal për çdo çerek viti të përfunduar. Këto raporte do t'i parashtrohen Kuvendit brenda 30 ditëve nga mbarimi i çdo çerek viti dhe do të publikohen nga Ministri.¹¹⁹

Sipas Profesor Bajramit “zakonisht raportet periodike, përfshijnë periudhën prej 6 muajve dhe një viti. Në praktikën parlamentare është i njohur instituti i kursimit të qeverisë për 100 ditët e para të punës së saj. Raportet e punës së qeverisë si rregull parashtrohen në formën e shkruar dhe në Kuvend prezentohen nga Kryeministri. Parashtrimi i raporteve periodike të qeverisë, shpesh herë mund të shërbëjë si bazë për veprim opozitar dhe hapjen e debatit të përgjegjësive të Qeverisë, që mund të rezultojë me mocionin për votëbesimin e qeverisë” [Bajrami, 2005:103]. Ndërsa raportimi i institucioneve dhe agjensive publike në kuadër të Kuvendit nuk ka rregulla të përcaktuara që definojnë ndonjë masë apo sanksion për bordin të cilit nuk i miratohet raporti vjetor. Si pasojë e kësaj, ka institucione dhe agjensi të pavarura, raporti vjetor i të cilave miratohet në komision por jo në seancë; ka institucione dhe agjenci, raportet e të cilave nuk miratohen në komision por miratohen në seancë dhe ka agjenci, raportet e të cilave nuk miratohen as në komision dhe as në seancë [MAP, 2016:7]. Për këtë arsye, del e nevojshme të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve specifike të institucioneve dhe agjensive publike në kuadër të Kuvendit dhe të rregullohet përfundimisht kjo çështje.

3.3.1.1.dh. Komisioni hetimor, mjet kontrolli për punën e Qeverisë

Profesor Bufi thekson se “e drejta e Parlamentit për të ngritur komisione hetimore është një prerogativë dhe një mjet i domosdoshëm që i nevojitet atij për të ushtruar funksionin e kontrollit, si dhe për të perfeksionuar në tërësi pushtetin legjislativ” [Bufi, 2000:511]. Komisionet hetimore janë mjet efektiv kontrolli që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit, të cilat ngrihen për çështje të veçanta

¹¹⁹ Kuvendi i Republikës të Kosovës Doracak funksioni mbikëqyrës i komisioneve parlamentare, Prishtinë, Qershor 2012, fq.34

të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit.¹²⁰ Prandaj, komisionet hetimore mund të bëjnë hetime shumë të thelluara për një kohë relativisht të shkurtër dhe të zbulojnë fakte që mund të jenë shqetësuese për qeverinë [Bufi, 2000:512].

Hetimi parlamentar nuk mund të jetë absolutisht i pakufizuar. Ky kufizim imponon që, objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese, që hetimi parlamentar të lidhet me veprimtarinë e legjislativit dhe që hetimi të mos përdoret në mënyrë abuzive.¹²¹

Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është për të njohur dhe verifikuar në thellësi një fenomen, një ngjarje, një veprimtari, me synimin që në përputhje me realitetin të nxirren përfundime për nevojën e miratimit, plotësimit apo korigjimit të ligjeve të veçanta [Bufi, 2000:511]. Ligji për hetimin parlamentar në nenin 2 përcakton se Komisioni themelohet për të hetuar probleme, çështje ku janë drejtpërsëdrejti të përfshirë përgjegjësitë qeveritare apo shtetërore. Komisioni themelohet me qëllim të konstatimit, përshkrimit të rrjedhës së ngjarjeve me qëllim të qartësimit të asaj se çfarë ka ndodhur dhe të përcaktimit të përgjegjësisë së atyre që kanë qenë të involvuar. Komisioni themelohet me qëllim të informimit, rekomandimit, ushtrimit të mbikqyrjes parlamentare dhe të arritjes së një përfundimi. Komisioni themelohet dhe funksionon mbi bazën e parimeve kushtetuese dhe rregullave të përcaktuara me këtë ligj. Komisioni përgatit raportin përfundimtar lidhur me hetimet brenda afatit të caktuar nga Kuvendi dhe në pajtim me ligjin. Po kështu, neni gjashtë parashikon se çështja e cila është përcaktuar për hetim parlamentar me vendim nga Kuvendi, mund të ndryshohet ose zgjerohet me vendim të Kuvendit me vonë, nëse propozuesi për iniciimin e Komisionit është pajtuar me ndryshimin. Komisioni është i obliguar t'i përmbahet mandatit të tij të dhënë nga Kuvendi. Neni 13 po i këtij ligji parashikon se me qëllim të ushtrimit të hetimeve, Komisioni ka të drejtë: të thërras bartësit e funksioneve publike të dëgjoen para Komisionit; të thërras persona të tjerë fizikë dhe juridikë të dëgjoen

¹²⁰Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, VGJK 18/2003.

¹²¹Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, VGJK 26/2006.

para Komisionit të japin dëshmi nën betim; të ketë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet zyrtare; të kërkojë dhe të marrë prova; të urdhërojë sjelljen e detyrueshme të personave të lartpërmendur të thirrur për të dhënë dëshmi para Komisionit; të krijojë një grup hetues nga anëtarët e Komisionit për të zhvilluar hetime të caktuara. Komisioni ka të drejtë të kërkojë ekspertizën e ekspertëve të pavarur gjatë kryerjes së detyrës. Mjetet financiare për këtë ekspertizë sigurohen nga Kuvendi. Puna e Komisionit mbështetet nga personeli i Kuvendit.¹²² Në Slloveni, hetime parlamentare mund të bëhen për çështje me rëndësi publike, kur kërkohet nga një e treta e deputetëve të Asamblesë Kombëtare ose kur kërkohet nga Këshilli Kombëtar. Për këtë qëllim, Asambleja Kombëtare do të emërojë një komision i cili në çështjet e hetimit dhe ekzaminimit ka kompetenca të ngjashme me ato të autoriteteve gjyqësore.¹²³ Në Kosovë, Ligji për hetimin parlamentar është miratuar në vitin 2010, ndërsa më herët në vitin 2004, kemi ngritjen e komisionit të parë duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit si bazë ligjore për krijimin e komisioneve hetimore për çështje të veçanta. Kuvendi i Kosovës këtë instrument të mbikëqyrjes e ka përdorur vetëm në tri raste.

Rasti i parë, ka të bëjë me trazirat e Marsit 2004, ku edhe pse ky komision zhvilloi disa takime radhazi, natyra e çështjes nën hetim, situata politike dhe rrethanat e krijuara ndikuan që komisioni të mos arrijë të përfundojë hetimin e rastit dhe përpilimin e një raporti për Kuvendin e Kosovës.¹²⁴

Rasti i dytë, ka të bëjë me krijimin e një komisioni hetimor, bazuar në raportin e Auditorit të Përgjithshëm të vitit 2005 për keqpërdorime financiare nga udhëheqja e Kuvendit të Kosovës. Veçanti e këtij komisioni ishte bashkëpunimi në nivel të mirë mes të anëtarëve të komisionit që vinin nga partitë opozitare dhe ato në pushtet, dhe komisioni arriti të përpilojë raportin final, i cili u dorëzua në Kuvend bashkë me rekomandimet konkrete për shqyrtim dhe miratim.¹²⁵

¹²² Ligji Nr. 03/1-176 për hetim parlamentar nenet 2,4, 5, 6 dhe neni 13

¹²³ Kushtetuta e Republikës të Sllovenisë neni 93, Official Gazette RS, Nos. 33/91-I, 42/97, 66/2000 and 24/03

¹²⁴ KDI & Forum 2015 Raport (analize) mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë, 2013 fq.16-17

¹²⁵ Po aty, Fq.16-17

Rasti i tretë, Komisioni Hetimor Parlamentar i ngritur lidhur me faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë, njehsorët dixhitalë dhe masat e ndërmarra në lidhje me këtë rast. Ngritja e këtij komisioni është shoqëruar edhe nga protestat e qytetarëve. Komisioni i ka rekomanduar Kryeministrit të Republikës së Kosovës që të ndërmarrë masat përkatëse sipas kompetencave të tij, për të siguruar zbatimin e plotë të ligjit dhe që të evitohen praktikat që ministrinë dhe ministrat të involvohen jashtë autorizimeve në fushëveprimin e institucioneve të pavarura, duke dëmtuar forcimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve dhe sundimin e ligjit në Kosovë.¹²⁶

Kuvendi i Kosovës gjatë pesë legjislativave nuk ka treguar vullnet politik për kontroll politik të ekzekutivit, për hetime parlamentare, për ngritje të komisioneve hetimore (ad hoc). Mosngritja e komisioneve hetimore për disa ministri dhe Agjensi të Pavarura, të cilat kanë detyrim t'i raportojnë Kuvendit, ishte pengues i zbardhjes të shumë aferave korruptive, shpërdorimit të detyrës zyrtare nga disa zyrtarë publikë dhe skandaleve të përfolura në publik (si: skandalet e privatizimit, vjedhja e Dhomës së Dëshmive në Prishtinë, vjedhja e arit në policinë e Pejës, afera e pasportave, aferat e pronave, skandali me KEK-un, me PTK-në, me aeroportin, Pronto afera etj). Kuvendi ka nevojë për vullnet politik të subjekteve politike parlamentare, për kontroll politik si mjete të demokracisë parlamentare dhe secili organ shtetëror duhet të kryejë mandatin e tij kushtetues. Rritja e vullnetit politik, gadishmëria për hetime parlamentare, për ngritje të komisioneve hetimore në institucione qeveritare, Institucione dhe Agjensi të Pavarura do të ketë ndikim në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, shpërdorimit të detyrës zyrtare në administratën publike, dhe do të sjellë një qeverisje më të mirë në Kosovë.

¹²⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës Transkripti e Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës , e mbajtur më 18, 19, dhe 25 Korrik 2013, Fq.103-104

3.4. Kontrolli administrativ i administratës publike

Kontrolli i brendshëm i administratës publike është kontrolli i organeve të larta ndaj organeve të ulëta të administratës publike, që ushtrohet si kontroll institucional dhe si kontroll hierarkik [Stavileci, 2010:100]. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Nenin 4, përcakton se Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet, zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari të tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.¹²⁷ Detyrat e administratës shtetërore gërshetojnë zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit, nxjerrjen e dispozitave për aplikimin e tyre, ushtrimin e mbikëqyrjes administrative me kryerjen e punëve të tjera administrative dhe profesionale.¹²⁸ Po kështu, neni 93 i Kushtetutës parashikon se në kuadër të kompetencave të shumta të Qeverisë, kjo e fundit udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës dhe udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike.¹²⁹

Veprimtaria administrative është tërësia e akteve individuale ose kolektive administrative të nxjerra nga organet e administratës publike, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre si dhe veprimet e kryera nga administrata për zbatimin e këtyre akteve.¹³⁰ Organet e administratës publike, në ushtrim të veprimtarisë administrative, duhet të vendosin një balancim të drejtë mes interesave publike dhe interesave private të përfshira në të, në mënyrë që të evitohen ndërhyrjet e panevojshme në të drejtat dhe interesat e personave fizikë dhe juridikë.¹³¹ Kontrolli administrativ i administratës përfshin kontrollin e akteve administrative dhe veprimeve administrative [Sokoli, 2009:251], kontrollin e të gjitha vendimeve të organeve të administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike për dy apo më shumë persona fizikë dhe juridikë, si dhe të gjitha vendimet e organeve të

¹²⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4, neni 92

¹²⁸ Ligji Nr. 03/L-189 për administratën shtetërore, neni 3.

¹²⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 93.

¹³⁰ Ligji Nr. 02/L-28 për procedurën administrative, Neni dy

¹³¹ Po aty, Neni 4

administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike në raste individuale.¹³² Këtu përfshihet edhe kontrolli hierarkik, sipas të cilit organet më të larta të administratës kanë jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin që të mbikëqyrin punën e organeve më të ulëta të administratës publike [Stavileci, 2010:100].

Sipas nenit 25 të Rregullores së punës të Qeverisë parashikohet se Kryeministri kërkon nga çdonjëri prej ministrave që t'i raportojë me shkrim mbi punën e tij/saj dhe ministrisë të cilën e kryeson, që t'i ofrojë informata dhe raporte nga fusha e vet e punës si dhe informata të tjera me rëndësi për mbarëvajtjen e punës së Qeverisë. Kryeministri mund të ftojë ndonjërin prej ministrave t'i raportojë gojarisht mbi punën nga fusha e vet. Gjithashtu, Ministri mund të kërkojë që Kryeministri të diskutojë me të për çështje nga fusha e punës së ministrisë, të cilat janë të rëndësishme për punën e Qeverisë apo për punën e ministrit.¹³³ Sipas Profesor Dobjanit “kontrolli i brendshëm ushtrohet brenda ministrisë, institucionit tjetër qendror dhe lokal si dhe kontrolli i ushtruar nga këto mbi organet, agjensitë publike dhe institucionet vartëse të fushës së tyre. Kontrolli i brendshëm bazohet në rolin drejtues që ka organi ose personi i caktuar (ministri). E drejta e kontrollit është pjesë përbërëse e veprimtarisë udhëheqëse dhe drejtuese të organit të administratës publike. Ajo përfshin të gjithë veprimtarinë drejtuese, organizuese, operative e konkrete për realizimin e detyrave dhe mandatit kushtetuese dhe ligjor” [Dobjani, 2004:197].

Sipas Modelit Weberian të administratës, koncepti i përgjithshëm bazohet në një ndarje vertikale sipas fushave të politikave ndërmjet ministrive dhe brenda ministrive. Përbërësit e tij të natyrshëm kanë qenë parimi i përgjegjësisë parlamentare të qeverisë dhe të ministrave, anonimati i personave përgjegjës në pjesën e poshtme, dhe një sistem hermetik që e mban informacionin brenda administratës, për të garantuar kështu përgjegjësinë ndaj ministrit për veprimet e nëpunësve të caktuar nën autoritetin e tij/e saj [SIGMA(2007)7, Nr. 43, fq.17].

¹³² Neni dy i Ligjit Nr. 02/L-28 për procedurën administrative

¹³³ Rregullore e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, neni 25,

Veprimtaria e administratës shtetërore bazohet në zbatimin e drejtpërdrejt të ligjit, në nxjerrjen e dispozitave për aplikimin e tyre, ushtrimin e mbikëqyrjes administrative dhe kryerjen e punëve të tjera administrative dhe profesionale.¹³⁴ Kryeministri dhe zëvendësit e tij janë përgjegjës për të siguruar që publiku të informohet mbi punën dhe vendimet e Qeverisë. Çdo ministër është përgjegjës për të siguruar që publiku të informohet mbi punën dhe vendimet e ministrisë¹³⁵ si dhe me vendimet e miratuara nga Qeveria.¹³⁶

Në kuadër të ligjit për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, Neni 61 përcakton shprehimisht se organet e administratës shtetërore mbikëqyren nga Qeveria, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj. Po kështu, neni 62 përcakton se: mbikëqyrja e menaxhimit të brendshëm të organit përkatës administrativ ushtrohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike përmes inspektorëve të saj. Në qoftë se udhëzimet nuk merren për bazë pa vonesë nga organi i mbikëqyrur, organi mbikqyrës mund të marrë masa të tilla si: të pezullojë ekzekutimin e një vendimi ose akti tjetër të organit të mbikëqyrur; të kërkojë ndryshimin e vendimit ose të aktit tjetër të organit të mbikëqyrur; dhe të urdhërojë zëvendësimin e vendimit ose të aktit tjetër nga organi i mbikëqyrur. Duke iu referuar po këtij ligji, neni 63 parashikon se organi mbikëqyrës ka të drejtë të kërkojë informacion dhe raporte nga organi, i cili i nënshtrohet mbikëqyrjes. Organi mbikëqyrës gjithashtu, ka të drejtë të inspektojë dokumentet, të kryejë auditime dhe kontrole të tjera, si dhe të hyjë në zyrat e organit të mbikëqyrur, të nxjerrë udhëzime të përgjithshme dhe udhëzime në lidhje me një rast të veçantë. Në qoftë se udhëzimet nuk merren për bazë pa vonesë nga organi i mbikëqyrur, organi mbikqyrës mund të marrë masat e mëposhtme:

- të pezullojë ekzekutimin e një vendimi ose akti tjetër të organit të mbikëqyrur;
- të kërkojë ndryshimin e vendimit ose të aktit tjetër të organit të mbikëqyrur;
- të urdhërojë zëvendësimin e vendimit ose të aktit tjetër nga organi i mbikëqyrur.

¹³⁴ Ligji nr. 03/1-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, neni 3

¹³⁵ Rregullore e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, neni 72

¹³⁶ Rregullore e Qeverisë Nr. 01/2007 për punën e Qeverisë, Neni 94

Organi mbikqyrës është i detyruar të veprojë në vend të organit të mbikqyrur në rast të rrezikut të vonesës ose nëse kryerja e rregullt e detyrës përkatëse nga organi i mbikqyrur nuk mund të sigurohet.¹³⁷ Organi publik verifikon kompetencën sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë. Në lidhje me konfliktet e kompetencave:

- kur janë ndërmjet dy a më shumë organeve publike, zgjidhen me marrëveshje unanime ndërmjet tyre;
- në rast se organet publike në konflikt nuk arrijnë një marrëveshje, konflikti i kompetencës zgjidhet nga organi i përbashkët epror, që vjen menjëherë më sipër në hierarki dhe që ka kompetenca kontrolli apo mbikqyrjeje mbi organet në konflikt;
- për konfliktet ndërmjet dy ministrive të ndryshme apo ndërmjet një ministrie dhe një organi qendror në vartësi të Kryeministrit, kompetente është Qeveria e Republikës të Kosovës;
- në rast se organet në konflikt nuk kanë një organ të përbashkët epror, konflikti i kompetencës zgjidhet nga gjykata kompetente për çështjet administrative.¹³⁸

Siç u theksua edhe më lart, kontrolli institucional është shprehje e pakënaqësisë së palës, përmes ankesës së saj në procedurën administrative kur goditet një akt administrativ i organit të shkallës më të ulët para organit të shkallës më të lartë të administratës publike [Stavileci, 2010:100].

Sa i përket shërbimeve publike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, ndërhyrja e politikës në administratën publike vazhdon, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të zbatuar plotësisht dispozitat relevante për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në shërbimet civile, veçanërisht duke ofruar trajnim të caktuar për nëpunësit civilë. Qeveria e re duhet të marrë një angazhim serioz politik për reformën e administratës publike. Ritmi i

¹³⁷ Ligji Nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, neni 61, neni 62 dhe neni 63

¹³⁸ Ligji Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative Neni 25 paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3, paragrafi 4, paragrafi 5, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2016, Prishtinë

ngadalshëm i reformave në këtë fushë vazhdon të përbëjë një nga sfidat më të mëdha në procesin e integritit evropian të Kosovës [Komisioni Evropian (2014), Raporti i Progresit për Kosovën, fq.11]. Pra, një kontroll efikas brenda vet administratës siguron një qeverisje të mirë në shërbim të qytetarit dhe rrit besimin e qytetarit të institucionet e Kosovës, minimizon dukuritë negative në administratë, shpërdorimin e detyrës zyrtare, korrupsionin, keqmenaxhimin e fondeve publike, si dhe rrit transparencën dhe llogaridhënien.

3.4.1. Mbikëqyrja e organeve të pavarura të administratës shtetërore dhe administratës së pushtetit lokal

Qeveria ka kompetencë të udhëzojë dhe mbikqyrë punën e organeve të administratës.¹³⁹ Ministrite mbikqyrin punën e organeve të administratës shtetërore, të organeve në varësi, të organeve të njësisve të vetëqeverisjes lokale, të personave juridikë të cilët kanë autorizime publike në punët e bartura të administratës shtetërore dhe agjensive ekzekutive [Pollozhani, Dobjani, Stavileci & Salihu, 2010:190]. Ligji Nr. 03/l-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, në nenin 64 parashikon se organet e pavarura të administratës shtetërore i nënshtrohen mbikqyrjes që ka të bëjë me ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre. Duke iu referuar po këtij neni përcaktohet se detajet e mbikqyrjes përcaktohen me ligjin për themelimin e organit të pavarur të administratës shtetërore.¹⁴⁰

Qeveria ka themeluar 46 organe qendrore si pjesë të ministrive të linjës. Shumë nga agjencitë e Qeverisë kanë ekzistuar më herët si departamente të ministrive, kurse më vonë janë shndërruar në agjenci për të evituar përplasjen e kompetencave mes tyre. Disa agjensi apo organe qendrore të Qeverisë nuk e aplikojnë ligjin për shërbimin civil në tërësinë e institucionit. Në disa raste, drejtorët e përgjithshëm të këtyre trupave me një pjesë të nëpunësve nuk i nënshtrohen Ligjit për Shërbimin Civil në

¹³⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 93 paragrafi 6

¹⁴⁰ Ligji Nr. 03/l-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, Neni 64

mënyrë që të kenë një pavarësi më të madhe në rekrutimin¹⁴¹ e personelit dhe mundësi për rregullim të pagave. Në disa organe qendrore apo agjensi në kuadër të Qeverisë nuk ka linja të qarta të llogaridhënies dhe raportimit. Prej 46 agjensive qeveritare, 13 nuk e kanë të definuar në ligj raportimin apo hartimin e raportit vjetor, dhe si rrjedhojë nuk dihet nëse raportojnë të Ministri i linjës, në Qeveria apo në asnjërën prej tyre. Nga këto 46 agjensi, 26 prej tyre nuk i kanë bërë raportet vjetore publike dhe 16 nuk kanë as faqe zyrtare.¹⁴²

Sa i përket organeve lokale, Ministria e administrimit të pushtetit lokal, në përputhje me mandatin e saj ligjor, mbështet dhe mbikëqyr në vazhdimësi aktivitetet e Komunave.¹⁴³ Kjo konsiston në promovimin e qeverisjes së mirë, respektimin e parimeve demokratike sipas Kushtetutës, ligjit dhe Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.¹⁴⁴

Filozofia e mbikëqyrjes së aktiviteteve të organeve vendore nga organe të niveleve të tjera qeverisëse, normalisht shoqërohet me *contrôles de tutelle*, që është traditë në shumë vende, që para shumë kohësh. Praktika të tilla janë: kërkesat për autorizim paraprak për të vepruar, ose për hyrjen në fuqi të konfirmimit të veprimeve, kompetenca për të anuluar vendimet e një organi vendor, kontrollet kontabël, etj. Mbikëqyrja administrative normalisht duhet të kufizohet në çështjen e ligjshmërisë së veprimit të organit vendor dhe jo në dobinë e tij. Një përjashtim i veçantë, por jo i vetmi, bëhet në rastin e detyrave të deleguara, kur organi që i delegon kompetencat mund të dëshirojë të ushtrojë ca mbikëqyrje mbi mënyrën sesi realizohen ato.

¹⁴¹ Ministria e Administratës Publike Rishikimi i Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura të Kuvendit dhe Organeve Qendrore të Qeverisë Dhjetor 2016 Fq.6 shih: <https://map.rks-gov.net/getattachment/0d53302c-5f3f-4175-bec7-707d9692e3af/Rishikimi-i-Institucioneve-dhe-Agjencive-te-Pavaru.aspx>

¹⁴² Ministria e Administratës Publike Rishikimi i Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura të Kuvendit dhe Organeve Qendrore të Qeverisë Dhjetor 2016 Fq.7 shih: <https://map.rks-gov.net/getattachment/0d53302c-5f3f-4175-bec7-707d9692e3af/Rishikimi-i-Institucioneve-dhe-Agjencive-te-Pavaru.aspx>

¹⁴³ Shala Mervete & Shala Skender Supervision and Control of Local Governance in the Republic of Kosovo European Journal of Interdisciplinary Studies, Jan-Apr 2016 Vol.4 Nr. 1, p.74-84 ISSN 2411-958X (Print) ISSN 2411-4138 (Online) (Pjesë të veçanta të mbikëqyrjes dhe kontrollit të së pushtetit lokal të punimit është publikuar në këtë Revist shkencore).

¹⁴⁴ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raport i funksionimit të Komunave të Republikës së Kosovës Janar- Dhjetor 2008 Fq. 19 Mars, 2009.

Gjithsesi, kjo nuk duhet ta ndalojë organin vendor nga ushtrimi i të drejtave të caktuara.¹⁴⁵

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 124 përcakton se komunat kanë kompetenca të veta, të zgjeruara dhe të deleguara¹⁴⁶ në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin. Duke ju referuar po këtij neni, përcaktohet se komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.¹⁴⁷ Autoritet qendrore i delegojnë përgjegjësi organeve vendore si: shënimet kadastrale, regjistrim civil, regjistrimin e votuesve, regjistrimin dhe licencimin e bizneseve, distribuimin e ndihmave sociale (me përjashtim të pensioneve), mbrojtjen e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara nga organet qendrore, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drurëve në bazë të rregullave të caktuara nga qeveria. Autoritetet qendrore mund të delegojnë edhe kompetenca shtesë nëse është e nevojshme.¹⁴⁸ Disa komuna si: Mitrovica e Veriut, Graçanica dhe Shtërpca kanë kompetenca të tyre të zgjeruara vetanake në fushën e shëndetësisë, edukimit dhe do të kenë të drejtë për të marrë pjesë në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore. Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës monitorojnë ushtrimin e kompetencave të zgjeruara në pajtim me legjislacionin qendror, që parasheh qasje të barabartë në shërbimet publike, standarde minimale sasiore dhe cilësore në ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe trajnimit të tyre, parimet e përgjithshme për licensim dhe akreditim të ofruesve të shërbimeve publike. Komunat që ushtrojnë kompetenca të zgjeruara

¹⁴⁵ Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore dhe raporti shpjegues, neni 8 paragrafi 2, Botim i Këshillit të Evropës Strasbourg 1986.

¹⁴⁶ Shala, Mervete. Challenges for the local governance in the Republic of Kosovo 6th International Conference on Social Sciences Istanbul, 11-12 September 2015 dhe Pjesë të veçanta për Kompetencat e Qeverisjes Vendore. Autonominë dhe sfida e qeverisjes lokale të Kosovës është prezentuar në Konferencë dhe publikuar në Academic Journal of Interdisciplinary Studies MCSER Publishing, Rome-Italy Vol 4 No 3 S12015, Fq. 661-671 E-ISSN 2281-4612 ISSN 2281-3993.

¹⁴⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 124.

¹⁴⁸ Ligji nr.03/1-040 për vetëqeverisjen lokale, neni 18, par. 1 dhe 2

komunale mund të bashkëpunojnë me çdo komunë në ofrimin e shërbimeve të tilla.¹⁴⁹ Komunat e lartpërmendura kanë kompetenca të zgjeruara komunale për përkujdesin dytësor shëndetësor, në shkollimin universitar, në fushën e kulturës dhe pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore lokale.¹⁵⁰

Sipas nenit 124, paragrafi 6 të Kushtetutës përcaktohet se rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes së tyre me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.¹⁵¹

Monitorimi dhe mbikqyrja e komunave është e drejtë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për të monitoruar dhe mbikqyrur realizimin e përgjegjësive nga organet e komunës, duke u kujdesur që aktet komunale, të jenë në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi, për kuadrin e kompetencave vetanake të komunave të Kosovës.¹⁵² Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoriteti mbikqyrës, nëse përgjegjësia për mbikqyrjen e komunave nuk i jepet me ligj ministrisë përgjegjëse apo institucionit që ka të bëjë me fusha (lëmi) të posaçme. Ndërsa shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato. Duke ju referuar Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 77 parashikon se autoritetet komunale dhe mbikqyrëse obligohen për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin në këtë proces.¹⁵³ Autoriteti mbikqyrës ka të drejtë të marrë dhe sigurojë informata të plota për të gjitha çështjet, përfshirë të drejtën për të vizituar zyrat komunale dhe objektet komunale, si dhe të drejtën për të kërkuar qasje në dokumentet komunale. Kryetari i komunës është përgjegjës për t'ia vënë në dispozicion informacionet autoritetit mbikqyrës. Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale ka të drejtën për të qenë e informuar rregullisht nga komunat në fushat në të cilat ministria nuk është autoritet mbikqyrës.¹⁵⁴ Më qëllim të lehtësimit të mbikqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar

¹⁴⁹ Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, neni 19

¹⁵⁰ Po aty, nenet 20-23

¹⁵¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 124.

¹⁵² Gjykata Kushtetuese Aktgjykim në Rastin nr. KI112/12

¹⁵³ Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale Neni 76 dhe 77

¹⁵⁴ Po aty, shih nenin 78

shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale, janë themeluar komisionet ndërministrore, sipas fushave specifike.¹⁵⁵ Prandaj, monitorimi dhe mbikqyrja e komunave në ushtrimin e kompetencave të tyre vetanake kufizohet vetem në monitorimin dhe mbikqyrjen e ligjshmërisë.¹⁵⁶

Mbikqyrja e ligjshmërisë do të thotë rishikim i realizuar nga organi mbikqyrës për t'u siguruar se aktet komunale janë nxjerrë në pajtim me dispozitat e zbatueshme ligjore, dhe se organi që i ka nxjerrë nuk ka vepruar në tejkalim të mandatit të tij të miratuar ligjor.¹⁵⁷ Monitorimi dhe mbikqyrja e komunave në ushtrimin e kompetencave të deleguara, duhet të përfshijë, mbikqyrjen e ligjshmërisë së veprimeve dhe mbikqyrjen e përshtatshmërisë së veprimeve.¹⁵⁸

Mbikqyrja e përshtatshmërisë do të thotë rishikim i bërë nga organi mbikqyrës për t'u siguruar së kompetencat e deleguara janë ekzekutuar në përputhje me rregullat, kriteret dhe standardet e përcaktuar nga qeveria qendrore, si dhe për t'u siguruar se masat e marra nga komuna kanë qenë të duhurat për arritjen e objektivave dhe rezultateve të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.¹⁵⁹ Mbikqyrja nga ana e autoriteteve të nivelit qendror bëhet në proporcion me rëndësinë e detyrave që janë duke u mbikqyrrur, derisa komunat do ta kenë të drejtën e shfrytëzimit të një mjeti juridik që të sigurojnë ushtrimin e lirë të kompetencave të tyre [MAPL, 2013:57]. Mirëpo pavarësisht individualitetit të komunave në kryerjen e veprimtarive të tyre, legjisllacioni ka përcaktuar një shkallë të varësisë në marrëdhënie me organet qendrore. Parashikimi me ligj i funksionit me natyrë mbikëqyrëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ministrive të tjera të linjës ndaj komunave, është me rëndësi të veçantë, pasi mundëson kufizim të

¹⁵⁵ Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës, Janar-Dhjetor 2013, fq. 25

¹⁵⁶ Udhezimi administrative Nr.2008/4 për ndryshimin e udhezimit administrative Nr. 2005/5 për zbatimin e përgjegjësive të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhjen me monitorimin dhe mbikëqyrjen e Komunave neni 6

¹⁵⁷ Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, neni 3.

¹⁵⁸ Udhezimi administrative Nr.2008/4 për ndryshimin e udhezimit administrative Nr. 2005/5 për zbatimin e përgjegjësive të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhjen me monitorimin dhe mbikëqyrjen e Komunave Neni 6

¹⁵⁹ Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale Neni 3

pjesëshëm të veprimtarisë së komunave.¹⁶⁰ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka ndërtuar një sistem të avancuar të monitorimit, mbështetur në dy mënyra kryesore: përmes monitorimit me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në Komuna dhe përmes monitorimit elektronik, i cili realizohet në disa forma të ndryshme, si dhe ka bërë instalimin e një programi të veçantë për të mundësuar mbikqyrjen nga distanca nëpërmjet teleprezencës [MAPL, 2013: fq.58, 59].

Në rastin e komunave, shqyrtimi administrativ ka këto objektiva: a) të forcojë aftësinë e organeve të vetëqeverisjes lokale në përmbushjen e përgjegjësive të tyre përmes këshillimit, mbështetjes dhe ndihmës; b) të sigurojë ligjshmëri të aktiviteteve të organeve të vetëqeverisjes lokale; c) të sigurojë që të drejtat dhe interesat e qytetarëve të respektohen.¹⁶¹


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përmes monitorimit të mbledhjeve të Kuvendeve të komunave ka evidentuar të gjitha aktet e nxjerra në Kuvendet e Komunave, aktet të cilat nuk kanë qenë në kompetencë të autoriteteve të tjera të nivelit qendror, dhe i ka vlerësuar nga këndvështrimi ligjor. Në anën tjetër, aktet për të cilat është vlerësuar jokompetenca, janë dërguar në ministrinë përgjegjëse, përkatësisht në komisionet ndërministrorë. Nga i gjithë ky proces, janë evidentuar një numër i shkeljeve ligjore në rastin e nxjerrjes së akteve nga kuvendet e komunave.¹⁶²

¹⁶⁰ Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raport i monitorimit të komunave të Republikës së Kosovës Janar-Dhjetor 2012, Prishtinë 2013, fq.4

¹⁶¹ Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, neni 74

¹⁶² Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës, Janar-Dhjetor 2013, fq. 25.

Grafiku 3: Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave nga 2009 deri në dhjetor 2016




Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve të MAPL,¹⁶³ të përpunuara nga autori i punimit

Grafiku i mësipërm pasqyron se Kuvendet e Komunave prej janarit të vitit 2009 deri në dhjetor 2016 kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve nënligjore dhe kanë miratuar 11765 akte; prej tyre 6 Statute të Komunave, 1121 Rregullore si dhe kanë miratuar 10638 vendime.

¹⁶³Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,Raporti vjetor i monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës 2010 fq.7,Raporti vjetor i monitorimit të Komunave 2011,fq.4,Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës Janar-Dhjetor 2012 fq.8,Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës, Janar-Dhjetor 2013, Fq.8, Raporti vjetor i funksionimit të komunave Janar-Dhjetor 2014 Prishtinë, Prill 2015, Fq.20 Raporti vjetor i monitorimit të Komunave Janar-Dhjetor 2015 Prill, 2016 fq.15, Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës, Janar - Dhjetor 2016 Prishtinë, Mars 2017 fq.6 , Raporte janë dorëzuar autorit të punimit në 28 Mars 2018, Raportin e vjetor i vitit 2017 dorëzohet vetem pasi të dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

Figura 1: Numri i përgjithshëm i shkeljeve të konstatuara



Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve të MAPL,¹⁶⁴ të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron se MAPL-ja gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së akteve ka evidentuar së Kuvendet e Komunave prej janarit të vitit 2012 deri në dhjetor 2016 kanë bërë shkelje, pasi kanë miratuar 230 akte juridike të kundërligjshme, 106 akte juridike janë rishqyrtuar nga komunat dhe janë harmonizuar me ligjin, kurse 40 akte juridike janë rishqyrtuar nga komunat por nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesën e organit mbikqyrës. Ndërsa, nga Komunat nuk janë rishqyrtuar 64 akte juridike dhe 20 akte juridike janë kthyer për rishqyrtim. Rishikimi dhe harmonizimi i akteve të komunave të cilat janë cilësuar të kundërligjshme vazhdojnë deri në evitimin e të gjitha çështjeve të kontestuara nga autoriteti mbikqyrës. Gjithashtu, shqyrtimi i ligjshmërisë nga ministritë e linjës duhet të ndodhë brenda afateve ligjore, si dhe duhet të shtohen përpjekjet për rishqyrtim dhe harmonizim të akteve të kundërligjshme nga komunat.¹⁶⁵

¹⁶⁴ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës Janar-Dhjetor 2012 fq. 8, Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës, Janar-Dhjetor 2013, Fq.8, Raporti vjetor i funksionimit të komunave Janar-Dhjetor 2014 Prishtinë, Prill 2015, Fq.20 Raporti vjetor i monitorimit të Komunave Janar-Dhjetor 2015 Prill, 2016 fq.15, Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës, Janar - Dhjetor 2016 Prishtinë, Mars 2017 fq.6

¹⁶⁵ MAPL, Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës, Janar - Dhjetor 2016 Fq.6 Prishtinë, Mars 2017

Mbikëqyrja dhe kontrolli i Komunave në Kosovë përcaktohet në dy rrafshë: kontrolli i brendshëm dhe kontrolli i jashtëm. Në kuadër të mbikqyrjes, duhet përmendur edhe mbikëqyrja shoqërore, e cila realizohet përmes formave të ndryshme të demokracisë së drejtpërdrejtë. Nga pikëpamja e kontrollit, nuk janë paraparë dispozita specifike që të normojnë formën e kontrollit (kuvend-ekzekutiv), dhe kjo çështje mund të kuptohet në bazë të hierarkisë së përcaktuar me ligj.¹⁶⁶ Kryetari i Komunës përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj, është përgjegjës të zbatojë aktet e Kuvendit të Komunës dhe udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj, si dhe mbikqyr administrimin financiar të komunës. Kryetari raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës. Kryetari mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti çënon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.¹⁶⁷

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoriteti përgjegjës për mbikqyrjen e Komunave të Kosovës dhe vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të komunave. Kjo ministri në të ardhmen duhet t'i kërkojë të gjitha komunave të bëjnë miratimin e akteve të komunës në pajtueshmeri me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë. Komunat duhet të detyrohën që në raste të miratimit të aktit të kundërligjshëm, të rishqyrtojnë aktin dhe të gjitha aktet komunale të harmonizohen me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë; në rast mos harmonizimi rasti të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese.

Mendoj se, një ndër sfidat në të ardhmen për organet mbikqyrëse, do të jetë mbikëqyrja dhe kontrolli i komunave me kompetenca të zgjeruara (komuna me shumicë serbe), pasi mbetet për t'u parë a do t'i marrin parasysh këto komuna kërkesat për t'i rishqyrtuar aktet e kundërligjshme dhe për t'i harmonizuar me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë.

¹⁶⁶ Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë, Gusht 2013, Prishtinë, Fq. 52-53

¹⁶⁷ Neni 58 Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale

3.5. Kontrolli gjyqësor i administratës publike

Kontrolli gjyqësor i administratës publike¹⁶⁸ është një nga llojet e kontrollit të administratës publike, që shtrihet në autorizimet të cilat i jepen një organi të pavarur nga pushteti politik dhe nga administrata që t'i zgjidhe konfliktet të cilat janë të shkaktuara në funksionimin e administratës publike [Stavileci,2010:100]. Administrata vihet nën kontrollin e gjyqësorit si organ i pavarur dhe neutral edhe nga administrata edhe nga pushteti politik me qëllim që të bëhet mbrojtja nga arbitrariteti i administratës, sepse në këtë mënyrë sigurohet parimi i ligjshmërisë në tërësi me kontrollin e ligjshmërisë së akteve të administratës publike [Sokoli, 2009:35].

Kontrolli gjyqësor duhet të sigurojë që autoriteti administrativ nuk do të kalojë kompetencat dhe duhet të ushtrojë kontrollin mbi administratën nëse autoriteti e tejkalon dhe i shkel të drejtat e qytetarëve [Zendeli,Memeti & Rustemi,2012:93]. Ky kontroll i punës së administratës i kontribuon kultivimit të një fryme ligjore në ushtrimin e të gjitha veprimeve nga ana e administratës. Nëse pa administratë nuk do të mund të funksiononte shoqëria, pa një kontroll të arsyeshëm nga ana e gjykatës nuk do të mund të jetonim në një shtet të së drejtës, nuk do të mund të jetonim në një klimë të sundimit të ligjit,por në të kundërtën,do të gjendeshim para abuzimeve të organeve të pushtetit [Batalli & Pepaj, 2015:768]. Kontrolli gjyqësor mbi administratën publike bazohet në parimet kushtetuese të balancimit të pushteteve dhe të shtetit të së drejtës dhe është sanksionuar si parim procedural edhe në Kodet e Procedurave Administrative e Civile.¹⁶⁹

Kontrolli gjyqësor i administratës, në shumicën e shteteve bashkëkohore është edhe kontrolli i jashtëm më i zhvilluar i administratës [Sokoli, 2009:250]. Sipas juristit të njohur amerikan Horsky, gjykata nuk është që të përcaktojë rastin sipas këndvështrimit të saj, por të përcaktojë nëse organi i administratës shtetërore

¹⁶⁸Shala, Mervete. Gerichtliche Überprüfung der Akten und Verwaltungsaktion The 8th International Conference on Private and Public Law 10 October, Vienna , Austria, 2015 Pjesë të veçanta të Kontrollit Gjyqësor i akteve dhe veprimeve administrative tëpunimit është prezentuar dhe publikuar në këtë Konferencë shkencore)

¹⁶⁹Vendimi i Gjykata Kushtetuese të Shqipërisë VGJK 41/2007

ushtron diskrecionin e deleguar apo jo [Batalli & Pepaj, 2015:769]. Prandaj, të gjitha aktivitetet e organeve të administratës shtetërore dhe publike janë subjekt i kontrollit qeveritar, kontrolli i brendshëm i organeve të administratës shtetërore (kontrollit të brendshme) dhe shqyrtim gjyqësor [Zendeli, Memeti & Rustemi, 2012:92].

Gjykatat gjatë kryerjes së funksioneve japin kontribut edhe për sigurimin e ligjshmërisë. Kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike paraqitet në këto forma:

- a. Kontrolli që ushtrohet nga gjykata në rastet kur ajo shqyrton ankimet kundër akteve administrative.
- b. Kontrolli indirekt (i terthortë) i ligjshmërisë së akteve administrative.
- c. Kontrolli në formën e realizimit të përgjegjësisë penale apo civile ndaj individëve (nëpunës civilë apo autoritete publike) për mospërbushjen e detyrimeve me karakter juridiko- administrative.
- d. Kontrolli nga Gjykata Kushtetuese [Dobjani, 2004: 219].

Kontrolli gjyqësor i administratës nga institucionet gjyqësore është në funksion të zbatimit të Kushtetutës dhe ligjeve nga administrata. Sipas nenit 4 dhe nenit 102, paragrafi 1 të Kushtetutës, është përcaktuar se pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat. Bazuar në nenin e lartcekur, paragrafi i dytë përcakton se pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.¹⁷⁰ Pavarësia e gjykatave garantohet dhe sanksionohet në Kushtetutë dhe në legjislacionin e vendit. Të gjitha institucionet kanë për detyrë të respektojnë pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Gjykatat, gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, dhe ky parim është bazë dhe kornizë e pavarësisë së tyre [Bajrami, & Shala, 2015:21].

Sipas Kushtetutës nenit 31, çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurën para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.¹⁷¹ Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës,

¹⁷⁰Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 102

¹⁷¹Po aty, neni 31

gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.¹⁷² Po kështu, neni 32 i Kushtetutës i garanton çdo personi të drejtën të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.¹⁷³ Pra, kontrolli gjyqësor i veprimtarisë administrative dhe e drejta e individëve dhe personave juridikë për t'iu drejtuar gjykatës lidhet jo vetëm me aplikimin e parimeve të përgjithshme, por edhe me përcaktimin e qartë e konkret, të treguar shprehimisht në ligjet e posaçme, të rrethanave, kushteve e procedurave konkrete për investimin e mundshëm, a të detyrueshëm të juridiksionit administrativ.¹⁷⁴

Në Kosovë, deri në reformën e gjykatave, sistemi i gjykatave të rregullta të Kosovës përbëhej nga 26 Gjykata Komunale, 5 Gjykata të Qarkut, Gjykata Ekonomike e Kosovës dhe nga Gjykata Supreme. Sistemi i Gjykatave për Kundërvajtje përbëhej prej 26 Gjykatave Komunale për Kundërvajtje dhe Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje. Miratimi i Ligjit Nr.03/L-199 për Gjykatat, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës shfuqizoi Ligjin për gjykatat e rregullta të KSAK-së, rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligjin për kundërvajtje. Prej 1 janari 2013 filloi të zbatohet në tërësi Ligji për Gjykatat i cili në nenin 8 përcakton shprehimisht se sistemi i Gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.¹⁷⁵ Mirëpo, Komisioni Evropian i kërkoi Kosovës të ndryshojë Kushtetutën e saj, në mënyrë që të pasqyrojë zotimet e saj për themelimin e Gjykatës Speciale [Komision Evropian (2014), Raporti i Progresit për Kosovën, fq. 5]. Sipas Daci, ish-Kryetari i Kuvendit “vendimi i Kuvendit për themelimin e Gjykatës Speciale shkel Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, por ai vlerëson se kjo ka ardhur për shkak të varësisë absolute të politikanëve të Kosovës karshi faktorit ndërkombëtar” [Daci, 2015].

¹⁷² Po aty, shih nenin 24

¹⁷³ Po aty, shih nenin 32

¹⁷⁴ Vendimit Nr. 461 i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë 2011

¹⁷⁵ Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat në Kosovë neni 8

Pavarësisht dispozitave të Kushtetutës të miratuar në vitin 2008, me Amendamentin nr.24 të Kushtetutës shtohet një nen i ri, Neni 162 me formulimin si në vijim: “pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, për të përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011, Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të Specializuara dhe një Zyrë të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë”. Sipas Dacit “Kosova nuk ka pasur nevojë për Gjykatë Speciale, nevojën e themelimit të saj mjerisht e ka sjellë politika në Kosovë. Ajo nuk ishte e nevojshme, është anti historike, është kundër traditës së ndërtimit të shteteve” [Daci, date: 01.09.2015].

Sipas nenit 7 të Ligjit nr.03/I-199 për Gjykatat në Kosovë parashikohet se çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta për gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtën për mbrojtje të barabartë me ligj, të drejtën për gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor. Duke iu referuar nenit 14 të Ligjit për Gjykatat në Kosovë është përcaktuar se, Departamenti për Çështje Administrative pranë kësaj gjykate, gjykon dhe vendos për konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.¹⁷⁶

Departamenti për Çështje Administrative gjykon dhe vendos për zgjidhjen e konflikteve të kompetencave dhe për konfliktet e lindura mes organeve të ndryshme të administratës publike.¹⁷⁷ Për lindjen e mosmarrëveshjes a të konfliktit të kompetencës ndërmjet organeve administrative, për zgjidhjen e të cilave kërkohet ndërhyrja e gjykatës kompetente, është e domosdoshme të plotësohen tri kushte:

- mosmarrëveshja apo konflikti të lindë ndërmjet organeve të ndryshme administrative;

¹⁷⁶Ligji Nr. 03/I-199 për Gjykatat në Kosovë, nenet 7, 8, 12, 14.

¹⁷⁷Ligji Nr. 02/L-28 për procedurën administrative, neni 27.

- mosmarrëveshja a konflikti të lindë ndërmjet organeve që deklarojnë vullnet pushteti;
- mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave [Baraliu & Stavileci, 2014: 84].


Në kuadër të këtij Departamenti vepron edhe Devizioni fiskal i cili është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim nga Departamenti i Ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi.¹⁷⁸

Në nenin 2 të Ligjit për konfliktet administrative është parashikuar sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizikë, juridikë dhe palëve të tjera, të drejta dhe interesa të cilat janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike. Referuar nenit 9 të këtij ligji, parashikohet se gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike e personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.¹⁷⁹ Për të pasur një pasqyrë më të qartë për çështjet administrative të drejtuara në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Departamentin për Çështje Administrative, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, në vijim po i paraqesim të dhënat në formë grafike dhe tabelë.

¹⁷⁸Ligji Nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat Nr. 03/L-222, neni 81. B.

¹⁷⁹Ligji Nr. 03/I-202 Për konfliktet administrative, neni 2 dhe neni 9.

Grafiku 4: Lëndët (çështjet) administrative të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura prej Janarit 2013 deri në Dhjetor 2017 në Gjykatën Themelore të Prishtinës.



Burimi: bazuar në të dhënat nga Raporti Statistikor dhe Raportet vjetore të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës prej Janarit 2013 deri në dhjetor 2017¹⁸⁰, të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron se në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës, lëndë administrative të pazgjidhura p.sh. në fillim të vitit 2014 ishin 2601 lëndë. Gjatë këtij viti janë pranuar 2566 lëndë pra, gjithsej ishin 5169 çështje për shqyrtim gjyqësor, dhe janë zgjidhur 1130 prej tyre, por kanë mbetur të pazgjidhura në fund të vitit edhe 4030 lëndë të cilat mbarten për vitin 2015.

Në vitin 2015 gjithsej ishin 6339 lëndë për shqyrtim gjyqësor. Prej tyre vetem 959 lëndë u zgjidhën dhe mbetën të pa zgjidhura 5380 lëndë në fund të vitit, të cilat u mbartën për vitin 2016. Ndërsa, në 2016 gjithsej për shqyrtim gjyqësor ishin 7596 lëndë ku prej tyre vetëm 2404 lëndë u zgjidhën, ndërsa mbetën të pazgjidhura në fund të vitit edhe 5192 lëndë, të cilat u mbartën për vitin 2017.

Ky Departament fillon vitin me një numër të madh të lëndëve duke llogaritur edhe ato të mbartura nga viti parardhës. Gjithsej për 2017 ishin 7592 lëndë (Çështje) ku 2268 prej tyre u zgjidhën, por mbetën të pazgjidhura në fund të vitit edhe 5304 lëndë. Pra, personat fizikë, juridikë dhe palët e tjera për realizimin e të drejtës dhe


¹⁸⁰ Këshilli Gjyqësor i Kosovës Raporti vjetor 2014 fq.52, Raporti vjetor vitit 2015 fq. 59, Raporti vjetor të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për vitin 2016 fq. 56, Raporti Statistikor i Këshillit Gjyqësor për vitin 2013 - 2017 dorëzuar autorit të punimit me date 02.02.2018.

interesit të tij/saj, që u janë cenuar me vendime individuale ose nga veprimet e organeve të administratës publike, duhet të presin me vite.

Ky Departament kishte vetëm 3 gjyqtarë, një numër shumë i vogël gjyqtarësh ky për të trajtuar një numër të lëndëve në rritje për shqyrtim gjyqësor. Pra, në këtë Departament, çdo vit krahasuar me vitin paraprak u rrit numri i lëndëve të zgjidhura, mirëpo u rrit edhe numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit.

Në vijim pasqyrohen lëndët (Çështjet) administrative në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, me të dhënat sipas viteve.

Grafiku 5: Lëndët administrative të pranuar, të zgjidhura dhe të pagjidhura për katër vite 2014-2017 në Gjykatën e Apelit në Prishtinë



Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve vjetore të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës prej Janarit 2014 deri në nëntëmuji të 2017¹⁸¹, të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku pasqyron gjendjen e Gjykatës së Apelit që ka juridiksion të shkallës së dytë për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Lëndë administrative në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën e Apelit në Prishtinë gjatë katër viteve ishin gjithsej 3031, nga të cilat janë zgjidhur 1,556 lëndë. Në fund të vitit 2014 mbetën të pazgjidhura 389 lëndë, në vitin 2015 mbetën 324 lëndë, në

¹⁸¹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës Raporti vjetor 2014, fq.48, Raporti vjetor 2015 fq, 57, Raporti vjetor të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për vitin 2016, fq. 54, Raporti Statistikor i Gjykatave Nëntëmuji - 2017 , fq. 8

vitin 2016 mbetën të pazgjidhura 334 kurse në nëntëmujorin e 2017 ishin edhe 428 lëndë të pazgjidhura.

Po kështu, në Gjykatën e Apelit janë një numër i vogël i gjyqtarëve, gjë që pamundëson shqyrtimin dhe zgjidhjen e lëndëve sipas afateve kohore.

Për shkak të ngarkesës së punës dhe numrit të vogël të gjyqtarëve që merren me lëndët administrative, numri i rasteve administrative të pazgjidhura sa vjen e rritet [MAP, 2015:24]. Subjektet e së drejtës duhet të presin me vite për realizimin e një të drejte të cenuar nga organet e administratës publike dhe autoritetet e tjera publike.

Në vijim pasqyrohet gjendja për lëndët administrative në Gjykatën Supreme në forme grafike dhe tabelë për disa vite.

Tabela 1: Lëndët administrative për vitet 2007-2013 në Gjykatën Supreme

Lëndët administrative sipas viteve	Të pakryera në fillim të vitit	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Të pakryera në fund të vitit
2007	2164	2886	5050	3057	1993
2008	1993	1402	3395	2308	1087
2009	1087	1031	2118	1326	792
2010	792	1244	2036	1008	1028
2011	1028	1550	2578	1194	1384
2012	1384	1637	3021	1405	1616
2013	-	8940	8940	8939	1
Totali		18,690	27,138	19,237	


Burimi: bazuar në të dhënat nga Raporti Statistikor të Gjykatës Supreme të Kosovës.¹⁸²

Tabela e mësipërme pasqyron se prej vitit 2007 deri në fund të vitit 2013 kjo gjykatë ka trajtuar gjithsej për këto vite 27,138 lëndë dhe ka zgjidhur 19,237 lëndë administrative. Të gjitha lëndët në Gjykatën Supreme të cilat nuk ishin zgjidhur me një vendim të formës së prerë, deri më 31 dhjetor të vitit 2012, filluan të trajtohen si lëndë të Gjykatës së Apelit prej 1 janarit të vitit 2013.¹⁸³ Më poshtë janë paraqitur të dhënat në formë grafike për lëndët administrative në Gjykatën Supreme pas riorganizimit sipas Ligjit për Gjykatat, i cili është në fuqi.

¹⁸² Këto të dhëna i janë ofruar autorit të punimit me date 25.01.2018 nga Gjykata Supreme e Kosovës.

¹⁸³ Gjykata Supreme e Kosovës Raporti i punës për vitin 2012 Periudha 01.01.2012 – 30.11.2012, fq 1

Grafiku 6: Lëndët administrative të pranuar, të zgjidhura dhe të pagjidhura për katër vite 2014-2017 në Gjykatën Supreme të Kosovës



Burimi: bazuar në të dhënat e Raportit vjetor të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës prej Janarit 2014 deri në nëntëmujorin e 2017,¹⁸⁴ të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku pasqyron rastet e paraqitura në Gjykatën Supreme të Kosovës, lëndë të pranuar, lëndë të zgjidhura dhe të pazgjidhura për katër vite. Në vitin 2014 kjo Gjykatë filloi vitin me pesë lëndë administrative të mbartura nga viti 2013. Gjatë këtyre viteve që janë rast studimi, Gjykata ka pranuar 316 lëndë, janë zgjidhur 298 lëndë dhe kanë mbetur të pa zgjidhura 12 lëndë në fund të nëntëmujorit të 2017. Sipas ish-Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Z.Hasanit “në Kosovë duhet të krijohet një Gjykatë Administrative Supreme, si një institucion i specializuar, që do të bënte kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë së punës së tërë administratës publike. E meta kryesore në Kosovë qendron në kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë, sepse po të ishte efektiv ky kontroll atëherë do të krijonte një standard të caktuar të sjelljes së administratës publike. Kështu, siç është gjendja, nuk ka një vijë të qartë të cilën duhet ta ndjekë administrata publike, gjë që vërehet qartë nga natyra arbitrare e vendimeve të administratës publike në Kosovë”.¹⁸⁵

¹⁸⁴Këshilli Gjyqësor i Kosovës Raporti vjetor 2014, fq.45, Raporti vjetor 2015 fq, 54, Raporti vjetor të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për vitin 2016, fq. 51, Raporti Statistikor i Gjykatave Nëntëmujori - 2017, fq. 4

¹⁸⁵Hasani, Enver. Intervistë me ish Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e realizuar nga autori i punimit, me date 13.09.2015.

Për këtë, Kosova duhet të ndryshojë dhe plotësojë Ligjin për Gjykatat, që të mundësohet krijimi i Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme në Kosovë, si gjykata të specializuara, si dhe të miratohet një ligj i veçantë për krijimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme. Gjykata Administrative do të shqyrtojë si mosmarrëveshje, çështjet e vlefshmërisë apo pavlefshmërisë së veprimeve administrative, të drejtën e vlerësimit të ligjshmërisë së akteve administrative [Zendeli, Memeti & Rustemi, 2012:92]. Gjyqtarët e gjykatës administrative do të jenë njohës më të mirë të së drejtës administrative dhe veprimtarisë së administratës, sepse deri tani institucionet gjyqësore në Kosovë si arsye për mos efikasitet gjatë këtyre viteve, kanë ngritur çështjen se kanë shumë lëndë dhe numri i gjyqtarëve është i vogël, dhe se çdo vit ka më tepër rritje të rasteve dhe lëndëve sesa rritje të numrit të emërimit të gjyqtarëve të rinj në Kosovë.

Në Kosovë, gjyqtarët e EULEX-it në procedurë penale kishin juridiksion dhe kompetencë për çdo lëndë të hetuar a të ndjekur penalisht nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK-ja). Në kuadër të shumë kompetencave të gjyqtarëve të EULEX-it, parashikohet edhe shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit (neni 339, KPPK), përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës (neni 340, KPPK), mashtrimi në detyrë (neni 341, KPPK), pranimi i ryshfetit (neni 343, KPPK), dhënia e ryshfetit (neni 344, KPPK).¹⁸⁶ Abuzimi me pushtetin penalizohet më dispoziat e Kodit Penal dhe parashikohet dënimi për veprat penale kundër detyrës zyrtare.

Referuar raporteve të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës Statistikat e Jurisprudencës për persona madhor prej vitit 2008 deri dhjetor 2016 gjykatat e Kosovës kanë dhënë shumë pak dënime për zyrtarë të administratës, ku më shumë ishin dënime me gjobë dhe dënime alternative se sa dënime me burg ndaj personave zyrtarë që kanë shpërdoruar detyrën zyrtare.¹⁸⁷ Këto vendime gjyqësore kanë

¹⁸⁶ Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, neni 3 paragrafi 3.3 pika p

¹⁸⁷ Sqarim: Gjykatat e Kosovës për vepra penale kundër detyrës zyrtare (Kapitulli XXIX neni 339-348) prej vitit 2008 deri në fund të vitit 2016 kanë shqiptuara dënime ndaj 370 personave. Denimet e shqiptuara janë: për 177 persona denim me gjobe, 41 persona denim 2-6 muaj, 23 persona 6-12 muaj, 26 persona 1-2 vjet, nentë (9) persona 2-5 vjet, dy persona 5 – 10 vjet dhe dënime alternative

ndikuar që të mos parandalohen dhe të luftohen dukuritë negative në administratën publike. Për këtë, ekziston një opinion tek intervistuesit se Qeveria po ndikon mbi pushtetin gjyqësor, në disa raste në proceset gjyqësore kur gjykohen anëtarët e lartë të partisë në pushtet apo ish-zyrtarë të lartë të qeverisë, kryetarë të komunave (rasti i kryetarit të komunës së Ferizajit, Skënderajt dhe Kaçanikut dhe zyrtarëve publike të tjerë) etj.

Sipas, Kryeprokurorit të Shtetit, Lumezi “duhet një ndarje e qartë e kompetencave të institucioneve dhe ushtrimi maksimal i diskrecionit profesional të çdo institucioni. Nëse ndonjëra nga hallkat e gjyqësorit nuk është në nivelin e detyrës, rrjedhimisht të gjitha organeve të tjera u vështirësohet funksionimi.”¹⁸⁸ Ndërsa, ish-Ministri Kuçi ka thënë se “Garancia më e qëndrueshme për qytetarët do të jetë nëse institucionet e vendit garantojnë që do të jenë në gjendje për të kontrolluar, stigmatizuar por edhe për të dënuar vetveten.”¹⁸⁹ Pra, në një sistem të pavarur gjyqësor, gjyqtarët japin llogari për veprimet e tyre mirëpo nuk i nënshtrohen faktorëve politikë apo ekonomikë në marrjen e vendimeve në rastet e paraqitura pranë tyre.¹⁹⁰ Siç e kishte vërejtur edhe Thomas Jeffersoni, nëse gjyqtarët janë në mëshirë të ndonjë dege të qeverisë për mandatin apo rrogën e tyre, atëherë vendimet e tyre do të ndikohen. Pyetjet nuk do të jenë “çfarë thotë kushtetuta?”; “çfarë thotë

ndaj 94 personave demim me kusht, dhe shtatë (7) persona me verejtje gjyqësore. Me gjerësisht shikoni në Raporte të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës Seria 5: Statistikat Sociale Statistikat e Jurisprudencës për Persona Madhor 2016 Shtator, 2017 fq. 73, Statistikat e Jurisprudencës për persona madhor 2015 Shtator, 2016 fq. 72, Statistikat e Jurisprudencës për persona madhor 2014 fq. 59, Statistikat e Jurisprudencës për persona madhor 2013 fq. 69, Statistikat e Jurisprudencës për persona madhor 2012 fq. 66, Statistikat e Jurisprudencës për personat madhor 2011 fq. 53, Statistikat e Jurisprudencës për personat madhor 2010 fq. 49, Statistikat e Jurisprudencës për persona madhor 2009 fq. 38, Statistikat e Jurisprudencës për personat madhor 2008 fq. 39.

¹⁸⁸ Lumezi, Alexander në fjalimin e promovimit të Doracakut për provimit të jurisprudence me date 16, shtator 2015 ne ora 14:49 Gazeta Tribuna shih në <http://gazetatribuna.com/lajme/promovohet-doracku-për-provimin-e-jurisprudence/>

¹⁸⁹ Kuci, Hairadin. kumtese në trvezën e organizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IDK). me rastin e publikimit të raportit “Luftimi i korrupsionit në Kosovë, prioritet në letër marre nga <http://www.md-ks.net/?page=1,8,1721> shikuar me 13. 12. 2015

¹⁹⁰ Omar E. García-Bolívar, Lack of Judicial Independence and Its Impact on Transnational and International Litigation, 18L. & Bus. Rev. Am. 29, 30-31 (2012). Cituar nga Gjyqtari Michael J. Davis Kryetar, Gjykata e Rrethit të Shteteve të Bashkuara, Rrethi i Minnesotes tema Ruajtja e të drejtave të njeriut në Gjykatat e Shteteve të Bashkuara – Roli i Avokatit mbrojtës dhe gjyqtarit, Qershor 29, 2012, 11:30 – 12:15 Prishtinë, Kosovë, E Drejta - Pravo - Law Nr. 1/2013, fq.161

ligji?” por do të jenë “A mos do të shkarkohem vallë?”, “A do të më hiqet apo zvogëlohet rroga?” apo “A mos vallë ky vendim nuk do jetë i popullarizuar?”¹⁹¹

Në Kosovë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor, është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve, për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin.¹⁹² Përveç këtyre, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për mbikqyrjen e funksionimit të gjykatave të Kosovës dhe përcaktimin e politikave dhe strategjive për funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave.

Kryesuesi i KGJK-së është zyrtari kryesor administrativ i gjykatave dhe, së bashku me KGJK-në, është përgjegjës për punën efektive dhe efikase të gjykatave.¹⁹³

Ndërsa, vlerësimi i performancës së gjyqtarëve me mandat fillestar bëhet së paku dy herë gjatë këtij mandati nga komisioni për vlerësim të performancës së gjyqtarëve, një herë pas trajnimit fillestar dhe një herë në fund të mandatit fillestar. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve me mandat të përhershëm bëhet çdo tre vjet.¹⁹⁴

Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve përbëhet nga gjyqtarë me përvojë në sistemin gjyqësor të Kosovës.¹⁹⁵

¹⁹¹ Gjyqtari Dale A. Kimball, The Importance of Lawyers and Judges in American Life, 25 Utah B.J. 20, 25 (Prill 2012). Cituar nga Michael J. Davis tema Ruajtja e të drejtave të njeriut në gjykatat e Shteteve të Bashkuara – Roli i Avokatit mbrojtës dhe gjyqtarit, Qershor 29, 2012, 11:30 – 12:15 Prishtinë, Kosovë, E Drejta - Pravo - Law Nr. 1/2013, fq.161

¹⁹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 108 paragrafi 1, paragrafi 3 dhe neni 5

¹⁹³ Këshilli i Evropës, Prill 2015, Raporti i vlerësimit mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit (LKK) Fq. 35 shih

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806eed0a>

¹⁹⁴ Ligji Nr. 05/L -033 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/1-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Neni 10

¹⁹⁵ Po aty, Neni 19/A

3.5.1. Kontrolli i administratës publike nga ana e Prokurorisë

Kontrollin e administratës nga prokuroria, shumë autorë e konsiderojnë si një formë të veçantë të kontrollit të administratës. Profesor Sokoli thekson se “kontrolli i Prokurorisë Publike mbi punën e administratës, sipas karakterit të vet qenësisht dallohet nga format e tjera të kontrollit të administratës, sepse autorizimet e prokurorisë publike në realizimin e ligjshmërisë janë të karakterit procedural, e jo meritor” [Stavileci, Sokoli & Batalli, 2010:144].

Në Kosovë, prokuroria publike ka funksionuar në tri nivele: Prokuroritë Publike Komunale, Prokuroritë Publike të Qarkut, Prokuroria Publike e Kosovës. Struktura organizative e Prokurorisë së Shtetit, pësoi ndryshime sikurse struktura organizative e gjyqësorit. Që nga 1 janari 2013 është: Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit si instanca më e lartë e Prokurorit të Shtetit, me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, Prokuroria e Apelit si shkallë e dytë dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës si organ prokurorial i specializuar me juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe Prokuroritë Themelore në shtatë qendra të mëdha. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Nenin 109 paragrafi një (1) përcakton se Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit. Sipas nenit 110 të Kushtetutës, Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore.¹⁹⁶ Po kështu, neni tre përcakton se Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime për të gjithë personat pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare,

¹⁹⁶ Ligji Nr. 05/L-035 përndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës neni 2

gjendjes apo të metave shëndetësore, apo pozitës shoqërore.¹⁹⁷ Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës në Nenin tre (3) paragrafi pesë (5) parashikohen se Prokurorët Special do të kenë kompetencë dhe përgjegjësi për të ushtruar funksionet e tyre, duke përfshirë edhe kompetencat dhe përgjegjësinë për të zhvilluar hetime dhe ndjekur penalisht krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PSRK-së, në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat që veprojnë në Kosovë¹⁹⁸. Sipas Profesor Stavilecit “karakterit procedural i autorizimeve të mbikqyrjes (kontrollit) të prokurorisë publike shprehet në atë se prokuroria publike nuk ka autorizime që t’i prishë, t’i ndryshojë ose t’i anulojë aktet e administratës, por ajo ka autorizime të karakterit procedural në procedurën administrative dhe në konfliktin administrativ, me të cilat vë në lëvizje mekanizmin i cili mund të sjellë deri anulimin, prishjen dhe ndryshimin e akteve të administratës” [Stavileci & Sokoli & Batalli, 2010:144].

Kontrollin në mënyrë indirekte të administratës e tregojnë raportet për punën e Prokurorit të shtetit të Republikës së Kosovës. Por ne po i referohemi një viti për mos të ngarkuar punimin me vite të tjera. Për shembull: gjatë vitit 2012 Prokuroritë, për veprat penale kundër detyrës zyrtare, (nenet 339-345 të KPK-së,) kanë pranuar 376 kallëzime kundër 868 personave. Në fillim të vitit prokuroritë kanë pasur kallëzimet e pazgjidhura penale kundër 802 personave, që do të thotë se kanë pasur kallëzimet penale kundër gjithsej të 1670 personave. Gjykatat gjatë vitit raportues kanë shpallur fajtorë dhe gjykuar me urdhër ndëshkimor 14 persona, kanë shpallur fajtorë dhe dënuar 104 persona, iu kanë shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm dy personave, kanë refuzuar aktakuzën kundër 24 personave dhe 18 persona i kanë liruar nga aktakuza.¹⁹⁹

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK),organi prokurorial i përhershëm dhe i specializuar, që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit të

¹⁹⁷ Ligji Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, neni 3 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 83 Datë e publikimit 29.10.2010

¹⁹⁸ Ligji Nr. 03/L-052 për prokurorinë speciale të Republikës së Kosovës, neni 3, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 27 / 03 Qershor 2008

¹⁹⁹ Prokurori i Shtetit i Republikës së Kosovës Raport për punën e Prokurorit të shtetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012 Fq. 40

Kosovës. Është Zyrë Prokuroriale unike, e përbërë nga prokurorë dhe staf mbështetës, vendor dhe të EULEX-it. Sipas Raportit mbi punën e Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës 1 Janar-31 Mars 2013, në tremujorin e parë të këtij viti, janë marrë 13 aktvendime për fillimin e hetimeve kundër 44 personave, ku prej tyre tre lëndë me 12 persona për veprën penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit.²⁰⁰

Kosova fillimisht e mirëpriti EULEX-in për të zbatuar Planin e Ahtisaarit. Megjithatë, mandati neutral ndaj statusit injoroi efektin që do të kishte tek popullata vendore që shpresonte që EULEX-i do të fuqizonte shtetin e tyre të ri. [GLPS & DPC, 2014:25]. Kontributi i EULEX-it është i pakontestueshëm në ngritjen e kapaciteteve institucionale për sundimin e ligjit. Ky mision (EULEX-i) ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përforcimin e efikasitetit të sistemit të gjyqësorit. Mirepo, priteshmerit për ndërtimin e një gjyqësori të fortë dhe efektiv për ndëshkimin e krimeve të luftës, krimit të organizuar dhe korrupsionit të profilit të lartë nuk është përmbushur. Duhet theksuar se në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë, EULEX-i përsëri ka refuzuar të përdorë funksionin e vet ekzekutiv për të mos dërguar as edhe një zyrtar të lartë publik në gjykatë, pavarësisht nga shpresat e mëdha të krijuara më parë nga deklaratat e EULEX-it.²⁰¹

Përceptimi publik është se EULEX-i dhe Qeveria e Kosovës janë në mosmarrëveshje kur është fjala për çështjen e nxehtë të korrupsionit të nivelit të lartë. EULEX-i dhe zyrtarë të qeverisë së Kosovës kanë lëshuar deklarata përçarëse në lidhje me arrestimin e mundshëm të zyrtarëve të lartë të qeverisë, jo vetëm në drejtim të mungesës së bashkëpunimit midis EULEX-it dhe institucioneve qeverisëse të Kosovës në luftimin e korrupsionit, por edhe në aspektin e të drejtave të EULEX-it për ta bërë këtë.²⁰² Sinjale të tilla të përziera kanë shërbyer vetëm për

²⁰⁰Raport mbi punën e Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Periudha raportuese, 1 Janar-31 Mars 2013, Raport nga Zëvendës kryeprokurorja e PSRK, Sevdije Morina, më 3 Maj 2013

²⁰¹ QKSS & Lëvizja FOL & GAP, & KPJ & KDI & IPOL Raport i progresit made in Kosova Tetor 2010, Prishtinë, Fq.8

²⁰²Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL) Raport i dytë përcjellës mbi vlerësimin e punës së EULEX-it, Fq.2

të ulur besimin e publikut në aftësinë e EULEX-it për të luftuar korrupsionin dhe kjo rrezikon të forcojë ambientin dhe kulturën e mosndëshkimit në Kosovë.²⁰³ Kryeprokurori i shtetit, Lumezi ka thënë se “Prokuroria e Shtetit me të gjitha institucionet vartëse është duke u konsoliduar dhe vazhdimisht është duke punuar në hetimin, ndjekjen dhe luftimin e kriminalitetit, në veçanti atij të organizuar dhe korrupsionit”.²⁰⁴

Rezultatet e EULEX-it në luftimin e korrupsionit dhe sundimin e ligjit në Kosovë janë shumë të vogla ndërsa pritshmëritë e qytetarëve ishin shumë të mëdha nga ky mision. EULEX-i dhe Prokurorët ndërkombëtarë më shumë bënë spektakle mediatike duke arrestuar ish-Gubernatorin e Bankës Qendrore, ish-ministrin, apo zyrtarë publikë, duke dalë para mediave me deklarime se janë në shenjstër “peshqit e mëdhenj” ndërsa, në praktikë ende qytetarët nuk po shohin asnjë rezultat për luftimin e këtyre fenomeneve negative në administratën publike. Misioni i EULEX-it për sundim të ligjit në Kosovë ka dështuar. Për këtë mision pati edhe publikime në media për afëra korruptive edhe në mesin e zyrtarëve të EULEX-it. Mos efikasiteti në punë i zyrtarëve të EULEX-it, UNMIK-ut dhe prokurorëve vendorë ka ndikuar në shfaqjen dhe mos parandalimin e fenomeneve negative në administratën publike në Kosovë.

Prokurorët e intervistuar për këtë punim janë shprehur se zbrazëtitrat ligjore dhe përplasjet e kompetencave janë faktorët kryesorë për mos efikasitet në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve korruptive, shpërdorimit të funksionit zyrtar dhe keqmenaxhimit të fondeve publike. Të gjitha këto shkaqe janë prezente, ku dominon faktori i vullnetit politik si parakusht qenësor për krijimin e një klime të volitshme për parandalimin e korrupsionit, si dhe përplasje kompetencash mes institucioneve. Më pas kemi Prokurorinë Speciale e cila kryesisht trajton veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, e më pas edhe Prokuroria e nivelit Themelor merret me këtë lloj krimi. Shkaku i tretë për kah pesha mund të jenë zbrazëtitrat

²⁰³Po aty Fq.2

²⁰⁴Lumezi, Aleksandër. Në fjalimin e promovimit të Doracakut për provimin e Jurisprudencës, gazeta Tribuna me 16 shtator 2015 ora 14:49 shih në <http://gazetatribuna.com/lajme/promovohet-doracaku-per-provimin-e-jurisprudences/>

ligjore, të cilat i referohen sidomos mos aprovimit të ligjit të ashtuquajtur “anti mafia”. Sipas opinionit të prokuroreve të intervistuar, shumica prej tyre konsiderojnë se mungon vullneti politik për këtë çështje. Po ashtu, si arsye kryesore është mungesa e kuadrit ligjor, për shkak se për përmbushjen e objektivave në luftimin e këtyre dukurive janë masat e veprimit të natyrës legjislative. Përprjekjet e bëra ende nuk kanë arritur objektivat e tyre, dhe procesi i luftimit të këtyre dukurive është ende në vazhdim deri te miratimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor të duhur. Pra, jo efikasiteti është rezultat i zbrazëtirave ligjore, por edhe i numrit të vogël të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe stafit mbështetës, që lidhet me mungesat buxhetore për shtim të personelit, e për këtë duhet vullneti politik.

3.6. Gjykata Kushtetuese në kontrollin e administratës publike

“Ne jemi nën Kushtetutën, por Kushtetuta është ajo çfarë gjyqtarët thonë se është”.
Charles Evans Hughes (1862-1948).²⁰⁵

Ushtrimi i kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve juridike njihet si kontrolli gjyqësor [Maksuti, 2012:89]. Roli i kontrollit kushtetues në statusin e një shteti me pushtete të ndara mund të përshkruhet qartazi si veprimtari e pastër gjyqësore. Nga njëra anë kjo kushtëzohet nga lidhja e juridiksionit kushtetues me një parim, ç’ka është tipike për pushtetin gjyqësor. Edhe për Gjykatën Kushtetuese vlen parimi: nëse nuk ka paditës, nuk ka gjyqtarë.²⁰⁶ Profesor Sadushi thekson se “Gjykatat kushtetuese janë pajisur me pushtet të gjerë në fushën e drejtësisë kushtetuese, por efekti më domethënës i tyre mbetet në kontrollin e

²⁰⁵I cituar në Përmbledhje të vendimet më të spikatura të Gjykatës Kushtetuese shqiptare, Fq. 13

²⁰⁶Vendime të për zgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, Fq.21.

kushtetutshmërisë së ligjit dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pushteteve”.²⁰⁷

Mëgjithatë, ka sisteme të ndryshme të kontrollit dhe mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, për vlerësimin e akteve juridike nëse janë në pajtueshmëri me Kushtetutën si akti më i lartë i shtetit, kontrollin e ekzistencës së shkeljes apo mosrespektimin e Kushtetutës apo kompetencave të garantuara me Kushtetutë nga organet dhe institucionet shtetërore dhe zyrtarë të lartë të shtetit, në raste kur kemi shkelje të Kushtetutës nga zyrtarë të lartë dhe shkarkimin e tyre. Sipas Profesor Omarit dhe Anastasit “kontrolli i kushtetutshmërisë është një nga kushtet e respektimit të shtetit juridik dhe lirive e të drejtave demokratike. Pavarësisht nga ngurrimet për ta pranuar atë dhe nga objeksionet e ndryshme, tashmë është afirmuar ideja e nevojës së kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, sepse është krijuar bindja se nuk mund të ekzistojë një shtet juridik në qoftë se partia ose koalicioni në pushtet, që drejton ekzekutivin dhe ka shumicën në Parlament, mund të imponojë ligje që shkelin Kushtetuten”[Omari & Anastasi, 2010:421].

Sipas Profesor Sadushit “drejtësia kushtetuese, përbën një pengesë ndaj veprimeve arbitrare të bartësve të funksioneve të pushtetit publik, bazohet në parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve dhe në veçanti në përfshirjen e Gjykatës Kushtetuese, si autoriteti më i lartë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe si një garant i respektimit të epërsisë së Kushtetutës në raport me normat e tjera të së drejtës. Rëndësia e kontrollit të kushtetutshmërisë qëndron në faktin se, në një mosmarrëveshje të lindur, ndërmjet shqyrtimit dhe vlerësimit të kushtetutshmërisë, gjykata zgjidh rastin konkret në raport me të drejtën dhe në veçanti me Kushtetutën”.²⁰⁸

Profesor Bajrami thekson se “Gjykatat kushtetuese në shume vende paraqet mekanizimin kryesor institucional, që në mënyrë meritore mbron kushtetueshmërinë dhe ligjshmërinë dhe siguron parimin e sundimit të ligjit në shoqëri” [Bajrami,

²⁰⁷ Sadushi, Sokol. Sfidat e Gjykatës Kushtetuese përballë legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit fq.1, shih: <http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/01/tema-20-vjet-GJK.pdf>

²⁰⁸ Sadushi, Sokol. Sfidat e Gjykatës Kushtetuese përballë legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit fq.1 shih: <http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/01/tema-20-vjet-GJK.pdf>.

2007:201].Një kontroll kushtetues që funksionon siç duhet, është kusht i domosdoshëm i një shteti të së drejtës, nëse me këtë të fundit do të kuptonim më shumë se thjesht një parim kushtetues.²⁰⁹

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 113 përcakton se Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese, si palë e autorizuar këtë të drejtë e kanë edhe individet për shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, por vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.²¹⁰

Kontrolli që ushtron Gjykata Kushtetuese mbi ankimin kushtetues të individit ndaj procesit gjyqësor mund të quhet edhe kontroll i kontrolluesve, pasi vetë gjykatat janë institucione të ngritura për të kontrolluar veprimtarinë e administratës publike. Si të tilla ato vetë janë garante të të drejtave themelore. Ajo përqendrohet thjesht në respektimin e garancive kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.²¹¹ Gjyqtarët në vende të ndryshme të botës, kanë qenë mjaft aktivë në forcimin e mbrojtjes kushtetuese të demokracisë, të të drejtave individuale dhe pavarësisë së gjyqësorit. [Anastasi, 2009: 82].

Në Kosovë pas vendosjes së administrimit të OKB-së (1999) dhe me nxjerrjen e Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme të Kosovës (2001) përcaktohet edhe themelimi i Kolegjit të Veçantë i Gjykatës Supreme mbi Çështjet e Kornizës Kushtetuese. Mirëpo në praktikë ky institucion nuk ka funksionuar ndonjëherë.²¹²

Rregulloret e UNMIK-ut dhe aktet nënligjore përkatëse kanë mbetur jashtë mundësisë së rishqyrtimit si për gjyqësinë vendëse ashtu edhe për atë ndërkombëtare të Kosovës. Paqartësia lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, ka rezultuar në evoluimin e shpejtë të ligjeve dhe institucioneve të Kosovës, dhe në

²⁰⁹Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, fq.15

²¹⁰Neni 113 i Kushtetutes se Republikës së Kosovës.

²¹¹ Vorpsi, Arta. Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, fq. 97 shih : <http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/08/procesi-i-rregullt-perfundimtar-19.11.pdf>.

²¹² Gjykata Kushtetuese Historiku i Gjykatës Kushtetuese Republikës së Kosovës, shiko me gjerë web faqe: <http://www.gjk-ks.org/>.

karakterin kundërthënës dhe konfuz të miratimit të disa prej ligjeve të reja, duke përfshirë edhe ligjet të cilat ndikojnë në funksionimin e gjyqësorit.²¹³

Gjykata Kushtetuese e Kosovës është kontrolli më i lartë mbi pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në Kosovë është arbitri më i lartë për interpretimin e dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.²¹⁴ Gjykata Kushtetuese e Kosovës i ka parashtruar vetes mision që të jetë: Institucion profesional, kompetent dhe i pavarur, që është duke krijuar një traditë të re të paanshmërisë dhe të pavarësisë gjyqësore, si dhe të llogaridhënies së plotë në shërbim të qytetarëve të Kosovës.²¹⁵ Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj. Për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese si palë e autorizuar janë: Kuvendi, Presidenti, Qeveria e Kosovës, Avokati i Popullit, komunat, gjykatat, deputetët, Kryetari i Kuvendit dhe individët për shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të parashtrojnë kërkesa për këto raste në vijim:

1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë disa çështje²¹⁶.

²¹³ Shoqata e Avokatëve Amerikanë, Indeksi i Reformës gjyqësore për Kosovë, Vëllim i III, Gusht 2007, fq.3

²¹⁴ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, shiko me gjerësisht në web faqe: <http://www.gjks.org/>.

²¹⁵ Gjykata Kushtetuese, Raporti vjetor 2014, Prishtinë 2015, fq.6

²¹⁶ Sipas nenit 112 dhe nenit 113 të Kushtetutës, si çështje të tilla përmendim:

a) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

Gjykata kushtetuese kontrollon dhe vendos për kërkesa të ngritura kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2, i cili përcakton se Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim: çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekretëve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën; përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën, duke specifikuar, *inter alia*, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën. Kërkesa duhet të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës. Nga Gjykata Kushtetuese çdo individ ka të drejtë të kërkojë mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Individi mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.²¹⁷ Gjykata Kushtetuese miraton këto lloje të vendimeve:

- Aktgjykimet, kur Gjykata vendos në bazë të meritave të një kërkesë;

b) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën, e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën,

c) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur; nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

ç) të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur e kanë.

d) Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.

dh) Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

e) Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

f) Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.

²¹⁷Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën kushtetuese të Republikës së Kosovës nenet 29, 33, 34,42,44, dhe neni 47

- Aktvendimet, kur vendos për pranueshmërinë e një kërkesë;
- Vendimet, kur Gjykata vendos përkitazi me kërkesat për masë të përkohshme;
- Vendimet administrative, sa herë që Gjykata vendos në seanca administrative për çështje administrative; dhe
- Urdhra të tjerë të tillë që kohë pas kohe konsideron si të duhur.²¹⁸

Profesor Bajrami thekson se “vendimet e gjykatave kushtetuese në shume shtete pranohen si burime formale kushtetuese dhe bëhen pjesë e sistemit kushtetues të një vendi. Duke zgjidhur mosmarrëveshjet kushtetuese, gjykatat kushtetuese bëjnë kontrollin e kushtetutshmërisë dhe shfuqizojnë dhe anulojnë të gjitha aktet që nuk janë në pajtim me Kushtetutën” [Bajrami, 2012:517].

Bajrami & Shala theksojnë se “në aspektin e përgjithshëm, kompetencat e gjykatave kushtetuese mund të ndahen në tri fusha kryesore: kontrolli i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe vlerësimi i ekzistimit të pajtueshmërisë së akteve juridike me Kushtetutën dhe ligjin, kontrolli i ekzistimit të shkeljeve, cenimit, ose mos respektimit të Kushtetutës nga organet dhe institucionet shtetërore, përfshirë këtu edhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë shtetërorë, dhe kontrolli i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së zgjedhjeve, referendumeve dhe akteve tjera juridike e politike” [Bajrami & Shala, 2008, fq.25-26].

Zaganjori & Anastasi theksojnë se “sipas filozofisë kelzeniane Gjykata Kushtetuese është ligjvënës negativ. Ajo nuk mund të zëvendësojë organin ligjvënës. Kontrolli i saj përqendrohet vetëm në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit. Për këtë qëllim ajo përpiket të zbulojë edhe përmbajtjen e tij, por pa pasur të drejtë të shkojë më tej, duke saktësuar apo korrektuar vetë ligjin”.²¹⁹ Sipas nenit 112 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.²²⁰

²¹⁸Rregullore e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Rregulli 56

²¹⁹Zaganjori, Xhezair & Aurela Anastasi & Eralda (Methasani) Çani, “Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Shtëpia Botuese Adelprint 2011, Fq.24 shih: http://www.kas.de/wf/doc/kas_22897-1522-33-30.pdf?110527101932

²²⁰ Neni 112 i Kushtetutes së Republikës së Kosovës

Neni 116 i Kushtetutës të Kosovës dhe rregulli 63 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, përcaktojnë se zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm për gjyqësorin, institucionet e Kosovës dhe gjithë individët.²²¹ Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese nuk karakterizohet vetëm nga kontrolli i ligjeve dhe vendimet lidhur me konfliktet midis organeve më të larta shtetërore. Mjaft e rëndësishme në praktikën e përditshme është kontrolli i një numri të madh aktesh të ekzekutivit dhe vendimeve të gjykatave në rastet e veçanta.²²²

Gjykata Kushtetuese shqyrton një numër aktesh të ngritura nga palët e autorizuar për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga Kuvendi, Qeveria, Kuvendet e Komunave, Gjykatat e rregullta dhe Institucionet e Pavarura. Për hulumtimin tonë, më gjerësisht, do të shtjellohen tre raste të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese.

Rasti i parë, Aktgjykimi në rastin nr.K073/16, që lidhej me Qarkoren Administrative Nr. 01/ 2016, të 21 janarit 2016, e nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, për të zbatuar Rregulloren nr.O5/ 2012 për klasifikimin e vendeve të punës dhe Katalogun e vendeve të punës në Shërbimin Civil, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2012. Kjo rregullore përcaktonte kriteret dhe procedurat për klasifikimin e vendeve të punës, gradave dhe hapave të gradave për nëpunësit civilë në institucionet e nivelit qendror dhe lokal, në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-149, dhe Ligjin Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal me rastin e klasifikimit të vendeve të punës, për nëpunësit civilë të Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.²²³ Ministria e Administratës Publike, me qëllim të mbështetjes së institucioneve në përgatitjen dhe përfundimin e procesit të klasifikimit të vendeve të punës dhe gradimit, nxjerr Qarkoren administrative të radhës, përmes së cilës përcakton dhe sqaron veprimet dhe hapat e mëtutjeshëm për zbatimin e klasifikimit dhe vendosjen e nëpunësve civilë në pozita dhe grada sipas Rregullores për Klasifikimin e

²²¹ Rregullore e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Rregulli 63

²²² Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, fq. 22.

²²³ Rregullore Nr. 05/2012 Për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil Neni 1

Nëpunësve Civilë dhe Katalogut të vendeve të punës të miratuar nga Qeveria. Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës e kontestoi kushtetutshmërinë e Qarkores Administrative nr.01/ 2016, të 21 janarit 2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, sepse cenon pavarësinë e Institucioneve të Pavarura si kategori kushtetuese dhe parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese që të bëhet vlerësimi i kushtetutshmërisë së Qarkores së kontestuar administrative.²²⁴

Gjykata konstatoi njëzëri, që “Qarkorja Administrative nr.01/2016 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike, në tërësi cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura të parapara me Kushtetutë, dhe është jokushtetuese në raport me këto institucione të pavarura. Qarkorja Administrative e lartpërmendur rrjedhimisht është e pavlefshme sa i përket parashtruesit të kërkesës dhe institucioneve të pavarura, shprehimisht të renditura në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura], konkretisht në nenet 132-135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 136-138 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave], si dhe përkritazi me Gjykatën, siç është përcaktuar në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës.”²²⁵

Rasti i dytë, Aktgjykimi në Rastin nr.K1112/12 lidhej me kërkesën e parshtruesit që kërkonte realizimin e së drejtës për kthim në vendin e tij të punës dhe zbatimin në terësi të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK), si dhe anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Skënderaj (Nr. 0242/2011) dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë (Ae.Nr.61/12), në pjesët ku nuk

²²⁴Sqarim Gjykata në rastin nr.K073/16, e konsideron se institucionet e pavarura, të përcaktuara në Kapitullin XII të Kushtetutes dhe, në veçanti, parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata gjenden jashte tri degeve të pushtetit dhe, si të tilla, ato nuk janë dhe nuk mund të përfshihen në nderveprimin e ndarjes se pushtetit dhe të kontrollit dhe balancimit që karakterizon të tri deget e pushtetit.....Gjykata gjen se Qarkorja Administrative në tërësi cenon dispozitat e Kushtetutës të përcaktuara në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura].

²²⁵Aktgjykim rastin nr. K073/16 Parashtrues Avokati i Popullit Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerre nga Ministria e Administrates Publike të Republikës se Kosovës, me 21janar 2016

ishite miratuar kërkesa e tij për kthim në vendin e punës. Parashtruesi ankohej se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshem, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.²²⁶ Gjykata vëren se më 13 shtator 2011, KPMK-ja (Vendimi Nr. A 02/200/ 2011) miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar nga Administrata Komunale në Skënderaj që, në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, të kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, duke përfshirë kompensimin e pagave mujore në mënyrë retroaktive.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, moszbatimi i tërësisë së vendimit të KPMK-së nga gjykatat e rregullta dhe dështimi i organeve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas për zbatimin e vendimeve përkatëse të organeve dhe të gjykatave, përben shkelje të neneve 31, 32 dhe neni 54 (të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për mjete juridike dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave) të Kushtetutes dhe të nenit 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Si rrjedhojë, e drejta për gjykim të drejtë dhe për mjete efektive juridike, e garantuar me nenet e lartcekura, është shkelur dhe vendimi përfundimtar i KPMK-se duhet të zbatohet në tërësi.

Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31,32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 6 dhe 13 të KEDNJ-së; konstatoi se është e panevojshme të trajtohen pretendimet për shkelje të neneve 21 dhe 49 të Kushtetutës, dhe e ktheu aktvendimin ac.Nr. 06/12, të 13 shkurtit 2012 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë për rishqyrtim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - dega Skënderaj, në përputhje me këtë aktgjykim.Gjithashtu urdhëroi Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega Skënderaj që, në pajtim me nenin 63 (5) të rregullorës së punës, t'i dorëzojë informata Gjykatës Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese.”²²⁷

²²⁶ Neni 31.1 i Kushtetutës përcakton se: "çdokujt i garantohet mbrojtje e barabarte e të drejtave në procedure para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

²²⁷ Aktgjykimi Gjykatës Kushtetuese, Rasti nr. KI112/12,Parashtrues Adem Meta. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës se Qarkut ne Mitrovice, Ac. Nr. 61/12, të 13 shkurtit 2012

Rasti i tretë, Aktgjykimi në Lëndën Nr. KO 01/09, që lidhej me Statutin e Komunës së Prizrenit. Parashtruesi i kërkesës ishte z. Qemajl Kurtishi, Zëvendës Kryesues për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Republika e Kosovës. Z. Kurtishi pretendonte se neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit shkelte nenet 3.1, 6.1, 58.1 dhe 59.1 të Kushtetutës. Më 15 tetor 2008, Komuna e Prizrenit miratoi vendimin për miratimin e Statutit Komunal, ku neni 7 i këtij Statuti parashikon se komuna ka emblemën, flamurin dhe simbolin e saj. Emblema e Komunës është "Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit", e rrethuar me fjalët në vijim "1878 - Prizren". Përdorimi i simboleve komunale do të rregullohet më tutje me një vendim të veçantë të Kuvendit. Kërkesa e dorëzuar nga z. Kurtishi theksonte se komunitetet jo-shumicë në atë kohë, kishin propozuar që fjalët "Komuna", "Opstina", "Belediye" të shkruhen brenda rrethit të emblemës, pa vitin "1878", për të simbolizuar kështu që ka disa komunitete që jetojnë në hapësirën e komunës, si dhe që Komuna është shumetnike.²²⁸ Gjykata Kushtetuese theksonte se pjesëmarrja e komunitetit në jetën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore është parakusht për një shoqëri pluraliste dhe vërtetë demokratike, qoftë në një shtet, rajon, komunë, apo njësi tjetër territoriale, në mënyrë që të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të kenë interes në atë shoqëri. Kjo pjesëmarrje nuk mund të arrihet nëse simboli i përbashkët i asaj shoqërie nuk përfaqëson të drejtat e të gjitha komuniteteve, por, në vend të kësaj, injoron të drejtat e komuniteteve jo-shumicë. Gjykata theksonte se formulimi "Komuna", "Opstina", "Belediye" duhet të shkruhet brenda rrethit të emblemës së

²²⁸Sqarim: komunitetet jo-shumice në Komunën e Prizrenit në atë kohe kishin propozuar që fjalët "Komuna", "Opstina", "Belediye" të shkruhen brenda rrethit të emblemës, pa vitin "1878". Ai propozim nuk ishte pranuar. Për më tepër, Zëvendës Kryesues për Komunitete pretendon që anëtarët e Kuvendit të Komunës nga komuniteti shumicë kishin injoruar faktin e pranisë tradicionale të komuniteteve jo-shumice në Komunë. Z. Kurtishi pretendon që paraqitja dhe simboli i Lidhjes së Prizrenit lartëson identitetin e vetemnjërit komunitet në Komunën e Prizrenit. Ai thekson se Lidhja e Prizrenit njih vetem rendësinë kulturore-historike të komunitetit shqiptar, dhe që emblema nuk ka elemente të cilat tregojnë komunitetet tjera që jetojnë në Komunë. Ai pretendon që emblema komunale duhet të simbolizojë dhe transmetojë porosinë e bashkëjetesës së komuniteteve dhe pjesëtareve të komuniteteve, si dhe praninë e etnive të shumta, kulturave të shumefishta, fete e shumta dhe gjuhët e shumta. Emblema, deklaroi ai, nuk dërgon porosinë e shumetnicitetit në vetë hapësirat shumetnike siç janë atë të Komunës së Prizrenit.

Komunës, pa vitin "1878". Gjykata ishte e mendimit se ky ishte propozim i arsyeshëm, i cili do të mund t'i përmbushte shqetësimet legjitime të komuniteteve.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se Kuvendi Komunal, gjatë marrjes së vendimeve për miratimin e nenit 7 të këtij Statuti, ka imponuar një emblemë e cila nuk mund të konsiderohet si simbol i përbashkët i të gjitha komuniteteve të Prizrenit, dhe në këtë mënyrë i ka dhënë rëndësi më të madhe Komunitetit Shqiptar mbi identitetin e komuniteteve të tjera në Prizren. Prandaj, Gjykata konstatonte se Kuvendi Komunal ka bërë shkelje të Kushtetutës. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe të drejtës në rastin konkret, detyrimin e komunës për të marrë në konsideratë të drejtat e komuniteteve jo-shumicë, nenet e Kushtetutës të referuara ndaj konventave ndërkombëtare dhe praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, Gjykata ka ardhur në konkluzionin se Komuna e Prizrenit, kur ka marrë vendim për miratimin e nenit 7 të Statutit të saj, nuk ka pasur vëmendjen e duhur ndaj të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë në trajtimin e të drejtës së komuniteteve pakicë, për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre.

Gjykata konstatoi se është bërë shkelje e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Prizren për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre dhe, për pasojë vendosi se neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në veçanti me nenet 3, 7.1, 58 dhe 59 të saj. Gjykata e urdhëroi Komunën e Prizrenit që, brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i këtij aktgjykimi, të ndryshojë Statutin dhe emblemën e saj në mënyrë që ta sjellë atë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të mos përjashtojë komunitetet jo-shumicë.”²²⁹ Pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, emblema e Komunës së Prizrenit është "Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit", dhe në rrethin e saj vetëm fjala Prizren.

²²⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Lënda Nr. KO 01/09, Qemajl Kurtishi Dhe Kuvendi Komunal i Prizreni, Prishtinë, date: 18 mars 2010 Ref. Nr. AGJ 07/10

3.7. Kontrolli i administratës publike nga Avokati i Popullit

Avokati i Popullit luan një rol të rëndësishëm në forcimin e përgjegjshmërisë së administratës publike, por ai mund të kontribuojë gjithashtu në rritjen e cilësisë administrative nëpërmjet ekspozimit të rasteve të keqadministrimit dhe duke rritur sensibilizimin e zyrtarëve publikë për pritshmëritë e publikut [SIGMA:(1998), Nr.26, fq.24]. Sipas Profesor Batallit “Avokati i Popullit vepron si një zyrtar i trupit legjislativ..... Vendimet e tij bazohen në fakte dhe në ligje” [Batalli, 2003:106].

Avokati i Popullit²³⁰ mbikqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të institucioneve qendrore dhe lokale. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.²³¹

Avokati është mekanizëm kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen, mbikqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike,²³² institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.²³³ Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, në nenin 38 parashikon se brenda 1 viti pas hyrjes në fuqi të ligjit, Institucioni i Avokatit të Popullit fillon me ushtrimin e kompetencave dhe obligimeve ligjore si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe

²³⁰Shala Mervete & Xhavit Shala The Role of the Ombudsman of the Republic of Kosovo European Journal of Law and Political Sciences, Vienna, № 1 2016,p.40-53 ISSN 2310-5712 (Pjesë të veçanta të kontrollit të administratës publike nga Avokati i Popullit të punimit është publikuar në këtë Reviste shkencore).

²³¹Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 132

²³² Ligji Nr. 03/1-195 për Avokatin e popullit Neni 1 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti v/ nr. 80 / 27 Gusht 2010

²³³Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit Neni 1

poshtëruese.²³⁴ Në korrik të vitit 2015, kanë hyrë në fuqi tre ligjet bazë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut: Ligji i Avokatit të Popullit, Ligji për Mbrojtje nga diskriminimi dhe Ligji për Barazi Gjinore, që kanë fuqizuar mandatin dhe i kanë dhënë kompetenca shtesë Avokatit të Popullit²³⁵ në funksionin e tij mbikqyrës dhe monitorues.

Ligji Nr.03/l-195 për Avokatin e popullit ka parashikuar dispozita që zbatohen për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të të gjithë personave në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të organeve të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës.²³⁶ Avokati i Popullit paraqet raportin vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës.²³⁷ Më kërkesën e Kuvendit, Avokati i Popullit duhet të dorëzojë raporte periodike ose tjera Kuvendit. Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit të Kosovës edhe raporte të veçanta për fusha të caktuara të të drejtave të njeriut. Raporte të veçanta Avokati i Popullit mund t'i publikojë edhe përmes mediave.²³⁸ Avokati i Popullit e paraqet raportin në seancë plenare, në të cilën diskutohet.²³⁹ Këto Raporte përfshijnë gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës. Avokati i Popullit ka përgjegjësi: t'i rekomandojë Kuvendit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit. Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe t'i rekomandojë

²³⁴ Po aty neni 38

²³⁵ Avokati i Popullit Fjala e Avokatit të Popullit në Raportin Vjetor 2015 Nr. 15 Fq.8

²³⁶ Ligji Nr. 03/l-195 për Avokatin e Popullit Neni 3

²³⁷ Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit Neni 29

²³⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 133 paragrafi 1 dhe 2 dhe Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit Neni 30

²³⁹ Ligji Nr. 03/l-195 për Avokatin e Popullit Neni 27

Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.²⁴⁰

Në përgjithësi, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë ka vazhduar gradualisht të përmirësojë punën e tij në të gjithë Kosovën. Autoritetet dhe institucionet e tjera në Kosovë duhet të përmirësojnë cilësinë e përgjigjeve të tyre në pyetjet e institucionit.[Komisioni Evropian (2014) Raporti i Progresit për Kosovën, fq.12]. Në lidhje me organet administrative ai ka kompetenca për të hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik, lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe konventa ndërkombëtare, veçanërisht me KEDNJ-në, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.²⁴¹ Të gjitha organet e pushtetit shtetëror kanë për detyrim ta ndihmojnë Avokatin e Popullit në zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.²⁴² Nëse Avokati i Popullit gjatë hetimeve konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet e çdo institucioni të Republikës së Kosovës dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që ka në

²⁴⁰ Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit Neni 18

²⁴¹ Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit Nenin 15 duke ju referuar këtij neni parashikon se Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut. Nëse Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë ose ndonjë person tjetër në emër të të dëmtuarit i drejtohet me parashtrësë Avokatit të Popullit për ngritjen e procedurës, është i nevojshëm pëlqimi nga personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut. Kur Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi, nuk është i nevojshëm pëlqimi i tyre.

²⁴² Po aty, shih Nenin 23

shqyrtim dhe sipas ligjit.²⁴³ Në kuadër të përgjegjësive si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKP), Avokati i Popullit është i obliguar që: të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë të drejtë qasjeje në informatat për gjendjen shëndetësore të personave të privuar nga liria, përfshirë edhe qasjen në dosjet e tyre mjekësore, me pajtimin e tyre, si dhe të dhënat personale të këtyre personave.²⁴⁴ Avokati i Popullit mund të publikojë raporte të veçanta edhe përmes mediave për shkeljet e bëra nga organi, nëse ky i fundit, pas kërkesave të përsëritura, nuk i është përgjigjur në mënyrë përkatëse propozimeve dhe rekomandimeve të tij.²⁴⁵

Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje edhe në Gjykatën Kushtetuese²⁴⁶, si:

- çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
- përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.²⁴⁷

Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës, duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.²⁴⁸ Bazuar në dispozitat ligjore, Avokati i Popullit mund të parashtrojë ankesë pranë Gjykatës

²⁴³Po aty, shih Nenin 16i cili parshikon se Avokati i Popullit mund të kërkojë nga çdo institucion i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, duke përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së Avokatit të Popullit. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të lëvizjes së kufizuar dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet

²⁴⁴Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit Neni 17

²⁴⁵Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit Neni 28

²⁴⁶Po aty, Neni 15

²⁴⁷Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 113

²⁴⁸Ligji Nr. 03/L-121 për gjykatën kushtetuese të Republikës së Kosovës Neni 29

Kushtetuese lidhur me ndonjë rast të cilin ai trajton. Ankesa pranë Gjykatës Kushtetuese parashtrohet vetëm pasi:

a) është marrë pëlqimi paraprak i ankuesit; dhe

b) është kryer një hetim paraprak, rezultati i të cilit është rekomandimi për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.²⁴⁹

Avokati i Popullit refuzon kërkesën kur procedurat për një lëndë janë duke u zhvilluar në organet gjyqësore ose në organet tjera kompetente, përveç në rastet e specifikuar me këtë ligj.²⁵⁰ Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura të tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të këtyre procedurave. Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit.²⁵¹ Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar disa here edhe Gjykatës Kushtetuese për disa çështje, ku disa prej tyre nga Gjykata janë kthyer pozitive e disa negative. *Çdo person, i cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të organeve të autoriteteve publike, organeve tjera dhe organizatave që ushtrojnë autoritete publike për llogari të tyre, mund të kërkojë nga Institucioni i Avokatit të Popullit fillimin e procedurës.*²⁵² Ankesat pranohen në të gjitha Zyrat e Avokatit të Popullit dhe regjistrohen në Zyrën qendrore në Prishtinë. Ankesa mund të paraqitet personalisht, me anë të postës, postës elektronike ose në raste urgjente me telefon. Pas kësaj, Zyra e Pranimit do t'ia caktojë rastin njërës prej njësave. Me kërkesë të parashtruesit ankesa mund të paraqitet gojarisht dhe regjistrohet me shkrim nga zyrtari i IAP si dhe nënshkruhet nga parashtruesi.²⁵³ E njëjta procedurë zhvillohet edhe në rastet e pritjes së ankuesve në “Ditët e Hapura” si dhe kur merret ankesë,

²⁴⁹ Rregullore e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës 2011 Neni 49

²⁵⁰ Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit Neni 20

²⁵¹ Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit Neni 16 Paragrafi 8 dhe 9 dhe paragrafi 11

²⁵² Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit Neni 17

²⁵³ Rregullore e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës 2011 Nenet 23-24;

kërkesë apo njoftim jashtë selisë së IAP.²⁵⁴ Pas pranimit të ankesës, Avokati i Popullit në afat prej tridhjetë ditësh vendos për pranueshmërinë e çështjes si në vijim: të shqyrtojë në procedurë të përshpejtuar rastin, të fillojë hetimin e plotë, të hedh poshtë ankesën për shkak se: nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit.²⁵⁵ Gjatë çdo faze të zhvillimit të procedurës së një ankese, Avokati i Popullit mund të kërkojë ndihmën nga cilido person, siç janë ankuesi, pala përgjegjëse ose përfaqësuesi i saj, përkthyesit, ekspertët e mjekësisë ligjore, të financave apo ekspertë të fushave të tjera.²⁵⁶ Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, nxjerr vendim në të cilin paraqiten konstatimet dhe rekomandimet e tij. Vendimi i tij i dërgohet parashtresit të ankesës dhe autoriteteve publike përgjegjëse. Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për masa disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.²⁵⁷

Avokati i Popullit evidenton dhe nxjerr në pah veprimet apo mosveprimet e parregullta e të paligjshme të organve qendrore dhe lokale, pikërisht për të forcuar rolin që ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin se të gjithë janë të barabartë para ligjit. Por, me gjithë këto veprime dhe përpjekje për përmirësimin e gjendjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, institucionet shtetërore janë pikërisht ato të cilat nuk do të duhej të shkelnin mbi parimet e drejtësisë ligjore, sepse po qe

²⁵⁴ Po aty shih, Nenet 27-28 e Rregullores se punës për Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës 2011 parashikojne se në rastet kur kërkesa e paraqitur nga ankuesi është e papranueshme, zyrtari i IAP e këshillon ankuesin që të heq dorë nga paraqitja e ankesës dhe të drejtohet në organin apo institucionin që ka kompetencë çështjese ankuesit. Zyrtari bën regjistrimin e ankesës në rast se ankuesi përkundër këshillimit, insiston që kërkesa e tij të regjistrohet në IAP.

²⁵⁵ Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit Neni 19 duku ju referuar ketij neni ankesa të hedhet poshtë edhe nëse ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me ligj; ankesa është anonime, ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës, ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit, të refuzojë ankesën si të pabazuar, të ndërpretë hetimet kur konstaton se rasti është zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër në pajtim me kërkesën e ankuesit. Në të gjitha rastet e mësipërme, Avokati i Popullit e njofton me shkrim palën brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës. Vendimi i Avokatit të Popullit për të hedhur poshtë apo për të refuzuar ankesën është i formës së prerë.

²⁵⁶ Rregullore e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës 2011 Neni 39

²⁵⁷ Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit Nenet 25-26, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 80 / 27 Gusht 2010

se shkelin mbi to, atëherë kanë dëmtuar thelbin e domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike.²⁵⁸

Sipas Avokatit të Popullit, Jashari “gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, imponon domosdoshmërinë e konsolidimit të sistemit ligjor, i cili vazhdon të jetë i fragmentuar dhe në shumë raste i pa harmonizuar. Efektet e një sistemi të tillë pengojnë mbrojtje adekuate të të drejtave të njeriut. Sistemi gjyqësor vazhdon të përballet me mbingarkesë të lëndëve dhe në këtë mënyrë është në pamundësi për të siguruar një mekanizëm efektiv juridik për mbrojtjen e të drejtave, përderisa administrata publike, në të dy nivelet, qendrore dhe lokale është jo llogaridhënëse, në pjesën më të madhe për shkak të mungesës së kontrollit adekuat gjyqësor të sektorit të administratës”²⁵⁹. Në tabelën më poshtë paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura nga qytetarët në IAP, rastet e mbyllura dhe raste të mbyllura pozitivisht.

²⁵⁸ Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës Raporti i dymbëdhjetë vjetor 1 Janar – 31 Dhjetor 2012 drejtuar Kuvendit të Kosovës, Publikuar nga: Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë, 2013 Fq. 12.

²⁵⁹ Avokati i Popullit, fjala e Avokatit të Popullit në Raportin Vjetor 2015, nr.15, fq.9

Tabela 2: Paraqet numrin e përgjithshëm të Ankesave të paraqitura nga qytetarët në IAP, Rastet e hapura për hetim, raste të mbyllura prej vitit janar 2010 deri në 17 dhjetor 2017

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Totali
Numri i ankesave të pranuar në IAP	1233	1453	1670	2047	2224	1995	1694	1774	14090
Përkatësia etnike/ ankuesve									
Shqiptarë	1080	1284	1464	1795	1938	1764	1481	1547	12353
Serbë	89	87	125	146	145	131	101	97	921
Boshnjakë	23	39	26	31	34	30	23	26	232
Romë	16	18	24	21	33	16	19	22	162
Turq	10	16	18	25	21	21	16	23	150
Të tjerë	15	9	13	29	53	33	54	59	265
Gjinia									
Meshkuj	942	1099	1328	1611	1717	1546	1313	1321	10877
Femra	288	354	342	436	307	449	381	453	3010
Rastet e hetuara									
Rastet e hapura nga ankesat e qytetarët	414	546		595	587	7	893	819	4581
Rastet e hapura ex officio	11	13	33	21	15	30	56	61	240
Numri i ankesave të shpallura të papranueshme	160	86	1113	1452	1637	1268	801	924	7441
Rastet e mbyllura	160	269	538	1309	534	580	418	679	4487
I zgjedhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e pales	183	162	276	587	296	328	247	314	2393
Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara									
Shqiptarë	332	471	446	474	470	608	755	687	4243
Serbë	65	39	78	82	73	82	80	65	564
Boshnjakë	5	9	12	12	10	9	11	13	81
Romë	3	8	10	7	12	5	10	12	67
Turq	-	-	7	10	8	9	9	11	54
Të tjerë	9	5	4	10	14	14	28	31	115
Gjinia									
Meshkuj	306	414	425	453	450	561	695	597	3901
Femra	108	132	132	142	137	166	198	222	1237
Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP									
Gjykatat	143	193	521	195	195	249	304	277	2077
Ministritë	107	141	368	133	139	202	252	245	1587
Komunat	81	107	298	90	147	146	171	169	1209
Prokuroritë	-	-	22	21	12	22	35	36	148
Policia	21	28	103	35	40	41	45	35	348
Ndërmarrjet publike	-	35	98	78	10	13	22	21	277
AKP	-	-	24	11	11	12	24	15	97
Kompanitë private	-	-	37	11	6	6	6	15	81
Të tjera	81	84	53	18	59	76	116	115	602

Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve të Institucionit të Avokatit të Popullit²⁶⁰ të përpunuar nga autori i punimit.

²⁶⁰Të dhënat të përpunuar nga autori i punimit bazuar nga Raporti i dhjetë vjetor 2010, publikuar nga IAP, 2011 fq.125,126,127Raporti i Njëmbëdhjetë Vjetor 2011, publikuar nga IAP, 2012 ; Raporti i

Tabela e mësipërme pasqyron rritjen e numrit të ankesave të paraqitura nga qytetaret dhe rasteve të mbyllura në çdo vit në krahasim me vitin e kaluar, qoftë në dorëzimin e ankesave ose duke kërkuar këshilla dhe ndihmë.

Të dhënat tregojnë për rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në ngritjen e vetëdijesimit dhe besimit të qytetareve te Institucioni i Avokatit të Popullit. Ky institucion prej 1 janari 2010 deri më 17 dhjetor 2017 ka pranuar 14090 ankesa nga qytetarët e Kosovës dhe ka mbyllur 4487 raste të hetuara. Prej rasteve të mbyllura të zgjidhura pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit janë 2393 raste. Palët përgjegjëse të rasteve të hetuara ishin Gjykatat, Ministrinë, Komunat, Prokuroritë Publike, Policia, Ndërmarrjet publike, Agjensioni Kosovar i Privatizimit dhe institucionet e tjera. Megjithatë, është shqetësuese rritja e numrit të ankesave nga qytetaret që pretendojnë se ju kanë shkelur të drejtat nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të insitucioneve qendrore dhe ato lokale. Mirëpo proceset që po kryhen nga Avokati i Popullit po konsiderohen më të sakta dhe më efektive në rivendosjen e të drejtave të shkelura nga Institucionet në favor të qytetareve kjo po ndikon në rritjen e besimit të qytetareve në Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit në kuadër të promovimit të drejtave dhe lirive të njeriut ka qenë aktiv duke dhënë rekomandime dhe propozuar masa, përfshirë dhe hartimin e plotësimin e kornizës ligjore. Sipas nenit 135, pragrafi 3 të Kushtetutës parashikohet së Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.²⁶¹ Gjithashtu, Institucioni i Avokatit të Popullit monitoron procesin gjatë hartimit të legjislacionit dhe jep rekomandime për


Dymbëdhjetë Vjetor 1 janar – 31 dhjetor 2012, publikuar nga IAP, 2013, fq.137,138, 140, Raporti Vjetor 2013 Nr. 13 Mars Prishtinë 2014, publikuar nga IAP, fq.151,152,154; Raporti vjetor 2014 Nr. 14 Prishtinë 2015 adresuar Kuvendit të Kosovës IAP, Prishtinë, 2015 , fq. 185, 186,188, Raporti Vjetor 2015 Nr.15, Raporti vjetor 2016, Nr.16 I publikuar nga IAP në 2017; Raporti nga Statistikat preliminare për vitin 2017 (deri me datën 17-12-2017) të IAP, këto të dhëna i janë ofruar autorit të punimit me date 24.01.2018). Statistikat finale publikohen sipas afatit ligjor në muajin Mars 2018

²⁶¹Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 135 paragrafi 3

fushat ku përmirësimi i mëtejshëm është i nevojshëm. Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar ndryshime dhe plotësime të disa ligjeve.²⁶²

Mirëpo fatkeqësisht është evidente mungesa e ndikimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në organet shtetërore, një pjesë e madhe e të cilave mjerisht, nuk bëjnë as përpjekjen më të vogël për të përmirësuar gjendjen.²⁶³

Grafiku 7: Zbatimi i Rekomandimeve të Avokatit të Popullit, janar 2012- dhjetor 2016



Burimi: bazuar në dhënat nga Raportet e Institucionit të Avokatit të Popullit²⁶⁴ të përpunuara nga autori i punimit.

Avokati i Popullit me qëllim të përmirësimit të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, për të gjitha rastet e veçanta kur ka konstatuar shkelje të të drejtave, në raportet e tij vjetore dhe të veçanta, ka bërë rekomandimet e duhura për të gjitha

²⁶²Hasani, Isa Zëvendës i Avokatit Popullit në intervisten e realizuar nga autori i punimit me date 5 mars 2014, Prishtinë, ka thënë se Avokati i Popullit në vitin 2013 ka dërguar komente për këto projektligje: Projektligji për mbrojtjen nga diskriminimi; Projektligji për pagat e funksionarëve publik; Projektligji për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore; Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve; Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-19 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

²⁶³ Raporti i dymbëdhjetë vjetor 1 janar – 31 dhjetor 2012 drejtuar Kuvendit të Kosovës, Publikuar nga: Institucioni i Avokatit të Popullit Prishtinë, 2013, Fq.9-10

²⁶⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit Raporti Vjetor 2012, Raporti Vjetor 2013, Raporti Vjetor 2014, Raporti Vjetor 2015, fq. 124 dhe Raporti Vjetor 2016 fq.192,193,194

autoritetet publike, ministritë, komunat si dhe agjencitë e tjera publike përgjegjëse. Por fatkeqësisht, në këtë drejtim ka një dështim të institucioneve publike. Një praktikë e tillë vazhdon të përcillet nga viti në vit dhe, si e tillë, është mjaft shqetësuese.²⁶⁵ Pra, grafiku i mësipërm pasqyron se institucionet, prej janarit të vitit 2012 deri në dhjetor 2016 kanë implementuar 88 rekomandime ndërsa, të paimplementuara janë 144 rekomandime dhe 125 rekomandime në pritje për implementim. Moszbatimi dhe injorimi i këtyre rekomandimeve, pikërisht nga institucionet të cilat janë të detyruara të zbatojnë ligjet dhe t'u krijojnë mundësi qytetarëve për të zgjidhur problemet e tyre, është tejet shqetësues. Jashtëzakonisht shqetësuese është përgjithësisht tendenca e institucioneve të ndryshme shtetërore për minimizimin e rolit të institucioneve të pavarura kombëtare, qoftë duke shpërfillur gjetjet e tyre, apo duke mos zbatuar rekomandimet e tyre, apo qoftë edhe duke bërë përpjekje kundërligjore për cenimin e pavarësisë së tyre kushtetuese.²⁶⁶ Rekomandimet dhe masat e propozuara nga Avokati i Popullit për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore duhet të zbatohen në mënyrë të detyrueshme për administratën publike.

3.8. Kontrolli i administratës publike nga Auditori i Përgjithshëm

Kushtetuta e Kosovës e ka përcaktuar se Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar.²⁶⁷ Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon:

- veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë;

²⁶⁵ Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës Raporti i dymbëdhjetë vjetor 1 Janar – 31 Dhjetor 2012 drejtuar Kuvendit të Kosovës, Publikuar nga: Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë, 2013 Fq. 12.

²⁶⁶ Raporti i dymbëdhjetë vjetor 1 janar – 31 dhjetor 2012 drejtuar Kuvendit të Kosovës, Publikuar nga: Institucioni i Avokatit të Popullit Prishtinë, 2013, Fq.9-10

²⁶⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 136

- përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;
- veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.²⁶⁸

Auditori i përgjithshëm është i pavarur dhe nuk i nënshtrohet urdhrit ose kontrollit nga cilido person ose institucion tjetër dhe raporton në Kuvend. Auditori i përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij apo të saj.²⁶⁹

Duke u bazuar në dispozitën kushtetuese - neni 137 dhe neni 3 i Ligjit Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit, përcaktohen shprehimisht kompetencat dhe përgjegjësitë e auditorit të përgjithshëm. Auditori i përgjithshëm në bazë vjetore kryen auditim të Rregullsisë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, organizatave buxhetore, duke përfshirë por pa u kufizuar, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, çdo ministri dhe agjensi ekzekutive, komunat, organet e pavarura, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe subjektet e tjera të cilat janë më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendët apo të ardhura të tjera të pataksueshme për të, duke përfshirë por pa u kufizuar, Shërbimin Doganor të Kosovës, Agjensinë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudspersonin.²⁷⁰ Po ashtu, sipas nenit 137 të Kushtetutës, Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, i paraqet Kuvendit:

- raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit;
- mendimin për raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar të shkuar, para se të miratohet nga Kuvendi;
- informacione për rezultatet e kontrolleve, sa herë që kërkohet nga Kuvendi.

²⁶⁸Po aty, Neni 137 i Kushtetutës e Republikës së Kosovës

²⁶⁹Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, neni 2

²⁷⁰Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, neni 3

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës i paraqet Kuvendit raportin vjetor për veprimtarinë e vet.²⁷¹ Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofroj një bazë për mbylljen e zinxhirit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë. Auditori i Përgjithshëm luan një rol kyç në promovimin e parimeve të llogaridhënies menaxheriale tek ministrite, komunat dhe ndermarrjet e tjera publike.²⁷² Çdo vit, Parlamenti miraton një buxhet për Ekzekutivin për administrimin e biznesit shtetëror, pra të burimeve të vendit. Në fund të vitit fiskal, Ekzekutivi është i detyruar të japë llogari në Parlament për administrimin e këtyre burimeve. Duke qenë se Parlamenti vetë nuk mund të verifikojë llogaritë e paraqitura nga Ekzekutivi, Audituesi i Përgjithshëm është i mandatuar nga Kushtetuta e vendit për t'i audituar këto llogari dhe për të raportuar gjetjet e tij në Parlament [Leskaj, 2013:16]. Auditimi i sektorit publik ka funksion të rëndësishëm, që i jep Parlamentit, Qeverisë dhe qytetarëve, reporte cilësore lidhur me faktin se si shpenzohen paratë e taksapaguesve dhe sesi menaxhohen asetet dhe likuiditetet në kuadrin e kontrollit publik.²⁷³ Auditori i përgjithshëm ka për mision të kontribuojë për menaxhimin e mirë financiar në administratë publike, të kryejë auditime të kualitetit në harmoni me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht dhe me praktikat e mira evropiane, të krijoj besueshmëri në shpenzimin e fondeve publike. Ai ka një rol aktiv për të siguruar interesin e tatimpaguesve dhe palëve të tjera për rritjen e llogaridhënies publike.²⁷⁴ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është institucion i pavarur për auditimin e jashtëm, që luan rol në luftimin e korrupsionit dhe promovimin e ndryshimeve në financat publike.²⁷⁵ Megjithatë, publiku pret që ata që janë përgjegjës për trajtimin e parave publike, të bëhen tërësisht përgjegjës për përdorimin e këtyre parave [Leskaj, 2013:17].

²⁷¹Neni 138 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

²⁷²Zyra e Auditorit të Përgjithshëm Raporti vjetor i auditimit 2011 fq.11 Prishtinë, Shtator 2012

²⁷³Menaxhimi i shpenzimeve publike, përgaditur nga Ministria e Financave me mbështetjen e GTZ-së, Tiranë, 2004, Fq.. 311

²⁷⁴Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP, Misioni i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me gjërësisht shiko në Web faqe <http://oag-rks.org/>

²⁷⁵Komisioni European, Raporti i progresit 2013 për Kosovën, Bruksel, 16.10.2013 SWD(2013) 416, Fq.42

Në Kosovë, ende nuk kemi menaxhim të mirë financiar nga administrata publike, duke u bazuar në disa raporte të auditimi në institucionet e Kosovës, të cilat janë analizuar që nga themelimi deri më tani. Sipas disa raporteve finale të auditimit, për pasqyrat financiare të disa institucioneve për një dekadë, ai ka vërejtur se ka progres por edhe dobësi në menaxhimin e financiare nga administrata publike. Në institucione qendrore dhe lokale, institucione të pavarura dhe ndërmarrje publike që shpenzojnë paranë publike, në disa ka progres në menaxhimin financiar dhe kontrollin në krahasim me vitet e kaluara. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka identifikuar mangësi në menaxhimin e procedurave të prokurimit, menaxhimin e pasurisë si dhe në shpenzimet për paga dhe mëditje.²⁷⁶ Mos funksionimi i mirëfilltë i kontrolleve të brendshme është vërejtur edhe në aspektin e procedurave të prokurimit, pranimit dhe shpërndarjes së librave, tek klasifikimi dhe regjistrimi i transaksioneve, menaxhimi dhe shpenzimi i subvencioneve, menaxhimi dhe raportimi i detyrimeve të pa paguara.²⁷⁷ Sidomos, është vërejtur dobësi sistematike në procedimin e pagesave, vonesa në implementimin e projekteve, shpenzime jo përmes prokurimit. Këtu përfshihen shpenzimet e telefonisë fikse, mëditjeve për udhëtimet zyrtare dhe komunale, mangësi në menaxhimin e personelit, subvencionin i projekteve pa thirrje publike, mangësi në regjistrimin e pasurisë jo-kapitale, vonesa në inventarizimin e pasurisë, dhe përdorimi i automjeteve zyrtare, etj.²⁷⁸ Rekomandimet e viteve të mëparshme nuk janë implementuar ende nga institucionet.

Konsideroj se Kuvendi i Kosovës duhet të ndryshojë dhe plotësojë Ligjin Nr 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe rritjen e kompetencave të saj, duke parashikuar edhe kompetencën e shtuar për auditimin e financave të

²⁷⁶Zyra e Auditorit të Përgjithshëm Raporti final i auditimit për pasqyrat financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012, Nr. i Dokumentit: 24.24.1-2012-08, Prishtinë, Maj 2013, Fq.4-5

²⁷⁷Zyra e Auditorit të Përgjithshëm Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2012, Nr. dokumentit: 21.4.1-2012-08 Prishtinë, Maj 2013, fq.4-5

²⁷⁸Zyra e Auditorit të Përgjithshëm Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Administratës Publike për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2013, Nr. i Dokumentit: 21.9.1-2013-08, Prishtinë, Qershor 2014

partive politike. Po kështu, për një afat kohor të kufizuar, duhet të bëjë kontrollin se si u shpenzuan fondet: Fondi i Qeverisë së Kosovës, Fondi i Lidhjes Demokratike dhe Fondi në kuadër të Këshillit për Financim dhe Fondi Vendlindja Thërret. Sepse për këto fonde nuk kemi ndonjë informacion përfundimtar se si u shpenzuan ato dhe, gjatë gjithë kësaj kohe, Kuvendi nuk i ka kërkuar asnjëherë ministrave të financave të qeverive të asaj kohe, të raportojnë para Kuvendit për këto fonde, ose të formojnë një komision hetimor për të hetuar se si janë shpenzuar dhe a ka pasur menaxhim të mirë apo keqmenaxhim të tyre. Konsideroj se mos llogaridhënia dhe mos transparenca e dy qeverive të asaj kohe edhe pas gjithë këtyre viteve, ka ndikuar negativisht edhe në qeveritë e tjera (pas çlirimit) sa i përket menaxhimit të fondeve të buxhetit të Kosovës, pasi janë po ata persona të cilët qeverisën Kosovën gjatë këtyre 18 viteve, dhe menaxhuan fondet publike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm mund të kontribuojë në një menaxhim më të mirë të fondeve publike nga administrata publike, në transparencë dhe llogaridhënie më të mirë për mënyrën se si shpenzohen paratë e taksapaguesve. Mendoj se Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i sigurohet imunitet ashtu sikurse Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, për shkak të rëndësisë së institucionit që ai drejton në parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimeve të fondeve publike.

Kosova ka synim integrimin në BE dhe për institucionet e Kosovës duhet të jetë prioritet mirëmenaxhimi i fondeve publike. Po ashtu, është sfida për të përmbushjen e standardeve të BE-së. Për këtë, institucionet e Kosovës duhet të bëjnë planifikim dhe kontroll të mirë të buxhetit, sepse pa një planifikim të mirë nuk mund të kemi kontroll të mirë.

3.9. Institucionet dhe agjensitë në kuadër të Kuvendit të Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Kapitullin XII përcakton Institucionet e Pavarura të cilat janë: Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Banka Qendrore e Kosovës dhe Komisioni i

Pavarur i Mediave.²⁷⁹ Ndërsa sipas nenit 142 përcaktohet se Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura, funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Ato kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligjin. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligjin.²⁸⁰ Mirëpo problemi i vërtetë me agjensitë apo krijimin e agjencive nga Kuvendi është neni 142 i Kushtetutës së Kosovës mbi agjencitë e pavarura. Kjo për faktin se ky nen është shumë i përgjithshëm sepse nuk ka përcaktuar kritere dhe në çfarë fusha mund të themelohen këto agjenci duke i dhënë diskrecion të plotë Kuvendit të Kosovës në themelimin e agjencive të pavarura, si dhe duke iu përcaktuar agjencive një pavarësi tepër të madhe që nga themelimi, funksioni, kompetencat dhe buxheti. Duke u bazuar në këtë nen, Kuvendi i Kosovës ka krijuar edhe 22 agjenci të pavarura të cilat së bashku me institucionet e krijuara si kërkesë nga Kushtetuta, përbëjnë 32 Institucioneve dhe Agjensi të Pavarura. Ndërsa në kuadër të Qeverisë së Kosovës janë themeluar 47 Agjenci.²⁸¹ Në vijim do të trajtohen Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe Agjencia kundër Korrupsionit.

3.9.1. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe që pasqyron diversitetin e popullit

²⁷⁹Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Kapitullin XII, neni 132, neni 136, neni 139, neni 140, neni 141,

²⁸⁰Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 142

²⁸¹Ministria e Administratës Publike Rishikimi i Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura të Kuvendit dhe Organeve Qendrore të Qeverisë Fq. 26, Dhjetor 2016

të Republikës së Kosovës.²⁸² Këshilli është organ i pavarur i cili i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.²⁸³ Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, në nenin 12 parashikon se nëpunësi civil i cili është i pa kënaqur me vendimin e organit të punësimit, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, ka të drejtë të ankohet në Këshill.²⁸⁴ Funkzionet e Këshillit janë: të shqyrtojë dhe të marrë vendime për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil, të vendosë nëse emërimet e nëpunësve civilë të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.²⁸⁵ Këshilli, përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.²⁸⁶ Sipas opinionit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësve civilë të nivelit drejtues të intervistuar për këtë çështje, konsiderohet se ‘në një masë të madhe këto parime nuk janë zbatuar dhe se akoma nuk zbatohen me rastin e pranimit në shërbimin civil të Kosovës. Kjo ndodh sepse ka interferime të ndryshme nga jashtë shërbimit civil, të cilat ndikojnë të kualiteti i këtij shërbimi, sa i përket aspektit profesional në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetareve.

²⁸² Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 101 paragrafi 2

²⁸³ Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Neni 3

²⁸⁴ Po aty, shih neni 12


²⁸⁵ Neni 10 i Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke ju referuar po neni 10 paragrafit 3 dhe neni 17 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ushtron funksionin e mbikëqyrjes për dosjet e personelit, procedurat e pranimit në shërbimin civil, zëvendësimin e kontratave të nëpunësve civil, pushimet në shërbimin civil, procedurat e avancimit në karrierë të nëpunësve civilë, procedurat e transferimit të nëpunësve civilë, vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civilë, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin civil, procedurat e ndërprerjes, pezullimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës, komisionet disiplinore dhe procedurat disiplinore si dhe për komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave dhe procedurat e ankesave në kuadër të institucioneve të administratës publike qendrore dhe lokale.

²⁸⁶ Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Raport Vjetor për vitin 2013, Prishtinë Shkurt 2014, Fq. 3

Në institucione pjesërisht zbatohen parimet bazë të shërbimit civil dhe nuk ka një sistem të qartë sa i përket parimit të meritës dhe aftësive profesionale. Deri me tani ky parim nuk është zbatuar si duhet dhe kryesisht ka rezultuar me ngarkesë të administratës në aspektin sasior. Përfaqësimi i barabartë kryesisht është zbatuar sa i përket përmbushjes së obligimeve për punësimin e minoriteteve dhe gjinisë femërore. Parimet nuk zbatohen nga institucionet qendrore dhe lokale, gjë që më së miri e tregojnë raportet e publikuara nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës’.

Në vijim do të paraqesim në formë grafike të dhënat për numrin e përgjithshëm të ankesave të paraqitura nga nënpunësit civilë.

Grafiku 8: Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale




Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve vjetore të punës së KPMSHCK-së²⁸⁷ të vitit 2007 deri në dhjetor 2016, të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron se në vitet e fundit ka rritje të numrit të ankesave nga nënpunësit civilë dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, të parashtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit, si kundër vendimeve të Institucioneve të Administratës Qendrore ashtu dhe atyre lokale.

²⁸⁷ Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Raporti vjetor të punës për vitin 2007 fq. 10, Raporti vjetor për vitin 2008 fq. 7, Raporti vjetor për vitin 2009 fq. 8, Raporti vjetor për vitin 2010 fq. 9, Raporti vjetor për vitin 2011 fq.9, Raporti vjetor për vitin 2012 fq. 8, Raporti vjetor për vitin 2013 fq.10, Raporti vjetor për vitin 2014 fq.11, Raporti vjetor për vitin 2015 fq.13, Raporti vjetor për vitin 2016 fq.12

Figura 2: Totali i ankesave të parashtuara në KPMSHCK prej janarit 2007 deri në dhjetor të vitit 2016.




Burimi: bazuar në të dhënat nga Raportet e KPMSHCK-ës²⁸⁸ të përpunuara nga autori i punimit.

Figura e mësipërme pasqyron totalin e ankesave për dhjetë vite në KPMSHCK, ku janë pranuar 46% e ankesave kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore (IAQ), ndërsa kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale (IAL) 43% e ankesave, dhe 11% e ankesave kundër vendimeve të Agjencive, Institucioneve dhe Organeve të Pavarura (AIOP).

²⁸⁸ Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë të Kosovës, Raportet vjetore të punës, KPMSHCK për vitin 2006-2016.

Grafiku 9: Zbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit, janar 2006-dhjetor 2016




Burimi: bazuar nga të dhënat e Raportet vjetore të KPM SHCK²⁸⁹ të vitit 2006 deri 2016 të përpunuara nga autori i punimit.

Ky grafik pasqyron zbatimin e vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit dhe tregon se në vitet e fundit ka një progres të zbatimit të vendimeve. Megjithatë, çdo vit ka pasur mungesë zbatueshmërie të vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit. Ndërsa figura Nr. 3 pasqyron totalin e vendimeve të KPM SHCK-së prej janarit 2006 deri në dhjetor 2016. Organet e punësimit kanë pasur obligim ligjor për të zbatuar 1750 (33%) vendime. Mirëpo nga rezultatet e njoftimit që Këshilli ka pranuar nga organet e punësimit dhe ankuesit rezulton se organet e punësimit kanë zbatuar 1256 (24%) vendime, ndërsa 420 (8%) vendime nuk janë zbatuar, kurse për pjesën tjetër të vendimeve nuk kanë informacion nëse janë zbatuar apo jo nga organet e punësimit.

²⁸⁹ Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Raporti vjetor të punës për vitin 2006 fq. 20, Raporti vjetor për vitin 2007 fq.10, Raporti vjetor për vitin 2008 fq.22, Raporti vjetor për vitin 2009 fq. 21, Raporti vjetor për vitin 2010 fq. 26, Raporti vjetor për vitin 2011 fq.17, Raporti vjetor për vitin 2012 fq. 21, Raporti vjetor për vitin 2013 fq.26, Raporti vjetor për vitin 2014 fq.23, Raporti vjetor për vitin 2015 fq.28, Raporti vjetor për vitin 2016 fq.32. Raporti vjetor i vitit 2017 nuk është i publikuar.

Figura 3: Totali i vendimeve dhe zbatimi i vendimeve të KPMSHCK nga organet e punësimit



Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve vjetore të KPMSHCK²⁹⁰ të vitit 2006 deri 2016, të përpunuara nga autori i punimit.

Vendimet e Këshillit janë vendime administrativ të formës së prerë dhe duhet të ekzekutohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit, i cili ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Vendimet janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe ekzekutimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit pesëmbdhjetë ditor nga dita e pranimit të vendimit.²⁹¹ Institucionet detyrohen për t'i zbatuar vendimet sepse “moszbatimi i vendimit nga personi përgjegjës i insitucionit paraqet shkelje të rënde të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”.²⁹²

²⁹⁰ Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Raporti vjetor të punës për vitin 2006 fq. 20, Raporti vjetor për vitin 2007 fq.10, Raporti vjetor për vitin 2008 fq.22, Raporti vjetor për vitin 2009 fq. 21, Raporti vjetor për vitin 2010 fq. 26, Raporti vjetor për vitin 2011 fq.17, Raporti vjetor për vitin 2012 fq. 21, Raporti vjetor për vitin 2013 fq.26, Raporti vjetor për vitin 2014 fq.23, Raporti vjetor për vitin 2015 fq.28, Raporti vjetor për vitin 2016 fq.32, Raporti vjetor i vitit 2017 nuk është i publikuar.

²⁹¹ Neni 13 I Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligji Nr. 03/l-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës neni 82

²⁹² Ligji Nr. 03/l-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës neni 66 Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës neni 15

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka njoftuar me shkrim Kryeministrin, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe eprorët e drejtpërdrejtë, të secilit person përgjegjës i cili nuk i ka zbatuar vendimet. Edhe pse njoftimet sipas ligjit janë bazë për iniciimin e procedurave disiplinore, ndaj personave përgjegjës për moszbatim të vendimeve, deri me tani nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për të inicuar edhe një rast të vetëm disiplinor.²⁹³ Mos zbatimi i vendimeve të Këshillit, nuk është vetëm përgjegjësi disiplinore²⁹⁴, por edhe përgjegjësi penale.²⁹⁵

Gjykata Kushtetuese ka vendosur një standard të ri dhe ka dhënë një kontribut të çmuar kur ka vendosur se *vendimet e Bordit të Pavarur Mbikqyres janë të ekzekutueshme, si kur janë në të holla ashtu edhe kur kanë të bëjnë me kërkesat për kthim në punë dhe të ngjashme* [Hasani, 2015]. Prandaj, Vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duhet të zbatohen si nga institucionet qendrore ashtu dhe ato lokale.

3.9.2. Agjencia Kundër Korrupsionit

Agjencia Kundër Korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Duke iu referuar nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit,

²⁹³ Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Raport i punës për vitin 2014, Prishtinë Shkurt 2015, fq.30

²⁹⁴ Sqarim Neni 66 paragrafi 4 i Ligjit nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës përcakton se për shkelje të rënda serioze shqiptohen masat disiplinore si në vijim: pezullimi nga puna dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor.

²⁹⁵ Sipas nenit 221 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës e përcakton se kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive për punësimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës; pagat apo të ardhurat e tjera; kohëzgjatjen e orarit të punës; punën jashtë orarit apo punën me ndërrime; pushimin apo mungesën nga puna; ose mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara dhe kështu punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Neni 222 përcakton se Kushdo që ia mohon apo kufizon personave tjerë të drejtën në punësim në kushte të njëjta, ashtu siç është përcaktuar me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet. Sikurse edhe kushdo që nuk vepron në pajtim me legjislacionin mbi të drejtat e personave të papunësuar dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë atyre, dënohet me dënimin me burgim deri në dy (2) vjet.

agjencia në kuadër të shumë kompetencave që ka theksojmë disa si: inicion dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjell kallëzimet penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente; mbikqyr dhe parandalon rastet e konfliktit të interesit dhe ndërmerr masat përkatëse si dhe mbikqyr pasuritë e zyrtarëve të lartë publikë dhe personave të tjerë, siç parashihet me ligj të veçantë; mbikëqyr pranimin e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmerr masat e parapara me ligj; bashkëpunon me autoritetet publike kompetente për hartimin, harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit; ofron opinione në lidhje me konfliktin e interesit dhe mbikqyrjen e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare; ofron sqarime në lidhje me mënyrën e deklarimit të pasurisë dhe çështje të tjera nga fushëveprimi i agjencisë; mbledh, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë; bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me korrupsionin. Kjo Agjensi i raporton Kuvendit një herë në vit dhe Komisionit çdo gjashtë 6 muaj për punën e Agjencisë, ku Komisioni mund të kërkojë raporte edhe më të shpeshta nga Agjencia.²⁹⁶ Agjencia kundër korrupsionit, si mekanizëm kontrolli, e ruan administratën publike nga format abuzive, siç janë: korrupsioni, mitëmarrja, nepotizimi dhe konflikti i interesit etj. Agjencia ka identifikuar zyrtarë të lartë të cilët ushtrojnë apo mbajnë dy e më shumë funksione/pozita. Kjo dukuri në aspektin ligjor nuk përbën vepër penale, por mund të paraqesë rrezik potencial për konflikt interesi. Kjo gjetje pasqyrohet në tabelën në vijim.

²⁹⁶Ligji Nr. 03/L- 159 për Agjencinë kundër korrupsionit, nenet 3 dhe 5, Shpallur me dekretin Nr. DL-006-2010, datë 19.01.2010, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / nr. 65 / 05 Shkurt 2010

Tabela 3: Funkcionet e shumëfishta të zyrtarëve të lartë

Zyrtarët që ushtrojnë më shumë se një funksion							
Viti	Zyrtar me 2 pozita	Zyrtar Me 3 pozita	Zyrtar me 4 pozita	Zyrtar me 5 pozita	Zyrtar me 6 Pozita	Zyrtar me 7 pozita	Totali
2015	1184	321	35	8	4	0	1552
2014	1155	312	31	10	1	0	1509
2013	1122	349	32	7	0	1	1511
2012	610	177	16	5	0	0	808

Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve të Agjencise Kundër Korrupsionit,²⁹⁷ të përpunuara nga autori i punimit.

Tabela e mësipërme pasqyron numrin e zyrtarëve që ushtrojnë më shumë se një funksion. Në Kosovë, çdo vit është rritur numri i zyrtarëve të lartë të cilët ushtrojnë apo mbajnë disa pozicione, madje disa edhe pesë apo gjashtë pozicione, apo në ndonjë rast edhe më shumë.

Agjencia Kundër Korrupsionit për të gjitha rastet e hetuara, kur janë gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive, i ka përcjellë në prokuroritë kompetente, prokurorinë e EULEX-it, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Njësinë e Hetimeve Financiare.²⁹⁸ Po ashtu, Agjencia, ka përcjellë raste në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore kundër personave zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës.²⁹⁹


Të dhënat pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm.

²⁹⁷ Agjensioni kundër Korrupsionit Raport Vjetor 01 Janar – 31 Dhjetor, 2012 mars, 2013, fq. 24, Raporti vjetor 01 janar 2014 deri 31 dhjetor 2014, mars 2015, fq.26. Raporti Vjetor 01 Janar-31 Dhjetor 2015 Prishtinë, mars 2016, fq.26, të dhënat e tjera nuk janë ofruar autorit të punimit pa e dorëzuar në Kuvend të Kosovës.

²⁹⁸ Agjensioni kundër Korrupsionit Raporti Vjetor 01 Janar-31 Dhjetor 2016 fq. 12 Prishtinë Mars 2017 fq.10

²⁹⁹ Po aty, fq.24

Grafiku 10: Raste të përcjella në organe kompetente si dhe personat e përfshirë prej 1 janarit 2007 deri në 31 dhjetor 2016



Burimi: bazuar në të dhënat nga raportet e AKK-se³⁰⁰ të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron se Agjencia kundër Korrupsionit ka paraqitur 718 raste në organet kompetente dhe në këto raste kanë qenë të përfshirë 1,445 persona. Aktiviteti i Agjencisë kundër Korrupsionit ka qenë i përqendruar në: zbatimin e ligjit, ku përfshihen përcjellja e kallëzimeve penale në prokuroritë kompetente, përcjellja e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore për shkeljet e dyshuara administrative.³⁰¹ Nga të dhënat rezulton se Kosova ka legjislacion mjaft të mirë kundër korrupsionit, por ka nivel shumë të dobët të implementimit dhe zbatimit të ligjeve.³⁰²

Në tabelën e mëposhtme do të pasqyrohet procesi i përgjithshëm të deklarimit të pasurisë, dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë.

³⁰⁰ Burimi i bazuar në të dhënat e Raporteve Vjetore 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2012, 2013 dhe 2014, 2015 dhe 2016 të Agjencise kundër Korrupsionit të përpunuar nga autori i punimit

³⁰¹ Burimi i bazuar në të dhënat e Raporteve Vjetore 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 të Agjencise kundër Korrupsionit të përpunuar nga autori i punimit

³⁰² Task Forca për Integrim Evropian Material Diskutues për Politikën Kundër Korrupsionit Tavolina e Rrumbullakëta “Drejtësi, Liri dhe Siguri” Fq.16 shih: http://www.mei-ks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Antikorrupision.pdf

Tabela 4: Procesi i përgjithshëm i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Nr. Obligim për deklarim	732	747	800	1560	1830	3656	3869	5196	4200	4352
Kanë deklaruar	713	733	776	1493	1768	3379	3840	5103	4143	4334
Nuk kanë deklaruar	14	14	16	67	62	277	29	93	57	18
Kontrrolli i plotë				237			1551			
Sipas listës së shortit								598	780	805
Ex-officio				237	526			14	19	19
Gjithsej të kontrolluara				295	540	800		612	799	824
Pa ndryshime							51	314	537	543
Ndryshime të evidentuar		43		34	39	111		187	262	281
Dërguar për trajtim të Konfliktit të interesit		45	47	65	9	131	5	77		
Të përcjella në DLK					2			11	43	38
Kontrrolli i të hyrave							863			
Deklarim i rreme							76			

Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve të Agjencisë kundër Korrupsionit,³⁰³ të përpunuara nga autori i punimit.


Agjencia gjatë krahasimit të deklarimeve të paraqitura në vitet 2008-2012 në 38 raste ka vërejtur ndryshime të theksuara në deklarimin e pasurisë, kurse në 9 raste janë gjetur ndryshime në vlerë milionëshe.³⁰⁴ Sipas Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit “Kodi Penal, e mbulon mjaftueshëm korrupsionin, duke përkufizuar keqpërdorimin e detyrës apo autoritetit zyrtar, konfliktin e interesit, mashtrimin në zyrë, marrjen dhe dhënien e ryshfetit dhe lëshimin e vendimeve të paligjshme gjyqësore si vepra penale. Pra, Kodi Penal ka bazë të fuqishme juridike për të vepruar, që mundet edhe të kompletohet me ndryshime të mëvonshme. Por faktor është plotësisht mungesa e vullnetit politik të Kuvendit që të aprovojë disa ligje specifike, dhe Qeveria të sigurojë fonde të nevojshme” [Preteni, 2016]. Drejtori i AKK-së thekson se “korrupsioni është i madh por organet e drejtësisë nuk kanë

³⁰³ Agjencia Kundër Korrupsionit Raporti Vjetor 01 Janar 31 Dhjetor 2016 Prishtinë Mars 2017 fq.15 , Fq.18; Raporti vjetor 01 Janar – 31 Dhjetor 2015 Mars 2016, fq.19, fq.21; Raporti vjetor 2014 Prishtinë mars 2015 fq. 22; Raporti vjetor 2013 , fq. 20, fq. 23,fq.24; Raporti vjetor 2012 fq. 18, fq.22 fq.25; Raporti vjetor 2011 fq. 21, fq. 23; Raporti vjetor 2010 fq. 23, fq.29,fq.34; Raporti vjetor 2009 , fq. 26,fq.32; Raporti vjetor 2008 fq.15 , fq 19; Raporti vjetor 2007 fq. 14 .

³⁰⁴ Agjencia Kundër Korrupsionit, Raport Vjetor 1 Janar–31 Dhjetor 2012, fq. 21-23, Prishtinë, Mars, 2013.

vepruar shumë ndaj këtij fenomeni. Politikanët e Kosovës më herët nuk kanë pasur asgjë dhe për një kohë të shkurtër janë bërë të pasur”.³⁰⁵ Pra, një nga arsyet për nivele të larta të korrupsionit në Kosovë konsiderohet të jetë kultura e mosndëshkimit.³⁰⁶

Grafiku11: Shkaktarët e shfaqjes së shpërdorimit të detyrës zyrtare, korrupsionit në administratën publike



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron opinionet e zyrtarëve të lartë publikë, ku 40% e zyrtarëve publikë deklarojnë se mungon vullneti politik për parandalimin dhe luftimin e këtyre fenomeneve negative në administratën publike, kurse 26% e zyrtarëve të lartë publikë deklarojnë se shkaktar ishte përplasja e kompetencave në mes institucioneve të cilat ishin të shumta. Krijimi i shumë institucioneve për të luftuar fenomenin e korrupsionit vetëm ka shpërndarë përgjegjësinë dhe llogaridhënien dhe deri më tani nuk ka treguar ndonjë efekt të prekshëm. Ndërsa, 20% e zyrtarëve të lartë publikë janë shprehur se shkaktar i shfaqjes dhe mos parandalimit në fillesat e para ishte numri i vogël i prokurorëve dhe gjyqtarëve,


³⁰⁵ Rtk live (2015) Drejtori i Agjencisë Anti korrupsion Hasan Preteni në emisionin “Betimi për Drejtësi” me date 09.dhjetor 2015 marre nga <http://www.rtklive.com/?id=2&r=51375> (pare me 15 dhjetor 2015)

³⁰⁶ Task Forca për Integrim Evropian Material Diskutues për Politikat Kundër Korrupsionit Tavolina e Rrumbullakëta “Drejtësi, Liri dhe Siguri” Fq.4 shih: http://www.mei-ks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Antikorrupsion.pdf.

kurse 14 % e zyrtarëve të lartë publikë deklarojnë se ishin zbrazëtitat ligjore, sepse ka shumë mangësi në aspektin legjislativ, dhe e gjithë paketa ligjore duhet të rishikohet pasi deri më tani deklarimi i pasurisë nuk ka ofruar rezultate pozitive. Ndërmjet këtyre ligjeve, ka shumë hapësira interpretimi e po ashtu jo harmonizim ndërmjet tyre.

Pyetja e shtruar: joefikasiteti në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve korruptive, shpërdorimi i funksionit zyrtar dhe keqmenaxhimit të fondeve publike në administratë publike ishte çështje e vullnetit politik, e zbrazëtirave ligjore dhe përplasjes së kompetencave në rrafsh ndër-institucional? Në vijim pasqyrohen opinionet e deputetëve në formë grafike.


Figura 4: Opinioni i deputeteve për joefikasitetin në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve negative në administratën publike



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Figura e mësipërme pasqyron opinionin e deputetëve, nga të cilët 88.9% e tyre deklarojnë se ishte çështje e vullnetit politik, zbrazëtirave ligjore dhe përplasjes së kompetencave në rrafsh ndër-institucional, shkaktarë për joefikasitetin për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, shpërdorimit të funksionit zyrtar dhe keqmenaxhimit të fondeve publike në administratën publike. Ndërsa, 11.1% e deputetëve nuk pajtohen se këto shkaqe ishin problem i mos parandalimit dhe mos luftimit të këtyre fenomeneve negative.

Figura 5: Opinioni i gjyqtarëve për joefikasitet në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve korruptive, shpërdorimit të funksionit zyrtar dhe keqmenaxhimit të fondeve publike në administratën publike.



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Figura më sipër pasqyron opinionet e gjyqtarëve, ku 39.3% e gjyqtarëve deklarohen se pajtohen me faktin së joefikasiteti në parandalimin dhe luftimin kundër fenomeneve korruptive, shpërdorimin e funksionit zyrtar dhe keqmenaxhimin e fondeve publike në administratën publike është çështje e vullnetit politik, e zbrazëtirave ligjore dhe përplasjes së kompetencave në rrafsh ndër-institucional. Ndërsa, 25% e gjyqtarëve deklarojnë se nuk pajtohen dhe 35.7% e gjyqtarëve deklarojnë se nuk e dinë.

Prokurorët e intervistuar janë shprehur se “zbrazëtirat ligjore dhe përplasia e kompetencave të institucioneve është faktori kryesor për mos efikasitet në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve korruptive, shpërdorimit të funksionit zyrtar dhe keqmenaxhimit të fondeve publike në administratën publike. Numri i vogël i prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe krijimi i shumë institucioneve për të luftuar fenomenin e korrupsionit vetëm ka shpërndarë përgjegjësinë dhe llogaridhënien dhe deri më tani nuk ka treguar ndonjë efekt të prekshëm”.

Sipas deputetëve të intervistuar “Kosova nuk është se vuan nga mospasja e ligjeve por nga moszbatimi i atyre ligjeve në praktikë ose përdorimi i standardeve të dyfishta dhe keq interpretimi i qëllimshëm. *Së pari*, mos koordinimi ndër-

institucional në luftimin e korrupsionit e vështirëson funksionimin e institucioneve që duhet të luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin, në rastin konkret edhe në parandalimin e konfliktit të interesit. Ky mos koordinim ndikon në rënien e mëtejshme të shkallës së besueshmërisë ndaj kësaj Agjensie. *Së dyti*, mos kontrolli i plotë i deklarimeve të pasurisë, pasi nuk hetohet pasuria jashtë vendit e zyrtarëve të lartë dhe mundësia që pasurinë e kanë lënë në emër të familjarëve të tyre. *Së treti*, nuk bëhen kalkulime aritmetike në mes të të hyrave të zyrtarit të lartë dhe pasurisë që ka në dispozicion. Shtuar kësaj edhe fakti se AKK është në pamundësi të qasjes në xhirrollogaritë bankare të zyrtarëve të lartë, në rastet kur ka prova dhe dyshohet se ka veprime korruptive. Ndërhyrjet arbitrare e tinëzare të pushtetit në sistemin e drejtësisë e kanë paralizuar sistemin e drejtësisë“. Prandaj, është e nevojshme promovimi i klimës së etikës, zbatimi i parimeve themelore të etikës nga të gjithë nëpunësit civilë nëpër institucione qendrore dhe lokale, efikasiteti, përgjegjshmëria dhe profesionalizimi, transparencja dhe llogaridhënia, që krijojnë bazë për rritje të besimit të qytetarëve në institucionet e Kosovës. Ndërsa, zbatimi i ligjit, forcimi i shtetit të së drejtës, fuqizimi edhe efikasiteti i institucioneve të drejtësisë janë mekanizma për parandalimin dhe luftimin e suksesshëm të korrupsionit në administratën e Kosovës [Shala, 2015:363].

KAPITULLI IV: INSTRUMENTET E KONTROLLIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË DISA SHTETE TË RAJONIT - ANALIZË KRAHASUESE

Në këtë kapitull trajtohen instrumentet e kontrollit të administratës publike të shteteve të rajonit. Punimi fokusohet në analizën krahasimore të instrumenteve të kontrollit të administratës publike të Republikës së Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Pra, shtete në tranzicion, shtete të cilët kanë disa karakteristika të përbashkëta, ashtu siç kanë edhe specifikat e tyre të veçanta kur flitet për procedurën e emërimit dhe shkarkimit, mandatin dhe kompetencat që kanë këto instrumente të kontrollit të administratës publike.

4.1. Kontrolli i administratës publike nga organi ligjvënës në shtetet e rajonit

Kuvendi, si institucioni më i lartë ligjvënës, ushtron kontroll jo vetëm mbi ekzekutivin, por edhe mbi organet kushtetuese të krijuara me ligj nga ai vetë, për të verifikuar zbatimin e kuadrit ligjor të miratuar prej tij. Këtë kontroll Kuvendi e ushtron nëpërmjet mekanizmave ligjorë të parashikuar në Kushtetutë e në Rregulloren e Kuvendit. Veprimtaria e legjislativit është shtrirë edhe në rritjen e transparencës dhe të ushtrimit të kontrollit parlamentar, si funksion tjetër kushtetues i tij.³⁰⁷ Kuvendi, për kryerjen e kontrollit mbi ekzekutivin, përdor instrumentet ligjore si: interpelancat, pyetjet, mocionet për debatet, raportimet, komisionet hetimore. Sipas profesor Bufit “mënyrat se si këto mjete përdoren, ndryshojnë nga një parlament në tjetrin, ato ushtrohen sipas procedurave të caktuara në rregulloret e Parlamentit. Karakteristikë e përbashkët e tyre është se funksioni i kontrollit parlamentar ushtrohet si në komisione parlamentare, ashtu edhe nga parlamenti në seancë plenare” [Bufi, 2010:498]. Në vijim, kemi pasqyruar se si këto instrumente parashikohen me dispozita kushtetuese, ligjore dhe me Rregullore të Kuvendit të

³⁰⁷ Kuvendi i Shqipërisë, Raport Vjetor mbi veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2014, fq. 12 Tiranë, 2015.

shteteve të cilat janë rast studimi. *Interpelancat* si instrumenti kryesor i ushtrimit të kontrollit ndaj qeverisë, kërkohen kryesisht nga mazhoranca parlamentare dhe në pak raste nga opozita.³⁰⁸

Në Republikën e Shqipërisë kërkesa për interpelancë mund të bëhet nga çdo deputet ose grup deputetësh.³⁰⁹ Kurse, zhvillimin e një interpelance për çështje urgjente mund ta kërkojë një kryetar grupi parlamentar ose 7 deputetë. Çdo kryetar grupi parlamentar nuk mund të kërkojë më shumë se një interpelancë për çështje urgjente për një muaj dhe çdo deputet nuk mund të nënshkruajë më shumë se një interpelancë të tillë për një muaj.³¹⁰

*Në Republikën e Maqedonisë*³¹¹ interpelancë mund të paraqesin së paku pesë deputetë³¹², *në Republikën e Malit të Zi* së paku 27 deputetë³¹³, ndërsa *në Republikën e Serbisë* të paktën 50 deputetë mund të propozojnë interpelancë në lidhje me punën e Qeverisë ose anëtarit të veçantë të Qeverisë.³¹⁴ Mundësia e kërkesës së interpelancës si instrument i kontrollit të Qeverisë dhe institucioneve të cilat i raportojnë dhe japin llogari në Kuvend, është shumë më e favorshme në Shqipëri se në shtete të tjera që janë rast studimi në këtë punim.

Mocion besimi ndaj Qeverisë si instrument kontrolli, ka të drejtë të paraqesë Kuvendi dhe Kryeministri në Kuvend.

Në Republikën e Shqipërisë një e pesta e deputetëve ka të drejtë të paraqesë për votim në Kuvend një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit në detyrë, duke propozuar një Kryeministër të ri.³¹⁵ *Në Republikën e Serbisë* ky mocion mund të kërkohet nga të paktën 60 deputetë,³¹⁶ *në Maqedoni* nga së paku 20 deputetë,³¹⁷ në

³⁰⁸ Kuvendi i Shqipërisë, Raport Vjetor mbi veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2014 Tiranë, 2015, fq. 12.

³⁰⁹ Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, neni 96.

³¹⁰ Po aty, neni 97.

³¹¹ Sqarim: Për arsye të kufizimit të fialeve në punim emri zyrtar i shtetit ish Republika Jugosllave e Maqedonisë në punim do të përdoret vetem emri Republika e Maqedonisë

³¹² Neni 72 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

³¹³ Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, neni 108.

³¹⁴ Neni 129 i Kushtetutës të Republikës së Serbisë, Official Gazette of RS, No. 98/06.

³¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 105.

³¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, Official Gazette of RS, No 98/06, neni 130

³¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 92.

Mal të Zi mund të kërkohet nga së paku 27 deputetë.³¹⁸ Në Shqipëri³¹⁹, Serbi³²⁰, Mali të Zi³²¹ dhe Maqedoni shkarkimi i Kryeministrit bëhet nga Kuvendi.³²² Kryeministri ka të drejtë t'i paraqesë Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave.³²³ Qeveria ka të drejtë të parashtrojë mocion besimi para Kuvendit.³²⁴ Mundësia e kërkesës së mocionit të besimit ndaj Qeverisë si instrument kontrolli ndaj Qeverisë, është shumë më e favorshme në Maqedoni se në shtete të tjera që janë rast studimi.

Ngritja e komisionit hetimor si instrument i kontrollit parlamentar për të shqyrtuar një çështje të caktuar, varion në vendet e rajonit. Kështu, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë.³²⁵ Në Maqedoni mund të paraqesin kërkesë së paku 20 deputetë,³²⁶ në Mal të Zi ngritja e komisionit hetimor bëhet me propozimin e së paku 27 deputetëve.³²⁷ Mundësia e kërkesës për themelimin e këtij komisioni për të gjitha fushat dhe për çdo çështje me interes publik ndaj Qeverisë si instrument kontrolli, është shumë më e favorshme në Maqedoni se në shtete të tjera që janë rast studimi.

Në Republikën e Shqipërisë³²⁸, Maqedonisë³²⁹, Serbisë³³⁰ dhe Malit të Zi³³¹, çdo deputet mund t'i parashtrojë *pyetje* Kryeministrit ose ndonjë Ministri, për të marrë informacion për një ose disa çështje të caktuara.³³²

³¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, neni 107.

³¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 104 dhe 105 dhe nenet 100 dhe 101. të Rregullores së Kuvendit, miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, Neni 113.

³²⁰ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 131.

³²¹ Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, neni 82.

³²² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 92.

³²³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 104.

³²⁴ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 93.

³²⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 77.

³²⁶ Neni 76 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë

³²⁷ Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, neni 109

³²⁸ Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, neni 90.

³²⁹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 72.

³³⁰ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 99.

³³¹ Rregullore e punës së parlamentit të Malit të Zi, neni 187.

³³² Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, neni 90

4.2. Kontrolli administrativ i administratës publike në shtetet e rajonit

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 4 përcakton se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Ndërsa, neni 7 përcakton se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.³³³ Neni 15 i Kushtetutës parashikon shprehimisht se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre³³⁴. Po kështu, neni 42 paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon shprehimisht se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.³³⁵ Pra, neni 15 dhe neni 42 i Kushtetutës, sanksionojnë edhe parimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së administratës publike dhe të drejtën e ankimit administrativ e gjyqësor të individit dhe subjekteve juridike. Parimi i shtetit të së drejtës, mes të tjerave, kërkon që të garantohet mbrojtja e plotë e individit dhe personave juridikë kundrejt cënimit të sferës së të drejtave të tyre nga ndërhyrjet e pushtetit publik. Kjo mbrojtje përfshin edhe parashikimin e qartë nga ligji të rregullave të sjelljes së administratës publike dhe individëve, të së drejtës (por edhe detyrimit) të këtyre të fundit për të kërkuar realizimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme, si dhe për t'u ankuar me mjete efektive nëse këto të drejta u cënohen apo u kufizohen pa respektuar ligjin dhe në mënyrë të paarsyeshme. Nga ana tjetër, në një shtet të së drejtës, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e hallkave të administratës publike duhet të jenë të përcaktuara me ligj. Organet publike nuk mund të ushtrojnë, sipas diskrecionit të tyre, kompetenca që nuk ua njeh shprehimisht ligji, veçanërisht nëse ushtrimi i tyre lidhet me çështje që kanë të

³³³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 4 dhe 7.

³³⁴ Po aty, shih nenin 15.

³³⁵ Po aty, shih nenin 42, paragrafi 2 i Kushtetutës.

bëjnë me kërkesa dhe ankesa të individëve e personave juridikë lidhur me pretendime për cënimin e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.³³⁶

Në Shqipëri, organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.³³⁷ Në dispozita vijuese të KPA parashikohet se veprimtaria administrative i nënshtrohet: kontrollit administrativ; kontrollit të gjykatës dhe çdo kontrolli tjetër.³³⁸ Prandaj, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, mjetet ligjore administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë. Mjetet ligjore administrative janë:

- a) ankimi administrativ, i cili përfshin: i) Ankimin administrativ ndaj aktit administrativ ose mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit brenda afatit të parashikuar dhe/ose veprimit procedural të organit publik gjatë procedurës administrative (Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ); ose ii) kundërshtimi administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ nën regjimin e së drejtës administrative (Kundërshtimi administrativ);

- b) rishikimi.

Pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjtën çështje.³³⁹ Pra, një nga format e kontrollit administrativ është ajo e ankimit

³³⁶ Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr. 1, Tiranë, më datë 26.11.2010, fq. 5.

³³⁷ Ligji Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, neni 4.

³³⁸ Po aty, shih nenin 21.

³³⁹ Kodi i Procedurave Administrative, neni 128.

administrativ, si një mjet juridik i rëndësishëm për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individëve dhe subjekteve juridike.³⁴⁰

Kodi i Procedurave Administrative njih ushtrimin e ankimit administrativ nëpërmjet apelimit administrativ dhe kërkesës joformale. Ushtrimi i ankimit administrativ nëpërmjet kërkesës joformale, nuk përbën një detyrim për subjektin, por një të drejtë të tij për t'iu drejtuar organit administrativ me qëllim shqyrtimin e ankimit si dhe zgjidhjen e problemit. Në rastet e kërkesës joformale, duke mbetur një opsion, një mundësi që ligji i njih individit për t'i paraqitur organit administrativ pretendimin e tij, gjykata nuk ka pengesë të investohet direkt për ta marrë atë në shqyrtim.

Apelimi administrativ i parashikuar shprehimisht në ligj, si një mjet juridik i plotë për të kërkuar shfuqizimin ose ndryshimin e aktit administrativ, përbën një mjet ankimi me natyrë shteruese, dhe njëkohësisht të detyrueshme për t'u ezauruar me qëllim që më pas t'i drejtohesh juridiksionit gjyqësor. Apeli administrativ kërkon respektimin e disa kushteve formale, pa të cilat nuk mund të pretendohet të kryhet një proces i rregullt administrativ. Këto kushte formale janë të parashikuara jo vetëm në Kodin e Procedurave Administrative, por edhe në ligje të veçanta.

Këto ligje të veçanta, të cilat rregullojnë fushat e veçanta të veprimtarisë administrative parashikojnë jo vetëm të drejtën dhe detyrimin e subjektit për të paraqitur apelim administrativ, por dhe të drejtën dhe detyrimin e organit konkret administrativ për ta marrë në shqyrtim ankimin administrativ me efekt shterues.³⁴¹

Shqyrtimi i ankimit administrativ ndaj aktit bëhet nga organi publik kompetent dhe nga organi epror. Sipas nenit 134 të KPA, parashikohet se ankimi ndaj një akti administrativ mund t'i drejtohet organit publik i cili e ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin; organit publik epror të organit i cili e ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin, ose një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj. Nëse

³⁴⁰ Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, Nr.1, Tiranë, më datë, 26.11.2010, fq. 6.

³⁴¹ Vendimi Unifikues i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në Shqipëri, nr.449, datë 18.10.2011, (fq.189, referuar materialit përmbledhje të vendimeve të vitit 2011).

ankimi i është drejtuar njërit prej organeve të sipërpërmendura, ato ia përcjellin pa vonesë organit kompetent.³⁴²

Fillimisht organi publik kompetent e shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, atëherë ai shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar. Nëse është e nevojshme, organi publik kompetent mund të kryejë hetime administrative shtesë.³⁴³ Ndërsa, organi epror shqyrton ankimin e përcjellë nga organi kompetent dhe, nëse është e nevojshme, zhvillon hetime shtesë, apo urdhëron organin kompetent që të zhvillojë hetime shtesë dhe të njoftojë për to.³⁴⁴

Pra, “ndjekja e rrugës administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t’i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ, mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ. Ligji i posaçëm mund të parashikojë edhe modalitete konkrete mbi afatet, kushtet e procedurat që duhen respektuar për të bërë të pranueshëm për shqyrtimin në themel ankimin administrativ, për procedurat e shqyrtimit dhe natyrën e vendimmarrjes nga organi administrativ, etj. Nëse rregulla të tilla eventuale nuk

³⁴² Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë, neni 134.

³⁴³ Neni 136 i KPA parashikon se “nëse anulimi, shfuqizimi ose ndryshimi i aktit administrativ të ankimuar apo nxjerrja e aktit të refuzuar do t’i shkaktonte dëm një pale tjetër, organi kompetent duhet t’i japë asaj mundësinë për t’u dëgjuar, sipas neneve 87 dhe 88, të këtij Kodi, përpara marrjes së vendimit për ankimin e paraqitur. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, ai me një akt të ri administrativ anulon, shfuqizon ose ndryshon aktin e ankimuar, ose përkatësisht nxjerr aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi nuk është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, pa vonesë dhe pa u shprehur mbi të, e përcjell atë për shqyrtim dhe vendimmarrje tek organi epror, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të dosjes dhe një raport me shkrim të qëndrimit të tij”.

³⁴⁴ Neni 137 i Kodit të Procedurës Administrative parashikon se “Organi epror, me akt administrativ, refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese e aktit administrativ të ankimuar është e ligjshme, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai refuzon ankimin dhe paraqet arsyetimin e ri. Nëse organi epror vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, ai vendos përfundimisht me një akt të ri duke anuluar, shfuqizuar apo ndryshuar, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, ose përkatësisht duke nxjerrë aktin e kërkuar nga pala. Nëse nuk është parashikuar shprehimisht ndryshe nga ligji, akti i organit epror mund të jetë vetëm në dobi të palës ankuese”.

janë parashikuar, gjejnë zbatim afatet, kushtet e procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative”.³⁴⁵ Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës.³⁴⁶ Neni 44 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon shprehimisht së “kushdo, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore, ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin”.³⁴⁷

Në Republikën e Maqedonisë, Qeveria cakton parimet për organizimin e brendshëm dhe për punën e ministrive dhe organeve të tjera të administratës, orienton dhe bën mbikëqyrje mbi punën e tyre. Qeveria cakton politikën e zbatimit të ligjeve dhe dispozitave të tjera të Kuvendit dhe mban përgjegjësi për zbatimin e tyre.³⁴⁸ Në rast konflikti për kompetenca ndërmjet organeve të administratës shtetërore, ndërmjet organeve të administratës shtetërore dhe personave juridike e të tjerë, të cilëve me ligj u janë besuar autorizime publike, zgjidhja duhet të bëhet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Konfliktin e kompetencave ndërmjet njësive organizative që janë krijuar për të kryer punë të caktuara administrative nga kompetenca e organit të administratës shtetërore, e zgjidh organi i administratës shtetërore në varësinë e të cilit kryejnë punët njësive organizative.³⁴⁹ Në punën administrative për vendosjen e të cilës është kompetent organi i administratës shtetërore, vendimin në procedurën administrative e merr funksionari që drejton organin. Funksionari që drejton organin e administratës shtetërore, mund ta autorizojë personin tjetër zyrtar nga i njëjti organ, për marrjen e vendimit në punët administrative të llojit të caktuar.³⁵⁰ Sipas Maksutit “mbikëqyrja e punës së organeve të komunës varet nga lloji i kompetencave. Të lloji i kompetencës burimore, mbikëqyrja ka të bëjë me ligjshmërinë e akteve dhe veprimeve si dhe mbi

³⁴⁵Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr.1, datë 26.11.2010.

³⁴⁶Vendimi nr.79, datë 27.12.2016 i Gjykatës Kushtetuese.

³⁴⁷Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 44.

³⁴⁸Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 91.

³⁴⁹Ligji për procedurë të përgjithshme administrative e Republikës së Maqedonisë, Neni 30, Стр. 34 - Бр. 38 СЛУЖБЕН ВЕСНИК НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА, 26 мај 2005.

³⁵⁰По аty, neni 33.

çështjet materiale dhe financiare të punës. Të kompetencat e deleguara, mbikëqyrja përfshihet edhe në efikasitetin e punës. Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve e ushtron ministria përkatëse e pushtetit lokal dhe mbikëqyrjen e punës së deleguar të komunës, e ushtron organi i administratës shtetërore që bën delegimin. Organet e administratës shtetërore ushtrjnë kontrolle mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunës” [Maksuti, 2012:297]. Prandaj, të gjitha aktet dhe dispozitat e organeve komunale i nënshtrohen procedurës së kontrollit dhe të mbikëqyrjes, ndërsa, lëndë e vlerësimit është baza juridike e aktit, dispozitivit dhe procesi i aprovimit të aktit [Zendeli, 2008:112].

Në Republikën e Serbisë, administrata publike jep llogari për punën e saj dhe parashihet me Kushtetutë dhe me ligj se duhet të jetë e pavarur. Punët e administratës publike në Serbi kryhen nga ministrinë dhe organet e tjera të administratës publike, të përcaktuara me ligj. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe organeve të tjera të administratës publike dhe të organizatave rregullohen nga Qeveria.³⁵¹ Administrata shtetërore është një pjesë e pushtetit ekzekutiv të Republikës së Serbisë për kryerjen e detyrave administrative në kuadër të të drejtave dhe detyrimeve të Republikës së Serbisë. Administrata shtetërore përbëhet nga ministrinë, autoritetet administrative brenda ministrive dhe organizatat e veçanta.³⁵² Ndërsa, puna e organeve të administratës shtetërore i nënshtrohet mbikëqyrjes së Qeverisë. Kuvendi mbikëqyr punën e organeve të administratës shtetërore nëpërmjet mbikëqyrjes së punës së Qeverisë dhe anëtarëve të Qeverisë.³⁵³

Puna e organeve të administratës shtetërore mbikëqyret nga Qeveria (mbikëqyrje kryesisht ligjore) dhe Kuvendi (mbikëqyrje politike, e cila arrihet në mënyrë indirekte përmes mbikëqyrjes së bërë nga Kuvendi mbi punën e Qeverisë dhe anëtarëve të Qeverisë).³⁵⁴ Autoritetet e administratës shtetërore janë autonomë në

³⁵¹Neni 136 i Kushtetutës së Republikës së Serbisë, Official Gazette of RS, No 98/06.

³⁵²Law on State Administration of Republic of Serbia Article 1 Official Gazette of RS, No. 79/05 (Ligji për administratën shtetërore i Republikës së Serbisë, neni 1)

³⁵³Po aty, shih nenin 2 dhe neni 3.

³⁵⁴Damjanovi, Jasmina. Overview of the State Administration Act, The Government and State Administration system in the Republic of Serbia compilation of laws and explanatory articles , fq. 26, shih:

kryerjen e detyrave të tyre dhe duhet të punojnë në përputhje me Kushtetutën, ligjin, legjislacionin tjetër dhe aktet e përgjithshme.³⁵⁵ Mbikëqyrja administrative mund të bëhet në tre forma: mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e akteve, mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e punës dhe mbikëqyrje inspektuese.³⁵⁶ Mbikëqyrja e brendshme sjell mbikëqyrje të autoriteteve të administratës shtetërore të kryer nga autoritetet e tjera të administratës shtetërore, si dhe të bartësve të kompetencave publike gjatë kryerjes së detyrave që i janë dhënë administratës shtetërore. Mbikëqyrja e brendshme sjell mbikëqyrjen e punës, mbikëqyrjen e inspektoriateve përmes inspektimit administrativ dhe formave të tjera të mbikëqyrjes të rregulluara me ligj të veçantë.³⁵⁷ Mbikëqyrja e punës përbëhet nga mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës dhe mbikëqyrja e qëllimit të punës së organeve të administratës shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike gjatë kryerjes së detyrave që i janë dhënë administratës shtetërore. Mbikëqyrja e ligjshmërisë përfshin hetimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme, ndërsa mbikëqyrja e qëllimit të punës përfshin hetimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kostos dhe vendosmërinë e organizimit të punës. Një ministër nuk mund të mbikëqyrë punën e ndonjë ministri tjetër.³⁵⁸

Në Republikën e Malit të Zi, puna e organeve të administratës shtetërore i nënshtrohet kontrollit. Kontrolli i punës së organeve të administratës shtetërore realizohet përmes mbikëqyrjes administrative, kontrollit gjyqësor dhe formave të tjera të kontrollit, në përputhje me ligjin.³⁵⁹ Sjellja e mbikëqyrjes administrative në Malin e Zi përbëhet nga: mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e akteve administrative, mbikëqyrja mbi ligjshmërinë dhe funksionalitetin e punës së autoriteteve administrative, organet e vetëqeverisjes lokale, institucionet dhe personat e tjerë

http://suk.gov.rs/global/pdf/strucna_literatura/The_Government_and_StateAdministration_in_the_Republic_of_Serbia.pdf.

³⁵⁵ Ligji për administratën shtetërore i Republikës së Serbisë, neni 7.

³⁵⁶ Damjanovi, Jasmina. Overview of the State Administration Act, The Government and State Administration system in the Republic of Serbia compilation of laws and explanatory articles, fq. 29, shih:

http://suk.gov.rs/global/pdf/strucna_literatura/The_Government_and_StateAdministration_in_the_Republic_of_Serbia.pdf.

³⁵⁷ Ligji për administratën shtetërore i Republikës së Serbisë, neni 45.

³⁵⁸ Po aty, neni 46.

³⁵⁹ Ligji Nr. 01-332/2 për Administratën e shtetit të Republikës së Malit të Zi, neni 6.

juridikë në kryerjen e punëve të besuara dhe të deleguara, si dhe inspektimit.³⁶⁰ Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e punës së organeve administrative kryhet nga ministritë. Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e punës së organit të administratës shtetërore, përcaktohet me aktin për themelimin e organit përkatës të administratës shtetërore.³⁶¹ Në kryerjen e mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë dhe funksionalitetin e punës së autoriteteve administrative, ministritë mund të pezullojnë aktet e nxjerra jashtë procedurës administrative, kur ato janë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e tjera, ose mund t'i propozojnë Qeverisë për t'i anuluar këto akte.³⁶²

4.3. Kontrolli gjyqësor i administratës publike në shtetet e rajonit

Kontrolli gjyqësor i punës së administratës publike është parim i pranuar dhe i zbatueshëm në praktikat më të mira nga shtetet e Bashkimit Evropian.³⁶³

Në Republikën e Shqipërisë, gjykatat janë garant për respektimin e të drejtave subjektive të individit, të cilat cenohen nga administrata [Sadushi, 2014:27]. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, u ka ngarkuar gjykatave misionin e mbrojtjes, garantimit dhe respektimit të parimeve themeltare kushtetuese dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut. Ky mision i gjykatave mund të realizohet vetëm atëherë kur zbatimi i ligjit nga hallkat e pushtetit ekzekutiv (nëse ato ndërhyjnë në sferën e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut), është i kontrollueshëm nga gjykatat.³⁶⁴ Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kodin e Procedurës Civile e në ligje të veçanta. Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Juridiksioni gjyqësor

³⁶⁰Po aty, neni 16.

³⁶¹Po aty, shih nenin 25.

³⁶²Po aty, neni 69.

³⁶³Komisioni Evropian, Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian, Komisionin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komisionin e Rajoneve, Strategjia e BE-së për Zgjerim, fq. 20.

³⁶⁴Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr.1, datë 26.11.2010, fq. 6.

civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera.³⁶⁵ Kur një çështje hyn në juridiksionin e gjykatës, ajo nuk mund të shqyrtohet njëkohësisht edhe nga një organ i administratës publike (juridiksioni administrativ) dhe anasjelltas. Parimet nga të cilat udhëhiqet legjislacioni në fuqi që rregullon veprimtarinë e administratës publike, parashikon se organet administrative dhe veprimtaria e tyre i nënshtrohen rrugës dhe mjeteve të kontrollit, ku përfshihen edhe kontrolli administrativ dhe ai gjyqësor. Ky kontroll i shërben ecuresë normale të veprimtarisë administrative dhe, mbi të gjitha, përbën një garanci për moscënimin e të drejtave të individëve dhe subjekteve juridike.³⁶⁶ Në Republikën e Shqipërisë, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë si dhe nga Gjykatat e Apelit e Gjykatat e Shkallës së Parë, të cilat krijohen me ligj.³⁶⁷ Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykata me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe gjykata me juridiksion të përgjithshëm të apelit. Gjykata të posaçme janë: a) gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit; b) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Gjykata e Lartë gjykon çështje të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm.³⁶⁸ Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.³⁶⁹ Gjykata Administrative, në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike. Gjykata administrative zbaton parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave e

³⁶⁵ Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë Neni 36 (Shtuar paragrafi i pestë me ligjin nr. 38/2017, 30.3.2017) Maj 2017 Tiranë

³⁶⁶ Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr.1, datë 26.11.2010, fq. 6.

³⁶⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 135.

³⁶⁸ Ligji Nr. 98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë neni 3

³⁶⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Nr. 65 datë 07.11.2016 Fq. 5

interesave të ligjshëm të personave privatë.³⁷⁰ Gjykatat e faktit shqyrtojnë jo vetëm paligjshmërinë apo pathemësinë e aktit, por dhe ligjshmërinë e veprimeve/mosveprimeve të organeve të administratës, jo vetëm për t’iu përgjigjur në kohë subjekteve për kërkesat/ankimet që ato paraqesin, por edhe nëse veprimet e kryera prej tyre janë të ligjshme apo jo dhe nëse ato iu përgjigjen rrethanave të faktit. Në vështrim edhe të neneve 18/b e 137 të KPA-së, gjykata ushtron kontroll për ligjshmërinë e aktit dhe veprimeve të organeve të administratës publike të cilat kontestohen para gjykatës, për shkak se, sipas pretendimeve të palës paditëse, kanë cënuar e kufizuar të drejta e interesa të ligjshme, duke e detyruar atë të paguajë një detyrim jo të bazuar në ligj e në gjendjen e faktit.³⁷¹ Gjyqtarët e gjykatave të posaçme, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit, shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.³⁷² Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.³⁷³ Në Republikën e Shqipërisë, gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit (i njohur si procesi i *vetingut*). Krite të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.³⁷⁴ Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi.³⁷⁵ Gjykatave mund t’iu drejtohet kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një

³⁷⁰ Ligji Nr. 49/2012 për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative (ndryshuar me ligjin nr. 100/2014) Neni 3

³⁷¹ Vendimi nr. 3 Unifikues I Kolegjet të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, më 12.02.2008

³⁷² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Neni 135 i ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

³⁷³ Neni 14 i Ligjit Nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

³⁷⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 136/a, shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

³⁷⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 137 i ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj.³⁷⁶ Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.³⁷⁷ E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara, të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.³⁷⁸ Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj.³⁷⁹ Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

³⁷⁶ Po aty, shih nenin 42.

³⁷⁷ Neni 1 i Ligjit Nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

³⁷⁸ Vendimi nr. 3 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, datë 23.02.2016, fq. 7.

³⁷⁹ Vendimi nr. 79, datë 27.12.2016 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze, mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që, një vonesë në ekzekutimin e një vendimi, mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës.³⁸⁰ Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre.³⁸¹

Në Republikën e Serbisë, gjykatat i përkasin juridiksionit të përgjithshëm dhe të veçantë. Gjykata Supreme e Kasacionit është Gjykata Supreme në Republikën e Serbisë.³⁸² Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm janë: Gjykatat Komunale dhe Gjykatat e Qarkut, Gjykatat e Apelit dhe Gjykata Supreme (e Lartë) e Serbisë. Gjykatat e specializuara janë: Gjykatat Tregtare, Gjykata e Lartë Ekonomike dhe Gjykata Administrative.³⁸³

Gjykata Administrative në Shkallë të Parë zgjidh mosmarrëveshjet administrative.³⁸⁴ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, në nenin 149 përcakton se gjyqtari, në ushtrimin e funksionit të tij/saj gjyqësor, duhet të jetë i pavarur dhe përgjegjës vetëm sipas Kushtetutës dhe ligjit. Ndalohet çdo ndikim mbi gjyqtarin gjatë kryerjes së funksionit të tij/saj gjyqësor.³⁸⁵ Këshilli i Lartë Gjyqësor është një organ i pavarur, i cili do të sigurojë dhe garantojë pavarësinë dhe autonominë e

³⁸⁰ Vendimi nr. 75, datë 23.11. 2017 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

³⁸¹ Vendimi nr.79, datë 27.12.2016 i Gjykatës Kushtetuese Republikës së Shqipërisë.

³⁸² Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 143, Official Gazette of RS, No. 98/06.

³⁸³ Law on Organisation of Courts of Serbia, neni 10.

³⁸⁴ Po aty, neni 26.

³⁸⁵ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 149.

gjykatave dhe gjyqtarëve.³⁸⁶ Në mosmarrëveshjet administrative, gjykatat mbikëqyrin ligjshmërinë e akteve individuale të organeve të administratës shtetërore.³⁸⁷

Pavarësia e gjyqësorit në Serbi nuk është e garantuar në praktikë. Ka hapësirë për ndërhyrje politike në rekrutimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Administrimi i drejtësisë është i ngadalshëm, me një mungesë të konsiderueshme të rasteve. Kushtetuta e Serbisë dhe ligjet lejojnë ndikimin politik, sepse Parlamenti emëron Kryetarin e Gjykatës Supreme dhe të gjithë kryetarët e gjykatave, Prokurorin e Shtetit dhe të gjithë prokurorët e tjerë.³⁸⁸

Në Republikën e Maqedonisë, sistemi ligjor njeh instrumentin e kontrollit gjyqësor për veprimet konkrete (individuale) të administratës. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë garanton legjitimitetin e mbrojtjes gjyqësore të akteve individuale të organeve të administratës shtetërore dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë autoritetin publik.³⁸⁹ Gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë mandat të përhershëm [Maksuti, 2012:269].

Pushtetin gjyqësor në Maqedoni e përbejnë Gjykatat Themelore, Gjykatat e Apelit, Gjykata Administrative, Gjykata e Lartë Administrative, dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, të cilat e ushtrojnë pushtetin gjyqësor brenda sistemit gjyqësor.³⁹⁰

Gjykata Administrative e ushtron pushtetin gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.³⁹¹ Gjykata e Lartë Administrative ushtron pushtetin gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.³⁹² Gjykata e Lartë Administrative është kompetente të vendosë për: ankesat kundër vendimeve të Gjykatës Administrative, konfliktin e kompetencave ndërmjet organeve të Republikës, ndërmjet komunave dhe Qytetit të Shkupit, ndërmjet komunave të Qytetit të Shkupit dhe për

³⁸⁶ Po aty, neni 153.

³⁸⁷ Ligji për administratën shtetërore i Serbisë, neni 2.

³⁸⁸ European Commission, Commission Staff Working Document, Serbia 2015 Report, Brussels, 10.11.2015 SWD(2015) 211 final, fq. 11.

³⁸⁹ *Zendeli, Memet Fadil, Memet Seit Memeti, Agron Selman Rustemi*, Judicial Control over Public Administration, Acta Universitatis Danubius, Juridica, Vol 8, No 2 (2012), fq. 91.

³⁹⁰ Ligji për Gjykatat në Maqedoni, neni 22.

³⁹¹ Po aty, neni 25.

³⁹² Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Gjykata Neni 25-a, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006 dhe 35/2008

mosmarrëveshjet e ndodhura për konfliktin e kompetencave ndërmjet komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe bartësve të autorizimeve publike, nëse kjo është paraparë me ligj, nëse me Kushtetutë ose ligje nuk është paraparë mbrojtje tjetër gjyqësore.³⁹³

Mosmarrëveshjet administrative në Republikën e Maqedonisë do të vendosen nga: Gjykata Administrative si gjykatë e shkallës së parë dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, e cila vendos mbi mjetet e jashtëzakonshme juridike.³⁹⁴

Gjykata Administrative në gjykimin administrativ vendos për ankesat kundër akteve administrative, ndërsa Gjykata Supreme vendos për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të Gjykatës Administrative. Gjykata Supreme vendos për konfliktin e juridiksionit ndërmjet Gjykatës Administrative dhe gjykatave të tjera.³⁹⁵

Në Republikën e Malit të Zi janë këto Gjykata: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit, Gjykatat më të Larta, Gjykatat Tregtare, Gjykata Administrative dhe Gjykata Supreme e Malit të Zi.³⁹⁶ Me Kushtetutën e Malit të Zi ndalohet themelimi i gjykatave të parregullta dhe të jashtëzakonshme.³⁹⁷ Gjykata ka për detyrë të vendosë për çështjet ligjore, për të cilat ajo ka juridiksion në mënyrë të ligjshme, objektive dhe në kohën e duhur.³⁹⁸ Përveç kushteve të përgjithshme, që një person të zgjidhet si gjyqtar gjithsesi, kërkohet që ai/ajo të ketë përvojë pune për kohëzgjatjen e mëposhtme në fushën e së drejtës. Për gjyqtar i gjykatës themelore kërkohet përvojë pune prej pesë vjet; për gjyqtar i gjykatës komerciale kërkohet përvojë pune prej gjashtë vjet; për gjyqtar të Gjykatës së Lartë kërkohet përvojë pune prej tetë vjet; për gjyqtar i Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Administrative kërkohet përvojë pune prej dhjetë vjet; për gjyqtar të Gjykatës Supreme kërkohet përvojë pune prej pesëmbëdhjetë vjet.³⁹⁹ Gjykata Administrative ka juridiksion në të gjithë territorin e Malit të Zi. Ajo vendos për mosmarrëveshjet administrative mbi ligjshmërinë e

³⁹³ Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Gjykata, Neni 34-a, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006 dhe 35/2008

³⁹⁴ Ligji mbi konfliktin Administrativ, neni 4 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 62, 22 Maj 2006).

³⁹⁵ Po aty, neni 16.

³⁹⁶ Ligji për Gjykatat në Mali të Zi, neni 14.

³⁹⁷ Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, neni 118.

³⁹⁸ Ligji për Gjykatat në Mali të Zi, neni 4 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi nr. 5/2002 dhe 49/2004 dhe Gazeta Zyrtare e Mali i Zi, nr. 22/2008).

³⁹⁹ Po aty, shih nenin 32.

akteve administrative, dhe ligjshmërinë e akteve të tjera individuale të parashikuara nga ligji, si dhe për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë dhe të detyrueshme në procedurat kundërvajtëse. Gjithashtu kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.⁴⁰⁰ Me kërkesë të gjykatave, organet e administratës shtetërore janë të obliguara të dorëzojnë aktet dhe të dhënat, në një afat kohor të përcaktuar nga ligjet që rregullojnë procedurën para gjykatës.⁴⁰¹

4.4. Gjykata Kushtetuese në kontrollin e administratës publike në shtetet e rajonit

Gjykata Kushtetuese kryen një funksion shumë të veçantë e tepër të rëndësishëm, atë të kontrollit të vetë procesit ligjvënës, e me këtë rast edhe të një prej funksioneve kryesore të parlamentit.⁴⁰² Për këtë arsye, kontrolli i procesit ligjvënës nga Gjykata Kushtetuese është cilësuar si kurorëzimi i shtetit të së drejtës. Priorja për të vënë nën kontroll kushtetues veprimtarinë e legjislativit, gjithmonë duke respektuar sovranitetin ligjvënës të tij, është kthyer në një tipar dallues në pothuaj të gjitha regjimet demokratike sot në botë.⁴⁰³ Sipas Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë B. Dedaj “kontrolli kushtetues konsiderohet i domosdoshëm, pasi Kushtetuta sado moderne të jetë, nuk mund të jetë në asnjë rrethanë një dokument perfekt dhe i painterpretuar dhe nga ana tjetër, organe të tilla si ligjvënësi apo gjykatat e zakonshme duhet të kontrollohen në mënyrë që mos t’i shmangen parimeve dhe vlerave kushtetuese gjatë veprimtarisë së tyre”.⁴⁰⁴

Gjykata Kushtetuese vepron si ndërmjetësi midis pushtetit të zgjedhur dhe degëve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor të qeverisjes, duke i mbajtur funksionet

⁴⁰⁰ Ligji për Gjykatat e Malit të Zi neni 23 dhe neni 24, Gazeta zyrtare e Republikës së Malit të Zi, nr. 5/2002 dhe 49/2004 dhe Gazeta zyrtare e Malit të Zi, nr. 22/2008.

⁴⁰¹ Ligji për Administratën Shtetërore të Malit të Zi, neni 75.

⁴⁰² Zaganjori, Xhezair & Aurela Anastasi & Eralda (Methasani) Çani, “Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, fq.24.

⁴⁰³ Me gjerësisht, shih faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë:
http://www.gjk.gov.al/web/Institucioni_89_1.php.

⁴⁰⁴ Dedja, Bashkim, Disa elementë të kontrollit kushtetues sipas jurisprudencës shqiptare, Moskë–Rusi, 2830 Tetor 2011, fq.1.

e tyre brenda limiteve kushtetuese. Juridiksioni kushtetues mban statusin e arbitrit gjyqësor duke vendosur për konfliktet e kompetencave ndërmjet institucioneve.⁴⁰⁵

Në Republikën e Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese sipas S. Sadushit “është mjet ligjor i veçantë, që përdoret ndaj shkeljeve kushtetuese të shkaktuara nga ligjet, aktet normative të organeve qendrore e vendore, aktet administrative, si dhe vendimet gjyqësore. Natyra e kërkesave që i paraqiten Gjykatës Kushtetuese nuk është e njëjlojtë për të gjitha çështjet që përfshihen në juridiksionin e kësaj gjykate. Forma dhe përmbajtja e kërkesës ndryshon në varësi të subjektit që e inicion gjykimin kushtetues”.⁴⁰⁶

Sipas nenit 131 të kushtetutës parashikohet se Gjykata Kushtetuese është kompetente dhe vendos për: pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre; pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare; mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore; kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre; shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij; çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre; kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij; gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë. Referuar këtij neni paragrafit dy Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin

⁴⁰⁵Tanchev, Evgeni, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë, 20 vjetori i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Konferencë Ndërkombëtare, Tiranë, 7-8 qershor 2012, fq.63

⁴⁰⁶ Sadushi, Sokol, Drejtësia kushtetuese në zhvillim, trajtime teorike dhe të praktikës së gjykimin kushtetues, Toena, Tiranë, 2012, fq. 358.

e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.⁴⁰⁷ Një mjet tjetër efikas konsiderohet edhe mundësia për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me qëllim kontrollin e akteve normative nëse janë apo jo në përputhje me Kushtetutën.⁴⁰⁸

Gjykata Kushtetuese e ka ritheksuar se çdo organ juridiksional, qoftë si institucion a organ pushteti, në kuptimin klasik administrativ të tij, apo dhe si subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i legjitimuar për të qenë palë në mosmarrëveshje pushtetesh.⁴⁰⁹ Pala kërkuese ka detyrimin të argumentojë karakterin antikushtetues të vendimit, ndërsa pala e interesuar ka detyrimin të përcaktojë veprimet ose mosveprimet që përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe ligjeve.⁴¹⁰

Në këtë vështrim, Gjykata mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që në parim u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor.⁴¹¹ Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Individi ka detyrimin të provojë se në ç'mënyrë ai është prekur në të drejtat e tij kushtetuese si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Interesi i tij për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak, dhe ai duhet të konsistojë tek e drejta e shkelur dhe tek dëmi real i shkaktuar.⁴¹² Detyra e kësaj Gjykate nuk është zgjidhja e një çështjeje konkrete, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj.⁴¹³

⁴⁰⁷Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 131.

⁴⁰⁸Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 15, datë 15.04.2010.

⁴⁰⁹Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 20, datë 04.05.2007.

⁴¹⁰Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 29, datë 27.06.2013, fq.7.

⁴¹¹Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 84, datë 30.12.2016, fq.5.

⁴¹²Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 12, datë 10.03.2016, fq.4.

⁴¹³Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 84, datë 30.12.2016, fq.5.

Po e ilustrime me një rast, çështjen e konstatimit të cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Objekt shqyrtimi është shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 666, datë 6.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 6, datë 9.1.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2016-13, datë 14.1.2016 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit, pasi nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij që lidhen me shkelje të ligjit dhe të të drejtave të tij kushtetuese.⁴¹⁴ Kërkuesi pretendon se gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit prej gjykatës ku ai është depozituar. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se në Gjykatën e Apelit Shkodër çështja ka qëndruar pa u gjykuar 2 vjet e 5 muaj. Gjykata, në Vendimin Nr. 26, datë 27.3.2017 vlerëson se, në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e

⁴¹⁴ Kërkuesi pretendon se nuk u është dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në recurs lidhur me proporcionalitetin e masës disiplinore; arsyetimet e vendimeve të dy gjykatave të faktit nuk mbështeten nga provat e administruara në gjykim; urdhri është nxjerrë pa asnjë motiv ligjor; raporti ku mbështetet urdhri është i sajuar; shkelja e pretenduar nuk mund të konsiderohet shkelje e rëndë; kërkuesit nuk i është komunikuar zyrtarisht masa disiplinore. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, sepse vendimi i mospranimit të rekursit nuk përmbush as kërkesat për një arsyetim minimal.

autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit.⁴¹⁵

Gjykata Kushtetuese vendosi konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm.⁴¹⁶

Sipas Vladimir Kristo, ish-Kryetar i GjK shqiptare “në përputhje me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese ka vetëm kompetencën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, pra, ajo vepron si ligjvënës negativ. Kjo do të thotë, se u takon organeve shtetërore përkatëse të plotësojnë boshllëkun ligjor që krijohet nga ky shfuqizim.⁴¹⁷ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore.⁴¹⁸

Në Republikën e Maqedonisë, Gjykata Kushtetuese është organi i cili mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.⁴¹⁹ Në kuadër të kompetencave të saj, sipas Nenit 110, Gjykata Kushtetuese vendos: për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën; për përputhshmërinë e rregullave të tjera dhe të marrëveshjeve kolektive me Kushtetutën dhe me ligjet; Gjykata mbron liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit, që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike; vendos për konfliktin e kompetencave midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor; për konfliktin e kompetencave midis

⁴¹⁵ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë Vendimin Nr. 26, datë 27.3.2017 Fq.5

⁴¹⁶ Vendimi Nr. 26, datë 27.3.2017, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë fq.7.

⁴¹⁷ Kristo, Vladimir “Kontrolli kushtetues i pajtueshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet e KEDNJ”, fq.11, në konferencën me temë: Përmirësimi i cilësisë së zbatimit të KEDNJ nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase 26-27 shtator 2007 të organizuar Ministria e Punëve të Jashtme Këshilli i Europës shih : http://www.gjk.gov.al/web/tema_e_kryetarit_71.pdf.

⁴¹⁸ Ligj Nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, neni 81 parashikon se “Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv”.

⁴¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 108.

organeve të Republikës dhe njërive të vetadministrimit lokal; vendos për përgjegjësinë e Presidentit të Republikës; për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave civile, si dhe vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.⁴²⁰ Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente të vlerësojë kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese dhe të traktateve ndërkombëtare të ratfikuar në pajtim me Kushtetutën. Traktatet ndërkombëtare kanë prioritet në krahasim me të drejten e brendshme të Republikës së Maqedonisë.⁴²¹ Gjykata Kushtetuese do të abrogojë ose shfuqizojë ligjin nëse konstaton se nuk është në përputhje me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese do të abrogojë ose shfuqizojë një rregull tjetër ose akt të përgjithshëm, marrëveshje kolektive, statut apo program të partisë politike ose të shoqatës, nëse konstaton se ato nuk janë në përputhje me Kushtetutën ose me ligjin. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme.⁴²²

Në Republikën e Serbisë, Gjykata Kushtetuese është autoritet shtetëror i pavarur dhe i pavarur në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të drejtave të njeriut dhe lirive të pakicave, dhe vendimet e saj janë përfundimtare, të zbatueshme dhe në përgjithësi të detyrueshme.⁴²³

Toader & Safta theksojnë se “Gjykata Kushtetuese e Serbisë është kompetente për rishikimin e një grupi të madh të akteve, të lëshuara nga autoritetet e ndryshme dhe personat juridikë. Karakteristikë është konkretisht më shumë natyra e tyre e përgjithshme. Kështu, ajo është kompetente të shyrtojë ligjet dhe aktet e tjera të përgjithshme të Kuvendit, Presidentit ose Qeverisë, aktet e përgjithshme të autoriteteve të tjera dhe organeve shtetërore, statutet dhe aktet e tjera të përgjithshme të autoriteteve nga krahina autonome, statutet dhe aktet e tjera të përgjithshme të subjekteve vetëqeverisëse lokale, aktet e përgjithshme të partive politike, sindikatave dhe shoqatave të qytetarëve, aktet e përgjithshme të organizatave që ushtrojnë funksionet publike, statute dhe aktet e tjera të

⁴²⁰Po aty, shih nenin 108, 109 dhe nenin 110.

⁴²¹ Maksuti Mersim, E drejta kushtetuese, Universiteti AAB Rinvest, Prishtinë, 2012, fq. 269.

⁴²² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 112.

⁴²³ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 166, Official Gazette of RS, No. 98/06.

përgjithshme të kompanive dhe institucioneve, aktet e përgjithshme të dhomave dhe shoqatave të tjera, aktet e përgjithshme të fondeve dhe shoqatave të tjera, si dhe marrëveshjet kolektive”⁴²⁴. Kuvendi merr parasysh informacionin e dhënë nga Gjykata Kushtetuese për gjendjen dhe problemet në vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, mendimet dhe treguesit e Gjykatës Kushtetuese mbi nevojën për të miratuar dhe ndryshuar ligje dhe merr masa të tjera për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.⁴²⁵ Iniciativën për të nisur procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë, mund ta fillojnë organet shtetërore, organet e autonomisë territoriale apo vetëqeverisjes lokale, si dhe të paktën 25 deputetë. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për një nismë të institutit të vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së një akti. Procedura mund të fillojë nga vetë Gjykata Kushtetuese.⁴²⁶ Në Serbi, ashtu si në shumicën e shteteve, Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Kushtetutën, ka juridiksioni për të zgjidhur mosmarrëveshje të natyrës kushtetuese. Gjykata Kushtetuese është e autorizuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet e juridiksionit. Ato mund të jenë pozitive apo negative, dhe mund të shihen si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht.⁴²⁷

Në Republikën e Malit të Zi, Gjykata Kushtetuese vendos për të gjitha format e shkeljeve të Kushtetutës që janë shkaktuar apo kanë ndodhur nga një ligj antikushtetues, rregullore apo akt tjetër i përgjithshëm ose akt individual.⁴²⁸ Sipas nenit 149 të kushtetutës të Malit të Zi parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos:

a) mbi përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe kontratat ndërkombëtare të ratifikuara dhe publikuara edhe mbi përputhshmërinë e akteve të tjera dhe akteve të përgjithshme me Kushtetutën dhe ligjin;

⁴²⁴Toader, Tudorel & Marieta Safta, The Constitutional Court’s Relationship to Parliament and Government, Fq. 20, shih http://www.riigikohus.ee/vfs/1214/Bukaresti%20kongressi%20raport_ingl.pdf.

⁴²⁵ Rules of Procedure of the National Assembly of Serbia, neni 282.

⁴²⁶ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 168.

⁴²⁷Lulia Antoanella Motoc, Ioana Marilena Chiorean & Cristina Cătălina Turcu, Resolution of Organic Litigations by the Constitutional Court, Bulletin of The Venice Commission, October 2009 for the XVth Congress of the CECC, Bucharest, fq. 28.

⁴²⁸The Venice Commission, General Report of the XVth Congress of the Conference of European Constitutional Courts on Relations of the Constitutional Court with other state authorities, Strasbourg, July 2012, fq. 13.

b) për ankesën kushtetuese për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike efektive, se a e ka shkelur Kushtetutën Presidenti i Malit të Zi;

c) për konfliktin e kompetencave ndërmjet gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore, në mes të organeve shtetërore dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe në mes të organeve të vetëqeverisjes lokale;

ç) mbi ndalimin e punës së një partie politike ose një organizate joqeveritare gjithashtu, për mosmarrëveshjet elektorale dhe mosmarrëveshjet lidhur me referendumin, të cilat nuk janë në kompetencë të gjykatave të tjera;

d) mbi përputhshmërinë me Kushtetutën të masave dhe veprimeve të organeve shtetërore të ndërmarra gjatë kohës së gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme.

Gjykata Kushtetuese kryen edhe funksione të tjera të përcaktuara me Kushtetutë. Nëse gjatë procedurës për vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë, dispozita ka pushuar së qeni në fuqi, dhe nuk janë mënjanuar pasojat e zbatimit të saj, Gjykata Kushtetuese përcakton se a ka qenë kjo dispozitë në përputhje me Kushtetutën, gjegjësisht me ligjin gjatë kohës që ka qenë në fuqi. Gjykata Kushtetuese garanton realizimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe njofton Kuvendin për dukuritë e vëna re të antikushtetutshmërisë dhe paligjshmërisë.⁴²⁹ Sipas nenit 150 të kushtetutës parashikon se çdokush mund të marrë iniciativën për të nisur procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Procedurën para Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë mund ta fillojë Gjykata, një organ tjetër shtetëror, organi i vetëqeverisjes lokale si dhe pesë deputetë. Gjykata Kushtetuese mund edhe vetë të fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Gjatë procedurës, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që të ndalohet ekzekutimi i një akti ose veprimi të veçantë, të cilët janë marrë në bazë të ligjit, një dispozite tjetër ose akti të përgjithshëm, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e të cilëve vlerësohet, nëse me ekzekutimin e tyre do të mund të vijë deri tek pasojat e dëmshme të pariparueshme.⁴³⁰

⁴²⁹ Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, neni 149.

⁴³⁰ Po aty, shih nenin 150.

Në Malin e Zi sikurse edhe në shumicën e vendeve, njësia ekonomike ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të zgjidhur një mosmarrëveshje institucionale, që mund të jetë çdo palë në mosmarrëveshje.⁴³¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm dhe ekzekutiv. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, kur kjo është e nevojshme, e siguron Qeveria.⁴³² Kur Gjykata Kushtetuese konstaton së ligji nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara, gjegjësisht që dispozita tjetër nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, ky ligj ose dispozitë tjetër pushon së qeni në fuqi me ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ligji ose dispozita, të veçanta të tyre, për të cilat, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, është përcaktuar se nuk janë në përputhje me Kushtetutën ose ligjin, nuk mund të zbatohen në raportet që kanë dalë para publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nëse deri në këtë ditë nuk janë zgjedhur në mënyrë të plotfuqishme.⁴³³

4.5. Kontrolli i administratës publike nga Avokati i Popullit në shtetet e rajonit

Në Republikën e Shqipërisë, Avokati i Popullit është një Institucion i Pavarur nga organet e administratës publike, përfshirë dhe ato gjyqësore, që financohet nga Buxheti i Shtetit.⁴³⁴

Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme ose të parregullta të organeve të administratës publike,⁴³⁵ jo vetëm të shtetasve shqiptarë, por dhe të huajve që janë

⁴³¹ Lulia Antoanella Motoc, Ioana Marilena Chiorean, Cristina Cătălina Turcu, Resolution of Organic Litigations by the Constitutional Court, The Bulletin of The Venice Commission, October 2009, for the XVth Congress of the CECC, Bucharest, fq.33.

⁴³² Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, neni 151.

⁴³³ Po aty, neni 152.

⁴³⁴ Avokati i Popullit në Shqipëri, Raporti vjetore për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, Botimi i dytë, Tiranë 2003, fq.11. Shih: <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/AP.pdf>.

⁴³⁵ Ligji për Avokatin e Popullit, Nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398. datë 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr.155/2014, datë 27.11.2014, neni 2.

ose jo banues të përhershëm në Shqipëri, duke dhënë rekomandime, bërë kërkesa apo propozime për vënien në vend të së drejtës së shkelur.⁴³⁶

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij.⁴³⁷ Avokati i Popullit është një institucion jogjyqësor, është një mjet i veçantë në llojin e tij, që i ndihmon qytetarët, kur këta ndeshin vështirësi dhe ankohen për administratën publike në shtetin e tyre.⁴³⁸

Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, dhe ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje.⁴³⁹

Institucioni i Avokatit të Popullit tashmë është pjesë e atij mekanizmi të kontrollit dhe balancës së pushtetit, i cili, duke qenë pjesë e pushtetit publik, pengon eksceset e këtij pushteti, madje u mëson autoriteteve parimet e mirësjelljes administrative. Ky institucion punon në funksion të realizimit të asaj që quhet “drejtësi e butë”. Ai është shumë më pak formal se gjykatat, por lehtësisht i arritshëm për të gjithë qytetarët.⁴⁴⁰ Avokati i Popullit zgjidhet nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje. Avokati i Popullit gëzon imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Avokati i Popullit nuk mund të bëjë pjesë në asnjë parti politike, nuk mund të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale dhe as të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare.⁴⁴¹

Detyra e Avokatit të Popullit është të shqyrtojë ankesat që rrjedhin nga veprimtaria e administratës publike. Nëpërmjet rekomandimeve, kërkesave apo propozimeve të tij, ai synon të sjellë përmirësime në standartet dhe cilësinë e shërbimeve si dhe të

⁴³⁶ Avokati i Popullit në Shqipëri, Raporti vjetor për veprimtari e Avokatit të Popullit, Botimi i dytë, Tiranë 2003 Fq.11 shih: <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/AP.pdf>.

⁴³⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 60.

⁴³⁸ Avokati i Popullit Raport Vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2005,

Tiranë 2006, fq. 8.

⁴³⁹ Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398. datë 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr.155/2014, datë 27.11.2014, neni 2.

⁴⁴⁰ Avokati i Popullit, Raport Vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor, Viti 2005, Tiranë 2006, fq. 10.

⁴⁴¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 61.

promovojë ndershmërinë në administratën publike. Synimi i tij është që individët të realizojnë të drejtat dhe liritë e tyre, pa qenë nevoja që çështja e tyre të shkojë e të zgjidhet në rrugë gjyqësore.⁴⁴² Në nenin 25 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, pas ndryshimeve, thuhet shprehimisht se: Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve. Ndryshimi u bë vetëm për faktin që Avokati i Popullit të mund të pranojë ankesa edhe për vendimet e formës së prerë, sepse për të drejtat e tjera të Avokatit të Popullit, kjo dispozitë nuk ka ndryshuar.⁴⁴³

Pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim, Avokati i Popullit kryen njërën nga veprimet e mëposhtme: a. ndërmerr vetë një proces hetimi; b. kërkon shpjegime nga organet e administratës, si dhe prokuroria, në rastet e arrestimeve dhe ndalimeve; c. i rekomandon Kontrollit të Lartë të Shtetit të ushtrojë funksionet e veta.⁴⁴⁴

Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: a. të kryejë hetime në vend; b. të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin; c. të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim; ç. të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.⁴⁴⁵ Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të

⁴⁴² Avokati i Popullit në Shqipëri, Raporti vjetore për veprimtari e Avokatit të Popullit, Botimi i dytë, Tiranë 2003 Fq.12 shih: <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/AP.pdf>.

⁴⁴³ Dobjani, Ermir. Rekomandime për të bërë të mundur realizimin e detyrës së Avokatit të Popullit për ankesat kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke bërë plotësimet e duhura në Kodin e Procedurës Penale dhe Civile, bazuar edhe në Rekomandimet e Këshillit të Europës, Nr. 213 Prot. Tiranë, më 02/10/2008 shih: http://www.avokatipopullit.gov.al/rekomandime_AV_Popullit/Rek1%2002102008.htm.

⁴⁴⁴ Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398. datë 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr.155/2014, datë 27.11.2014 Neni 18.

⁴⁴⁵ Po aty, shih nenin 19.

klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror.⁴⁴⁶

Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime: a. i shpjegon ankuesit se të drejtat e tij nuk janë shkelur; b. paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; c. paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen; ç. i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale; d. për shkelje të rënda, të vëna re, i propozon çdo organi, si dhe Kuvendit, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre; dh. për shkelje të të drejtave nga organet e pushtetit gjyqësor, pa ndërhyrë në procedurën që ato zbatojnë, Avokati i Popullit i bën të ditur shkeljet organit kompetent; e. u rekomandon personave të dëmtuar të paraqesin padi në gjykatë; por duke pasur parasysh se rastet e mësipërme nuk përjashtojnë njëri-tjetrin.⁴⁴⁷

Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre është shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë: a. t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve; b. t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; c. t'i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla.⁴⁴⁸

Roli i Avokatit të Popullit nuk kufizohet thjesht tek mbrojtja e të drejtave të qytetarëve në raport me padrejtësitë dhe abuzimet e administratës ose të nëpunësit publik. Përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga objektivat e tij kryesore është të zhvillojë atë që quhet kultura e qeverisjes së mirë. Kjo do të thotë

⁴⁴⁶ Po aty, shih nenin 20.

⁴⁴⁷ Po aty, shih nenin 21.

⁴⁴⁸ Neni 24 i Ligjit për Avokatin e Popullit, Nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398. datë 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr.155/2014, datë 27.11.2014.

administrim i mirë, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike para njerëzve që paguajnë taksa për ta mbajtur atë.⁴⁴⁹

Në Republikën e Maqedonisë, Avokati i Popullit ose Ombudsmani është organ specifik, i veçantë, profesional dhe i pavarur, me status special për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, që dmth se nuk është trup ligjvënës, pushtet ekzekutiv ose gjyqësor, dhe më pak prokuror ose organ inspektues dhe mbikqyrës.⁴⁵⁰

Avokati i Popullit është kompetent të ndërmarrë veprime për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore kur janë shkelur nga administrata shtetërore apo organet e tjera të cilat kanë autorizime publike [Maksuti, 2012:278]. Avokati i Popullit është përfaqësues parlamentar i autorizuar për të proceduar petitionet e qytetarëve dhe gjithashtu për të filluar një procedurë me iniciativë të vet, sa herë që ai vëren aktivitete të paligjshme ose të papërshtatshme të administratës publike, të cilat janë duke shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.⁴⁵¹ Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Avokati i Popullit mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të shtetasve të cilat u janë shkelur nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat e tjera që kanë autorizime publike. Avokati i Popullit i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së parimeve të mosdiskriminimit, të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të komuniteteve në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe në institucionet dhe shërbimet publike.⁴⁵² Avokati i

⁴⁴⁹ Avokati i Popullit, Raport Vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor, Viti 2005, Tiranë 2006, fq. 9.

⁴⁵⁰ Avokati i Popullit në Republikën e Maqedonisë, shih:

http://ombudsman.mk/SO/p%C3%ABr_avokatin_e_popullit/p%C3%ABr_institucionin.aspx.

⁴⁵¹ Ana Pavlovska-Daneva, Report Alternatives to litigation between administrative authorities and citizens:

Macedonian experience, Trieste, Italy 14 – 18 March 2005, Fq. 3 me gjereisht shiko ne web faqe : [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-UDT\(2005\)017-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-UDT(2005)017-e).

⁴⁵² Amendamenti XI pikat 1 dhe 2 I Kushtetutes se Republikës së Maqedonisë (Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 77, ndërsa me pikën 2 plotësohet paragrafi 2 i nenit 77 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.) Numër 07-3795/1 16 nëntor 2001

Popullit zgjidhet për një mandat prej tetë vjetësh, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.⁴⁵³

Avokati i Popullit është i pavarur dhe i mëvetësishëm në kryerejen e funksionit. Avokati i Popullit kryen funksionet në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, në pajtim me Kushtetutën. Në procedurë, Avokati i Popullit mund të thirret edhe në parimin e drejtësisë.⁴⁵⁴ Në Maqedoni, renditja e Avokatit të Popullit është në të njëjtin nivel me atë të një ministri, Kryetari të Gjykatës së Lartë, Prokurorit Publik, një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese dhe Guvernatorit të Bankës Kombëtare.⁴⁵⁵ Roli i Avokatit të Popullit është i dyfishtë, nga njëra anë, ai punon në zgjidhjen e ankesave të qytetarëve, dhe nga ana tjetër, në drejtim të përmirësimit të administratës publike.⁴⁵⁶

Në Republikën e Serbisë, Avokati i Popullit është organ i pavarur shtetëror i cili mbron të drejtat e qytetarëve dhe është organi përgjegjës për mbrojtjen ligjore të të drejtave dhe interesave të Republikës së Serbisë, si dhe monitoron punën e organeve të administratës publike, si dhe të organizatave të tjera, kompanive dhe institucioneve të cilat e kanë fuqinë publike të deleguar. Avokati i Popullit nuk është i autorizuar për të monitoruar punën e Kuvendit, Presidentit të Republikës, Qeverisë, Gjykatës Kushtetuese, gjykatave dhe prokurorive publike.⁴⁵⁷

Avokati i Popullit ka kompetenca për të kontrolluar respektimin e të drejtave të qytetarëve, për shkeljet që rezultojnë nga aktet, veprimet apo mosveprimet nga ana e autoriteteve administrative, në qoftë se ato janë shkelje të ligjeve, rregulloreve dhe

⁴⁵³ Neni 77 I Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Numër 08-4642/1, 17 nëntor 1991, Shkup

⁴⁵⁴ Neni 3, Ligji për Avokatin e Popullit të Maqedonisë

⁴⁵⁵ CDL (2011) 079 mendime dhe studime dhe raporte për hartimin e Insitucionit të Avokatit të Popullit të miratura nga Komisioni I Vencias neSesionin Plenare 87-te (17- 18 Qeshor) opinions and reports/studies adopted up to and including the Venice Commission's 87th Plenary Session (17- 18 June 2011 me gjerësisht shiko ne web faqe www.venice.coe.int Fq. 9 shkarkuar me 25 Maj 2015

⁴⁵⁶ Ana Pavlovska-Daneva, Report Alternatives to litigation between administrative authorities and citizens:

Macedonian experience, Trieste, Italy 14 – 18 March 2005, Fq.3 me gjerësisht shiko ne web faqe: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-UDT\(2005\)017-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-UDT(2005)017-e).

⁴⁵⁷ Kushtetuta e Republikës së Serbisë neni 138 e miratuar më 30 shtator 2006 , Official Gazette of RS No 98/06.

akteve të tjera të përgjithshme të Republikës. Avokati i Popullit ka kompetenca për të kontrolluar ligjshmërinë dhe rregullsinë e punës së autoriteteve administrative.⁴⁵⁸

Avokati i Popullit u prezantua zyrtarisht në sistemin juridik të Serbisë në vitin 2005, ndërsa Avokati i Popullit i pari, u emërua në korrik të vitit 2007. Avokati i Popullit serb ka një mandat parlamentar për qëllimin e përgjithshëm të mbrojtjes së të drejtave civile.⁴⁵⁹ Pozita e këtij institucioni u përforcua me Kushtetutën e Republikës së Serbisë të vitit 2006, e cila e bëri Avokatin e Popullit kategori kushtetuese, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.⁴⁶⁰

Avokati i Popullit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Avokati i Popullit jep llogari për punën e tij/saj në Kuvend. Avokati i Popullit gëzon imunitet si deputet. Kuvendi vendos për imunitetin e Avokatit të Popullit.⁴⁶¹ Avokati i Popullit emërohet për një periudhë prej pesë vjetësh dhe mund të ri-emërohet.⁴⁶²

Avokati i Popullit është i autorizuar të ketë qasje të pakufizuar në zyrat e autoriteteve publike dhe për të hyrë në çdo të dhënë që mund të jetë relevante për procedurën e kryer nga Avokati i Popullit, pa marrë parasysh nivelin e klasifikimit të informacionit; të ketë qasje të pakufizuar në institucionet për zbatimin e sanksioneve dhe vende të tjera, ku mbahen personat e privuar nga liria. Avokati i Popullit ka kompetenca për të rekomanduar publikisht shkarkimin e një zyrtari, i cili është përgjegjës për shkeljen e të drejtës së qytetarëve, gjegjësisht për fillimin e procedurës disiplinore kundër një punonjësi të autoriteteve administrative, i cili është përgjegjës për shkeljen.⁴⁶³

⁴⁵⁸Law on the Protector of Citizens neni 17 The Law was published in the “Official Gazette of the Republic of Serbia”, no. 79/2005 and 54/2007.

⁴⁵⁹ Kešetović, Želimir. The Role and Impact of Ombudsman in the Field of Ecology - Case of Serbia, fq.1 shih: http://www.fvv.um.si/nato_arw/documents/NATO%20ARW_Abstract_Kesetovic.pdf.

⁴⁶⁰Protector of Citizens, Regular Annual Report of the Protector of citizens for 2014, Ref. No. 7919, Belgrade, 14 March 2015, Fq. 25

⁴⁶¹Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 138.

⁴⁶²Venice Commission, (2004), European Commission for democracy through law, Draft law on the Ombudsman of Serbia neni 3, CDL(2004)113, Strasbourg, 17 November 2004.

⁴⁶³Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 138, neni 20.

Avokati i Popullit është i autorizuar për fillimin e procedurës para Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera të përgjithshme.⁴⁶⁴ Nëse zbulon se aktivitetet e një zyrtari ose një punonjësi të autoriteteve administrative përmbajnë elementë të veprës penale apo të tjera të dënueshme, Avokati i Popullit ka kompetenca për të paraqitur kërkesë, pra të paraqesë një mocion për të iniciuar procedimin penal, kundërvajtjese ose procedura të tjera të përshtatshme.⁴⁶⁵

Në Republikën e Malit të Zi, Mbrojtësi i të drejtave dhe lirive të njeriut (Avokati i Popullit) në mënyrë sovrane dhe të pavarur, sipas parimeve të drejtësisë dhe paanësisë, ndërmerri masat për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, kur janë të cenuara me akte, veprime ose mosveprime të organeve shtetërore, organeve të administratës shtetërore të qeverisjes lokale, shërbimeve publike dhe bartësve të tjerë më kompetenca publike, si dhe masat për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të trajtimit çnjerëzor apo poshtërues si dhe penalizimit dhe masat për mbrojtjen nga diskriminimi.⁴⁶⁶ Krahas këtij funksioni, Avokati i Popullit ka dhe një mision më të gjërë, krijimin e vetëdijes për nevojën e pushtetit ligjor, për mbrojtjen e plotë e konsekuente të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, dhe në përgjithësi, për krijimin e sigurimit juridik të qytetarëve, të punës ligjore të paanshme dhe objektive të të gjitha organeve shtetërore. Avokati i Popullit kryen funksionin e vetë në bazë të Kushtetutës e ligjit dhe në punën e vet i përmbahet parimeve të drejtësisë dhe saktësisë.⁴⁶⁷ Procedurën e hetimit të shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut e fillon me rastin e ankesës ose me iniciativën e vet. Avokati i Popullit heton shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut me iniciativë të vet kur kupton se me një akt, veprim ose mosveprim të organit janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut. Për procedurën me iniciativë të vet, është i domosdoshëm pëlqimi i/e të dëmtuarit/-ës.⁴⁶⁸ Procedura para Avokatit të Popullit është konfidenciale. Personi i cili paraqet

⁴⁶⁴ Po aty, neni 19.

⁴⁶⁵ Po aty, shih nenin 21.

⁴⁶⁶ Law on the Protector of Human Rights and Freedoms of Montenegro, neni 2.

⁴⁶⁷ Ombudsmani në Republikën e Malit të Zi, shikoni në web faqe:

<http://www.ombudsman.co.me/alb/index.htm>, shkarkuar me date 20 Maj 2015

⁴⁶⁸ Ligji për Mbrojtësin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Mal të Zi, neni 28.

ankesën ose merr pjesë në procedurë nuk mund të thirret në përgjegjësi, e as të vendoset në një pozitë të pavolitshme.⁴⁶⁹ Avokati i Popullit nuk ka kompetenca të përzihet, të shfuqizojë ose anulojë aktet e organit.⁴⁷⁰ Pas përfundimit të hulumtimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, Avokati i Popullit jep mendimin se a janë shkelur, në cilën mënyrë dhe në cilën masë janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut. Kur Avokati i Popullit konstaton se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, mendimi i tij përmban edhe rekomandimin për atë se çka duhet ndërmarrë për të mënjeluar shkeljen, si dhe afatin për mënjanimin e saj.⁴⁷¹ Kryesuesi/-ja, i/e cili drejton organin me të cilin ka të bëjë rekomandimi, është i detyruar që në afatin e përcaktuar, ta dorëzojë raportin mbi masat që janë marrë për përmbushjen e rekomandimit. Nëse kryesuesi/-ja, i/e cili drejton organin nuk vepron sipas rekomandimit brenda afatit të përcaktuar, Avokati i Popullit mund ta njoftojë drejtpërdrejt organin më të lartë, të parashtojë raport të veçantë ose ta njoftojë opinionin.⁴⁷²

4.6. Kontrolli i administratës publike nga Insitucioni i Lartë i Auditimit në shtetet e rajonit

Në Republikën e Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Në krye të këtij insitucioni është Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për shtatë vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.⁴⁷³ Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon:

⁴⁶⁹ Po aty, neni 29.

⁴⁷⁰ Po aty, neni 22.

⁴⁷¹ Po aty, neni 41.

⁴⁷² Ligji për Mbrojtësin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Mal të Zi, neni 42.

⁴⁷³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 162.

a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë;

b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;

c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.⁴⁷⁴

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualet në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Auditimi mbulon fushat e përputhshmërisë, ligjshmërisë, rregullshmërisë, menaxhimit financiar, kontabilitetit, si dhe ekonomicitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore.⁴⁷⁵ B. Leskaj thekson se “Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni suprem i auditimit, mbështetur edhe në Kushtetutën e vendit dhe në ligjet në fuqi, duhet të evidentojë dëmin ekonomik, të evidentojë shkeljet, parregullsitë gjatë ushtrimit të detyrës në administratën publike, në institucionet e ndryshme shtetërore të pushtetit qendror dhe vendor, si dhe të japë rekomandimet përkatëse.⁴⁷⁶

Kontrolli financiar ndihmon në procesin llogaridhënës të Qeverisë, duke hartuar raporte të pavarura mbi saktësinë, rregullshmërinë dhe besueshmërinë e treguesve financiarë të subjektit, mbi kontrollin e brendshëm dhe përputhjen me dispozitat ligjore. Gjithashtu, kontrolli i drejtimit (performancës), ndihmon në procesin e llogaridhënies, në përdorimin e fondeve publike dhe kryerjen e shërbimeve ndaj taksapaguesve.⁴⁷⁷ Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit: a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit; b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi; c)

⁴⁷⁴ Po aty, shih nenin 163.

⁴⁷⁵ Ligj Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 6.

⁴⁷⁶ Kuvendi, Procesverbali i Komisionit për Ekonominë dhe Financat Tiranë, më 28.06.2016, ora 10:00 – 11:44, fq. 22.

⁴⁷⁷ Kontrolli i Lartë i Shtetit, Standardet e Kontrollit të KLSH-së, dhjetor 2005, fq.6.

informacion për rezultatet e kontrolleve, sa herë që kërkohet nga Kuvendi. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.⁴⁷⁸

Kontrolli i jashtëm që kryhet nga KLSH-ja, mund të përshkruhet si një “ekzaminim i pavarur dhe raportim publik i transaksioneve, treguesve, operacioneve financiare dhe të tjera veprimtari të ekzekutivit, nga kontrollorët që veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore”.⁴⁷⁹ Për shembull, KLSH-ja gjatë vitit 2015: ka ushtruar veprimtarinë audituese në 211 insitucione, sipas niveleve të administrimit shtetëror, administratës fiskale dhe shoqërive me kapital shtetëror si dhe ka zbuluar një shumë totale të dëmit efektiv të përgjithshëm për parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhura dhe në shpenzimet e kryera në vlerën prej 125,8 miliardë lekë ose 919,9 milionë euro. Këto shkelje financiare i përkasin veprimtarisë ekonomike-financiare për periudhën kohore 2008-2015.⁴⁸⁰ Dëmi ekonomik i zbuluar për periudhën 2012-2015 është 8 herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar për periudhën 2008-2011. KLSH-ja ka rekomanduar për zhdëmtim 46.7 për qind të totalit të shkelejeve financiare.⁴⁸¹ KLSH-ja, nga shkeljet ligjore dhe abuzimet e konstatuara në auditimet për vitin 2015, ka dërguar në prokurori 51 kallëzime penale, përgjatë katër viteve 2008-2011, dhe 159 drejtues të nivelit të mesëm dhe të lartë.⁴⁸² Krahasuar me periudhën katërvjeçare 2008-2011, kallëzimet penale të katër viteve 2012-2015 janë 170, ose 3.2 herë më shumë.⁴⁸³ KLSH ka ngritur një sistem efektiv të kontrollit të integritetit dhe një infrastrukturë etike efektive dhe që kontribuon duke udhëhequr sipas shembullit në promovimin e integritetit në sektorin publik dhe rrjedhimisht për

⁴⁷⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 164.

⁴⁷⁹ Kontrolli i Lartë i Shtetit Standardet e Kontrollit të KLSH-së, dhjetor 2005, fq.4.

⁴⁸⁰ Kuvendi i Shqipërisë Rezolute për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015, fq.2. Shih : http://www.klsh.org.al/web/rezoluta_2015_2647.pdf.

⁴⁸¹ Kuvendi, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Procesverbal Raporti i performancës së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015 Tiranë, më 28.06.2016, ora 10:00 – 11: 44, Bujar Leskaj, fq. 4.

⁴⁸² Po aty, shih Bujar Leskaj , fq.7.

⁴⁸³ Leskaj, Bujar. Gjetjet e KLSH-së për vitin 2015 analizuar mbi bazën e Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit fq. 5 shih: http://www.klsh.org.al/web/fjala_kryetarit_2625.pdf.

një qeverisje të mirë.⁴⁸⁴ Nëpunësit Civilë veprojnë me integritet nëse zbatojnë vlerat dhe standardet e një administrimi të mirë. Integriteti mbulon jo vetëm kërkesat e mos korrupsionit, por gjithashtu mbulon vlera si: ndërshtëmëria, sinqeriteti, shoqërueshmëria, neutraliteti, konsiderata, besueshmëria, fokusi tek klienti, respekti, objektiviteti dhe mirësjellja. Një nëpunës civil duhet të kujdeset që të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj dhe të përdorë fuqinë, informacionin dhe burimet në dispozicion në të mirë të publikut ose të interesit të përgjithshëm, të cilit i shërben, si dhe të silllet në mënyrë korrekte me kolegët e tij dhe me publikun.⁴⁸⁵

Në Republikën e Maqedonisë, Zyra Shtetërore e Auditimit (ZSHA) është një institucion suprem i auditimit, qëllimi i së cilës është që objektivisht dhe në kohë të informojë Parlamentin, Qeverinë dhe bartësit e tjerë të Zyrës publike për gjetjet e auditimeve që ata kryejnë. Enti Shtetëror për Revizion mbështet Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në kryerjen e kompetencave të tij, duke identifikuar dhe ekspozuar parregullsi, rastet e sjelljes të paligjshme dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës. Enti Shtetëror për Revizion jep rekomandime të qarta dhe efektive, duke mbështetur një menaxhim më të mirë të institucioneve shtetërore dhe përdoruesit e fondeve publike.⁴⁸⁶ Enti shtetëror për Revizion ka për detyrë auditimin shtetëror dhe është një autoritet shtetëror i Republikës së Maqedonisë.⁴⁸⁷ Enti Shtetëror për Revizion udhëhiqet nga Auditori i Përgjithshëm i Shtetit. Mandati i Auditorit të Përgjithshëm të Shtetit dhe zëvendësi i tij/saj është nëntë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Auditori i Përgjithshëm Shtetëror dhe zëvendësi i tij/saj betohet përpara Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.⁴⁸⁸ Auditori i Përgjithshëm Shtetëror dhe zëvendësi i tij/saj nuk do të jenë penalisht

⁴⁸⁴ Nano, Luljeta & Irena Islami, Forcimi i infrastruktures etike në Institucionet Supreme të Auditimit, tendencë e kohës, KLSH Auditimi Publik Revistë katërmujore kërkimore-shkencore-informative shqip - anglisht Nr. 16/2017, Tiranë, fq.93.

⁴⁸⁵ Po aty, shih fa. 94.

⁴⁸⁶ State Audit Office Audit Reports, publikuar me 10/9/2014, fq. 4.

Shiko ne web faqe:
http://www.dzr.mk/en/Uploads/PRIRACNIK_Voved_revizorski_izvestai_ENG.pdf.

⁴⁸⁷ Ligji Nr 07-2001/1 për Auditim të Shtetit neni 3 Official Gazette of RM, no. 66, from 13 May 2010.

⁴⁸⁸ Neni 4 Ligji Nr. 07-2001/1 për Auditim të Shtetit Official Gazette of RM, no. 66, from 13 May 2010.

përgjegjës ose nuk do të ndalohen për pikëpamjet e deklaruara, opinionet dhe rekomandimet në lidhje me auditimet.⁴⁸⁹ Auditimi i Shtetit do të kryhet në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, Presidentin e Republikës së Maqedonisë, Buxhetin e Republikës e Maqedonisë dhe buxhetet e komunave, përdoruesit dhe njësitë e shfrytëzuesve të fondeve buxhetore; ndërmarrjet publike, shoqërite tregtare, ku shteti është aksionar dominant, agjencitë dhe institucionet e tjera të përcaktuara me ligj, institucione të tjera financuara nga fondet publike, Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë, partitë politike që financohen nga fondet buxhetore, përfituesit e fondeve të BE-së dhe përfituesit e fondeve nga institucionet e tjera ndërkombëtare.⁴⁹⁰ Auditimi i shtetit përfshin procedurën e shqyrtimit financiar si dhe transaksionet e shpenzimeve qeveritare, në aspektin ligjor dhe shpenzime të autorizuara.⁴⁹¹

Në Republikën e Serbisë, Institucioni i Kontrollit Shtetëror është organi më i lartë shtetëror për auditimin e financave publike, është organ i pavarur, i cili i nënshtrohet mbikëqyrjes së Kuvendit dhe është përgjegjës për punën e tij.⁴⁹² Institucioni i Auditimit Shtetëror është institucioni kryesor në sistemin e llogaridhënies financiare në vend. Ai kontribuon në një menaxhim të qëndrueshëm financiar, në rritje të përgjegjshmërisë së përgjithshme të të gjithë përfituesve të fondeve publike, si dhe lufton kundër korrupsionit.

Institucioni punon në interesin e tatimpaguesve, si dhe ndihmon që fondet publike të shpenzohen me përgjegjësi dhe në mënyrë transparente. Ai ndikon në rritjen e besimit të qytetarëve dhe informon Kuvendin Kombëtar dhe qytetarët për paratë e taksapaguesve, se si po shpenzohen në mënyrë efektive, efikase, ekonomikisht dhe në përputhje me ligjin.⁴⁹³ Në kryerjen e veprimeve brenda kompetencave të tij, institucioni i jep llogari Kuvendit të Republikës së Serbisë. Aktet me të cilat

⁴⁸⁹Po aty, neni 11.

⁴⁹⁰Po aty, neni 22.

⁴⁹¹ Ligji për Auditimin e Shtetit të Maqedonisë, neni 2, Official Gazette of the Republic of Macedonia" No. 65/97, 70/01, 31/03, 19/04, 70/06)

⁴⁹²Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 96.

⁴⁹³Sretenovic, Radoslav, President/Auditor-General, shih: <http://www.dri.rs/about-us/presidential-welcome.184.html>.

Institucioni kryen kompetencat e tij të auditimit nuk mund të jetë një objekt i mosmarrëveshjes para gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore.⁴⁹⁴ Ky Institucion auditon: subjekte që drejtpërdrejtë dhe indirekt janë përfitues të mjeteve buxhetore të Republikës, autonomisë territoriale dhe autoriteteve lokale, në përputhje me rregullat që qeverisin sistemin e buxhetit dhe sistemin e të hyrave publike dhe shpenzimeve; organizatat e sigurimeve shoqërore të detyrueshme; Bankën Qendrore (Kombëtare) të Serbisë në pjesën lidhur me asetet publike dhe transaksionet me buxhetin e shtetit; ndërmarrjet publike, shoqatat e biznesit, si dhe personat e tjerë juridikë, të themeluar nga përfituesit direkt apo indirekt të fondeve publike; personat juridikë, përfituesit e drejtpërdrejtë ose të tërthorte, që marrin pjesë në kapital ose në menaxhim; partitë politike, në përputhje me financimin qeverisës dhe ligjin e partive politike; përfituesit nga fondi i BE-së, donacionet dhe asistencën e organizatave ndërkombëtare, qeverive të huaja dhe organizata jo-qeveritare, etj.⁴⁹⁵

Në Republikën e Malit të Zi, Institucioni shtetëror i Auditimit (revizionit) është organ i pavarur dhe suprem i revizionit shtetëror. Institucioni shtetëror i Auditimit (revizionit) kontrollon ligshmërinë dhe shkallën e suksesit të menaxhimit me pronën shtetërore dhe obligimet, buxhetet dhe të gjitha punët financiare të subjekteve të cilat, si burime të financimit kanë mjetet publike ose që krijohen me shfrytëzimin e pronës shtetërore.⁴⁹⁶ Qëllimi kryesor i auditimit të jashtëm të sektorit publik është që të japë raport të plotë dhe të saktë mbi rregullsinë e përdorimit të fondeve publike, por edhe për të treguar nëse përdoruesit e fondeve publike kanë arritur të përmbushin qëllimet për fondet e dhëna.⁴⁹⁷ Subjektet e audituara janë organet dhe organizatat e menaxhimit të buxhetit ose pronës së shtetit dhe njësisive të vetëqeverisjes lokale, fondet dhe personat e tjerë juridikë të themeluar nga shteti, ose në të cilat shteti është aksioneri kryesor apo mban shumicën e aksioneve.

⁴⁹⁴Law on State Audit Institution, The Law was published in the “Official Gazette of the Republic of Serbia”, no. 101/2005, 54/2007 and 36/2010, neni 3.

⁴⁹⁵Law on State Audit Institution, The Law was published in the “Official Gazette of the Republic of Serbia”, no. 101/2005, 54/2007 and 36/2010, neni 10.

⁴⁹⁶Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, neni 144.

⁴⁹⁷Institute Alternative, The State Audit Institution in Montenegro The Influence Strengthening Proposals, Publisher, December, 2010, Podgorica, fq.5. Shiko web faqe: http://media.institut-alternativa.org/2012/09/institute_alternative_the_state_audit_institution_in_montenegro.pdf.

Institucioni kontrollon gjithashtu subjektet që ekzekutojnë pjesët e buxhetit, menaxhojnë pronën shtetërore, marrin subvencione, grante ose garanci nga shteti, ose që bëjnë biznes me një entitet të audituar, apo përdorin fondet e BE-së dhe fondet e organizatave të tjera ndërkombëtare apo institucioneve për financimin e nevojave publike. Institucioni kryen auditimin e pasqyrave financiare të Bankës Qendrore të Malit të Zi, duke u kujdesur për të ruajtur autonominë e Bankës Qendrore të Malit të Zi në arritjen e objektivave të saj dhe ushtrimin e funksionit të saj kushtetuese.⁴⁹⁸ Për subjektet e audituara, që u janë dhënë kredi, garanci, apo garanci të tjera nga shteti, institucioni mund të shqyrtojë nëse janë marrë masat e duhura, në mënyrë që të shmanget ndonjë pasojë e dëmshme për shtetin.⁴⁹⁹

⁴⁹⁸Law on State Audit Institution of the Republic of Montenegro' Neni 4 ('Official Gazette of the Republic of Montenegro', No. 28/04 of 29 April 2004, No. 27/06 of 27 April 2006, No. 78/06 of 22 December 2006, 'Official Gazette of Montenegro', No. 17/07 of 31 December 2007, 73/10 of 10 December 2010, 40/11 of 8 August 2011, No. 31/14 of 24 July 2014)

⁴⁹⁹ Po aty, shih nenin 8.

KAPITULLI V. ANALIZË E TË DHËNAVE EMPIRIKE

Ky kapitull trajton analizën dhe rezultatet e kërkimit nga instrumentet e mbledhjes së të dhënave primare, përmes analizimit të raporteve vjetore të institucioneve, intervistave dhe pyetësorëve në terren, si dhe gjetjet kryesore. Gjithashtu, gjejnë pasqyrim rezultatet e hulumtimit për instrumentet e kontrollit të administratës publike në Republikën e Kosovës, si dhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat janë ballafuar mekanizmat dhe instrumentet e kontrollit të administratës publike gjatë funksionimit të tyre, që nga themelimi e deri në vitin 2017. Ky hulumtim është fokusuar në disa aspekte të analizës. A i ka Kosova të gjitha instrumentet e kontrollit të administratës publike? A ka nevojë për reformë institucionale?

A është e nevojshme një riorganizim i administratës publike për përcaktimin e qartë të mbikëqyrjes dhe raportimit të Insitucioneve dhe Agjensive të pavarura në kuadër të Kuvendit dhe Qeverisë? A është e nevojshme krijimi i institucioneve të tjera për kontrollin e administratës publike? Nëse po, çfarë institucioni? Cilat do të ishin risitë që sjellin këto institucione në ligjshmërinë e veprimtarisë së administratës publike dhe në përmirësimin e qeverisjes së mirë në Kosovë? A ka nevojë për reformë ligjore në Kosovë? A ka legjislacion të kompletuar sa i përket instrumenteve të kontrollit të administratës publike? Nëse po, në legjislacionin në fuqi a ekzistojnë zbrazëtira ligjore? Sa po zbatohet ky legjislacion në praktikë nga institucionet e kontrollit të administratës publike dhe nga administrata publike? Nëse jo, cila pjesë e legjislacionit mungon dhe duhet plotësuar? A është domosdoshmërisht e nevojshme të miratohet ky legjislacion për të pasur instrumente të kontrollit të administratës publike më efikase?

Metodologjia e përdorur në këtë studim është analizimi i kuadrit ligjor, i literaturës dhe analizimi i raporteve vjetore të punës së instrumenteve të kontrollit të administratës publike dhe arritja e gjetjeve individuale. Në bazë të këtyre gjetjeve është bërë ndërtimi i pyetjeve të intervistave dhe pyetësorëve. Formulimi i pyetjeve është realizuar në atë formë që të identifikohej zbrazëtirat ligjore të legjislacionit që rregullon kontrollin e administratës publike, zbatimin e ligjit në praktikë, masat për

fuqizim të instrumenteve të kontrollit të administratës publike, çfare institucioni duhet të krijohet për garantimin e qeverisjes së mirë në Kosovë, dhe si të bëhet përcaktimi i qartë i mbikqyrjes dhe raportimit të Institucioneve dhe Agjensive në kuadër të Kuvendit dhe Agjensive në kuadër të Qeverisë.

Qëllimi i përdorimit të instrumenteve për mbledhjen e të dhënave me intervista dhe pyetsorë dhe ndërtimi i pyetjeve të orientuara synojnë të japin përgjigjë për pesë (5) pyetjet kërkimore të shtruara dhe vërtetimin ose jo të hipotezës kryesore dhe dy nënhipotezave të ngritura në këtë punim. Në bazë të hulumtimit dhe të dhënave empirike janë argumentuar hipoteza dhe nënhipotezat e ngritura. Një pjesë e intervistave është realizuar drejtpërdrejt me zyrtarë të lartë publikë. Një pjesë e intervistave është realizuar përmes formës elektronike, për arsye të kufizimit të kohës së zyrtarëve të lartë publikë dhe disa përfaqësuesve të shoqërisë civile. Ndërsa një pjesë e intervistave janë realizuar përmes plotësimit të tyre në letër. Të dhënat e grumbulluara në këtë hulumtim përfshijnë opinionet e zyrtarëve të lartë publikë të intervistuar dhe intervistat e përfaqësuesve të shoqërisë civile, si dhe pyetsorët e Zyrtarëve të Lartë Publikë.

Tabela 5 - Zyrtarë të lartë publikë pjesëmarrës në këtë hulumtim

Institucionet	Zyrtarë të Lartë Publikë të përfshirë në hulumtim	Numer
Kuvendi i Kosovës	Kryetari i Kuvendit në Republikën e Kosovës dhe deputet	35
Ministri	Ministër dhe ish-Ministër të Ministrisë së Administratës publike	1
Gjykata Kushtetuese	Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjyqtarë të GJK	2
Gjykata e Apelit	Gjyqtarë në Gjykatën e Apelit	10
Gjykata Themelore në gjithë Kosovën	Gjyqtarë në Gjykata Themelore	92
Prokuroria Themelore në Pejë, Prishtinë, Prizren	Prokurorë në Prokurorinë Themelore	10
Ministri	Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues	7
MAP dhe Presidencë	Këshilltar Politik të Ministrit dhe Presidentit	4
IAP	Avokati i Popullit dhe Zëvendës Avokati i Popullit	2
Policia e Kosovës	Zyrtarë në Policinë e Kosovës, Drejtoria për krime ekonomike dhe korrupsion	2
Agjensioni Kundër Kurrosionit	Drejtori i Agjensionit Kundër Korrupsionit	1
Totali Zyrtar të Lartë Publikë		166
Institute dhe OJQ, Gazetar	Shoqëri Cvile	10
Totali i target grupit		176

Në vijim, do të shtjellohen një pjesë e pyetjeve të përdorura për hulumtim dhe interpretimin e të dhënave të grumbulluara dhe prezantimin e rezultateve të studimit të cilat i kemi paraqitur në formën teorike, tabelare dhe grafike.⁵⁰⁰ Përmes interpretimit të këtyre të dhënave primare bëhet vërtetimi i hipotezës kryesore dhe nënhipotezave të parashtruara gjatë punimit.

⁵⁰⁰Sqarim: Për Intervistat e një numri të zyrtarëve të lartë publik dhe të shoqërisë civile nuk do të publikohen emrat e intervistueseve me kërkesën e tyre. Në punim do të përdoret opinioni i deputetëve, gjyqtarëve, prokurorëve, Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunës civilë të nivelit të drejtues, Këshilltar Politik dhe intervistueseve të shoqërisë civile.

5.1. Instrumentet e kontrollit të administratës publike në Kosovë – trajtim analitik


Lidhur më çështjen e problematikës së ekzistencës së legjislacionit apo mungesës së tij, sa i përket instrumenteve të kontrollit të administratës publike në Republikën e Kosovës, ne kemi parashtruar pyetjen: *a ka Kosova legjislacion të mjaftueshëm sa i përket Instrumenteve të Kontrollit të Administratës Publike; a ekzistojnë vakume (zbrazëtira) në legjislacion sa i takon Instrumenteve të kontrollit të administratës publike? Nëse po, a janë ato të natyrës dispozitive (materiale) apo procedurale?* Sipas ish-Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Krasniqi “Kuvendi në periudhën e pasluftës, përfshirë edhe periudhën pas shpalljes së pavarësisë, ka qenë i fokusuar në plotësimin e kornizës ligjore, kryesisht në miratimin e ligjeve por edhe në plotësimin dhe ndryshimin e tyre. Sa i përket kontrollit të punës së ekzekutivit nga ana e Kuvendit, kjo çështje është e rregulluar me Kushtetutë dhe rregullore të punës. Kosova ka krijuar edhe institucione të tjera të pavaruara të cilat janë përgjegjëse për kontrollin e vazhdueshëm të performancës institucionale dhe kontrollin e zbatimit të ligjit dhe procedurave”.

Sipas opinionit të zyrtarëve të lartë publikë, legjislacioni pozitiv ka parashikuar instrumentet e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të administratës publike, si organe individuale, kolektive, komisionet dhe ato gjyqësore.

Një pjesë e zyrtarëve të lartë publikë janë shprehur se ka legjislacion të mjaftueshëm edhe sipas standarteve evropiane, dhe e mohojnë se ekzistojnë vakume në legjislacion, por problem është mos zbatimi i legjislacionit. Kurse, një pjesë e zyrtarëve të lartë publikë janë shprehur se ka vakume në legjislacion të natyrës procedurale dhe se mungojnë edhe disa ligje të cilat janë të nevojshme për kontrollin e administratës publike. Ndërsa, sipas Ministres Tahiri “legjislacioni përkatës është mjaft i kompletuar dhe i hartuar mbi një koncept modern të vlerave evropiane dhe në harmoni me legjislacionin e BE-së. Sfidë kryesore është në zbatimin e plotë të këtij legjislacioni, e cila kërkon ndryshime në mendësinë dhe kulturën e administratës publike, duke marrë parasysh se Kosova është një shtet i ri,

që ka qenë gati 9 vite nën administratën e përkohshme ndërkombëtare (UNMIK) dhe tani po zhvillon një administratë publike vendore dhe të pavarur. Sipas ish-Ministrit të Drejtësisë Kuçi “Kosova ka një kornizë mëse të konsoliduar të ligjeve, ndër ligjet më të mira në rajon, të cilat janë funksionale dhe sipas standardeve të BE-së” [Kuçi,2015]. Sipas Raportit të Këshillit të Evropës, Kosova gjatë viteve të fundit, ka bërë përpjekje legjislative dhe institucionale për të pasur korniza të përgjithshme dhe të specializuara lidhur me kontrollin, inspektimin dhe auditimin e aktiviteteve publike (administrative, gjyqësore, financiare, policore, doganore, tatimore, inspektoriate të ndryshme dhe organe të tjera monitoruese dhe mbikëqyrëse) [KE, 2015:74]. Të dhënat dhe opinionet e zyrtarëve të lartë publikë pasqyrohen më poshtë në formë grafike.

Grafiku12 - Koniza ligjore për kontrollin e Administratës Publike




Burimi: autori i punimit, bazuar në hulumtim.

Grafiku i mësipërm tregon rezultatet e opinionit lidhur me legjislacionin sa i takon instrumenteve të kontrollit të administratës publike. Sipas zyrtarëve të lartë publikë, 90% e tyre pohojnë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron bazë të mjaftueshme për kontroll të administratës publike, se Kosova ka 80% të legjislacionit të mjaftueshëm sa i përket Instrumenteve të Kontrollit të Administratës Publike. Mirëpo, legjislacioni ka vakume të natyrës procedurale, ka paqartësi të dispozitave ligjore dhe në disa raste edhe përplasje mes ligjeve. Kurse, disa zyrtarë të lartë publikë janë shprehur se 90 % e problemit qendron më tepër në mos

zbatimin e legjislacionit nga zyrtarët e lartë publikë dhe kjo jep hapësirë për shkelje procedurale, se sa te mungesa e ligjeve. Sipas Ministres Tahiri “në Kosovë, për vetë faktin se ka ende dukuri negative në administratën publike, kjo flet për pamjaftueshmëri të zbatimit të instrumenteve të kontrollit dhe llogaridhënies” [Tahiri, 2016].

Grafiku13: Opinioni i zyrtarëve të lartë publikë mbi legjislacionin për Kontrollin e Administratës Publike në Kosovë



Burimi: autori bazuar në hulumtim.

Grafiku pasqyron rezultatet e hulumtimit dhe opinionet e zyrtarëve të lartë publikë të intervistuar, ku 80 % e tyre janë shprehur se Kosova ka legjislacion të mjaftueshëm për kontrollin e Administratës Publike. Ndërsa, 20 % e zyrtarëve të lartë publikë pjesëmarrës në studim, pohojnë se mungon legjislacioni dhe ai duhet të miratohet.⁵⁰¹ Në Kosovë, është e nevojshme miratimi i një Ligji për funksionimin e Kuvendit, Ligjit për Qeverinë dhe një reformim ligjor që lidhet me ligje, si: Ligji për Administratën Shtetërore, Ligji për Shërbimin Civil, Ligji për Pagat, Ligji për Konfliktin Administrativ, Ligji për Hetimin Parlamentar, Ligji për Gjykatat, Ligji për Konfliktin e Interesit, Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave

⁵⁰¹Sqarim: Sepse ende nuk është miratuar ligji i procedurës të përgjithshme administrative, Ligji për procedurë të përgjithshme të Inspektoriatit. Hulumtimi është realizuar para miratimit të ligjit të procedurës së përgjithshme administrative) dhe reformimin e kornizës ligjore, ligjit për konfliktin administrativ, ligjit për shërbimin civil, ligji për pagat.

për të gjithë personat zyrtarë, Ligji për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, Ligji për Organizimin e Administratës Publike, Ligji antimafia etj.

Në Kosovë janë themeluar një numër i madh i Institucioneve, Agjencive të Pavarura në kuadër të Kuvendit dhe Qeverisë, të cilat janë themeluar me ligje të veçanta, pa bërë më parë analizë nëse është e nevojshme të themelohen këto Institucione.⁵⁰² Ky legjislacion ekzistues parashikon themelimin dhe funksionimin e institucioneve dhe agjencive (gjysmë) të pavarura, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore të tyre (përfshirë pagat e nëpunësve civilë, nëpunësve publikë dhe stafit tjetër të punësuar në këto organizata) [MAP, 2016:66]. Prandaj, është e nevojshme ndryshimi dhe plotësimi i secilit ligj specifik për Institucionet dhe Agjensitë në kuadër të Kuvendit dhe Agjensitë (organet qendrore dhe të pavarura) në kuadër të Qeverisë, deri sa të bëhet një riorganizim i tyre dhe të eliminohet duplikimi i institucioneve.

Gjithashtu, mbetet të përcaktohet mbikëqyrja dhe raportimi i këtyre trupave, sepse disa institucione nuk e kanë të përcaktuar me rregulla, në mënyrë të qartë, se ku duhet të raportohet, cili institucion ka për kompetencë të shqyrtojë dhe miratojë raportin e tyre.

5.2.. Përmbyshja e detyrave dhe përgjegjësi të Kuvendit në kontrollin e administratës publike


Lidhur me çështjen dhe problematikën e kontrollit të administratës publike nga Kuvendi, përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar si dhe performancës së instrumenteve të tjera të kontrollit të administratës publike të cilat i raportojnë Kuvendit, në hulumtim kemi parashtruar disa pyetje të cilat i shqyrtojmë në vijim.

⁵⁰²Sqarim: Disa Institucione dhe Agjenci të krijuara kanë bërë duplikimin e Institucioneve; ekzistojnë departamente në Ministri dhe Agjenci dhe kjo ka ndikuar vetëm në shpërndarjen e përgjegjësi, ndërsa rezultatet mungojnë. Këto Institucione dhe Agjenci të Pavarura nuk e kanë të përcaktuar në mënyrë të qartë mbikëqyrjen/kontrollin dhe raportimin e tyre, si dhe kanë një numër shumë të lartë të koficientëve të pagave. Gjithashtu del si domosdoshmëri, miratimi i ligjit për organizimin e administratës publike.

Sipas ish-Kryetarit të Kuvendit, Krasniqi “ushtrimi dhe përdorimi i instrumenteve parlamentare në mënyrë efikase nga ana e Kuvendit, e bën qeverinë përgjegjëse për veprimet e saj dhe sigurohet për zbatimin efikas të politikave dhe sundimit të ligjit” [Krasniqi, 2016].

Në pyetjen, a ka arritur Kuvendi të mbikëqyrë punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit, sipas opinionit të deputetëve, Kushtetuta ofron bazën ligjore që Kuvendi të ushtrojë mandatin e tij kushtetues për mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat kanë detyrim t’i raportojnë Kuvendit.

Grafiku14: Opinioni i deputetëve të Kuvendit të Kosovës për mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike




Burimi: Autori i punimit bazuar në hulumtim.

Grafiku i mësipërm pasqyron opinionet e deputetëve, ku 61.1 % janë shprehur se Kuvendi nuk ka arritur të ushtrojë në mënyrë të mjaftueshme funksionin e mbikëqyrjes së punës së Qeverisë dhe të institucioneve të tjera të pavaruara, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit. Ndërsa, 38.9% e deputetëve pohojnë se Kuvendi ka arritur të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në

lidhje me punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike. Po kështu, 60% e deputetëve janë shprehur se nuk kanë arritur t'i përmbushin në mënyrë të kënaqshme detyrat dhe përgjegjësitë e tyre (si deputetë) në Kuvend për kontrollin e administratës publike. Ndërsa, 40% e deputetëve pohojnë se kanë arritur t'i përmbushin në mënyrë të kënaqshme detyrat dhe përgjegjësitë e tyre (si deputetë) në Kuvend, të mbikëqyrin ekzekutivin dhe trupat e tjera që i mbikëqyr Kuvendi. Mirëpo, për rritjen e efikasitetit më të madh, Kuvendit i mungojnë mekanizmat ndëshkues (përveç përgjegjësisë politike) në mënyrë që Kuvendi të mund të ndër marrë masa.


Në bazë të hulumtimit dhe të dhënave empirike, kemi pasqyruar në formë grafike përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar në pesë legjislatura.

Grafiku15: Përdorimi i instrumenteve të kontrollit parlamentar



Burimi: bazuar në transkripte të mbledhjeve Plenare të Kuvendit dhe në Raportet e punës së Kuvendit.

Grafiku16: Pyetjet parlamentare për tre Legjislatura



Burimi: bazuar në Raportet vjetore të punës së Kuvendit⁵⁰³ të përpunuara nga autori i punimit.


Në dy grafikët e mësipërm, pasqyrohen qartë se në të gjitha Legjislaturat, deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk i kanë përdorur instrumentet e kontrollit parlamentar në nivel të kënaqshëm. Në legjislaturat e fundit, ka pasur rënie të interesimit të deputetëve për parashtrimin e pyetjeve parlamentare drejtuar ministrave apo kryeministrit, për arsye se nuk merrnin përgjigje në pyetjet e tyre nga kabineti qeveritar. Duke u bazuar në rezultatet e mësipërme për përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar në pesë legjislatura, ne i parashtruam pyetje deputetëve në intervista dhe pyetësorët e hartuar për këtë studim.

A jeni të kënaqur me përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar: Interpelancat, Mocionet dhe me ngritjen e komisioneve hetimore?

Rezulton se, Kuvendit të Kosovës gjatë pesë legjislaturave, i mungoi vullneti politik për mbikqyrje dhe kontroll të Qeverisë, Institucioneve dhe Agjensive të Pavarura të cilat kanë detyrim t'i raportojnë Kuvendit.

⁵⁰³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Raport për punën e Kuvendit për Legjislaturën e III-të 2008-2010, fq.24, Raport për punën e Kuvendit për Legjislaturën e IV-të 2011-2014, fq. 4, Raport për punën e Kuvendit për Legjislaturën V-të 2014-2017, fq.21 (Raporte të Kuvendit të cilat janë ofruara për qasje autorit të punimit).

Grafiku17: Opinioni i deputetëve për përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar



Burimi: Autori i punimit bazuar në hulumtim.

Grafiku i mësipërm pasqyron opinionet e deputetëve dhe rezultatet, ku 31.8% e deputetëve janë shprehur se janë të kënaqur me përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar, interpelancat, mocionin e votëbesimit të qeverisë dhe shkarkimin e qeverisë dhe me ngritjen e komisioneve hetimore. Ndërsa, 40.9% e deputetëve pohojnë se janë të pakënaqur me përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar, si dhe 9.1% e deputetëve deklarojnë se nuk janë as të kënaqur as të pakënaqur, kurse 13.6% pohojnë se janë shumë të pakënaqur dhe 4.5% e deputetëve nuk komentojnë. Pra, 54.5% e deputetëve janë të pakënaqur me përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar.

Instrumentet e kontrollit parlamentar u shfrytëzuan shumë pak prej periudhës së legjislaturës së parë të vitit 2001 deri në dhjetor 2017 në legjislaturën e pestë. Sepse nuk kishte vullnet politik për ngritjen e komisioneve hetimore dhe shumë çështje të rëndësishme janë tentuar të hetohen përmes ngritjes së komisioneve parlamentare, por një gjë e tillë ka dështuar. Në shumë raste është arritur numri i deputetëve nënshkrues për ta ngritur komisionin, por ka dështuar të organizimi dhe funksionimi i tij, për shkak se me nenin 8 të ligjit për hetimin parlamentar për përbërjen e komisionit, kur në shumicën e rasteve pozita nuk ka dërguar deputetin përfaqësues, atëherë çështja ka mbetur e pa proceduar. Për këtë çështje, 57.1% e deputetëve të

Kuvendit të Kosovës, pohojnë se mosngritja e komisioneve hetimore ishte pengues i mos zbardhjes së shumë aferave korruptive, shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe skandaleve të përfulura në publik në administratën publike. Ndërsa, 28.6% e deputetëve nuk pajtohen me faktin se mos ngritja e komisioneve hetimore ishte shkaktar i mos zbardhjes së këtyre fenomeneve negative në administratën publike. Kurse, 14.3 % e deputetëve deklaruan se nuk e dinë nëse mosngritja e komisioneve hetimore ishte pengues i zbardhjes së shumë aferave korruptive, shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe skandaleve të përfulura në publik në lidhje me administratën publike.


Pyetja tjetër ishte: sa jeni të kënaqur me performancën e instrumenteve të tjera të kontrollit të administratës publike?

Sipas drejtorit të departamentit ligjor në MAP, ka pasur kritika të mëdha nga Komisioni Evropian veçanërisht për mos llogaridhënie dhe për shtime të tepërta të të punësuarve në administratë. Problem kryesor është që, sidomos agjensitë ekzekutive në një fazë të caktuar, janë konsideruar si ‘ishuj më vete’ dhe disa prej tyre, në disa raste kanë pasur mungesa në llogaridhënie (Shamolli, 2018). Në Kosovë, për ta kontrolluar dhe drejtuar në mënyrë aktive performancën e institucioneve dhe agjensive gjysmë të pavarura që i japin llogari Kuvendit ose Qeverisë, nevojitet të përmirësohen kapacitetet e Kuvendit të Kosovës dhe të ministrive të Qeverisë së Kosovës. Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe drejtuese kërkon më shumë personel me aftësi analitike dhe ekspertizë relevante (duke përfshirë identifikimin e komisionit përgjegjës për mbikëqyrje) dhe masa apo mundësi adekuate për mbikëqyrje, si për shembull: dëgjime të rregullta, inspektime, auditime dhe raporte të veçanta. Duhet që të rishikohet roli i Bordeve në Kosovë për mbikëqyrjen e performancës administrative, buxhetore dhe funksionale të institucioneve dhe agjensive gjysmë të pavarura ose të pavarura, drejtimi i menaxhimit të tyre, si dhe sigurimi i llogaridhënies së tyre [MAP, 2016, fq.59, 60].

Sipas Zëvendëskryetares së Komisionit parlamentar për Buxhet dhe Financa “bazuar në territorin që kemi dhe bazuar në numrin e popullsisë së Kosovës, kemi një administratë publike të ngarkuar me një numër të madh të institucioneve,


gjithashtu një administratë publike të ngarkuar me numrin e të punësuarve. Duhet me seriozitet t'i qasemi reformës në administratën publike. Një numër i madh i Agjensive të Pavarura nuk ka rregullim të duhur të pagave në këto institucione. Prandaj, duhet reforma në administratën publike, për të bërë një hap para në drejtim të integriteteve evropiane” (Hadërgjonaj; 2018).

Grafiku18: Opinioni i deputetëve për performancën e instrumenteve të tjera të kontrollit të administratës publike



Burimi: autori i punimit bazuar në hulumtim.

Grafiku 19: Opinioni i Gjyqtarëve për performancën e instrumenteve të tjera të kontrollit të administratës publike



Burimi: autori në bazë të hulumtimit

Nga të dhënat e mësipërme, rezultojnë se vetëm 31.8% e deputetëve dhe 15.7 % e gjyqtarëve janë shprehur të kënaqur me performancën e Institucioneve dhe Agjensive të Pavarura; kurse pjesa tjetër, disa të pakënaqur, dhe disa as të kënaqur as jo.

Në bazë të hulumtimit të bërë dhe rezultatit të të dhënave empirike ***vërtetohet Nënhipoteza e dytë se:*** në Kosovë është e nevojshme një riorganizim i administratës publike, për përcaktim të qartë të mbikëqyrjes apo kontrollit mbi performancën e institucioneve dhe agjensive që funksionojnë në kuadër të Kuvendit dhe Qeverisë, si dhe të mënyrës dhe modaliteteve të raportimit të tyre.

5.3. Kontrolli i punës së administratës shtetërore përmes mbikëqyrjes administrative- trajtim analitik


Qeveria më qëllim të përmirësimit të procedurave administrative dhe modernizimit të shërbimeve publike-administrative është e përqendruar në zbatimin e mekanizmave për kontrollin e punës së administratës shtetërore në bazë të legjislacionit në fuqi. Një ndër objektivat do të jetë ngritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve publike-administrative të mira, informimi i vazhdueshëm i qytetarëve për të drejtat dhe mënyrat e realizimit të tyre, për mënyrat e marrjes së shërbimeve publike-administrative, mënyrat e regjistrimit dhe çështjet e tjera që mund të jenë me interes për ta. Po ashtu, do të krijohen mekanizmat për matjen e opinionit për cilësinë e shërbimeve publike-administrative nga ana e organeve publike dhe organizatave të tjera në nivel lokal dhe qendror [Tahiri, 2016].

Një pyetje tjetër ishte se *a keni arritur t'i përmbushni detyrat dhe përgjegjësitë (si Ministër, Sekretar, Drejtor Departamenti) në ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së administratës shtetërore?*

Sipas intervistuesve, Kosova akoma nuk ka ndonjë agjensi të themeluar enkas për mbikëqyrjen dhe kontrollin e administratës shtetërore. Ata mendojnë se duhet të ekzistojë patjetër kjo agjensi, për faktin se vetë ekzistenca e një organi të tillë, në

masë të madhe, do të ndikonte në ngritjen e efikasitetit të punës tek ata që janë bartës të institucioneve shtetërore. Në këtë aspekt, edhe Drejtori i Departamentit duke pasur parasysh faktin se është një organ mbikëqyrës më i lartë, do të ishte shumë më i përkushtuar në drejtim të mbikëqyrjes dhe kontrollit të punës së atyre që janë vartës të tij.

Grafiku 20: Opinioni i nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësve civilë të nivelit drejtues për kontroll dhe mbikëqyrje të punës së administrates shtetërore.



Burimi: autori i punimit bazuar në hulumtim.

Grafiku i mësipërm pasqyron opinionet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunës civil të nivelit drejtues të përfshirë në studim, ku 65% e të intervistuarve pohojnë se kanë arritur t'i përmbushin në tërësi detyrat dhe përgjegjësitë, në ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së administratës shtetërore, ndërsa në mjaft raste, performanca e dobët në vite ka qenë shkak edhe për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës sipas legjislacionit të shërbimit civil. Ndërsa, 35 % e të intervistuarve deklarojnë se detyrat dhe përgjegjësitë kanë arritur t'i përmbushin pjesërisht në lidhje me ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së administratës shtetërore.

Sipas nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësve civilë të nivelit drejtues, ligji për administratën shtetërore është organizativ dhe funksional, prandaj zbrazëtitë janë të natyrës procedurale, ka fushëveprim tepër të ngushtë, ka mungesa

të kritereve për krijimin e organeve që janë në varësi të organeve të larta shtetërore, të standardeve për organizimin e brendshëm të organeve të administratës shtetërore, si dhe ka nevojë të nxirren akte me të cilat do të zbërthehen parimet dhe zgjidhjet ligjore për nevoja praktike, pasi janë evidentuar probleme në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi. Me plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për administratën shtetërore, duhet të caktohen kritere dhe masa të cilave duhet t'i përmbahen të gjitha Agjensitë e Pavarura të themeluara nga Kuvendi. Pra, duhet të ekzistojë një ligj, i cili unifikon këto çështje në nivel horizontal, për të gjitha agjensitë.

Organe qendrore kanë themeluar 12 ministri, të cilat njihen me emra si: agjensi, agjenci ekzekutive dhe organe qendrore të administratës shtetërore. Baza ligjore për themelimin e tyre është Ligji për Administratën Shtetërore [MAP, 2016: 27]. Prandaj, prioritet duhet të jetë finalizimi dhe miratimi i ligjit të ri për administratën shtetërore, organizimin e administratës publike dhe llogaridhënien, aktivitetet që lidhen me zbatimin e këtij ligji e sidomos në shërbim të vendosjes së sistemit të llogaridhënies së agjensive të pavarura dhe atyre ekzekutive, krijimin e sistemit për mbikëqyrjen e zbatimit të kodit të etikës dhe transparencës [MAP, 2015:37]. Kjo sepse, struktura e organizimit të brendshëm në këto institucione dhe agjensi varion, ku disa organizohen në dy, tri apo katër nivele, por pa linja të qarta të llogaridhënies në mes tyre. Nuk ka linja të qarta të llogaridhënies në disa organe qendrore apo agjensi në kuadër të Qeverisë, pasi 13 agjensi qeveritare nga 46, nuk e kanë të definuar në ligj raportimin dhe mënyrën e raportimit, e si rrjedhojë, nuk dihet nëse raportojnë të Ministri, në Qeveri apo në asnjërën prej tyre [MAP, 2016:7]. Shumë nga agjensitë e Qeverisë kanë ekzistuar më herët si departamente të ministrive, ndërsa më vonë janë shndërruar në agjensi, ku vihet re se disa agjensi dhe departamente ministrore po krijojnë duplikim të roleve dhe përgjegjësive mes tyre [MAP, 2016:6]. Secila ministri që ka agjensi apo organe qendrore në varësi të saj, duhet të ketë një njësi e cila të merret ekskluzivisht me mbikëqyrjen e performancës së këtyre organeve. Kjo përgjegjësi duhet të ceket në rregulloret për organizimin e brendshëm të secilës ministri [MA, 2016: 62].

5.4. Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil në institucionet qendrore dhe lokale - analizë e tyre

Në kuadër të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes funksionon Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka funksion të shqyrtojë dhe marrë vendime për ankesat e nëpunësve civilë⁵⁰⁴ kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil; të vendosë nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës; të mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil (Ligji Nr. 03/L-192, neni 10).

Një administratë publike funksionale është një gur themeli në një shoqëri demokratike. Shërbimi civil, qoftë në nivelin qendror apo lokal të administratës publike, është ofrues kryesor i shërbimeve publike për popullin, dhe efektshmëria e tij ndikon drejtpërsëdrejti në mundësinë e banorëve për të pasur qasje në të drejtat e tyre themelore (OSBE, 2013:5). Në Shërbimin Civil të Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarve:

- nëpunës civilë të karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet në baza të përhershme për arritjen e objektivave të përgjithshme institucionale; dhe
- nëpunës civilë të jo karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në dy (2) vjet, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimin


⁵⁰⁴Sqarim: Shërbim civil është i tërë trupi i personelit administrativ të punësuar në institucionet e administratës qendrore dhe komunale, të parapara me ligjin për shërbimin civil, të cilët zbatojnë politikat dhe sigurojnë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse (Shih nenin 2, Ligji Nr. 03/L-149).

Statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe performuesit e artit, zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale. Zyrtarët e zgjedhur në pozita zgjedhëse në institucionet e administratës publike dhe zyrtarët e emëruar nga zyrtarët e zgjedhur në pozita të caktuara, të gjithë nëpunësit e punësuar në kabinetet e funksionarëve publike nuk janë nëpunës civilë.

Shih nenin 4 Ligji Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

e përkohshëm të nëpunësve të përhershëm civilë si dhe në raste të mbingarkesave në punë [Ligji Nr. 03/L-149, neni 12].

Figura 6: Të punësuarit në Agjenci të Kuvendit, Qeverisë dhe Ministrive (përfshirë Zyrën e Kryeministrit, por pa llogaritur Policinë e Kosovës).



Burimi: MAP 2016:40.

Institucionet e administratës qendrore dhe komunale, administrata e Kuvendit, administrata e Presidencës, Zyra e Kryeministrit dhe ministritë, agjensitë ekzekutive, agjensitë e pavarura dhe ato rregullatore si dhe administrata komunale janë të obliguara të zbatojnë ligjin për shërbimin civil. Mirëpo disa institucione dhe agjensi të pavarura të Kuvendit dhe disa agjensi apo organe qendrore të Qeverisë, në praktikë nuk e aplikojnë Ligjin për Shërbimin Civil në tërësinë e institucionit. Në disa raste, drejtorët e përgjithshëm të këtyre trupave me një pjesë të nëpunësve, nuk i nënshtrohen këtij ligji. Në përgjithësi, në institucione dhe agjensi të pavarura të Kuvendit por edhe agjensi të Qeverisë vërehet një tendencë për mos aplikim të Ligjit për Shërbimin Civil, në mënyrë që të ketë një pavarësi më të madhe në rekrutimin e personelit dhe mundësi për rregullim të pagave. Institucionet dhe agjensitë e pavarura në kuadër të Kuvendit, aplikojnë nivele të ndryshme të pagave, të cilat nuk kanë bazën e duhur ligjore. Në administratën publike ka raste kur, për të njëjtin pozicion, zyrtari paguhet ndryshe në disa institucione qeveritare dhe ndryshe në institucione apo agjensi të pavarura, pasi nuk vlen parimi “punë e njëjtë - pagë e

njëjtë” [MAP, 2016, fq. 6, 7]. Në tabelën më poshtë, janë pasqyruar dy shembuj për dallimet në pagë mes tre institucioneve.

Tabela 6: Paga për pozitë të njëjtë në Ministri, Institucion dhe Agjensi të Pavarur


Paga bazë (bruto)	Ministria e Administratës publike	Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Gjykata Kushtetuese	Agjensioni Kosovar i Privatizimit
Zyrtar i lartë ligjor	464.75 €	863.36 €	1,046.25 €
Zyrtar i lartë i prokurimit	464.75 €	756 €	1,157 €

Burimi: MAP, 2016:45

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka rekomanduar se, deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Civil, institucionet e pavarura kushtetuese dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave, duhet të përcaktojnë listën e çështjeve të ngritura, të cilat ndikojnë në pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të nxjerrin akte nënligjore që përcaktojnë dhe definojnë qartë këto çështje, në mënyrë që gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil të ruhet pavarësia funksionale e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të mos krijohen paqartësi, të cilat do të ndikonin në realizimin e objektivave të institucioneve të pavarura. Me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Civil duhet të përcaktohen në mënyrë taksative çështjet të cilat, gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, lidhen me ruajtjen e pavarësisë funksionale të institucioneve të pavarura kushtetuese [KPMSHK, 2016:70].

Këshilli është një institucion i pavarur për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së menaxhimit në shërbimin civil [Ligji Nr.03/L-149, neni 9]. Në vijim, pasqyrohet në formë grafike mbikëqyrja e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në institucione, si dhe e procedurës së rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues.


Grafiku 21: Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në institucione



Grafiku i mësipërm pasqyron vizitat e realizuara dhe shkeljet e konstatuara në institucionet e monitoruara dhe dhënien e rekomandimeve për zyrtarët përgjegjës në këto institucione.

Këshilli, vetëm në vitin 2016, ka realizuar 57 vizita monitoruese të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore dhe lokale, si dhe në 5 ambasada. Këshilli ka evidentuar dhe ka konstatuar 337 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë 245 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

Grafiku 22: Vizitat monitoruese të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në institucione




Burimi: bazuar në Raportet vjetore të KPMSHCK-ës⁵⁰⁵ të përpunuara nga autori i punimit.

Të dhënat nga grafiku i mësipërm pasqyrojnë se për tre vite, Këshilli ka realizuar 146 vizita monitoruese të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore dhe lokale, si dhe në disa ambasada. Këshilli, ka evidentuar dhe ka konstatuar 563 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë 424 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

Në formë grafike, më poshtë pasqyrohet funksioni i vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civilë të nivelit drejtues.

⁵⁰⁵Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Raporti vjetor i punës për vitin 2014, fq.26; Raporti vjetor për vitin 2015, fq. 49; Raporti vjetor për vitin 2016, fq. 35.

Grafiku 23: Vëzhgimi i procedurës së rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues prej janarit 2010 deri në dhjetor 2016




Burimi: bazuar në të dhënat nga Raportet vjetore të KPMSHCK-së⁵⁰⁶ të përpunuara nga autori i punimit.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se vitet e fundit ka pasur rritje të vëzhgimit në lidhje me rekrutimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues, ku në vitin 2016 ka pasur 248 procedura vëzhgimi, prej tyre 104 janë procedura të rekrutimit të aprovuara, dhe janë anuluar 144 procedura të rekrutimit.

⁵⁰⁶Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Raporti vjetor i punës për vitin 2010, fq.32; Raporti vjetor për vitin 2011, fq.29,30; Raporti vjetor për vitin 2012, fq.35; Raporti vjetor për vitin 2013; fq.31; Raporti vjetor për vitin 2014,fq.27; Raporti vjetor për vitin 2015, fq. 48, Raporti vjetor për vitin 2016, fq. 38.

Grafiku 24: Procedura e vëzhgimit të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues



Burimi: bazuar në të dhënat nga Raportet vjetore të KPMSHCK-së⁵⁰⁷ të përpunuara nga autori i punimit.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se prej janarit 2010 deri në dhjetor 2016, Këshilli ka marrë pjesë në 540 procedura vëzhgimi lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civilë të nivelit drejtues. Nga 540 raste që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar si të rregullta 305 procedura, kurse 225 procedura janë anuluar për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale. Prandaj, Këshilli për zbatimin e vendimeve nga ana e organeve të punësimit në nivel qendror dhe lokal, pret angazhimin e Qeverisë, të eprorëve të drejtpërdrejtë (ministrat, kryetarët e komunave, etj.), të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues të institucioneve (sekretarët e përgjithshëm, kryeshefat ekzekutivë, drejtorët ekzekutivë, etj.), të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe gjykatave, me qëllim që vendimet e Këshillit të zbatohen përfundimisht, në pajtim me ligjin [KPMSHC, 2011:34].

Përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të parimeve dhe rregullave për etikën në kuadër të shërbimit civil i përket Ministrisë së Administratës Publike, gjegjësisht Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil (DASHC-it). Ligji për Shërbimin

⁵⁰⁷ Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Raporti vjetor i punës për vitin 2010, fq.32, Raporti vjetor për vitin 2011, fq.29,30, Raporti vjetor për vitin 2012, fq.35, Raporti vjetor për vitin 2013, fq.31, Raporti vjetor për vitin 2014, fq.27, Raporti vjetor për vitin 2015, fq. 48, Raporti vjetor për vitin 2016, fq. 38

Civil i Kosovës (LSHCK) përcakton themelimin e Komisioneve Disiplinore dhe Komisioneve të Ankesave,⁵⁰⁸ në çdo institucion të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e konflikteve dhe pranimin e ankesave. Çdo institucion i administratës publike, i cili punëson nëpunës civilë, ka për detyrim të krijojë një komision disiplinor për marrjen e masave disiplinore në rast të shkeljes së rëndë të Ligjit të Shërbimit Civil apo të akteve nënligjore në zbatim të tij (Ligji Nr.03/L-149, neni 70). Organe të veçanta për zgjidhjen e konflikteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil, krijohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë.

Procedurat për zgjidhjen e konflikteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe:

1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe
2. Këshilli i Pavarur Mbikqyrës (Ligji Nr. 03/L-149, neni 81).

Komisionet për zgjidhjen e konflikteve dhe ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e konflikteve dhe pranimin e ankesave. Vendimet e këtyre komisioneve janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës (Ligji Nr.03/L-149, neni 82).

Masat e mundshme disiplinore ndaj të punësuarve në institucione vendosen nga Komisioni Disiplinor brenda institucionit, ndërsa konfliktet dhe ankesat mund të adresohen po ashtu nga Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave dhe Konflikteve brenda institucionit. Jashtë institucionit, nëpunësit civilë mund të ankohen në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil (KPMSHC) e pastaj në gjykatën përkatëse; të punësuarit me statusin e nëpunësit publik, jashtë institucionit mund të drejtohen në Inspektoratin e Punës dhe gjykatën përkatëse [MAP, 2016].

Komisionet disiplinore në procedurat lidhur me përgjegjësinë disiplinore, shpesh marrin vendime arbitrare pa u proceduar përmes menaxherit të personelit dhe komisionit disiplinor. Shqiptimi i masave disiplinore në disa raste nuk ka qenë në

⁵⁰⁸Rregullore Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave Rregullore Nr. 04/2011 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil.

proporcion me shkeljet e bëra nga nëpunësit civilë, dhe këtë situatë e ka sjellë mos caktimi i zyrtarëve adekuatë në komisione disiplinore, si dhe mungesa e trajnimeve në fushën e shërbimit civil. Anëtarët e komisioneve disiplinore shpesh janë emëruar mbi baza nepotike e politike, duke iu nënshtruar ndikimeve të jashtme në vendimarrje. Nëpunësit drejtues apo të lartë, shpesh me vendime arbitrare, shqiptojnë masa disiplinore pa përfillur procedurat ligjore dhe pa bërë cilësimin paraprak të shkeljes. Në disa raste të procedimit disiplinor, institucionet nuk kanë marrë parasysh përmirësimin e sjelljes së nëpunësit civil, por ndëshkimin [KPMSHC, 2012:29].

5.5. Kontrolli gjyqësor si kontroll i jashtëm i administratës publike –qasje analitike


Në shumicën e shteteve bashkëkohore, kontrolli gjyqësor është kontrolli kryesor i jashtëm mbi administratën. Sipas Kryetarit të Gjykatës Supreme, “dhënia e drejtësisë nuk është vetëm një mision i shenjtë për gjyqtarin, por njëkohësisht një obligim për këdo që ushtron pushtet, për më tepër, kur ky pushtet i ka bazat tek ata që çdo ditë presin një drejtësi të shpejtë dhe të barabartë për të gjithë. Për fat të keq, qeverisja e mirë në shtetin e Kosovës, e veçanërisht gjyqësori, janë vazhdimisht nën kritikën për korrupsion, ndikime politike, drejtësi selektive, e shumë çka tjetër (GJSRK, 2015:4).

Siç e kemi theksuar në kapitullin e tretë, në Kosovë që nga hyrja në fuqi e ligjit të ri për Gjykatat më 2013, konfliktet administrative shqyrtohen nga Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Departamenti ka gjithashtu një divizion për çështjet fiskale. Gjetjet e hulumtimit të bërë dhe të analizës së të dhënave empirike tregojnë se në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka numër të madh të lëndëve dhe numër të vogël të gjyqtarëve. Gjithashtu, sipas analizës teorike dhe ligjore, shtetet që ishin rast studimi, kanë themeluar Gjykatat Administrative për trajtimin e

çështjeve administrative. Më poshtë pasqyrohen të dhënat empirike në formën grafike.

Pyetja e shtruar ishte se: *a ka arritur Departamenti për Çështje Administrative t'i përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e tij? Nëse jo, a janë shkaqe për këtë gjë numri i vogël i gjyqtarëve dhe numri i madh i çështjeve?*


Figura 7: Opinioni i gjyqtarëve për Departamentin për Çështje Administrative



Burimi: autori i punimit bazuar në hulumtim.

Të dhënat e mësipërme tregojnë opinionet e gjyqtarëve pjesëmarrës në këtë studim, ku në total 82.5% e gjyqtarëve pajtohen me faktin se Departamenti për Çështje Administrative nuk ka arritur t'i përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë, për arsye të numrit të vogël të gjyqtarëve dhe numrit të madh të çështjeve në ngarkim, ndërsa 15 % e gjyqtarëve të intervistuar janë deklaruar se nuk e dinë nëse Departamenti për Çështje Administrative ka arritur t'i përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e tij ose jo, për arsye të numrit të vogël të gjyqtarëve dhe numrit të madh të lëndëve.

Figura 8- Opinioni i gjyqtarëve për krijimin e Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatat Themelore




Burimi: autori në bazë të hulumtimit

Figura e mësipërm pasqyron opinionet e gjyqtarëve pjesëmarrës në këtë studim të cilët janë të mendimit se nuk duhet të krijohen Departamenti për Çështje Administrative në Gjykatat Themelore në qendra tjera.

Në lidhje me pyetjen e shtruar *se a duhet të themelohet Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme*, janë dhënë grafikisht opinionet e marra dhe të analizuara për këtë qëllim.


Grafiku 25: Opinioni i deputetëve për Themelimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme.



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron opinionet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ku në total 86.6% e deputetëve pjesëmarrës në këtë studim janë të mendimit se duhet të themelohet Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme, ndërsa 13.3% e deputetëve deklarojnë se nuk e dinë nëse është e nevojshme dhe a duhet të themelohet Gjykata e Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme e Kosovës.


Grafiku 26: Opinioni i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për themelimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron opinionin e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, ku në total 60% e gjyqtarëve deklarojnë se pajtohen me nevojën për krijimin në Kosovë të Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme. Ndërsa, 30% e gjyqtarëve nuk pajtohen dhe deklarojnë se nuk ka nevojë të themelohet Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme në Kosovë; dhe 10 % e gjyqtarëve deklarojnë se nuk e dinë a duhet të themelohet ose jo Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme.

Figura 9: Opinioni i gjyqtarëve të Gjykatave Themelore për krijimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme




Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Figura e mësipërme pasqyron opinionin e gjyqtarëve, ku në total 72.5 % e gjyqtarëve janë shprehur se pajtohen me krijimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme, ndërsa 15% e gjyqtarëve janë shprehur se nuk pajtohen me themelimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme dhe 12.5% e gjyqtarëve deklarojnë se nuk e dinë nëse duhet të themelohen këto gjykata. Pra, në bazë të hulumtimit të bërë dhe rezultateve të të dhënave, në Kosovë duhet të ndryshohet dhe plotësohet ligji për gjykatat si dhe të miratohet një ligj për Gjykatën Administrative.

Sipas ish-Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve në Gjykata Themelore të intervistuar, pranohet se “për çështjet administrative, do të duhej të krijoheshin Gjykatat Administrative si përgjigje ndaj sfidave të funksionimit të administratës shtetërore, dhe se ekzistenca e vetëm një Departamenti pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk paraqet zgjidhjen e duhur. Në Kosovë duhet të krijohet një Gjykatë Administrative Supreme, si një institucion i specializuar, që do të bënte kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë së punës së tërë administratës publike. E meta kryesore në Kosovë qendron në kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë, sepse po të ishte efektiv ky kontroll, atëherë do të krijonte një standard të caktuar të sjelljes së administratës publike. Kështu siç është gjendja, nuk ka një vijë të qartë të cilën duhet ta ndjekë

administrata publike, gjë që vërehet qartë në disa raste nga natyra arbitrare e vendimeve të administratës publike në Kosovë”.


Grafiku 27: Opinioni i zyrtarëve të lartë publikë për krijimin e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron opinionin e zyrtarëve të lartë publikë të përfshirë në hulumtim, nga të cilët 80% e deputetëve, 70% e gjyqtarëve dhe 55% e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësve civilë të nivelit drejtues deklarojnë se është e nevojshme të krijohet Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme. Për këtë çështje kemi edhe opinione kundër krijimit të Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme.

Grafiku 28: Opinioni i zyrtarëve të lartë publikë kundër krijimit të Gjykatës Administrative.



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.


Grafiku i mësipërm pasqyron opinionet e zyrtarëve të lartë publikë të cilët janë kundër themelimit të Gjykatës Administrative. Prej tyre, 20 % e deputetëve deklarojnë se janë kundër themelimit të ndonjë institucioni për kontrollin e administratës publike, pasi aktualisht ka institucione të mjaftueshme që merren me administratën, por vetëm duhet më tepër vullnet politik; se nuk ka nevojë për instrumentet shtesë të kontrollit të administratës publike, sepse ekzistojnë të gjitha institucionet e nevojshme; se ka legjislacion të mirë, por mungon vetëm zbatimi i tij. Ndërsa 30% e gjyqtarëve deklarojnë se nuk ka nevojë të krijohet ndonjë institucion tjetër për kontrollin e administratës publike, sepse ka mjaft institucione të tilla në Kosovë. Mirëpo, duhet një vullnet më i madh dhe një pavarësi më e plotë nga politika, që do të mundësonte një funksionim më të mirë të institucioneve.

Një pjesë e gjyqtarëve deklarojnë se nuk ka nevojë fare për krijimin e Gjykatës Administrative ose ndonjë institucioni tjetër për kontrollin e administratës publike në Kosovë, vetëm duhet të rritet numri i gjyqtarëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Departamentin për Çështje Administrative.

Pyetja tjetër: *si e vlerësoni, a ka ndërhyrje politike në punën e gjyqësorit, në rastet kur zyrtarët qeveritarë vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatave në media, nuk zbatojnë vendimet dhe i debatojnë vendimet gjyqësore?*

Një kornizë ideale ligjore nuk mund të garantojë vendime të pavarura, nëse vetë gjyqtarët nuk kanë vullnet të plotë që të marrin vendime duke u bazuar vetëm në ligj, por në vend të kësaj kanë tendencë të veprojnë referuar ndikimeve të jashtme (OSBE, 2009:8).

Figura: 10- Tregon opinionet e gjyqtarëve për ndërhyrje politike në punën e gjyqësorit



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Figura e mësipërme pasqyron opinionet e gjyqtarëve, ku në total 52 % e gjyqtarëve janë shprehur se pajtohen me faktin se ka ndërhyrje politike në punën e gjyqësorit, ndërsa 34% e gjyqtarëve nuk pajtohen se ka ndërhyrje të politikës në gjyqësor; dhe 14 % e tyre deklarojnë së nuk e dinë nëse ka ndërhyrje politike në veprimtarinë e gjyqësorit.

Në Kosovë sa i përket pavarësisë dhe paanshmërisë, ka pasur raste të ndërhyrjes politike në gjyqësor. Ka pasur edhe një përpjekje nga ana e Kuvendit për të hetuar një rast që kishte kaluar në të gjitha hapat e procedurës gjyqësore (rasti Kiqina). Në shqyrtimin e një çështje penale (që përfshin një kryetar komune), Gjykata

Kushtetuese duke marrë përsipër rastin dhe duke e referuar atë rast përsëri në Gjykatën Supreme për rishqyrtim, gabimisht sugjeroi se ajo mund të marrë përsipër të veprojë si gjykatë (shtesë) e shkallës së fundit (KE, 2013:11).

5.6. Ndikimi i kontrollit kushtetues në administratën publike–qasje analitike

Në pyetjen *sa keni arritur t'i përmbushni detyrat dhe përgjegjësitë tuaja (si gjyqtar/e), të mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë dhe të siguroni parimin e sundimit të ligjit në Kosovë*, perceptimi i përgjithshëm i të intervistuarve është se Gjykata Kushtetuese ka arritur t'i përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë, të mbrojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë dhe të sigurojë parimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Ish-Kryetari i Gjykatës Kushtetuese E. Hasani ka thënë se “gjatë mandatit tim, Gjykata ka vënë themelet e një praktike gjyqësore kushtetuese që vështirë se mund të tej kalohet lehtë. Në fakt, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës janë në Buletin e Komisionit të Venecias, si ndër më të shikuarat, dhe jashtë vendit është shkruar mjaft për to në mënyrë afirmative” (Hasani, 2015).

Në këtë hulumitim është bërë një analizë sa i përket kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave dhe institucioneve të tjera të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese (për kërkesat e paraqitura nga personat fizikë dhe juridikë). Në vijim pasqyrohen dy raste, si dhe të dhënat e tjera në formë grafike për kërkesat e parashtruara dhe vendimet e kontestuara.

Rasti i parë, Vendimi në Rastet KI58, KI66 dhe KI94/1 që lidhej me vendimet e Komunave për kushtëzimet e qytetarëve në qasje në shërbimet komunale me pagesën e obligimeve ndaj ndermarrjeve publike. Pra, objekt i çështjes së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ishte kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Komunës së Mitrovicës, Gjilanit dhe Vitisë për kushtëzimet e qytetarëve në qasje në shërbimet komunale me pagesën e detyrimeve ndaj ndermarrjeve publike. Me vendime të tilla, Komunitat i kushtëzonin qytetarët në qasjen të shërbimit komunale si: nxjerrjen e dokumenteve personale, regjistrimin e automjeteve, të lejes së ndërtimit, kthim të pasurisë së patundshme. Bizneset

“kushtëzohen” që më rastin e aplikimit për leje për regjistrim dhe leje të biznesit të tyre, të ofrojnë dëshmi se i kanë kryer obligimet (borxhet) ndaj ndërmarrjeve publike, ndërsa operatorët ekonomikë kushtëzohen me rastin e aplikimit për tenderim, ku duhet të dëshmojnë faturën se i kanë shlyer detyrimet ndaj ndërmarrjeve publike. Kjo metodë e kushtëzimit të qytetarëve për ofrim të shërbimeve aplikohet nga disa Komuna për të mbledhur tatimet më lehtë, dhe kjo ka rezultuar në mbushjen e arkës së Komunave dhe mbledhjen e borxhit të ndërmarrjeve publike. Vendime të tilla kishin nxjerrë shumë Kuvende Komunale, për mos ofrimin e një shërbimi të caktuar nga drejtoritë e administratës komunale ndaj personit fizik dhe juridik deri në përmbushjen e detyrimit nga ana e tij të pagesës së tatimit në pronë, faturave për mbeturina dhe ujë. Në disa komuna janë shfuqizuar këto vendime të Kuvendit të Komunës.⁵⁰⁹


Rasti i dytë, Aktvendimi në Rastin Nr. KI30/14, që lidhej me kërkesat e nëpunësve civilë që kontestonin njoftimin e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) nr.4278, të 29 gushtit 2013, për largimin nga lista e pagave të nëpunësve civilë të cilët ishin zgjedhur si anëtarë të kuvendeve komunale. Ministria e Administratës Publike me njoftimin nr.4278, të 29 gushtit 2013, i kishte informuar të gjithë nëpunësit civilë për të drejtat dhe detyrimet sipas Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, të cilët do të dëshironin të kandidonin në zgjedhjet komunale të vitit 2013, të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës. Parashtruesit e kësaj kërkesë ishin nëpunës civilë në institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Gjykata konstaton se parashtruesit e kësaj kërkesë kanë dështuar të provojnë se i kanë shteruar mjetet efektive juridike në dispozicion, sipas ligjit në fuqi. Në këtë kontekst, parashtruesit para së të dorëzonin kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese, do të duhej të kishin shteruar të gjitha mundësitë në procedurën administrative, përkatësisht të kërkonin zgjidhjen e çështjes së tyre brenda MAP-it dhe më pas në gjykatën kompetente, përkatësisht në Departamentin për Çështje

⁵⁰⁹Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për heqje të kërkesës nga lista në Rastet KI58, KI66 dhe KI94/12, Prishtinë, 5 korrik 2013, Nr. Ref.VTK 466/13

Administrative. Gjykata konstaton së kërkesa e parashtruesve nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, pasi parashtruesit nuk i kanë shteruar mjetet efektive juridike të parapara me ligj.⁵¹⁰ Në formë grafike, më poshtë pasqyrohen kërkesat e parashtruara dhe vendimet e kontestuara.

Grafiku 29: Kërkesa të parashtruara nga personat fizikë dhe personat juridikë në Gjykatën Kushtetuese prej vitit 2010 deri në dhjetor 2016




Burimi: bazuar në të dhënat e raporteve vjetore 2010-2016 të Gjykatës Kushtetuese, të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron se janë parashtruar 1170 kërkesa nga persona fizikë dhe juridikë, ku 1048 janë kërkesa të parashtruara nga individët për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të gjykatave dhe institucioneve të tjera, për pretendime që lidhen me shkelje të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ndërsa personat juridikë (Qeveria, gjykatat, subjektet politike, kompanitë private, sindikatat dhe organizatat religjioze) kishin parashtruar 122 kërkesa.

⁵¹⁰ Aktvendim për papranueshmëri në Rastin Nr. KI30/14 Parashtrues Zymrije Haxhimusa, Ekrem Abazi, Ferinaze Isufi, Avdullah Hoxha dhe Hyzri Delolli Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së njoftimit të Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës, Nr. 4278, të 29 gushtit 2013 Prishtinë, me 14 korrik 2014 Nr.ref.:RK674/14

Grafiku 30: Vendimet e institucioneve gjyqësore dhe insitucioneve shtetërore të kontestuara për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore



Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve vjetore të Gjykatës Kushtetuese të përpunuara nga autori i punimit.⁵¹¹

Grafiku i mësipërm pasqyron se prej janarit 2009 deri në dhjetor 2015, në Gjykatën Kushtetuese janë parashtruar kërkesa për vlerësimin kushtetues të 1094 vendimeve, prej të cilave 909 vendime të gjykatave të rregullta, të cilat kontestoheshin për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, ndërsa 185 janë kërkesa për vlerësimin kushtetues të vendimeve të institucioneve shtetërore apo të institucioneve të tjera publike. Këto vendime janë kontestuar për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore si kategori kushtetuese.

5.7. Kontrolli i administratës publike nga Avokati i Popullit – trajtim analitik

Avokati i Popullit mbron, mbikëqyr dhe promovon të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të institucioneve qendrore dhe lokale.

⁵¹¹Gjykata Kushtetuese, Raportet vjetore 2009 -2015, të dhënat të përpunuara nga autori i punimit.

Në pyetjen se *a po respektohen të drejtat dhe liritë e personave fizikë dhe juridikë nga autoritetet publike në Kosovë*, janë marrë edhe përgjigjet përkatëse të trajtuara në vijim.


Më 1999, UNMIK-u nuk e njohu njërin nga principet themelore të demokracisë, ndarjen e pushtetit. Një nga veprimet e hershme të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara, ishte shpallja e një Rregulloreje të UNMIK-ut me të cilën i veshi vetes tërë pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ. Gjithashtu i lejoi vetes autoritetin administrativ mbi gjyqësorin. PSSP-ja mund të vepronte jashtë kufijve të kontrollit gjyqësor për të kufizuar apo mohuar të drejtat themelore të individëve në Kosovë. Për shembull, ai e ka ushtruar këtë fuqi për të larguar kandidatët nga lista zgjedhore dhe për të pezulluar vendimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë për të liruar individë të caktuar nga paraburgimi. Individët në Kosovë janë paraburgosur pa kurrfarë vendimi apo kontrolli gjyqësor, ose nga PSSP-ja ose nga Komandanti i KFOR-it.⁵¹² Largimi i një kategorie të caktuar të ankesave lidhur me të drejtat e njeriut nga juridikcioni i gjykatave, vendosja e tyre nën kontrollin e organeve administrative të UNMIK-ut dhe pamundësia që vendimet e marra të shqyrtohen në pajtim me ligjin, konfirmon që shkrirja e funksioneve ekzekutive me ato legjislative, së bashku me anulimin e rolit të gjyqësisë nuk ka shërbyer në interes të të drejtave të njeriut në Kosovë.⁵¹³ Ndërsa Rekomandimet e Ombudspersonit dhe të tjerëve, që regjimi ligjor që qeveris paraburgimet t'i kthehet autoritetit dhe kontrollit gjyqësor, në pajtim me të gjitha standardet relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, janë injoruar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/38, Ombudspersonit nuk i lejohej të ushtronte çfarëdo autoriteti, t'i adresojë KFOR-it lidhur me praktikën paralele të paligjshme

⁵¹²Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, Raporti i Parë Vjetor 2000 – 2001, adresuar z. Hans Hakerup Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, 18 korrik 2001, Aneksi 1 Përmbledhja e Çështjeve 21 nëntor 2000 deri më 30 qershor 2001, fq.1

⁵¹³Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, Raporti i tretë Vjetor 2002 – 2003, drejtuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, 10 korrik 2003, Aneksi 1: Përmbledhje statistikore e rasteve (30 korrik 2002 deri më 30 qershor 2003), fq.4,5.

të tyre lidhur me këtë çështje.⁵¹⁴ Paraqesim më poshtë të dhënat për numrin e kërkesave dhe të ankesave të paraqitura nga qytetarët në IAP, rastet e mbyllura dhe raste të mbyllura pozitivisht prej vitit 2001-2008.

Grafiku 31: Numri i kërkesave formale dhe ankesave, si dhe rasteve të zgjidhura pozitivisht



Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve të IAP⁵¹⁵ të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron se prej vitit 2001 deri në 2008, qytetarët në IAP kanë paraqitur gjithsej 3836 kërkesa dhe ankesa, ku të shpallura të papranueshme ishin 1387 kërkesa dhe ankesa, kurse raste të mbyllura të zgjidhura pozitivisht në pajtim me kërkesën e ankuesit ishin 1050 raste.


Sipas Kurteshit “shkelja e ligjit nga vetë autoritetet publike dhe sidomos veprimi jo etik, qoftë edhe në një rast të vetëm individual, i cili mbetet i pasanksionuar, janë dy veprime që shlyejnë tërësisht çfarëdo besimi tek shteti dhe përbëjnë dëshminë kyçe

⁵¹⁴Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë Raporti i Parë Vjetor 2000 – 2001, adresuar z. Hans Hakerup Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara 18 korrik 2001, Aneksi 1 Përmbledhja e Çështjeve 21 nëntor 2000 deri më 30 qershor 2001, fq.2.

⁵¹⁵Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë Raporti vjetor 2001, Raporti vjetor 2002, Raporti vjetor 2003, Raporti vjetor 2004, Raporti vjetor 2005, Raporti vjetor 2006, Raporti vjetor 2007, Raporti vjetor 2008.

të keqadministrimit dhe dështimit të një sistemi të administratës”.⁵¹⁶ Të dhënat për përkatësinë etnike pasyqohen në grafikët më poshtë.

Grafiku 32: Përkatësia etnike e parashtruesve të kërkesave dhe ankuesve prej vitit 2001 deri në 2008




Burime: bazuar në të dhënat e Raporteve të IAP⁵¹⁷, të përpunuara nga autori i punimit.

Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun e mësipërm, në lidhje me përkatësinë etnike të ankuesve në IAP prej 2001 deri në 2008, ishin gjithsej 2544 shqiptarë, 906 serbë dhe 302 të përkatësive të tjera etnike. Në grafikë paraqiten palët përgjegjëse.

⁵¹⁶Kurteshi Sami, Avokati i Popullit në Raportin Vjetor 2013, Nr. 13, dt.31 mars 2014, Prishtinë, fq.4

⁵¹⁷Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë Raporti vjetor 2001, Raporti vjetor 2002, Raporti vjetor 2003, Raporti vjetor 2004, Raporti vjetor 2005, Raporti vjetor 2006, Raporti vjetor 2007, Raporti vjetor 2008

Grafiku 33: Palët përgjegjëse për kërkesa dhe ankesa




Burime: bazuar në të dhënat e Raporteve të IAP⁵¹⁸, të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm pasqyron se gjithsej në 1243 kërkesa dhe ankesa e parashikonin si palë përgjegjëse UNMIK-un, mandej autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP ishin Komunitet me 619 raste, Gjykatat 466 raste, Ministritë në 405 raste e kështu me radhe Institucionet tjera. Ish Avokati i Popullit, Kurteshi thekson se “sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës çdo person ka në dispozicion një varg mjetesh ligjore për të kërkuar drejtësinë në raste të shkeljeve të tilla. Mirëpo, këto mjete, në radhë të parë duhet të jenë të qarta dhe efektive. Së dyti, mekanizmat për zbatimin e tyre duhet të jenë efikase dhe të përgatitura për t’u ballafaquar me raste të tilla. Gjendja aktuale e administratës publike, përfshirë edhe gjyqësorin në Republikën e Kosovës, është e tillë që ajo nuk është gjithmonë në gjendje të ballafaqohet me raste të tilla, sidomos brenda një afati të arsyeshëm kohor. Trajtimi dhe zgjidhja e rasteve individuale të shkeljeve të ndryshme, më shumë se punë e

⁵¹⁸Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë Raporti vjetor 2001, Raporti vjetor 2002, Raporti vjetor 2003, Raporti vjetor 2004, Raporti vjetor 2005, Raporti vjetor 2006, Raporti vjetor 2007, Raporti vjetor 2008

Avokatit të Popullit, duhet të jetë punë e vetë autoriteteve publike.”⁵¹⁹ Të dhënat për gjendjen e respektimit të të drejtave të njeriut pas pavarësisë së Kosovës, pasqyrohen në formë grafike më poshtë.

Grafiku 34: Ankesat, rastet e mbyllura dhe rastet e mbyllura pozitivisht



Burimi: bazuar në të dhënat e raporteve të Avokatit të Popullit⁵²⁰ të përpunuara nga autori i punimit.

Të dhënat e pasqyruara me lart tregojnë rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në ngritjen e vetëdijesimit të qytetareve dhe rritjen e besimit të qytetareve të ky Institucion me vetë faktin se nga 1 janari 2010 deri me 17 dhjetor 2017 ka pranuar 14,090 ankesa nga personat fizik dhe juridik, prej tyre 7,441 ankesa janë shpallur të papranushme kurse janë mbyllur 4,487 raste. Rastet të mbyllura të zgjidhura pozitivisht në pajtim me kërkesën e ankuesit janë 2393 raste, që do të thotë Avokati Popullit ia rivendosi të drejtën e shkelur individëve.

Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP ishin: Gjykata, Ministrinë, Komunitet, Prokuroritë Shtetërore, Policia dhe institucione tjera. Rritja e numrit të ankesave nga qytetaret, të cilët pretendojnë së të drejtat dhe lirite të garantuara me kushtetute ju janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të institucioneve qendrore dhe lokale. Zgjidhje e një numri të rasteve në pajtim me kërkesën e ankuesit është një indikator që tregon se nuk po respektohen të

⁵¹⁹Kurteshi Sami Avokati i Popullit në Raportin Vjetor 2013 Nr. 13 me 31 mars 2014 Prishtinë Fq.4

⁵²⁰Institucioni I Avokatit të Popullit Raportet vjetore 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe Statistikat preliminare prej janarit deri 17 dhjetor 2017 të dorëzuara autorit të punimit.

drejtat e njeriut në Kosovë. Në vijim kemi pasqyruar lëndët e rasteve të hetuara nga IAP në formë tabele.

Tabela 7: Lëndët e rasteve të hetuara nga Institucioni i Avokatit: janarit 2010-dhjetor 2017.

Lënda e rasteve të hetuara	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Totali
E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	68	111	163	143	180	228	259	243	1395
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	36	81	89	59	63	109	152	152	741
E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	65	102	63	63	82	110	146	121	752
Mbrojtja e pronës	73	81	74	157	95	118	143	105	846
E drejta për mjete juridike	99	76	77	68	52	79	93	146	687
Të drejtat e të akuzuarit	10	5	4	30	34	55	65	53	265
Barazia para ligjit	28	21	44	23	26	53	59	32	286
Të drejtat e fëmijës	5	13	12	10	26	22	53	32	173
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	7	14	21	23	39	27	16	12	159
E drejta për arsimin	5	12	15	8	26	22	27	15	130
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	10	18	13	18	18	17	18	7	119

Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve të Avokatit të Popullit⁵²¹ të përpunuara nga autori i punimit.

Numri më i madh i rasteve që janë hetuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara) gjatë periudhës janar 2010 deri 17 dhjetor 2017, kanë qenë të lidhura kryesisht me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen e pronës, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën për mjete juridike, të drejtat e të akuzuarit për barazinë para ligjit, të drejtat e të akuzuarit, të drejtat e fëmijës, ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, e drejta për arsimin, mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe të drejtat e tjera të garantuara me Kushtetutë.

Sipas ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Hasani “në Kosovë, çdo ditë shkelen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kosova një ditë do të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës dhe për pasojë, edhe e Gjykatës së Strasburgut. Kosova para se të bëhet

⁵²¹ Avokati i Popullit Raporti vjetor 2016 fq.190,191 Raporti vjetor 2015 fq.121, Raporti vjetor 2014 fq.185, Raporti vjetor 2013 fq.162, Raporti vjetor 2012 fq. 147,148 , Raporti vjetor 2011 fq.147,148, Raporti vjetor 2010 fq. 130.131 , Statistikat preliminare të Avokatit të Popullit për vitin 2017 (deri me datën 17-12-2017).

anëtare duhet të këtë një buxhet rezervë për përgjegjësinë që ka shteti i Kosovës ndaj shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut këto 10 vite shtet. Për Kosovën do të jetë shumë me dramatike se sa rasti i Shqipërisë, Turqisë e shumë vendeve të tjera që janë klientë të rregullt të Gjykatës së Strasburgut.” [Hasani, 2018].


Sipas opinionit të Avokatit të Popullit (Jashari,) dhe Zëvendës Avokatit të Popullit (I., Hasani), mosrespektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, përkatësisht shkelja e tyre është pasojë e moszbatimit të ligjit nga autoritetet publike, të cilat janë të autorizuar ligjërisht për zbatimin e tij, por në disa raste është edhe si rezultat i mosnxjerrjes në kohë të akteve nënligjore për zbatimin e ligjit, por dhe të vendimeve administrative. Nga Raporti vjetor i punës së Avokatit të Popullit, vërehet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, si të personave fizikë, ashtu edhe të atyre juridikë. Në të gjitha rastet e konstatuara të shkeljeve, Avokati i Popullit ka ndërmarrë veprime ligjore ndaj autoriteteve publike, duke rekomanduar evitimin e shkeljeve të të drejtave (Jashari, 2016 & Hasani, 2014). Sipas Avokatit të Popullit, Jashari “pjesa dërrmuese e mos zbatimit të rekomandimeve deri më tani vjen nga sistemi gjyqësor dhe nga administrata publike, përkatësisht Qeveria e vendit, që përfshin të dyja nivelet si nivelin lokal ashtu dhe atë qendror. Një pjesë e madhe, sidomos nga niveli lokal vijnë për shkak të mos informimit adekuat lidhur me detyrimet që kanë nga rekomandimet e Avokatit të Popullit. Sipas tij, kjo është e drejtë e cila është marrë nga Konventa Evropiane, që gjithashtu është e zbatueshme në sistemin tonë juridik. Mirëpo, pjesa më e madhe e qytetarëve nuk e gëzon këtë të drejtë, pasi të gjitha rastet e tyre në një afat mesatar mbi bazën e vlerësimit që është bërë, zgjatin diku mbi 8.5 vite për të përfunduar një procedurë nga gjykatat”⁵²² që është në kundërshtim flagrant me Kushtetutën, ligjet dhe Konventat Ndërkombëtare.⁵²³

⁵²² Jashari Hilmi, në tryezë diskutimi lidhur me moszbatimin e rekomandimeve nga ana e Avokatit të Popullit e mbajtur nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut. Bota sot më 26 Shkurt 2018 në ora:11:36. Shih: <http://www.botasot.info/aktuale-lajme/841417/gjate-2016-institucionet-publike-zbatuan-59-rekomandime-te-avokatit-te-popullit>.

⁵²³ Jashari Hilmi, në tryezë diskutimi lidhur me moszbatimin e rekomandimeve nga ana e Avokatit të Popullit e mbajti Komisioni për të Drejtat e Njeriut. shih: <http://www.arbresh.info/lajmet/49-per-qind-e-rekomandimeve-te-avokatit-te-popullit-nuk-zbatohen>.

Në vijim pasqyrohet në formë grafike zbatimi i rekomandimeve për periudhën janar 2012 deri në dhjetor 2016.

Grafiku 35: Zbatimi i Rekomandimeve të Avokatit të Popullit



Burimi: bazuar në të dhënat e Raporteve vjetore të Avokatit të Popullit për vitin 2012 deri në dhjetor 2016, të përpunuara nga autori i punimit.

Grafiku i mësipërm jep një pasqyrim të qartë se institucionet e Kosovës nuk i implementojnë në tërësi rekomandimet e Avokatit të Popullit. Sipas ish-Avokatit të Popullit, Kurteshi (Deputet nga LVV në Kuvendin e Kosovës) “nevojitet të krijohet një Komision ad-hoc në kuadër të Kuvendit që do të merrej me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit”.⁵²⁴ Avokatit i Popullit Jashari deklaroi se “në të gjitha rastet kur ka vërejtur se një normë ligjore shkel të drejtat dhe liritë e njeriut, Avokati i Popullit ka rekomanduar Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit përkatës. Gjithashtu, në disa raste, bazuar në kompetencat kushtetuese të Avokatit të Popullit, në Gjykatën Kushtetuese kemi parashtruar kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve të ndryshme apo edhe të çështjeve të ndryshme ligjore”. (Jashari, 2016).

⁵²⁴Kurteshi Sami, në tryezë diskutimi lidhur me moszbatimin e rekomandimeve nga ana e Avokatit të Popullit e mbajtur nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut. shih bota sot më : 26 Shkurt 2018 në ora :11:36

shih webfaqe: <http://www.botasot.info/aktuale-lajme/841417/gjate-2016-institucionet-publike-zbatuan-59-rekomandime-te-avokatit-te-popullit>.

Avokati i Popullit është institucion i pavarur, është një vlerë e shtuar e shoqërisë që bën mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga institucionet e administratës publike në Kosovë. Prandaj, rritja e besimit të qytetarëve të Avokati i Popullit si dhe rivendosja e të drejtave të shkelura nga institucionet në favor të qytetarëve, është shumë pozitive.

5.8. Krijimi i institucioneve të reja për kontrollin e administratës publike

Lidhur me problematikën e çështjes nëse Kosova i ka krijuar të gjitha institucionet për kontrollin e administratës publike, gjatë hulumtimit kemi parashtruar pyetjen: *A ka nevojë të krijohet edhe ndonjë institucion tjetër për kontrollin e administratës publike në Kosovë? Nëse po, çfarë institucioni dhe cilat do të ishin kompetencat e tij?*

Sipas ish-Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Krasniqi “Kosova nuk vuan për mungesë të Institucioneve. Mund të thuhet se ka shumë institucione dhe ato vuajnë nga jo kompetenca. Inkompetenca është sëmundja më e madhe e institucioneve tona.” Ndërsa sipas ish-Kryetarit të Kuvendit, Daci “Kosova nuk ka pasur nevojë për Gjykatë Speciale. Nevojën e themelimit të saj mjerisht e ka sjellë politika në Kosovë. Ajo që nuk ka ngjarë askund në Evropë është që jashtë gjykatës ndërkombëtare, për një vend që është shkatërruar nga fashizmi serb, krijohet një Gjykatë Speciale, me seli jashtë Kosovës dhe me preteks se do të jetë në kuadër të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës” (Daci, 2015). Sipas Avokatit të Popullit, Jashari “Avokati i Popullit nuk ka pasur ndonjë rekomandim për krijimin e institucioneve të tjera për kontrollimin e administratës publike, por kërkon vetëm zbatimin e ligjit nga institucionet ekzistuese të kontrollit të administratës publike.” (Jashari, 2016). Sipas opinionit të një grupi të zyrtarëve të lartë publikë të përfshirë në hulumtim, është e domosdoshme që këto instrumente që merren me kontrollin e administratës publike, të fuqizohen për të ushtruar funksionet e tyre kushtetuese dhe ligjore. Por një grup i zyrtarëve të lartë publikë pohojnë se Kosova ka mungesë të institucioneve të kontrollit të administratës publike, dhe se kontrolli i administratës

publike nuk është në nivelin e duhur, sidomos tek ato institucione të administratës publike, të cilat themelohen nga Kuvendi i Kosovës. Duhet të fuqizohet roli i Kuvendit për monitorimin e zbatimit të ligjeve. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës duhet të fuqizohet po ashtu, dhe duhet të zbatohen vendimet e tij. Kuvendi do duhet të luajë një rol më aktiv.

Ndërsa, 45 % e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësve civilë drejtues deklarojnë se disa institucione duhet të shuhen, sepse vetëm kanë krijuar konfuzion në sistemin e kontrollit, si për shembull: Agjensia Kundër Korrupsionit nuk ka nevojë të ekzistojë sepse rastet e abuzimeve dhe keqpërdorimeve duhet të shkojnë direkt në prokurori dhe gjykata. Duhet të forcohet roli i institucioneve të ministrive, komunave dhe ndërmarrjeve publike, që puna e tyre dhe shërbimet të jenë më transparente, në mënyre që të eliminohen procedurat burokratike që çojnë shpesh tek elementet korruptive. Opsioni i vetëm dhe çelësi është zbatimi i ligjit. Po kështu, është shprehur opinioni se ka nevojë të krijohet një Agjensi e Pavarur për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Administratës Shtetërore, e cila do të raportojë drejtpërdrejt në Kuvend. Themelimi i një agjensie të tillë do të ndikonte në efikasitetin e punës së administratës shtetërore, dhe do të rriste llogaridhënien e zyrtarëve që janë bartës të kësaj administrate, gjë që aktualisht nuk po ndodh. Kosovës i mungon Inspektorati i Administratës Shtetërore, i cili do të ketë kompetencë kontrollin e organeve të administratës shtetërore, mbikëqyrjen, inspektimin, ndëshkimin, etj. Gjithashtu, është e nevojshme forcimi i kapaciteteve të administratës shtetërore, Auditorit të Përgjithshëm dhe auditorëve të brendshëm, inspektoriateve të fushave përkatëse, etj. Nga hulumtimi i bërë kontrollit gjyqësor të administratës publike dhe nga rezultatet e të dhënave empirike ***vërtetohet nënhipoteza e parë*** e ngritur se: fuqizimi i mekanizmave aktualë të kontrollit të administratës dhe themelimi i Gjykatës Administrative për kontrollin e ligjshmërisë së punës së administratës publike janë faktorë për të krijuar një shtet të së drejtës, qeverisje të mirë në Kosovë, me institucione funksionale, një shoqëri demokratike dhe integrim në Bashkimin Evropian.

Sipas hulumtimit të bërë dhe rezultateve të të dhënave në Kosovë, rezulton se shpesh vendimet për masat disiplinore për shkelje të Kodit të Etikës ndaj nëpunësit civil dhe të punësuarit me statusin e nëpunësit publik, janë marrë në mënyrë arbitrare e jo në proporcion me shkeljet e bëra nga të punësuarit në institucione qendrore, lokale dhe institucione dhe agjensi të pavarura. Në shumë raste, komsionet disiplinore janë emëruar në baza politike, nepotizimi, me persona pa përvojë në shërbimin civil dhe meritë për të punuar në shërbimin civil, e që kanë marrë edhe vendime të kundërligjshme. Me këto vendime arbitrare të komsioneve disiplinore është dëmtuar buxheti i shtetit. Këshilli Mbikëqyrës i Pavarur i Shërbimit Civil, Inspektoriat i Punës dhe gjykata kompetente kanë konstatuar se janë marrë vendime pa respektuar procedurat ligjore. Gjykatat në shume raste kanë marre vendime në favor të nëpunësve civilë dhe publikë për kthimin në vendin e punës, dhe janë detyruar institucionet të dëmshpërblejnë individët për pagat.

Në Kosovë, shihet e nevojshme të formohet një Këshill Etike për administratën publike dhe anëtarët e Këshillit të kenë mandat të vlerësimit të respektimit apo shkeljes së etikës dhe Kodit etik. Anëtarë të Këshillit duhet të jenë: ish-gjyqtarë, ish-Avokat Populli dhe ish-nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësit drejtues që kanë treguar një profesionalizëm dhe etikë të lartë gjatë karrierës. Këtij Këshilli do të kenë të drejtë t'i drejtohen të gjithë nëpunësit civilë, nëpunësit publikë dhe zyrtarët e lartë publikë.

Nga të gjeturat e hulumtimit dhe rezultatet e të dhënave empirike, vërtetohet se instrumentet e kontrollit të administratës publike duhet të fuqizohen. Së pari, Kuvendi duhet të mbikëqyrë dhe kontrollojë administratën publike sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore dhe të kërkojë llogari nga institucionet të cilat kanë detyrim kushtetues dhe ligjor t'i raportojnë Kuvendit. Duhet të riorganizohet administrata publike në vijë horizontale, sepse ka shumë institucione dhe agjensi në kuadër të Kuvendit dhe organe qendrore të administratës shtetërore me emërtime të ndryshme në kuadër të Qeverisë, për të mënjanuar duplikimin e institucioneve. Në vijë vertikale, duhet të përcakohet në mënyrë të qartë mbikëqyrja dhe llogaridhënia, si dhe raportimi i këtyre institucioneve dhe agjensi në kuadër të Kuvendit dhe

agjensive në kuadër të Qeverisë. Së dyti, del si domosdoshmëri një zbatim më i mirë në praktikë i dispozitave ligjore nga institucionet qendrore e lokale, si dhe detyrimi i tyre që të zbatojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Së treti, është e nevojshme të krijohet edhe Gjykata Administrative në nivelin e parë dhe Gjykata Administrative Supreme, si gjykatë e veçantë kompetente, e cila do të zgjidhë të gjitha çështjet administrative. Kontrolli gjyqësor nga gjykata administrative do të ndikojë në rritjen e cilësisë së administrimit dhe të qeverisjes së mirë. Gjykata administrative, përveç që do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve të administratës publike, do të ndikojë edhe në rritjen e besimit të qytetarëve të institucionet dhe drejtësia. Krijimi i gjykatës administrative dhe emërimi i gjyqtarëve të cilët janë specializuar në fushën administrative dhe kushtetuese dhe fushën juridiko financiare, do të jenë garantuese për gjykimin e çështjeve administrative në mënyrë më profesionale, brenda afateve ligjore më të shpejta dhe të arsyeshme.

Subjektet, për të mbrojtur një të drejtë të garantuar me dispozita kushtetuese dhe ligjore, nuk do të presin më me vite. Do të reduktohen shpenzimet gjyqësore për subjektet, do të bëhet shqyrtimi gjyqësor brenda afatit ligjor, dhe nuk do të dëmtohet buxheti i shtetit, siç ka ndodhur në disa raste. Institucionet kanë larguar nga puna në mënyrë të padrejtë nëpunës civilë apo zyrtarë nga organet qendrore dhe lokale. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK) si shkallë e dytë administrative, ka evidentuar se mjaft vendime të largimit nga puna janë të padrejta. Gjithashtu, kthimi në punë me vendime gjyqësore pas një procesi gjyqësor pas disa viteve dhe pagesa e pagave në mënyrë retroaktive, deri më tani ka dëmtuar buxhetin e shtetit.

Së fundi, në Kosovë ka nevojë të formohet një Këshill për Etikën në administratën publike dhe anëtarët e Këshillit duhet të kenë mandat për vlerësimin e respektimit apo shkeljes së etikës.

5.9.Kontrolli i administratës publike, faktor për një qeverisje të mirë në Kosovë


Lidhur me problematikën se si të arrihet të një qeverisje e mirë në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës, në hulumtim kemi parashtruar pyetjen: *çfarë masa duhet të ndërmerren që të kemi një qeverisje të mirë në Kosovë, që të rritet besimi i qytetarëve të institucionet shtetërore?*

Sipas Avokatit të Popullit “krijimi dhe zhvillimi i kulturës së qeverisjes dhe administrimit të mirë, kërkon administratë profesionale, efikase dhe efektive, transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të administratës publike ndaj qytetarëve, që ndikon në forcimin dhe zhvillimin e sundimit të ligjit, ndikon në rritjen e besimit të qytetarëve në administratën publike, sistemin gjyqësor dhe autoritetet e tjera publike.” Sipas Ministres Tahiri “etika në qeverisje dhe etika e atyre që qeverisin, duhet të jenë në nivelin e duhur, ku interesi i qytetarëve dhe interesat nacionalë janë mbi çfarëdo interesi të ngushtë apo personal.Lufta efektive kundër korrupsionit dhe ndëshkimi i merituar i të korruptuarave, si dhe pamundësimi i tyre të marrin detyra qeveritare, do të ishin masat e duhura. Reforma në drejtësi duhet të plotësohet me hartimin dhe aprovimin e ligjit për dekriminalizimin, për të nxjerrë nga politika dhe qeverisja të korruptuarit”.

Sipas opinionit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësve civilë të nivelit drejtues në ministri, me fillimin e aplikimit *online* të prokurimit publik elektronik (E-Prokurorimi) dhe me vullnet politik, të gjitha fenomenet e shfaqura do të eliminohen dhe do të ketë një qeverisje shumë më të mirë në administratën shtetërore.

Për të arritur një qeverisje të mirë në Kosovë, duhen njerëzit e duhur, me aftësitë e duhura, në kohën e duhur dhe në vendin e duhur, si dhe forcimi i gjykatave, disiplina në polici, si dhe forcimi i mekanizmave të tjerë, si: auditimi financiar i jashtëm i institucioneve. Sipas opinionit të këshilltarëve politikë në MAP dhe në MAPL, zbatimi i dispozitave kushtetuese dhe ligjore nga të gjitha institucionet si në nivelin qendror ashtu dhe lokal, merr rëndësi të veçantë.

Figura 11: Opionioni i deputetëve për masat të cilat duhet të ndërmerren për qeverisje të mirë.




Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Figura e mësipërme pasqyron opinionet e deputetëve për masat të cilat duhen të merren në të ardhmen, që në Kosovë të kemi një qeverisje të mirë, që do të ndikojë në rritjen e besimit të qytetarëve të institucionet shtetërore. Sipas opinionit të të intervistuarve, 90.9 % e deputetëve deklarojnë se kryesore për një qeverisje të mirë është sundimi i ligjit ndërsa, 68.2 % mendojnë se si masë për një qeverisje të mirë është ndëshkimi i merituar i të korrptuarave dhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies. Mandej, 63.6% e deputetëve shohin si masë rritjen e vullnetit politik, forcimin e mekanizmave të kontrollit të administratës publike dhe punësim të nëpunësve publikë në bazë të meritave e jo në bazë të nepotizimit dhe militantizmit partiak. Kurse, 50 % e deputetëve janë shprehur se si masë për qeverisje të mirë është etika në qeverisje dhe etika e atyre që qeverisin si dhe krijimi dhe zhvillimi i kulturës së qeverisjes dhe administrimit të mirë, etj.

Kontrolli nga Kuvendi i Kosovës do të luajë një rol të rëndësishëm gjatë ushtrimit të funksioneve, dhe do të promovojë demokracinë parlamentare, ekzistencën e një parlamenti i cili në mënyrë aktive do të kontrollojë qeverinë dhe performancën e të gjitha Institucioneve/Agjensive të Pavarura të cilat i raportojnë Kuvendit.

Në vijim kemi pasqyruar opinionin e gjyqtarëve në Gjykata Themelore.

Figura 12: Tregon opinionin e gjyqtarëve për masat që duhet të ndërmerren për qeverisje të mirë.



Burimi: autori i punimit në bazë të hulumtimit.

Figura pasqyron opinionin e gjyqtarëve se cilat masa duhet të merren në të ardhmen në Kosovë, që të ketë qeverisje të mirë. Sipas opinionit të gjyqtarëve, 71.8% e gjyqtarëve deklarojnë se si masë kryesore është sundimi i ligjit, kurse 50.7% e gjyqtarëve janë shprehur se si masë që kërkohet të merret në të ardhmen për një qeverisje të mirë, është ndëshkimi i merituar i të korruptuarve, rritja e transparencës dhe llogaridhënies dhe forcimi i mekanizmave të kontrollit të administratës publike. Ndërsa, 49.3% e gjyqtarëve pohojnë se si masë kryesore është rritja e vullnetit politik dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe të gjitha masat e sipërpërmendura.

Kontrrolli i administratës publike në të gjitha format e saj do të ndikojë në qeverisjen e mirë në Kosovë. Qeverisja e mirë nuk është më luks për asnjë shtet, madje është domosdoshmëri për Kosovën, si një shtet i ri. Me qeverisje të mirë në Kosovë dhe sundim të ligjit, respektim të të drejtave të njeriut dhe barazi politike, do të ketë një qëndrueshmëri më të madhe zhvillimore, ekonomike dhe sociale.

Nga hulumtimi i bërë dhe rezultatet e të dhënave empirike, **vërtetohet hipoteza bazë** se: kontrolli i administratës publike është faktor kryesor për funksionimin e një

administratë publike të qëndrueshme, profesionale, të përgjegjshme, transparente, llogaridhënëse për përmirësimin e qeverisjes së mirë në Kosovë.

Të intervistuarit e përfshirë në këtë hulumtim kanë deklaruar se “Mediat mund të kontribuojnë për qeverisje të mirë, me pasqyrimin sa më të saktë dhe korrekt të gjërave, pa anshmëri politike apo partiake, duke u bazuar në parimin e së vërtetës për çdo gjë dhe në të mirë të lexuesit-opinionit publik. Mediat janë ato që mund ta detyrojnë një qeveri të jetë transparente dhe e përgjegjshme. Po kështu, angazhimi i përhershëm i shoqërisë civile, mund të bëjë që institucionet lokale dhe ato qendrore të rrisin nivelin e transparencës dhe nivelin e performancës para qytetarëve.

KAPITULLI VI: KONKLUZIONE

Nga shqyrtimet teorike të përgjithshme të instrumenteve të kontrollit të administratës publike, u ndalëm në trajtimin përkatësisht të kontrollit politik, të brendshëm, kontrollit kushtetues, financiar dhe mekanizmeve të tjerë të cilët kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e mirëqeverisjes të administratës publike. Në pajtim me qasjen krahasimore të përgjithshme dhe qasjen analitike–empirike të punës së Kuvendit, Qeverisë, Gjykatave, Gjykatës Kushtetuese, Avokatit të Popullit, Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe institucioneve të tjera mbikëqyrese të administratës publike, kemi dalë në disa konkluzione.

Nga analiza krahasuese e instrumenteve të kontrollit të administratës publike në Republikën e Kosovës me instrumentet e kontrollit të administratës publike në Republikën e Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë, nuk ka dyshim se mund të nxirren një varg përfundimesh të bazuara, por në këtë rast, për arsye të natyrës së kufizuar të punimit, po paraqesim disa konstatime në trajtën e përfundimeve (konkluzioneve) si dhe disa rekomandime.

Kosova nën administrimin ndërkombëtar të udhëhequr dhe ndihmuar nga UNMIK ka themeluar, ngritur dhe konsoliduar pothuajse të gjitha komponentët kryesore të një shteti. Në këtë periudhë janë zhvilluar kapacitetet institucionale për formimin e shtetit të Kosovës duke filluar nga ndërtimi I institucioneve demokratike të njohura ndërkombëtarishte e të cilat me von kanë shërbyer si një bazë e mire për procesin e shtetndërtimit të Kosovës.

Republika e Kosovës me Kushtetutën e saj, ka përcaktuar ndarje të pushteteve dhe kontrole e balanca mes tyre. Mirëpo, në praktikë kjo tregon se akoma nuk është arritur niveli i respektimit të aktit me të lartë në vend (Kushtetutës).

Në Kosovë ka legjislacion të mjaftueshem sa i përket instrumenteve të kontrollit të administratës publike. Mirëpo, legjislacioni ka vakume të natyrës procedurale, ka paqartësi të dispozitave ligjore dhe në disa raste edhe përplasje mes ligjeve, prandaj për këtë arsye, është e nevojshme një reformë ligjore. Po kështu, një problem tjetër

ka të bëjë me moszbatimin e legjislacionit nga zyrtarët e lartë publikë, për vet faktin se ka pamjaftueshmëri të zbatimit të instrumenteve të kontrollit dhe llogaridhënies.

Funksioni i kontrollit parlamentar është atribut kushtetues i institucionit të parlamentit, që përcakton veprimtarinë politike të tij, që përfshin një numër të madh instrumentash, të cilat mund t'i përdorë parlamenti gjatë ushtrimit të funksionit të kontrollit, si: interpelancat, mocionet, pyetjet parlamentare, miratimi i buxhetit, debatet, komisionet hetimore, raportimet, etj. (Bufi, 2010). Ushtrimi dhe përdorimi i këtyre mekanizmave në mënyrë efikase nga ana e Kuvendit, e bën Qeverinë përgjegjëse për veprimet e saja dhe garantohet zbatimi efikas i politikave si dhe i sundimit të ligjit. Kuvendi, në mandatin e tij, ka bazë kushtetuese për mbikëqyrje të punës së Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat kanë detyrim t'i raportojnë atij.

Kuvendi nuk ka arritur mjaftueshëm të ushtrojë funksionin mbikëqyrës ndaj administratës publike. Kjo për arsye të mungesës së përvojës parlamentare, koalicionit në mes dy partive më të mëdha, një opozitë e cila ishte e pafuqishme por dhe i mungoi vullneti politik. Në tërësi, mund të themi se Kuvendit të Kosovës i mungoi vullneti politik për mbikëqyrje dhe kontroll të Qeverisë dhe Agjensive të pavarura përmes interpelancave parlamentare për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme, që janë në kompetencën e punës së Qeverisë në përgjithësi, apo të një ministrie në veçanti.

Vullneti politik i Kuvendit mungoi edhe për ngritjen e komisioneve hetimore në pesë legjislatura. Mosngritja e komisioneve hetimore ishte pengesë për zbardhjen e shumë aferave korruptive, shpërdorimin e detyrës zyrtare dhe skandalet e përfolura në publik për administratën publike. Ligji Nr. 03/L-176 për hetime parlamentare, në nenin 4 përcakton se Kuvendi, detyrimisht në seancë plenare themelon Komisionin për çështjen e kërkuar, në rastet kur kërkesa për themelimin e Komisionit parashtrohet nga një e treta e deputetëve. Në rastet e iniciativës nga një Komision i përhershëm parlamentar ose grup deputetësh që përbëjnë më pak se një të tretën e anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi mund të vendosë me shumicë të thjeshtë të votave për ngritjen e Komisionit. Kjo dispozitë ligjore e bëri të pamundur ngritjen e

komisioneve hetimore, sepse nuk kishte vullnet politik. Në bazë të hulumtimit rezulton se është e nevojshme që, ky ligj për hetimin parlamentar të ndryshohet dhe të plotësohet, ku si kriter të përcaktohet se, në rastet kur kërkesa për themelimin e Komisionit parashtrohet nga një e pesta e deputetëve, Kuvendi detyrimisht në seancë plenare duhet të themelojë Komisionin për çështjen e kërkuar.

Në të gjitha legjislaturat, deputetët nuk i përdorën instrumentet e kontrollit parlamentar në nivelin e kënaqshëm, dhe votuan në dy raste mocion të votëbesimit të Qeverisë dhe shkarkimin e saj, si dhe një mocion për shpërndarjen e Kuvendit dhe 24 interpelanca.

Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore, çdo deputet i Kuvendit ka të drejtë për të parashtruar pyetje parlamentare, për përgjigje me gojë apo me shkrim të një anëtari të Qeverisë ose Kryeministrit, në kuadër të kompetencave të tyre. Në tre legjislatura pas pavarësisë, deputetët parashtruan 2,083 pyetje parlamentare, zhvilluan 65 debate parlamentare dhe 69 mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve. Këtë të drejtë e realizuan shumë deputetë duke parashtruar pyetje, ku vetëm gjatë periudhës janar 2011-dhjetor 2015, deputetët e Kuvendit parashtruan 771 pyetje për Qeverinë për përgjigje me gojë, nga të cilat 443 pyetje kanë marrë përgjigje nga Kryeministri ose nga ministrat përkatës. Ndërsa, 328 pyetje parlamentare kanë mbetur pa përgjigje për shkak të mosprezencës së ministrave dhe ato pyetje janë publikuar në buletin e Kuvendit. Në legjislaturat e fundit ka pasur rënie të interesimit të deputetëve për parashtrimin e pyetjeve parlamentare drejtuar ministrave apo Kryeministrit. Një prej arsyeve ishte mos përgjigja nga kabineti qeveritar për pyetjet e tyre.

Siç doli nga hulumtimi, me përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar si: Interpelancat, Mocionin e votëbesimit të Qeverisë dhe shkarkimin e saj, si dhe me ngritjen e komisioneve hetimore, vetëm 31.8% e deputetëve janë të kënaqur. Ndërsa, 54.5% e deputetëve janë shprehur se janë të pakënaqur me përdorimin e instrumenteve të kontrollit parlamentar, si dhe 9.1% e deputetëve deklarojnë se nuk janë as të kënaqur, as të pakënaqur. Gjithashtu, 66.7 % e deputetëve të Kuvendit të Kosovës pohojnë se mosngritja e komisioneve hetimore ishte pengues i zbardhjes së

shumë aferave korruptive, shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe skandaleve të përfolura në publik për administratën publike.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nevojë të fuqizohet për të ushtruar mandatin e tij kushtetues për mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat kanë detyrim t'i raportojnë Kuvendit. Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë llogari dhe të përcaktojë përgjegjësi për ato institucione që nuk përmbushin obligimet e tyre. Meqenëse Kuvendi i Kosovës funksionon në bazë të rregullores së punës dhe nuk parashikohet detyrimi për Kryeministrin dhe ministrin që të përgjigjen në pyetjet parlamentare, atëherë del si nevojë që të miratohet një ligj për punën e Kuvendit të Kosovës. Në dispozitat e këtij ligji, duhet të parashikohet detyrimi për Kryeministrin dhe ministrat që të përgjigjen në pyetjet parlamentare, ndërsa për Interpelancën të mundësohet që kjo të kërkohej nga një deputet, një kryetar grupi parlamentar ose 3 deputetë. Miratimi i këtij ligji do të ndikojë në përmirësimin e kapaciteteve, për një efikasitet më të madh në mbikëqyrjen e Qeverisë, si dhe të Insitucioneve dhe Agjensive të Pavarura, të cilat kanë detyrim t'i raportojnë Kuvendit.

Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore, procedura e kërimit dhe përdorimit të interpelancës parlamentare ka dallime në shtete të ndryshme (të cilat janë marrë si raste studimi në këtë punim), në kriterin e numrit të deputetëve që mund të propozojnë interpelancë, e cila lidhet me punën e Qeverisë ose të një ministrie. Në Republikën e Kosovës, kërkesë për interpelancë për të shqyrtuar një çështje që lidhet me punën e Qeverisë mund të parashtrijë një grup parlamentar ose gjashtë a më shumë deputetë. Kurse në Maqedoni, interpelancë mund të paraqesin së paku pesë deputetë, në Malit të Zi së paku 27 deputetë, në Serbi të paktën 50 deputetë. Në Shqipëri kërkesa për interpelancë mund të bëhet nga çdo deputet ose grup deputetësh. Mundësia për kërkesë të interpelancës si instrument kontrolli, është shumë më e favorshme në Shqipëri sesa në shtete të tjera që janë marrë si raste studimore, kjo sepse ka mundësi që kërkesa të bëhet nga çdo deputet, kurse në raste urgjente mund të bëjë kërkesë kryetari i një grupi parlamentar ose 7 deputetë.

Sa i përket komisionit hetimor si mjet i kontrollit parlamentar, në shtetet që ishin rast studimi, si shteti më favorizues për këtë qëllim është Maqedonia, pasi aty mund të paraqesin propozimin e tyre së paku 20 deputetë, e që dallon nga shtetet e tjera që kanë si kriter një numër më të madh deputetësh, nga 27-40 deputetë.

Kontrolli nga Kuvendi i Kosovës merr rëndësi për efekt të ushtrimit të funksioneve dhe promovimit të demokracisë parlamentare. Prandaj, roli i Kuvendit duhet të fuqizohet për monitorimin e zbatimit të ligjeve, për të arritur një qeverisje të mirë dhe mirëadministrim në Kosovë.

Institucionet janë të obliguara që punën dhe funksionet e tyre t'i ushtrojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, si dhe të bëjnë ushtrimin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes administrative të organeve vartëse. Qeveria, më qëllim të përmirësimit të procedurave administrative dhe modernizimin e shërbimeve publike-administrative, është e përqendruar në zbatimin e mekanizmave për kontrollin e punës së administratës shtetërore në bazë të legjislacionit në fuqi. Mirëpo ligji për administratën shtetërore ka paqartësi si në aspektin e statusit juridik të trupave të ndryshëm administrativë, ashtu edhe në aspektin e kriterëve funksionale dhe organizative, në të cilat bazohet krijimi i trupave administrativë. Shumë organe qendrore të administratës shtetërore janë themeluar të funksionojnë si agjenci ekzekutive. Por, nëse shikohet natyra e punës së tyre, ato në të vertetë nuk luajnë rolin e institucioneve ekzekutive, dhe nuk kanë dallime nga departamentet politike përbërës të strukturës së ministrive. Në anën tjetër, sistemi i mbikëqyrjes së punës të organeve qendrore të administratës nga ana e ministrive nën vartësinë e të cilave janë ato, është shumë i dobët. Kjo për shkak të kapaciteteve të dobëta mbikëqyrëse që kanë institucionet, si dhe numrit të madh të agjencive nën vartësinë e Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive. Në Kosovë, janë krijuar nëntë agjenci, ku numri i të punësuarve është nën dhjetë, dhe ku ka edhe agjenci me vetëm katër persona të punësuar. Gjithashtu, shumë institucione dhe agjenci nuk e kanë të përcaktuar qartë kontrollin, mbikëqyrjen dhe raportimin e tyre. Për këtë arsye, është nevojshme të bëhet një riorganizim i tyre dhe të menjahet duplikimi i institucioneve/agjencive, sepse me krijimin e një numri të madh të

institucioneve/agjencive dhe organeve rregullatore, është bërë vetem shpërndarje e përgjegjësive, por mungon rezultati i tyre. Prandaj, del si domosdoshmëri të miratohet ligji për organizimin e administratës publike.

Në Kosovë, reforma e administratës publike vazhdon tashmë për vite të tëra, por pa arritur të krijohet një administratë moderne dhe profesionale. Problem i theksuar mbetet partitizimi i administratës publike, që njëherësh ka qenë edhe vërejtje në të gjitha raportet ndërkombëtare për Kosovën. Realizimi i reformës së administratës publike është sfidë për Kosovën, por është domosdoshmëri që, për të arritur këtë qëllim, nevojitet edhe reformimi i kornizës ligjore dhe refomes institucionale. Administrata publike në Republikën e Kosovës është në një proces të reformave të thella, në pajtim me kërkesat për një administratë moderne, efikase dhe profesionale.

Në Kosovë kontrolli i administratës publike nuk është në nivelin e duhur, sidomos tek ato institucione të administratës publike të cilat themelohen nga Kuvendi i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, si institucion i pavarur, shqyrton vetëm mbrojtjen e të drejtave të nëpunësve civilë, por jo edhe të nëpunësve të tjerë në administratën publike (si: shëndetësi, arsim etj). Kosova, edhe pse ka arritur të garantojë në legjislacionin e saj për shërbimin civil, parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, zbatimi i tyre nganjëherë përballet me vështirësi, veçanërisht sa i përket çështjes së pavarësisë së shërbimit civil. Legjislacioni aktual i Kosovës për shërbimin civil nuk lejon mjaftueshëm rekrutimin dhe promovimin e nëpunësve civilë në pozitë më të larta, në atë mënyrë që, në masë të madhe të zvogëlohet mundësia e ndikimit politik. Në tërësi, institucionet qendrore dhe lokale nuk zbatojnë në praktikë parimet në rastin e pranimit dhe avansimit në shërbimin civil të Kosovës, edhe pse ato janë të parashikuara në legjislacion. Kjo sepse ka ndërhyrje të ndryshme nga jashtë, të cilat ndikojnë në cilësinë e shërbimit civil.

Disa institucione dhe agjensi të pavarura të Kuvendit apo organe qendrore të Qeverisë nuk e aplikojnë ligjin për shërbimin civil në tërësinë e institucionit. Në

disa raste, drejtorët e përgjithshëm të këtyre institucioneve/agjensive bashkë me një pjesë të nëpunësve, nuk i nënshtrohen Ligjit për Shërbimin Civil. Në përgjithësi, në institucione dhe agjensi të pavarura të Kuvendit, por edhe agjensi të Qeverisë, vërehet një tendencë për moszbatim të Ligjit për Shërbimin Civil. Për këtë arsye, është e nevojshme të miratohet ligji i ri për shërbimin civil, të ndryshohet ligji për pagat nëpunësve civil, dhe ligji për administratën shtetërore, në mënyrë që të këtë një pavarësi më të madhe në rekrutimin e personelit dhe mundësi për rregullimin e pagave, si dhe respektimin e parimeve bazë mbi të cilat organizohet dhe funksionon administrata publike.

Institucionet qendrore dhe lokale nuk i zbatojnë të gjitha vendimet e KPMSSHCK-së, ku vlen të theksohet se Gjykata Kushtetuese ka vendosur një standard të ri dhe ka dhënë një kontribut të çmuar, kur ka vendosur se vendimet e Bordit të Pavarur Mbikëqyrës janë të ekzekutueshme, si kur janë në të holla ashtu edhe kur kanë të bëjnë me kërkesat për kthim në punë dhe të tjera të ngjashme me to. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës duhet të fuqizohet dhe të zbatohen vendimet e tij.

Kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike paraqitet kur gjykata shqyrton ankimet kundër akteve administrative (kontrolli indirekt (i tërthortë) i ligjshmërisë së akteve administrative) si dhe kontrolli në formën e realizimit të përgjegjësisë penale apo civile ndaj individëve (nëpunës civilë apo autoritete publike) për mospërmbushjen e detyrimeve me karakter juridiko-administrativ, dhe kontrolli nga Gjykata Kushtetuese (Dobjani, 2004).

Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Me kërkesën e Komisionit Evropian, Kuvendi i Kosovës amendoi Kushtetutën për themelimin e Gjykatës Speciale, e cila do të fillojë funksionimin e saj së shpejti.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Po kështu, i garantohet çdo personi, e drejta të përdorë mjetet juridike

kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij, në mënyrën e përcaktuar me ligj (neni 24,31,32).

Në Kosovë, që nga hyrja në fuqi e ligjit të ri për gjykatat në vitin 2013, konfliktet administrative janë kompetencë e Departamentit për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila ka juridiksion në gjithë territorin e Kosovës. Në kuadër të këtij Departamenti vepron edhe Divizioni Fiskal, i cili është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim të ardhur nga Departamenti i Ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi (Ligji Nr.04/L-102, neni 81.B). Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë departamente për çështje administrative të cilat vendosin si instanca/shkallë më të larta për konfliktet administrative. Mirëpo, për shkak të ngarkesës së punës, numrit të madh të lëndëve dhe numrit të vogël të gjyqtarëve që merren me çështje administrative, numri i rasteve administrative të pazgjidhura sa vjen e rritet. Për këtë arsye kemi realizuar një hulumtim për të parë nëse është e nevojshme të krijohet Gjykata Administrative. Në bazë të hulumtimit të bërë dhe të dhënave empirike, rezulton se në Kosovë është e nevojshme që të themelohet Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme.

Gjykata Administrative do të jetë një garantues për një proces të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, për mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike. Kontrolli gjyqësor nga Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme do të mundësonte kontrollin gjyqësor të ligjshmërisë së punës dhe veprimtarisë së administratës publike, do të ndikonte në rritjen e cilësisë së administrimit dhe të qeverisjes së mirë, si dhe në rritjen e besimit të qytetarëve tek institucionet. Po kështu, fuqizimi i mekanizmave aktualë të kontrollit të administratës publike dhe themelimi i Gjykatës Administrative, do të krijonte një standard të caktuar të sjelljes së administratës publike, si një faktor për të krijuar një shtet të së drejtës, qeverisje të mirë në Kosovë, me institucione funksionale, shoqëri demokratike dhe integrim në Bashkimin Evropian.

Kontrulli kushtetues i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese është forma më e mirë për të garantuar kushtetutshmërinë funksionale të organeve shtetërore, me qëllimin e vetëm për të mos i lënë vend arbitraritetit dhe anarkisë, me pasoja të drejtpërdrejta tek individët dhe tek të drejtat e liritë e tyre, si dhe tek niveli i demokracisë në vend. Prej vitit 2009 deri në vitin 2015, në Gjykatën Kushtetuese janë parashtruar kërkesa nga personat fizikë dhe juridikë për vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të gjykatave dhe institucioneve të tjera, për pretendime të individëve që lidhen me shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra, Gjykata Kushtetuese ka bërë vlerësimin e 1094 vendimeve, prej të cilave 909 vendime të gjykatave të rregullta të cilat kontesoheshin për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, ndërsa 185 kërkesa për vlerësimin kushtetues të vendimeve të institucioneve shtetërore apo të institucioneve të tjera publike, vendime që kontestoheshin për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore si kategori kushtetuese. Prandaj, çdo vit po rritet besimi i qytetarëve të Kosovës të Gjykata Kushtetuese, në nxjerrjen e vendimeve objektive dhe të paanshme. Tek disa institucione ndodh e kundërta, pasi vendimet e Gjykatës Kushtetuese në disa raste janë vlerësuar si ndërhyrje në kompetencat e gjykatave të rregullta, kurse disa drejtues të institucioneve të tjera i vlerësuan disa vendime të Gjykatës Kushtetuese më shumë si vendime politike se sa gjyqësore.

Ajo që vlen të theksohet për Gjykatën Kushtetuese në të gjitha vendet e marra në studim, është se ajo, në pajtim me kompetencat e saj kushtetuese, garanton pajtueshmërinë e të gjitha akteve juridike me Kushtetutën, si akti me fuqinë juridike më të lartë.

Avokati i Popullit si mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, si Mekanizëm Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, prej vitit 2001 deri në 2017, ka ndikuar në ngritjen e vetdijësimit të qytetarëve dhe rritjen e

besimit të qytetarëve të ky institucion. Kjo duket edhe për vetë faktin se nga 2001 deri në 2008, qytetarët kanë paraqitur gjithsej 3836 kërkesa dhe ankesa pranë këtij institucioni. Ndërsa pas pavarësisë së Kosovës, nga 1 janari 2010 deri më 17 dhjetor 2017, Avokati i Popullit ka pranuar 14,090 ankesa nga personat fizikë dhe juridikë, ku prej tyre 7,441 ankesa janë shpallur të papranushme, kurse janë mbyllur 4,487 raste. Raste të mbyllura, të zgjidhura pozitivisht në pajtim me kërkesën e ankuesit janë 2393 raste, që do të thotë se Avokati i Popullit ka rivendosur të drejtën e shkelur individëve. Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga Avokati i Popullit ishin: gjykatat, ministrinë, komunat, prokuroritë shtetërore, policia dhe institucione të tjera. Mosrespektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, përkatësisht shkelja e tyre, është pasojë e moszbatimit të ligjit nga autoritetet publike që janë të autorizuar ligjërisht për zbatimin e tij, por në disa raste është edhe si rezultat i mosnxjerrjes në kohë të akteve nënligjore për zbatimin e ligjit, apo dhe të vendimeve administrative. Prandaj, është shqetësuese rritja e numrit të ankesave nga qytetarët që pretendojnë se ju janë shkelur të drejtat nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të institucioneve qendrore dhe atyre lokale. Por megjithatë, rritja e besimit të qytetarëve te Avokati i Popullit është shumë pozitive. Avokati i Popullit në të gjitha rastet e konstatuara të shkeljeve deri tani ka ndërmarrë veprime ligjore ndaj autoriteteve publike, duke rekomanduar evitimin e shkeljeve të të drejtave. Në të gjitha rastet, kur ka vërejtur se një normë ligjore shkel të drejtat dhe liritë e njeriut, ai i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë plotësimin dhe ndryshimin e ligjit përkatës. Në disa raste, bazuar në kompetencat kushtetuese të Avokatit të Popullit, ky institucion ka parashtruar në Gjykatën Kushtetuese kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve të ndryshme, apo edhe të çështjeve të ndryshme ligjore.

Rekomandimet dhe masat e propozuara nga Avokati i Popullit për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore, duhet të jenë të detyrueshme për administratën publike. Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë përgjegjësi dhe llogari nga institucionet vartëse, në rastet kur Avokati i Popullit, në raportin e dorëzuar Kuvendit, raporton për mos

përmbushje të rekomandimeve nga institucioni për të gjitha rastet e ngritura për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në Kosovë, për të pasur një performancë të mirë, duhet që mekanizmat e kontrollit të administratës publike të kenë një legjislacion në pajtim me standartet e BE-së, si dhe me standartet dhe praktikat e mira.

Auditori i Përgjithshëm është i pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative dhe nuk i nënshtrohet urdhrat ose ndikimit nga cilido person apo institucion tjetër. Auditorit të Përgjithshëm nuk i garantohet imuniteti nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësisë të tij. Konsideroj se Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i garantohet ky imunitet, ashtu sikurse Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe Avokatit të Popullit, për shkak të rëndësisë së Auditorit të Përgjithshëm në mirë administrimin financiar, mbrojtjen dhe përdorimin efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike. Për këtë qëllim, duhet të amendohet Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, duke garantuar imunitetin e tij, për arsye se Zyra Kombëtare e Auditimit mund të kontribuojë në një menaxhim më të mirë të fondeve publike nga administrata publike, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies se si po shpenzohen paratë e taksapaguesve. Po kështu, në ligj duhet të parashikohet edhe kompetenca shtesë për Zyrën Kombëtare të Auditimit që të auditojë edhe financat e partive politike. Kosova duhet t'i japë prioritet mirëmenaxhimit të fondeve publike, për të përmbushur standardet e BE-së. Media mund të ndikojë pozitivisht, si një gardian i së vërtetës dhe luftës pa kompromis, kundër keqpërdorimeve, abuzimeve, vjedhjeve, ndikimeve politike të padrejta, nepotizmit në administratën publike. Shoqëria civile dhe mediat duhet të luajnë rolin që kanë në një shoqëri demokratike e që është edhe obligim i tyre ligjor, për çdo keqpërdorim apo keqmenaxhim, nepotizëm etj., në administratën publike, dhe që duhet të pasqyrohet sa më saktë dhe korrekt, pa anësi politike apo partiake, duke u bazuar në parimin e së vërtetës për çdo gjë dhe në të mirë të opinionit publik. Mediat dhe shoqëria civile mund ta detyrojnë një qeveri të jetë më transparente dhe

e përgjegjshme. Kosova ka nevojë të ndërtojë një administratë publike profesionale, të lirë nga ndërhyrjet politike dhe ky duhet të jetë prioritet i lartë politik.

Në Kosovë për vet faktin se ka ende dukuri negative në administratën publike, kjo flet për pamjaftueshmëri të zbatimit të instrumenteve të kontrollit dhe llogaridhënies. Në Kosovë janë krijuar shumë mekanizma për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit e shpërdorimit të parasë publike brenda institucioneve shtetërore. Krijimi i shumë institucioneve për t'i luftuar këto fenomene negative në administratën publike vetëm ka shpërndarë përgjegjësinë dhe llogaridhënien, por deri më tani nuk ka treguar ndonjë efekt të prekshëm e konkret. Problemi qëndron jo vetëm te ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave të ligjeve, por në bashkërendimin, koordinimin efikas të veprimeve institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe veprave të tjera, të cilat lidhen me ushtrimin e detyrës zyrtare, ku rolin kryesor duhet ta këtë gjyqësori. Joefikasiteti në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve korruptive, shpërdorimit të funksionit zyrtar dhe keqmenaxhimit të fondeve publike, mbeten çështje të vullnetit politik dhe institucioneve të dobëta të kontrollit. Pra, Kosova nuk vuan nga mungesa e legjislacionit, por nga moszbatimi i ligjeve në praktikë ose përdorimi i standardeve të dyfishta dhe keq interpretimi i qëllimshëm. *Së pari*, mos koordinimi ndër-institucional në luftimin e korrupsionit, e vështirëson funksionimin e institucioneve që luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin, në rastin konkret edhe në parandalimin e konfliktit të interesit. Ky moskoordinim ndikon në rënien e mëtejshme në shkallën e besueshmërisë ndaj Agjensisë Kundër Korrupsionit. *Së dyti*, moskontrolli i plotë i deklarimeve të pasurisë, pasi nuk hetohet pasuria jashtë vendit e zyrtarëve të lartë dhe mundësia që pasurinë e kanë vënë në emër të familjarëve të tyre.

Së treti, nuk bëhen kalkulime në mes të hyrave të zyrtarit të lartë dhe pasurisë që ka në dispozicion. E gjithë paketa ligjore duhet të rishikohet pasi që deri më tani, deklarimi i pasurisë nuk ka ofruar rezultate pozitive. Ligji për deklarimin e pasurisë dhe ligji për konfliktin e interesit duhet të harmonizohen mes tyre. Mangësitë në këto ligje janë të shumta, si: mosdeklarimi i prejardhjes së pasurisë, pamundësia e qasjes në institucionet bankare (AKK nuk ka të drejtë qasjeje), mungesa e

standardeve për caktimin e vlerës (pronësia), mosdeklarimi i pasurisë jashtë vendit etj. Për këtë problematike është e nevojshme edhe miratimi i ligjit të quajtur ligji anti mafia.

Në Kosovë me këtë shkallë të lartë të korrupsionit, vullneti politik është përcaktues për luftimin e këtij fenomeni, sepse paketa e ligjeve antikorrupsion ofron një bazë solide ligjore për të pasur progres në këtë drejtim. Kushtëzimet e BE-së dhe organizatave ndërkombëtare financiare (BB dhe FMN) për përmbushjen e standarteve, do të kenë ndikim pozitiv në uljen e shkallës së korrupsionit. Kosova vuri në funksion prokurimin elektronik, i cili padyshim do të ketë efekte pozitive për një administrim më të pastër.

Në Kosovë, për sigurimin e një qeverisje të mirë, duhet të merren këto masa: të ketë sundim të ligjit, ndëshkim të merituar të të korruptuarve, rritje të transparencës dhe llogaridhënies, punësim të nëpunësve publikë në bazë të meritave e jo në bazë të nepotizimit dhe militanizmit partiak, dhe etikë në qeverisje etj. Forcimi i mekanizmave të kontrollit të administratës publike, rritja e vullnetit politik dhe zhvillimi i kulturës së qeverisjes dhe administrimit të mirë, për një respektim sa më të mirë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbeten primare për reformimin e administratës publike.

Në Kosovë është e nevojshme të formohet një Këshill për Etikën në administratën publike, dhe anëtarët e Këshillit duhet të kenë mandat për vlerësimin e respektimit apo shkeljes së rregullave të etikës.

Kontrolli i administratës publike është faktor kryesor për qeverisje të mirë në Kosovë. Prandaj, Kosova ka nevojë për një reformë kushtetuese–ligjore, reformë institucionale si dhe reformë politike, që do të ndikojnë për një qeverisje të mirë në Kosovë.

Rekomandimet

Gjatë hulumtimit dhe analizës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, hulumtimit empirik sistematik dhe qasjes krahasimore lidhur me këtë temë, janë nxjerrë dy lloje rekomandimesh për Kosovën: a) Reformë ligjore dhe institucionale dhe b)

përmirësimi praktik i punës së zbatueshmërisë së legjislacionit. Në lidhje me këto rekomandime përmendim:

- Të amendamentohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ku neni 135 të ndryshohet dhe të plotësohet, duke parashikuar se rekomandimet dhe masat e propozuara nga Avokati i Popullit për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore, duhet të jenë të detyrueshme për administratën publike.
- Të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji Nr. 03/L-199 “Për Gjykatat”, ku në nenin 4 të parashikohet krijimi i Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Administrative Supreme. Po ashtu, të shtohet një dispozitë ligjore, ku të parashikohet se gjykata administrative vendos në konfliktet administrative sipas padive, kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj. Të gjitha çështjet në gjykatën administrative duhet të gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, si dhe të shtohen dispozita ligjore, ku të përcaktohen kompetencat e Gjykatës Administrative, si dhe të Gjykatës Administrative Supreme me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës.
- Të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji Nr. 05/L-055 “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, ku të parashikohet se Auditori i Përgjithshëm gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet apo vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësisë të Auditorit të Përgjithshëm. Në nenin 18 të shtohet një paragraf për auditimin e financave të partive politike, si dhe një dispozitë ligjore për kompetenca shtesë për një afat të kufizuar kohor për Zyrën Kombëtare të Auditimit, që të parashikojë se Auditori i Përgjithshëm do të kryejë auditimin e ish-Fondit të Qeverisë së Kosovës (ish-Fondi i Lidhjes Demokratike, ish-Fondi në kuadër të Këshillit për Financim dhe ish-Fondi ‘Vendlindja Thërret’).
- Ligji 2010/03-L-176 “Për Hetimin Parlamentar” të ndryshohet dhe plotësohet neni 4, në kuptimin që ngritja e një komisioni hetimor të bëhet me më pak deputetë nga një e pesta (1/5) e deputetëve, si dhe të bëhet plotësimi në nenin 23, ku nëse evidentohen shkelje, nëse gjatë hetimit gjenden materiale, dëshmi

dhe ekspertiza që kanë të bëjnë me vepra penale, raporti përfundimtar t'i dërgohet organeve përgjegjëse, në këtë rast Prokurorisë së Shtetit.

- Të kalohet nga Rregullorja e punës së Kuvendit në ligj. Të miratohet ligji i punës për Kuvendin e Republikës së Kosovës që përcakton organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të organeve, të trupave të punës së tij, të drejtat dhe detyrat e deputetëve. Në dispozitat e tij të parashikohet se kryeministri dhe ministri kanë detyrim për t'u përgjigjur në pyetjet parlamentare. Kuvendi duhet t'i kërkojë llogari Kryeministrit dhe kabinetit qeveritar, kur hezitojnë apo injorojnë të përgjigjen në seancën e pyetjeve parlamentare të deputetëve. Kërkesa për Interpelancë duhet të bëhet vetëm nga një ose 3 deputetë, si dhe kryetari i një grupi parlamentar. Të përcaktohet me dispozita ligjore raportimi për secilin Institucion/Agjensi të Pavarur në kuadër të Kuvendit, në seancë plenare apo përmes komisioneve funksionale të Kuvendit. Të përcaktohet se, nëse nuk miratohet raporti, anëtarët e bordit/Këshillit apo drejtori do ta vazhdojnë apo e përfundojnë mandatin.
- Të miratohet ligji për organizimin e administratës publike që rregullon themelimin dhe funksionimin e Institucioneve dhe Agjensive të Pavarura. Më dispozitat e tij të përcaktohet qartë mbikëqyrja apo kontrolli mbi performancën e institucioneve dhe agjensive që funksionojnë në kuadër të Kuvendit dhe Qeverisë, si dhe të raportimit të tyre. Duhet të bëhet një riorganizim i tyre, ku të përcaktohet mënjanimi i duplikimit të institucioneve/agjencive, bashkimi i atyre trupave/organeve të cilat kanë ngjashmëri të veprimtarisë së punës, ndërsa agjensitë në kuadër të Qeverisë, të kthehen në departamente të ministrive përkatëse.
- Të miratohet një ligj për inspektoriatet, i cili të rregullojë në përgjithësi procedurat e inspektimit për të gjithë inspektoriatet që funksionojnë në Kosovë.
- Kuvendi i Kosovës duhet të përdorë të gjitha mekanizmat mbikëqyrës ndaj Qeverisë dhe të ushtrojë mandatin e tij kushtetues, pra të rrisë efikasitetin në funksionin e tij të mbikëqyrjes. Kuvendi i Kosovës duhet të luajë një rol të

rëndësishëm kontrolli gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe të promovojë demokracinë parlamentare.

- Të zbatohen të gjitha rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit në institucionet publike, dhe në rast të moszbatimit të rekomandimeve, Kuvendi i Kosovës të kërkojë llogari dhe përgjegjësi ndaj Qeverisë.
- Gjykatat duhet të respektojnë afatet ligjore për rastet që iniciohen nga Avokati i Popullit e që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.
- Në Kosovë, del si domosdoshmëri krijimi i një Këshilli të Lartë për Etikën në administratën publike, si dhe të përcaktohet përbërja dhe funksionet e tij. Këshilli duhet të bëjë vlerësimin e respektimit apo shkeljes së etikës dhe Kodit etik.
- Rekomandohet që hulumtuesit e ardhshëm të fokusohen më shumë në hulumtime shkencore në lidhje me instrumentet e kontrollit të administratës publike, si dhe ndikimin e kontrollit të administratës publike për një qeverisje të mirë.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

Literaturë

Burime Parësore:

A) Legjislacion ndërkombëtar dhe akte ndërkombëtare

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e miratuar Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor të vitit 1948,
2. Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Europian
3. Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore dhe raporti shpjegues, Botim i Këshillit të Evropës Strasbourg 1986
4. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore ndryshuar me Protokollin Nr. 11 shoqëruar nga Protokollet Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13
5. Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
6. Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966 hyrë në fuqi: 23 mars 1976Nr.31003-01924-00-2011 i Regj. Themeltar Nr.00-2011-2033 i Vendimit (461) i Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
http://kosovo.ohchr.org/repository/docs/Pakti_Nderkombetar_per_te_Drejtat_Ekonomie_Sociale_dhe_Kulturore.pdf
7. Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni, Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Europian, Strasbourg, më 12 dhjetor 2007 (GZ C 303, 14.12.2007,).
8. Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
9. Traktati i Bashkimit Europian Versioni i Konsoliduar https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lisbones_-Verzioni_i_Konsoliduar.pdf
10. Versioni i Konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian
11. Council of the European Union Outcome of Proceedings Enlargement and Stabilisation and Association Process 15356/15, ELARG 73 COWEB 150 Brussels, 15 December 2015 (OR. en) shih :
<http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15356-2015-INIT/en/pdf>

A) Kushtetuta

12. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (me amendamentet I-XXIV) Ky botim përfshinë tekstin e Kushtetutes të Republikës së Kosovës (të miratuar me 9 prill 2008) me Amendamentet I - XXII (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 25 dt. 7 shtator 2012) me Amendamentin XXIII (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7 dt. 26 mars 2013) dhe me Amendamentin XXIV (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20 dt. 5 gusht 2015).

13. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndryshuar me Ligjin Nr. 76/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare Viti: 2016 – Numri: 138
14. Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi Official Gazette of Montenegro 01/07 of 25 October 2007
15. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Numër 08-4642/1, 17 nëntor 1991 , Shkup shih :<https://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nsp>
16. Amendamenti XI pikat 1 dhe 2 I Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 77, ndërsa me pikën 2 plotësohet paragrafi 2 i nenit 77 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.) Numër 07-3795/1 16 nëntor 2001
17. Kushtetuta e Republikës së Serbisë , Official Gazette of RS No 98/06. shih: <https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/74694/119555/F838981147/SRB74694%20Eng.pdf>
18. Constitution of the Republic of Slovenia Kushtetuta e Republikës të Sllovonisë Official Gazette of the Republic of Slovenia Nos. 33/91-I, 42/97, 66/2000, 24/03, 69/04, 68/06, and 47/13 <http://www.us-rs.si/media/constitution.-.2016.-.precisceni.dokument.dodan.70a.c.len.pdf>
19. Rregullore Nr. 2001/9 për Kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë

B) Ligjet :

20. Ligji Nr. 03/l-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, Nr. rendor i GZ 82. Data e publikimit në Gazetë Zyrtare (GZ) 21.10.2010
21. Ligji Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, Nr. rendor i GZ /20. Data e publikimit në Gazetë Zyrtare (GZ)21.06.2016
22. Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, Nr. i Gazetës Zyrtare 46, Data e publikimit në Gazetë Zyrtare 15.01.2009, Prishtinë
23. Ligji Nr. 03/l-199 për Gjykatat të Republikës së Kosovës, Nr. rendor i GZ 79 Data e publikimit në Gazetë Zyrtare (GZ). 24.08.2010
24. Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës se Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së auditimit të Kosovës. Nr. i Gazetës Zyrtare 32. Data e publikimit në Gazetë Zyrtare 15.06.2008, Prishtinë
25. Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës. Nr. i Gazetës Zyrtare 17 Data e publikimit në Gazetë Zyrtare 10.06.2016
26. Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit në Kosovë. Nr. i Gazetës Zyrtare 80. Data e publikimit në Gazetë Zyrtare 27 Gusht 2010 Prishtinë

27. Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit Nr. i Gazetës Zyrtare 16. Data e publikimit:26.06.2015
28. Ligji Nr. 03/l-176 për hetim parlamentar,Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / nr. 74 / 20 Korrik 2010
29. Ligji Nr. 03/L- 159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Shpallur me dekretin Nr. DL-006-2010, datë 19.01.2010, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / nr. 65 / 05 Shkurt 2010
30. Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 16 / 14 Shtator 2011, Prishtinë
31. Ligji Nr. 04/L -228 për ndryshimi/n dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë
32. Ligji Nr. 03/l-202 për konfliktet administrative, Nr. rendor i GZ 82, Data e publikimit në Gazetë Zyrtare (GZ)21.10.2010
33. Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë,Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 27 / 03 Qershor 2008
34. Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 27 / 03 Qershor 2008
35. Ligji Nr. 03/l-225 për Prokurorin e Shtetit, Gazetë Zyrtare Nr. rendor83 Data e publikimit në Gazetë Zyrtare (GZ)29.10.2010
36. Ligji Nr. 05/L -034 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, Gazetë Zyrtare Nr. rendor 17, Data e publikimit:30.06.2015
37. Ligji Nr. 05/L -035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 30 qershor 2015, Prishtinë
38. Ligji Nr. 04/L-165 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 Nr. Gazeta Zyrtare: 36/2012 Data e publikimi:21.12.2012
39. Ligji Nr. 04/l-233 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014. Nr. Gazeta Zyrtare: 1 Data e publikimit:09.01.2014
40. Ligji Nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.Nr. Gazeta Zyrtare :1/2018, Data e publikimit 09.01.2018
41. Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. Gazeta Zyrtare:27/2008 Data e publikimit: 03.06.2008
42. Ligji Nr. 02/L-28 për procedurën administrative Republikës së Kosovës Nr. Gazeta Zyrtare: 8/2007 Data e publikimit:01.01.2007

43. Ligji Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale Nr. Gazeta Zyrtare: 28/2008 Data e publikimit:04.06.2008
44. Ligji Nr. 05/L -033 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr. Gazeta Zyrtare 17 Data e publikimit:30.06.2015
45. Ligji Nr.8485, datë 12.5.1999 Kodi i procedurës administrative të Shqipërisë
46. Ligj Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë
47. Ligj Nr. 8549, date 11.11.1999 Statusi Nepunësit civil në Shqipëri
48. Ligj Nr. 152/2013 për Nëpunësin civil në Shqipëri
49. Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Gazeta Zyrtare: 77/2010 Data e publikimit: 16.08.2010
50. Ligji nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës Nr. Gazetes Zyrtare:72/2010 Data e publikimit: 25.06.2010
51. Ligji Nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat Nr. 03/L-222 Nr. Gezates Zyrtare 13 Data e publikimit 30.05.2012
52. Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes Ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës Gazeta Zyrtare:25/ 2012 Data e publikimit: 07.09.2012
53. Ligji Nr. 04/L -273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërliohen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropain për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës
54. Ligj Nr. 49/2012 për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative (ndryshuar me ligjin nr. 100/2014)
55. Ligj Nr. 8577, datë 10.2.2000 “për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar
56. Ligji Nr.98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë
57. Ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000 për Avokatin e Popullit ndryshuar me ligjin nr. 9398 date 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 155/2014 ,date 27.11.2014
58. Ligj Nr. 154/2014 për organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit
59. Ligj për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë shih://www.sobranie.mk/ligji-per-kuvendin-e-rm-se.nspX
60. Ligji për procedure të përgjithshme administrative në Maqedoni Official Gazette of the Republic of Macedonia no. 38/2005 of May 26 2005
61. Ligji për Gjykatat në Maqedoni Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006 dhe 35/2008

62. Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Gjykata Neni 34-a, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006 dhe 35/2008
63. Ligji mbi konfliktin Administrativ (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 62 data 22 Maj 2006)
64. Ligji për Avokatin e Popullit të Maqedonisë Law on the Ombudsman ("Official Gazette of the Republic of Macedonia" no. 60/2003 and 114/2009).
65. Neni 31-b Dispozita të ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit. GZ. Nr.114/2009
66. Ligji Nr 07-2001/1 për Auditim të Shtetit të Maqedonisë Official Gazette of RM, no. 66, from 13 May 2010
67. Ligji për Auditimin e Shtetit të Maqedonisë , Official Gazette of the Republic of Macedonia" No. 65/97, 70/01, 31/03, 19/04, 70/06)
68. Ligji Nr. 01-332/2 i administratës shtetërore të Republikës së Malit të Zi
69. Ligji për Gjykatat në Mali të Zi (Official Gazette of the Republic of Montenegro, no. 5/2002)
70. Ligji për Gjykatat e Malit të Zi (Gazeta zyrtare e Republikës së Malit të Zi 5/2002 dhe 49/2004 dhe Gazeta zyrtare e Malit të 22/2008
71. Ligji për Gjykatën Kushtetuese në Mal të Zi, ligji është publikuar në Gazeten zyrtare e Malit të Zi , Nr. 64/2008 date 27 Tetor 2008
72. Ligji për administratën shtetërore të Malit të Zi
73. Law on the Protector of Human Rights and Freedoms of Montenegro
74. Law on State Audit Institution of the Republic of Montenegro’ ('Official Gazette of the Republic of Montenegro’, No. 28/04 of 29 April 2004, No. 27/06 of 27 April 2006, No. 78/06 of 22 December 2006, ‘Official Gazette of Montenegro’, No. 17/07 of 31 December 2007, 73/10 of 10 December 2010, 40/11 of 8 August 2011, No. 31/14 of 24 July 2014)
75. Law on the National Assembly of the Republic of Serbia (National Gazette of RS, No. 9/10)
76. Law on State Administration of Republic of Serbia Official Gazette of RS, no. 79/05, 101/07, 95/10 - correction and 99/14);
77. Law on Organisation of Courts of Serbia
78. Law on the Protector of Citizens The Law was published in the “Official Gazette |of RS”, no. 79/05 a54/07.
79. Law on State Audit Institution,The Law was published in the ‘‘Official Gazette of the Republic of Serbia’’, no. 101/2005, 54/2007 and 36/2010
80. Ligji për Avokatin e Popullit të Republikës së Sllovonisë

Ç) Kode:

81. Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare:19/2012
Data e publikimit:13.07/2012
82. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Nr. 04/L-123
83. Kodin e etikës të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës
84. Kodi i Mirësjellës për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës
85. Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Maj 2009
86. Kodi i Procedures Civile i Republikës së Shqipërisë (shtuar paragrafi i peste ne ligjin nr.38/2017 , 30.3.2017) Maj 2017 Tiranë

D) Rregulloret:

87. Rregullore Nr. 1999/1 UNMIK/Rreg/1999/1 me 25 Qershor 1999, Për autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë. Kjo rregullore konsiderohet të ketë hyrë në fuqi më 10 Qershor 1999, datë e miratimit të Rezolutës 1244 (1999) nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
88. Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 29 Prill 2010
89. Rregullore e Qeverisë Nr. 01/2007 për punën e Qeverisë Numri i aktit:RR01/2007 QRK Data e Publikimit.24.01.2007
90. Rregullore Nr. 09/2011, e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 15 / 12 Shtator 2011, Prishtinë
91. Rregullore e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
92. Rregullore e Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Miratuar më 23 nëntor 2010) (Ndryshuar më 8 korrik 2011) (Ndryshuar më 4 dhjetor 2012) (Ndryshuar më 17 qershor 2013) (Ndryshuar më 1 mars 2015)
93. Rregullore Nr. 01/2011 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit
94. Rregullore Nr. 2000/38 UNMIK mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, 30 qershor 2000
95. Rregullore Nr. 05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil Qeveria e Republikës së Kosovës
96. Rregullore Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave Rregullore Nr. 04/2011 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil
97. Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, Ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005, Ndryshuar me vendimin nr. 193, datë 7.7.2008, Ndryshuar me vendimin nr.21, datë

- 04.03.2010,Ndryshuar me vendimin nr. 41,datë 24.6.2010,Ndryshuar me vendimin nr. 88, datë 24.2.2011,Ndryshuar me vendimin nr. 41/2013(date 30.05.2013),Ndryshuar me vendimin nr. 95/2014 (datë 27.11.2014)
98. Rregullore Nr. 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë
99. Rregullore Nr. / 2007/15 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë 19 mars 2007
100. Rregullore e punës për Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës 2011
101. Rregullore e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit, më 21/12/2011 Prishtinë
102. Rregullore e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare, Nr. 91/2008
103. Rregullore e punës të parlamentit të Malit të Zi
104. Rregullat Procedurale të Institucionit të Auditimit të Shtetit të Malit të Zi Neni 4 dhe neni 5 ("Official Gazette of RoM", No. 50/07 as of August 17th , 2007)
105. Rules of Procedure of the National Assembly of Serbia
106. Legislative Committee of the National assembly of the Republic of Serbia the Rules of Procedure of the National Assembly of the Republic of Serbia has been harmonised with decisions of the Constitutional Court of the Republic of Serbia IU No. 61/01 of 20 February 2004 (Official Gazette of the Republic of Serbia, No. 16/04) and IU No. 312/94 of 22 April 2004 (Official Gazette of the Republic of Serbia, No. 54/04). 06 No. 02-1374/05 Belgrade, 28 June 2005.

DH) Udhëzim administrativ

107. Udhëzimi administrativ Nr. 2008/4 për ndryshimin e udhëzimit administrativë Nr. 2005/5 për zbatimin e përgjegjësive të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhjen me monitorimin dhe mbikëqyrjen e Komunave

E) Vendimet administrative dhe Gjyqësore

108. Aktgjykim rastin nr. K073/16 Parashtrues Avokati i Popullit Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerre nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, me 21 janar 2016
109. Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese Rasti nr. KI112/12 Parashtrues Adem Meta Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës se Qarkut ne Mitrovice, Ac. Nr. 61/12, të 13 shkurtit 2012

110. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Lënda Nr. KO 01/09, Qemajl Kurtishi Dhe Kuvendi Komunal i Prizreni, Prishtinë, date: 18 mars 2010 Ref. Nr. AGJ 07/10
111. Aktvendim për papranueshmëri në Rastin Nr. KI30/14 Parashtrues Zymrije Haxhimusa, Ekrem Abazi, Ferinaze Isufi, Avdullah Hoxha dhe Hyzri Delolli Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se njoftimit të Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës, Nr. 4278, të 29 gushtit 2013 Prishtinë, me 14 korrik 2014 Nr.ref.:RK674/14
112. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për heqje të kërkesës nga lista në Rastet KI58, KI66 dhe KI94/12 Prishtinë, 5 korrik 2013 Nr. Ref.VTK 466/13
113. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë VGJK 26/2006
114. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë VGJK 41/2007
115. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë VGJK 18/2003
116. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë Nr. 15, datë 15.04.2010 (V – 15/10)
117. Vendimi Nr. 3 të Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me datë 23.02.2016
118. Vendimi nr. 75 datë 23.11. 2017 të Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
119. Vendimi nr.79, datë 27.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
120. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Nr. 20, më datë 04.05.2007
121. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Nr. 29, më datë 27.06.2013
122. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nr. 84, më datë 30.12.2016
123. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Nr. 12, më datë 10.03.2016
124. Vendim Nr. 26, Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me datë 27.3.2017
125. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Nr. 65 datë 07.11.2016
126. Përmbledhje të vendimet më të spikatura të Gjykatës Kushtetuese shqiptare,
127. Vendimi nr. 3 Unifikues i Kolegjet të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, më 12.02.2008
128. Vendimi Unifikues Civil i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë Nr.1, Tiranë, më datë, 26.11.2010

129. Vendimi Unifikues i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë në Shqipëri Nr.449, më datë 18.10.2011, (referuar materialit përmbledhje të vendimeve të vitit 2011)
130. Vendimit Nr. 461 i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë 2011
131. Vendimi nr 16, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Datë 11.11. 2004
132. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Nr. 62 datë 23.09.2015 (V-62/15)
133. Vendimit i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë në Shqipëri Nr.449, më datë 18.10.2011
134. Vendimi i Gjykatës Komunale në Skenderaj Nr. 0242/2011), që ka hedhur poshte propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbardimin e vendimit sa i përket kthimit në vendin e punës dhe e ka aprovuar vetem propozimin për kompensimin e pagave.
135. Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane; shih : http://www.kas.de/wf/doc/kas_22457-1522-1-30.pdf?110411104408

Ë) Intervistat :

136. Krasniqi, Jakup. Ish Kryetar i Kuvendit në Republikën e Kosovës (2007-2014) në intervistën e realizuar nga autori i punimit me date 20.01. 2016
137. Tahiri, Edita. Ministre e shtetit për dialog me Serbinë dhe ish Ministre e Ministrisë së Administratës Publike në Republikën e Kosovës në intervistën e realizuar nga autori i punimit me date 23.01.2016
138. Hasani,Enver. Ish Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Profesor Universitar, Intervistë e realizaur nga autori i punimit me date 13.09.2015 Prishtinë
139. Jashari, Hilmi. Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës në intervistën e realizuar nga autori i punimit me date 20.01. 2016
140. Hasani, Isa. Zëvendës i Avokatit Popullit intervistë e realizuar nga autori i punimit më datë 5 mars 2014
141. Preteni, Hasan. Drejtori i Agjencisë Anti Korrupsion intervistë e realizuar nga autori i punimit 2016
142. Kelmendi, Salih. Ish drejtori i TVSH programi Satilitor dhe profesor Universitar intervistë e realizuar nga autori i punimit në vitin 2015

F) Trasnkripte të Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Kosovës të Republikës së Kosovës

143. Kuvendit Republikës së Kosovës Transkripti i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Kosovës të Republikës së Kosovës, të mbajtur me 2 Nëntor 2010
144. Kuvendi i Republikës së Kosovës Procesverbal i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur me 28 Mars 2013

145. Kuvendi i Kosovës Transkripti i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 10 Maj 2017
146. Kuvendi i Kosovës Transkripti i Mbledhjes se Jashtëzakonshme Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 7 Maj 2014
147. Kuvendi i Republikës së Kosovës Transkripti e Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës , e mbajtur më 18, 19, dhe 25 Korrik 2013
148. Kuvendi i Republikës së Kosovës Procesverbali i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 12 e 13 Korrik 2012, Mbledhja plenare e Kuvendit P- 71, Prishtinë, më 12 Korrik 2012, Interpelanca e ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35 % për importimin e çimentos nga Shqipëria
149. Kuvendi i Shqipërisë Kuvendi Komisioni për Ekonominë dhe Financat Procesverbal Raporti i performancës së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015 Tiranë, më 28.06.2016, ora 10:00 – 11: 44 Bujar Leskaj
150. Leskaj, Bujar. Gjetjet e KLSH-së për vitin 2015 analizuar mbi bazën e Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit ‘fjala e kryetarit drejtuar deputeteve http://www.klsh.org.al/web/fjala_kryetarit_2625.pdf

G) Raporte të Institucioneve të Kosovës dhe Institucioneve ndërkombëtare:

151. Agjencia Kundër Korrupsionit, Raport Vjetor 01 Janar– 31 Dhjetor 2007 nga Agjencia Kundër Korrupsionit Prishtinë, Mars 2008,
152. Agjencia Kundër Korrupsionit, Raport Vjetor 01 Janar– 31 Dhjetor 2008 nga Agjencia kundër Korrupsionit Prishtinë, mars 2009,
153. Agjencia Kundër Korrupsionit, Raport Vjetor 01 Janar– 31 Dhjetor 2009 nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Prishtinë, Mars 2010,
154. Agjencia Kundër Korrupsionit, Raport Vjetor 01 Janar– 31 Dhjetor 2010 nga Agjencia Kundër Korrupsionit, 2011, Prishtinë
155. Agjencia Kundër Korrupsionit, Raport Vjetor 01 Janar– 31 Dhjetor 2011 nga Agjencia kundër Korrupsionit, Mars Prishtinë, Mars 2012
156. Agjencia Kundër Korrupsionit , Raport Vjetor 01 Janar– 31 Dhjetor 2012 nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Prishtinë, Mars 2013,
157. Agjencia Kundër Korrupsionit Raport Vjetor 01 Janar – 31 Dhjetor 2013 nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Prishtinë, Mars 2014
158. Agjencia Kundër Korrupsionit Raport Vjetor 01 Janar – 31 Dhjetor 2014 nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Prishtinë, Mars 2015

159. Agjencia Kundër Korrupsionit, Raport Vjetor 01 Janar – 31 Dhjetor 2015 nga Agjencia Kundër Korrupsionit Prishtinë, Mars 2016
160. Agjencia Kundër Korrupsionit, Raport Vjetor 01 Janar – 31 Dhjetor 2016 nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Prishtinë, Mars 2017
161. Avokati i Popullit në Shqipëri, Raporti vjetore për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, Botimi i dytë, Tiranë 2003 shih:
<http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/AP.pdf>
162. Avokati i Popullit në Shqipëri, Raport vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2005, Tiranë 2006
163. Avokati i Popullit i Shqipërisë , Raport Vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2014 Tiranë, Shkurt 2015
164. Avokati i Popullit në Republikën e Maqedonisë shih :
<http://ombudsman.mk/SQ/p%C3%ABr%20avokatin%20e%20popullit/p%C3%ABr%20institucionin.aspx>
165. Avokati i Popullit Fjala e Avokatit të Popullit në Raportin Vjetor 2015 Nr. 15
